monumentet



DO NOT COPY

2/1981

DO NOT COPY

Kopertina e parë:

Shëtitorja e Apolonisë e shek. III p.e.sonë

Shëtitorja e Apolonisë e
shek. III p.e.sonë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

monumentet

DO NOT COPY

2 / 1981 (22)

REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi», Nr. 7

Formati 70 x 100/12

Stash 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ DHE MATERIALE

Faqe

Apollon BAÇE
Neritan CEKA

Shetitoret e periudhës qytetare ilire 5

Halil MYRTO

Hartë e monumenteve dhe gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit 55

Frederik STAMATI

Restaurimi dhe konservimi i epitafit të Lashovës 81

Shuaip MANE

Vështrim mbi veprat hidrike në Beratin mesjetar 85

Stilian ADHAMI

Shtjefën Gjeçovi një ndër pionierët e mbrojtjes dhe gjurmimit të monumenteve 91

Aleksandër MEKSI
Pirro THOMO

Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (përfundime) 99

Emin RIZA

Banesa dyfamiljare në qytet 115

Fabian MIRAJ

Mbishkrimet për ujësjellsin e Durrësit. 127

Pëllumb NURE

Palokalaja e Janjarit 131

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

Andromaqi GJERGJI

Emin Riza «Qyteti muze i Gjirokastrës» (monografi) 135

JETA SHKENCORE

Sesioni i IV shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës 141

Maketi «Historia e arkitekturës shqiptare (deri në v. 1912)». 146

Mbrojtje disertacionesh të shkallës së I-rë të kualifikimit 147

DO NOT COPY

TABLE DES MATIERES

ARTICLES

Page

Apollon BAÇE
Neritan CEKA

Les stoas de la periode urbaine illyrienne 5

Halil MYRTO

Carte des monuments de la région de Durrës 55

Frederik STAMATI

Restauration et conservation de l'épitaphe de Lashove 81

Shuaip MANE

Regard sur les ouvrages hydrauliques du Berat médieval 85

Stilian ADHAMI

Shtjefën Gjeçovi l'un des pioniers de la protection et de la recherche des monuments 91

Aleksandër MEKSI
Pirro THOMO

L'architecture Post-byzantine en Albanie 99

Emin RIZA

L'habitation urbaine pour deux familles 115

Fabian MIRAJ

Inscriptions sur l'aqueduc de Durrës 127

Pëllumb NURE

La forteresse de Janjar 131

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

Andromaqi GJERGJI

«La ville musée de Gjirokastër» (monographie). 135

LA VIE SCIENTIFIQUE

IVe session scientifique de l'institut des Monuments de Culture 141

La maquette de «L'histoire de l'architecture albanaise» (jusqu'en 1912). 146

Présentation de dissertations du Ier degré de qualification 147

DO NOT COPY

APOLLON BAÇE – NERITAN CEKA

SHETITORËT E PERIUDHËS QYTETARE ILIRE*)

DO NOT COPY

Deri më sot në vendin tonë njihen shtatë shetitore të shekujve IV-III p.e.s.: dy në Apolloni e Dimal dhe nga një në Nikae (Klosi i rrethit të Fierit), Bylis e Butrint.[1]) Gjetja e tyre dhe në qendra të tilla si Butrinti, Dimali dhe Nikaia, tregon se numri i shetitoreve ka qënë më i madh. Të tilla duhen pritur në Antigone, Amantie, Orik, Lis e qendra të tjera dhe jashtë çdo dyshimi në Dyrrah, ku dhe janë gjetur gjurmë, e në Foinike.

Shetitoret (gr. στοά, lat. porticus)[2]) kanë si element thelbësor galerinë e mbuluar, ku në kohë me diell të fortë ose shi, të dyja karakteristike për klimën tonë, shetitej, shkëmbeheshin mendimet zhvillonin mësimet e tyre shkollat e ndryshme dhe kryeheshin aktivitete të tjera të jetës qytetare.[3])

Rëndësia e shetitores për jetën e ngritur të qytetit sintetizohet qartë nga thënia e Ciceronit se «vlerën e tij e përcaktojnë theatri, gjimnazi, shetitorja dhe fortifikimi».[4]) Kuptohet pra qartë se prania e shetitores në qytetet e mësipërme është dëshmia materiale e jetës së tyre intelektuale. Nuk është e rastit që këto shetitore i përkasin pikërisht shekujve IV-III p.e.s. asaj kohe kur jeta qytetare në Iliri, falë zhvillimit ekonomik, njohu lulëzimin më të madh,

---

*) Rikonstruksionet nga A. Baçe, skicat nga A. Qyshka, fotot të autorëve.

1) Shetitoret e Apollonisë janë zbuluar prej L. Rejit i cili në dy artikuj serialë jep rezultatet e gërmimeve pjesore në njërën prej tyre, më të renë (L. Rey, **Fouilles de la Mission Française à Apollonie d'Illyrie (1925),** «Albania», Milano – Roma – Paris 1927, nr. 2, f. 11-23; L. Rey, **Fouilles de la Mission Française à Apollonie d'Illyrie (1926-1927),** Paris, 1928, nr. 3, f. 13-31).

Autori i gërmimit dhe botimit të shetitoreve të Dimalit është B. Dautaj: **Zbulimi i qytetit ilir Dimal,** «Studime historike» 2, 1965, **Qyteti ilir i Dimalit i parë në dritën e të dhënave arkeologjike,** «Iliria», 1972, II.

Për një shetitore në Nikae L. Papajani, **Disa monumente të arkitekturës në qytetin ilir në Klos,** «Monumentet» 11, f. 24.

Shetitorja e Bylisit preket shkarazi prej C. Praschnikerit **(Muzakhia und Malakastra),** «Jahreshefte des Österreichishen archologisches Institutes», Wien 1922, XXI-XXII, f. 80) që bazohet në një sondazh të kryer nga G. Veith.

Shetitorja e Butrintit u zbulua prej misionit italian por rezultatet e gërmimeve nuk u botuan, Përmbledhtas ajo trajtohet prej A. Baçes, (në A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, **Historia e arkitekturës shqiptare (deri në vitin 1912) maket),** Tiranë 1979, f. 100). Po këtu jepen përmbledhtas dhe shetitoret e tjera.

2. Për origjinën e emrit Hobein s. v. stoa, «Pauly-Wissowa Real-enzyclopädie der klassischen Altertumswissenschaft, zweite Reihe vol. IV, 7, Stuttgart, 1931). Kemi parapëlqyer trajtën e shqipëruar shetitore që i përgjigjet plotësisht funksionit, pasi me termin stoa kuptohen të tëra galeritë me kollona, nga të mirëfilltat e deri te depot e mallrave në skela, ndërsa me portik çdo kollonadë e mbuluar.

3. Vitruv **De architt.,** V. 9; Ch. Daremberg–E. Saglio, **s. v. porticus,** «Dictionnaire des Antiquités Grecques et Romains», vol. IV, f. 585.

4. Cic. **de rep.** III 44.

dhe trajtat më demokratike.

Ndonëse shetitoret e mësipërme i përmbahen parimeve të përgjithshme, në elementet e tyre arkitektonikë dhe trajtimin planimetrik, vërehen një sërë zgjidhjesh të veçanta, të cilat i dallojnë ato cilësisht nga shetitoret e tjera bashkëkohëse. Këto vlera, mungesa e një punimi sintetizues dhe disa mangësi e të meta në trajtimin e shetitoreve qenë shkaqet e shkrimit të këtij artikulli. Një shkak tjetër, dhe jo i dorës së dytë, por kryesor, është dhe domosdoshmëria e krijimit të pamjes së qartë të këtyre shetitoreve për kryerjen e ndërhyrjeve më të thella restauruese. Synimet e artikullit janë përkatësisht përshkrimi më i saktë dhe i plotë i shetitoreve ekzistuese, vendosja në kohë, rindërtimi grafik i gjendjes së tyre të parë, krahasimi me njera tjetrën dhe shetitoret e tjera bashkëkohëse, nxjerrja në pah e së përbashkëtës dhe të veçantës, e traditës dhe e së resë. Së fundi do mundohemi të përvijojmë, për aq sa është e mundur, disa nga elementet e pavarur dhe paraprijës të arkitekturës ilire, të cilët na ofrohen nga arkitektura e shetitoreve.

SHETITORET E APOLLONISË

Merita e zbulimit të shetitoreve të Apollonisë i takon arkeologut francez Leon Rej i cili dyshoi në rënien e terrenit në jugperëndim të lartësisë 104 një ndërtim monumental. Gërmimet u kryen me ndërprerje në dy fushata, në vitet 1925-1927 dhe 1931--1933. Rezultatet e gërmimeve të fushatës së parë u botuan në numrat 2 dhe 3 të revistës «Albania», ndërsa ecurinë e gërmimeve të tjera mund ta ndjekim nga dy planimetri të sjella prej tij lidhur me gërmimet në monumentin e Agonotetëve dhe Odeon dhe një shënim i shkurtër.[5])

L. Rej ndalet në përshkrimin dhe veçoritë e nikeve, kanalit kollonave, parapetit dhe kryesisht të shtatoreve, por lë pa prekur ose pa trajtuar elementët e tjerë. I bazuar në këto shqyrtime autori fillimisht mendon se ka të bëjë me një nymfe ose bibliotekë, por më tej ai e quan atë drejt portik.[6]) L. Rej e mendon monumentin njëkatësh, me dy rrugë kalimi, të mbuluar pjesërisht ose plotësisht me çati, me kollonadë jonike jashtë dhe me kollona tetëkëndëshe brenda.[7]) Një dëm, ndonse të pavetdijshëm, autori solli me largimin nga vendi të elementeve të rrëzuara pa kryer të paktën dokumentacionin e tyre, elementë që siç kuptohet nga dy fotografi të kantjerit, nuk kanë qenë të pakët.[8])

Sido që të jetë, me gjithë këto mangësi, disi të justifikueshme nga njohja e pakët e kësaj gjinie në këto vite, botimi i L. Rejit mbetet një botim serioz.

Përveç gërmimeve në vitet 1959-1961 në shetitoren e Apollonisë, të renë (II), u kryen përforcime dhe u ringritën blloqet e murit me nike, të mënjanuara ose dëmtuara nga presioni i dheut.[9])

SHETITORJA E PARË

Trajtimi planimetrik. Prej shetitores së parë, më të hershme, ruhet një pjesë e krahut jugor, stilobati i krahut lindor dhe një nike e këtij krahu. (Tab. II) Stilobati u zbulua gjatë gërmimeve prej L. Rejit i cili e mendoi mur mbajtës, por siç shihet nga planimetria ai vjen e puqet me një kënd të drejtë me krahun jugor. Përveç kësaj në fillim të traktit ndërmjetës që lidh krahun jugor me shetitoren e II, ndodhet një nike përmasat e së cilës janë pak më të mëdha edhe se niket e krahut jugor (fig. 1). Nikejo paralele dhe po aq larg nga stilobati sa dhe nike e krahut jugor, është ndërtuar prej të njëjtit materia me to, në të kundërt me niket e reja të këtij trakti, më të vogla dhe të punuara me një material tjetër. Si kuptohet nga këto gjurmë, shetitorja duket se kishte trajtën e shkronjës L dhe përvizonte sheshin qendro të qytetit nga lindja dhe jugu. Vazhdimi i stilobati paralel me rrugën kryesore të Apollonisë që vinte dhe mbaronte në këtë shesh, tregon se dhe sheshi nënshtrohej kërkesave të sistemit urbanistik ortogonal, hipodamik.[10])

5. Planimetritë në L. Rey, **vep. cit.** nr. 5, Paris 1935, **vep. cit.,** nr. 6, Paris 1939. Shënimi (L. Rey, **vep. cit.** nr. 5. shën. 1) ve në dukje se pastrimi i portikut u krye pas publikimit të numrit të tretë të revistës «Albania».

6. L. Rey, **vep cit.** nr. 2, f. 19; nr. 3, f. 31; nr. 5 shën. 1.

7. L. Rey, **vep. cit.** nr, 3, f. 14, 15.

8. L. Rey, **vep. cit.,** nr. 2 fig. Nr. 9, nr. 3, fig. 1, 2. Të tërë këta elemente së bashku me dheun e gërmuar gjenden në trajtën e një kodrine para tërë gjatësisë së shetitores.

9. Punimet u kryen nga Grupi i kulturës materiale të Institutit të Historisë nën drejtimin e K. Zhekut, por materialet e kësaj ndërhyrje kanë mbetur pa u botuar.

10. Për sistemin ortogonal të rrugëve të Apollonisë, B. Dautaj, **Një rrugë kryesore në Apolloni,** «Monumentet» 7-8, 55-67. Trajtimi i shesheve me një bosht simetrie siç kuptohet nga planimetritë e prura prej Lavedanit (P. Lavedan, **Histoire de l'urbanisme,** I, Paris, 1959) është karakteristik për qytetet që ndjekin sistemin urbanistik «hipodamik»: Dura Europosin, Kosin, Lindosin, Magnezien, Miletin, Mesenën, Nysën, Olynthin, Pergamin, Prienën etj.

DO NOT COPY



Fig. 1

Gjatësia e vetë krahut lindor përcaktohet nga kanali i largimit të ujërave, që gjendet 115 m në veri të pikës së bashkimit të dy krahëve. Gjerësia e sheshit ishte sa dyfishi i largësisë ndërmjet boshtit të rrugës dhe ballit të krahut lindor, pra rreth 65 m (fig. 2). Por në se ka qënë po kaq dhe gjatësia e krahut jugor të shetitores kjo mbetet e paqartë, pasi ky krah nuk ruhet i plotë.[11]) Megjithëkëtë gjasa më e madhe, duke u nisur nga tipologjia,[12]) është që ajo të ketë qënë dhe gjatësia e këtij krahu.

Mundësia që shetitorja të zhvillohej në formë «Π»-je është mjaft e pakët. Së pari mungon çdo gjurmë, terreni nuk është dhe aq i përshtatur për këtë zhvillim dhe nga ana tjetër një trajtim i tillë do humbiste dhe pamjen e pejsazhit nga shetitorja, ndaj të cilit urbanistët dhe arkitektët e asaj kohe nuk kanë qënë mospërfillës. Në të vërtetë nga i tërë krahu lindor vështrimit i hapet një horizont i gjerë mbi tërë fushën e gjerë që ndan kodrën e Apollonisë nga ujërat e kaltërta të Adriatikut. Po kjo pamje shihet dhe nga krahu jugor, por prej kësaj ane nuk kapeshin dot dredhërimet e argjenta të Vjosës, së cilës ky krah i kthente shpinën.



Fig. 2

Muri i pasëm. Shetitorja përbëhej prej murit të pasëm, stilobatit, kollonadës e çatisë. Nga muri i pasëm i krahut jugor ruhen tre nike, e para në 6 rreshta (fig. 3), ndërsa dy të tjerat në dy rreshta,

11. Krahu jugor ruhet në 24 m gjatësi. Në lindje ai mbyllet prej një muri të tërthortë, ndërsa në perëndim gjurmët përzihen e humbasin nën ndërtimet e mëvonëshme. Por në lindje shihet se muri i pasëm vazhdon nën shtresën e dheut dhe tej murit të tërthortë me sa duket për t'u puqur në kënd të drejtë me krahun lindor.

12. Zakonisht krahu i gjatë i shetitoreve në formë L-je është sa 4/3 ose 5/4 e krahut të shkurtër, (J. Coulton, **The architectural development of the Greek stoa,** Oxford 1976, f. 96).

DO NOT COPY



Fig. 3

të mbuluara pjesërisht në shekullin e II prej mureve (fig. 4). Niket rrethore, me diametër 5.35-5.50 m,[13] të ndara prej ballesh të drejtë, 2.50 metrash, vazhdonin cilindrike deri lart, në takimin me tavanin, pa fituar formë absidale.[14] Muret nga ana e pasme të drejtë dhe të gjerë (fig. 4)[15] përbëhen prej këmishës së jashtme me blloqe të larta prej guri ranor dhe mbushjes me dhe e gurë.

Kollonada. Ndodhet 4,80-5,20 m larg ballit të murit të pasëm dhe 7.65 m larg fundit të nikeve, largësi kjo që lejonte si lëvizjen e lirshme në shetitore ashtu dhe mbulimin e lehtë.[16] Kollonada mbështetej në traktin e ruajtur, në një stilobat njëshkallësh, (0,33 m) që në këtë rast njësohet me euthynterien, rreshtin mbi të cilin mbështeteshin kollonat (fig. 5). Kjo i lejohet nga terreni i cili në krahun jugor vazhdon i drejtë. Se në ç'mënyrë ka qënë trajtuar stilo-



Fig. 4

13. Nikeja e krahut lindor që ruhet në 2 rreshta lartësi, është më e madhe, 6.25 m.

14. Nikeja e parë vazhdon cilindrike deri në 2.60 m lartësi pa treguar ndonjë shenjë harkimi. Në se kësaj lartësie do t'i shtonim lartësinë e harkut të absidës së supozuar, 2.65 m, sa rrezja e nikes, dhe gjerësinë e ballit të çerek kupolës së absidës 0.60 m atëhere lartësia më e pakët e saj do ishte 5.85 m. Kjo do t'i përgjigjej një raporti diametër kollone (në rastin e dhënë 0.52 m) lartësi kollone 1 : 11.5. Ky raport në vlerat e tij më të larta për orderin dorik arrin vetëm 1 : 8, në stoan verilindore të Epidaurit (J. Coulton, **Vep. cit.,** f. 108). Për më tepër në shetitoren e mëvonëshme (II) ky raport është vetëm 1 : 6,1. Vetëkuptohet pra se niket vijonin me faqe të drejta.

15. Gjerësia e tij në vendin e holluar arrin në 1.20-180 m ndërsa në më të gjerin 4.55 m çka e tregon atë një mur masiv.

16. Gjerësia e shetitoreve me një rrugë kalimi lëviz nga 3.60 m (stoa jugore e Didimës) deri në 14.7 m (stoa veriore B 4 në Kirenë). Por këto të fundit kanë qënë të hapura pa çati gjë që i bënte të papërdorshme në kohë me diell ose shi. Siç shihet nga katalogu i stoave, i sjellë prej Kulltonit **(vep. cit.)** shumica e shetitoreve kishte një hapësirë drite 5-7 m që i përgjigjet dhe shetitores në shqyrtim.

DO NOT COPY



Fig. 5a



Fig. 5b



Fig. 6

bati i krahut lindor ku ndryshimi i kuotës së fillimit me fundin është rreth 1.5 m, këtë nuk e dimë.[17])

Blloqet e stilobatit, të latuar pastër qarkohen prej një kornize kënddrejtë dhe të plotë lart dhe një kornize të hapur poshtë. Në mesin e blloqeve janë lënë në reliev 1-2 të dalura në formë trekëndëshi, ndoshta shenjat apotropeike, për të lidhur «syrin e keq» (fig. 5). Në njerin prej blloqeve shihet se një ganxhë i kalonte tërthor anës së brendshme, (fig 6). Kjo si dhe prerja e drejtë e faqes së brendshme të blloqeve të lënë të kuptosh se dyshemeja e shetitores ka qënë shtruar me pllaka guri.[18]) Kalimi i shpeshtë në shetitore nga kjo anë, kuptohet prej ngrënies së blloqeve të stilobatit nga këmbët, por vetëm në hapësirën e lirë nga kollonat.

Kollonat e orderit dorik janë të paisura me 21

17. Në se supozojmë një stilobat në të cilin numri i këmbëve të shkallëve rritej dora-dorës, ai do arrinte deri në 7-8 këmbë. Zgjidhje kjo jo estetike dhe që do cënonte pamjen e monumentit. Zgjidhje më e mundshme do të ishte që me rritjen e pjerrësisë stilobati njëshkallësh të kthehej në xokol duke lejuar hyrjen vetëm nga fillimi praktikë kjo e zbatuar në një sërë shetitoresh.

18. Kjo tregon për një trajtim të kujdesshëm të shetitores pasi zakonisht shetitoret shtroheshin me dhé që ngjishej periodikisht. Gjurmët e dyshemeve në një varg shetitoresh (stoa në Selinunt, ajo e Perahorës, Paladionit në Athinë, Atalit në Athinë e Delfi, stoa në Lato, Agorës në Magnezia dhe Zeusit në Athinë) nuk përcaktohen dot qartë së cilës periudhë i përkasin, asaj të ndërtimit ose romakes (I. Coulton, **vep. cit.**, f. 146-147). Në këtë rast dëshmia e mësipërme ka interes pasi ganxha e tërthortë, krejt e njëjtë me ato të lidhjes së blloqeve me njeri tjetrin, i takon kohës së ndërtimit së shetitores dhe jo shekujve të erës sonë.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

kanelyra (fig. 5). Diametri i poshtëm i kollonave është 52 cm, interkolumni largësia në mes tyre bosht më bosht, 213 cm,[19]) dhe hapësira e dritës 158 cm, e mjaftueshme «për kalimin krah për krah të dy grave të pjekura në moshë», siç e kërkon Vitruvi.[20]) Për mbulimin e kësaj hapësire duhet një sistem frizi prej tre dhe jo dy metopesh.[21]) Kollonat i përgjigjen mesit të nikeve dhe skajeve të mureve ndërmjet nikeve.[22])

Trungjet e kollonave (102 cm) kanë një konicitet të vogël (2 cm/1 m).[23]) Pjesa e kapitelit dorik ka poshtë një cung kollone me diametër 37 cm, ekinin të ndarë prej tij nga dy unaza të vogla, veçse jo si zakonisht të thelluara por të dala, dhe mbi të abakun katror (fig. 7). Ajo që të tërheq vëmendjen është se cungu i kollonës ka konicitet të kundërt, ndërsa brinjët e kanelyrave vetëm sa janë përvizuar lehtë, por jo gdhendur. Siç shihet modeluesit i kanë lejuar vetes një farë lirie, ndonëse mezi të kapshme, edhe në trajtimin e një orderi kaq të rreptë si doriku.

Kapitelet janë dy përmasësh: njeri me diametër 44 cm dhe tjetri 37 cm.[24]) Përveç kësaj një trung kollone i gjetur brenda shetitores (fig. 3) e ka diametrin e sipërm 37 cm.[25]) Kjo dukuri do shpjegohej lehtë në se shetitorja kishte dy kate dhe kapiteli më i vogël dhe kollonat përkatëse i takonin katit të sipërm.[26]) Për një kat të sipërm të shtynë të mendosh dhe një sërë argumentash të tjerë: Gjerësia e madhe e murit të pasëm, forma cilindrike e nikeve që s'lidhet dot estetikisht me një çati të hapur dhe së fundi fakti se në sheshin prapa krahut jugor gjendej simboli i qytetit, obelisku. Rrjedhimisht një çati e ulët që nis drejt e në nivelin e terrenit, i cili këtu lartësohet menjëherë për 4. m (fig. 8) do të ishte një kontur i papërshtatshëm për sheshin pas krahut jugor të shetitores.[27]) Nga ana tjetër ky krah nuk do të mund të bashkëjetonte harmonikisht me shetitoren e re, po të mos që dykatësh.

Teknika. Bllogjet (0.4-1 x 0.3-0.6 x 0.6 m) e kanë ballin drejtkëndësh e të rrafshët, por të punuar pa ndonjë cilësi të mirë (fig. 3, 4, 9). Në skajet e mu-

19. Po këtë interkolumn ka edhe kollonada e shetitores së II por diametri i poshtëm i kollonave të saj është më i madh (59 ndaj 52 cm). Diametri i sipërm i njëjtë, shpjegohet me konicitetin më të madh të kollonave të shetitores së II.

20. Vitruv **De Architt.** 3. 3. 3.

21. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 114-120

22. Vendosja në muret ndërmjet nikeve nuk është rreptësisht në skaj, por pak më brenda.

23. Në dy trungje të njëpasnjëshëm diametri i poshtëm i trungut të sipërm është i barabartë me diametrin e sipërm të trungut të poshtëm. Të dy trungjet janë 102 cm të lartë dhe kanë konicitetin e mësipërm.

DO NOT COPY

reve mes nikeve blloqet janë paisur me vijë peshimi. Vendosja e tyre është në rreshta të drejtë, paralelë, por me lartësi të ndryshme, me dhëmbëzime të lehta dhe ndërfutje pykash. Ashtu si dhe stilobati muri i mesëm i pasëm mbështetet mbi një themel prej blloqesh të së njëjtës natyrë por me ballë të papunuar. Si për nga teknika e ndërtimit, ashtu dhe materiali i përdorur, këta mure janë të njëjtë me muret rrethues të qytetit të shekullit IV p.e.s.[28]

Ndryshe prej tij dhe kollonat stilobati (fig. 5) janë punuar me blloqe prej guri gëlqeror të Karaburunit (0.86-1.55 x 0.32 x 0.59 m), të latuar mjaft imët me daltë të sheshtë. Nga sipër blloqet lidhen me njeri tjetrin me ganxha hekuri të kapura me plumb, rreth 18 cm të gjata (fig.5). Kapja me ganxha shihet dhe në blloqet e ballit të murit pasëm.

Euthynteria, në vendet e vendosjes së kollonave është gdhendur cekët, për një vendosje më të mirë të tyren. Lidhja është kryer me një kunj të vetëm metalik të kapur me plumb, i cili jo gjithnjë gjendet në qendër (fig. 5). Po me kunja të tillë është kryer lidhja e trungjeve me njëri tjetrin dhe kapitelin. Mbi këtë të fundit gjendet një vrimë kuadratike (7 x 7 x 5 cm) për bashkimin me antablementin. Brenda abakut shihen gjurmët e një rrethi të plotë (49 cm), duke nisur nga i cili janë vizuar brinjët katrore.

Vlerësimi estetik. Shetitorja i kundërvihej shikimit që në hapat e para gjatë rrugës kryesore të qytetit, të drejtë dhe të gjatë, që niste në rrëzë të kodrës. Dora dorës me afrimin në qendër ajo rritej në madhësi derisa me hyrjen në shesh i shpalosej vështrimit me dy krahët e saj (fig. 10). Ajo paraqitej e thjeshtë me konture të rreguilt që krijonin një kornizë në mes të natyrës kodrave, dhe asaj ç'kish bërë dora e njeriut, sheshit. Vargu i pandërprerë i kollonave dhe hapësirave të gjera mes tyre, këmbimi i vazhduar i dritë hijes kushtëzoi një arkitekturë të parënduar, ritmike. Por në të njëjtën kohë stili i saj dorik siguronte rigorozitetin e kërkuar për kohën. Nga brenda monotoninë e paevitueshme të një muri të rrafshët e të gjatë që dukej sikur nuk merrte fund, arkitekti e kishte zgjidhur në mënyrë krijuese, të veçantë. E tërë sipërfaqja e murit të pasëm gjymtyrizohej në një shkëmbim ballesh dhe nikesh në një lojë dritë-hije të butë, opake. Në



Fig. 9

24. Ndërsa kapiteli tjetër me diametër 37 cm gjendet në këtë shetitore, kapiteli tjetër është gjetur në shetitoren e II, por, siç e ve në dukje L. Rey, ata janë të ripërdorur (**vep. cit.**, nr. 2, f. 15) me sa duket të marrë nga shetitorja në shqyrtim.

25. Trungu, në vazhdim të një pjese tjetër të futur në dhé, gjendet në skajin juglindor. Ai ka një lartësi 92 cm.

26. Në të kundërt prania e dy kapiteleve nuk do të shpjegohet dot dhe për të arritur në diametrin 37 cm do duhej një konicitet rreth 5 cm/1 m që nuk takohet në orderin dorik.

27. Raporti i lartësisë së kollonës me diametrin e saj të poshtëm nuk njihet për shek. IV p.e.s. Mesatarja ndërmjet raportit të stoave të kohës së Perikliut (stoa e Zeusit në Athinë 1 : 5,5) e atij të stoave të shek. III-II p.e.s. (stoa e Atalit 1 : 7.25, stoa verilindore e temenosit të Athina Polias në Pergam 1 : 7.35, stoa verilindore në Aigai 1 : 8.1), 1 : 6.5-1 : 7 do na jepte një lartësi prej 3.40-3.64 m të kollonadës që i afrohet mjaft lartësisë së kollonadës së shetitores së re (II). Duke i shtuar asaj lartësinë e antablementit 1.5-2 diametra kollone, 0.75-1 m do merrnim një latrësi 4.10-4.66 m për katin e parë. Këto përmasa janë vetëm orientuese dhe jo të prera, pasi largimi nga normat nis që në shek. IV p.e.s. në mos më herët), aq sa lartësia e terrenit.

28. H. Ceka, **Muri rrethues i Apollonisë,** B.U.SH.T. Ser. shk. shoq. 1963, 3, f. 151.

NO FOTOCOPY



Fig. 10

se në niket ka pasur shtatore ose jo kjo s'mund të thuhet me siguri, por gjetja e shtatoreve të shekujve I-II tregon për një traditë. Po kështu i hapur mbetet problemi në se trajtimit tepër të kujdesshëm të stilobatit i përgjigjet suvatimi i murit me nike, të punuar pa ndonjë cilësi të veçantë.

SHETITORJA E DYTË

Në një periudhë të dytë shetitorja e Apollonisë pësoi një ritrajtim rrënjësor. Shkaqet e kësaj ndërhyrje të thellë duhen parë në një shembje të mundshme për shkak të ndonjë tërmeti, i cili do të këtë lënë pa dëmtuar krahun jugor. Në këtë ritrajtim planimetria pësoi ndryshim (Tab. II). Në vend që krahu perëndimor të vazhdonte me kënd të drejtë me krahun jugor ai u tërhoq brenda dhe u kthye me një kënd rreth 30°, duke e zgjeruar sheshin për 1020 m^2 dhe duke e thyer gjeometrizimin e tij. Me këtë rast shpina e shetitores nuk i mbështetej më një terreni me lartësi të pakët, por kodrës, gjë që ka kërkuar prerjen e shpatit dhe punime masive zbankimi.

Trakti ndërmjetës. Shetitorja e vjetër nuk u la krejtësisht pas dore: krahu jugor u ruajt po ai. Ndërmjet korpusit të ri dhe këtij krahu u krye një rakordim me një linjë të ndërmjetme, as 90° si shetitorja e vjetër por as në ndjekje të linjës së re që do puqej me 120° (Tab. I). Kjo zgjidhje e zbut bashkimin midis dy korpuseve, pa i zhdukur krahut jugor ndonjë element, që do të ndodhte po të ndiqej linja e ballit të shetitores së re. Nga kjo pjesë ruhen tre nike që zenë një gjatësi prej 19.50 metrash (fig. 1). E para, më e madhe, siç kuptohet nga materiali dhe përmasat i takonte shetitores së vjetër ndërsa dy të tjerat janë punuar me gurë konglomerat, si niket e shetitores II dhe i kanë diametra (4.20; 4.45 m) dhe pilastrat ndërmjet nikeve (1.75 m me përmasa më të vogla. Por nga ana tjetër forma vëllimore e nikeve jo absidale, por cilindrike[29] i afron ato me shetitoren e parë. Kjo afri duket dhe nga gdhendja në rreshtin e dytë të blloqeve e trekëndëshave të njëjtë me stilobatin e shetitores së vjetër. Se në ç'mënyrë zhvillohej në vëllim kjo pjesë ishte e hapur a mbulohej me çati, kishte një kat a dy kate, s'e përcaktojmë dot për shkak të mungesës së elementeve të tjerë. Sidoqë të jetë trakti i më sipërm kryente dhe rolin e një muri tarracimi për dhérat e kodrës.

Trajtimi planimetrik. Shetitorja e re me planimetri thuajse drejtkëndëshe ka në ballë një gjatësi pre 78.2 m dhe 76.1 brenda për brenda murit të pasëm Gjerësia e saj është 10.50 m deri në ballin e mur

29) Kjo kuptohet nga që nikeja vazhdon deri në 3 m lartësi me formë cilindrike.

DO NOT COPY

të pasëm dhe 12 m deri në fund të nikeve. Shetitorja e tipit me ante, e mbyllur nga anët, ka qënë me dy rrugë dhe dy kate (Tab. I, II).

Kati i parë i shetitores përbëhej nga muri i pasëm, me nike dhe pilastra mes tyre, tabani, muret anësore, stilobati, kollonada dhe antablementi.

Kolonada e katit të parë. Ka pasur dy rreshta kollonash. Prej rreshtit të jashtëm në drejtim të nikes së katërt ruhen gdhendjet në stilobat të vendeve të dy kollonave të njëpasnjëshme (fig. 11).[30] ndërsa prej rreshtit të brendshëm thuajse tërë bazamentet, madje gjatë gërmimit u zbuluan dhe disa trungje të poshtëm kollonash «in situ».[31] Duke u bazuar në këto gjurmë mund të përcaktohet mirë trajtimi i kollonadës.

Largësia bosht në bosht, ndërmjet rreshtave të kollonave dhe rreshtit të brendshëm e ballit të murit të pasëm, është përkatësisht 5.35 dhe 4.75 m, largësi këto që lejonin një lëvizje të lirshme dhe nuk paraqesin vështirësi për mbulim.[32] Çdo mesi nikeje dhe pilastri të murit të pasëm i përgjigjeshin një kollonë e brendshme dhe një e jashtme. Interkolumni si në rreshtin e brendshëm ashtu dhe të jashtmin, është 2.10-2.20 m, më shpesh 2.15 m, sa ai i shetitores së parë, ndërsa hapësira e dritës 1.60 m. Ky interkolumn lejonte që kollonat të mbanin mbi vete antablement ose arkitrarë të gurtë. Por nëse ky interkolumn për rreshtin e jashtëm është afër caqeve të zakonshëm (2.20-2.50 m),[33] ai është krejt i pazakontë për rreshtin e brendshëm, i cili në tërë shetitoret e njohura lëviz nga 4 në 4.5 m. Kjo zgjidhje krejt e veçantë, tregon se mbi rreshtin e brendshëm mbështeteshin arkitrarë guri, që kishin mbi vete një ngarkesë të paheqshme.



Fig. 11

30. Këto gjurmë i kanë shpëtuar pa parë L. Rejit, kështu që ai radhën e jashtme e mendon me kollona jonike (L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 15), të cilat në të vërtetë i përgjigjen katit II.

Krahu jugor i shetitores së parë ndërpritet nga fillimi i monumentit të Agonotëve për t'ja lënë vendin një stilobati krejt të njëjtë me atë të shetitores në shqyrtim. Mbi të ruhen gjurmët e 7 kollonave tetëkëndëshe, të vendosura me një interkolumn prej 2.76 metarash. Lartësia prej 0.50 m mbi trotuarin e rrugës tregon se kemi të bëjmë me elemente të ripërdorur, prej shetitores së mësipërme.

31. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 13.

32. Rastet skajore i paraqesin stoa veriore III në Korinth, dy rrugëshe 5.85 m e gjerë (2.92 aks në aks) dhe stoa veriore B 5 e Kirenës 21.46 m (10.75 aks në aks). Nëse e para paraqet vështirësi për qarkullim dhe akoma më tepër për përdorimin e saj si sallë, e dyta paraqet vështirësi të mëdha në mos pamundësi mbulimi. Gjerësia normale e rrugëve në stoat e kësaj kohe ishte 5-6 m (J. Coulton, **vep. cit.,** f. 79).

33. Interkolumni i jashtëm në shetitoret pas shek. IV p.e.s lëviz nga 2.20-2.50 m. Ç'është e vërteta hasen dhe interkolumne më të mëdhenj deri në 3.70 m (stoa C në Selinunt) por në këto raste antablatura ka qënë e drunjtë. Por kjo është karakteristike për shetitoret para shek. IV p.e.s. Për shetitoret nga shek. IV p.e.s. e këtej, me përjashtim të një rasti të datuar sigurt (stoa lindore e gjimnazit në Olympie e shek. II p.e.s.) dhe një rasti të padatuar (stoa e Nea Pleuronit), kjo dukuri nuk haset asnjëherë.

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14



Fig. 15

Kollonat kanë formën e një prizmi ose më sak
të trungu piramide tetëkëndëshe të ngushtuar leh
tësisht (2.75 cm/1 m). Secila prej tyre përbëhe
prej tre trungjesh të veçantë (78, 128, 128 cm
(fig. 11, 12) dhe kapitelit (fig. 13). Standartizimi
këtyre përmasave lejonte dhe zëvendësimin e pjesë
përkatëse të një kollone me atë të një kollone tje
tër. Trupi i kollonës ka një diametër të poshtëm
54.5 cm faqe në faqe (59 cm brinjë në brinjë), i c
li ngushtohet dora-dorës lart, në takimin me kapite
lin, në 44.5 cm (49 cm). Ky i fundit e ka ekini
të punuar në një copë me abakun dhe me t
lidhet dhe një cung i shkurtër i trupit (fig. 13
Ekini i ndarë prej trupit të kollonës pr
një torusi, unaze të gjerë, hapet ndaj abakut m
45° pjerrësi, po me faqe tetëkëndëshe

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY

trupi i kollonës. Abaku po aq i lartë sa ekini (10 cm) ka trajtën e një pllake katrore. Në syprinën e tij del në relievër për 1 cm forma e trungut të kollonës (fig. 14, 15), me sa duket për ta përqëndruar ngarkesën e arkitrarëve drejt e në kollonë.

E tërë lartësia e kollonës arrin në 3.65 m (fig. 16). Raporti diametër i poshtëm kollone lartësi, 1 : 6.11 (ose 1 : 6.7 për diametrin faqe më faqe),[34] më i ulët se në shetitoret e tjera bashkëkohëse ku lëviz nga 1 : 7 në 1 : 8,[35] tregon për një kollonë të proporcionuar mirë, të ndërtuar thuajse sipas raportit të «prerjes së artë», (1 : 6.18).[36]

Kollonat e rreshtit të jashtëm ngrihen drejt e mbi stilobat ndërsa ato të rreshtit të brendshëm mbi bazamente katrore prej blloqesh guri (84 x 84 x x 16 cm) (fig. 17) të cilët kanë për themel blloqe të tjerë guri ranor, paksa më të mëdhenj, me faqet anësore të çrregullta.

Muri i pasëm dhe antet. Në anën veriore ku gjurmët janë më të qarta, shihet se muri i pasëm kthehet në 100° dhe vazhdon me gjerësi 0.60 m deri në takimin me stilobatin. Këtu ai nuk ndal por vazhdon për 2.15 m, sa një interkolumn ballit të sheti-

34. Nëse do të niseshim nga raportet e moduleve që kërkon Vitruvi për stoan do kishim, duke marrë për bazë interkolumnin 2.15 m, një lartësi kollone 4.30 m dhe rrugë po kaq të gjerë. Në të vërtetë këto janë të ndryshme përkatësisht lartësia e kollonës është 3.65 m dhe e rrugëve 5.10 m dhe 4.50 m. Siç kuptohet nga ky rast dhe rastet e tjerë modelet idealë të Vitruvit kanë pak lidhje me realitetin dhe kërkimi i plotësimit teorik të pjesëve të mangëta të monumenteve duke u nisur nga modulet, shmanget nga realiteti.

35. Vitruvi e kërkon këtë raport 1 : 7.5 ose të paktën 1 : 7 **De archit** 5.9.3) si ekstreme, stoa e Atalit në Athinë, e ka këtë raport 1 : 7.25, kurse stoa veriperëndimore e Aigait arrin 1 : 8,1. Më tepër këtij raporti i afrohet vetëm stoa e Filipit në Delas që bën përjashtim nga të tjerat 1 : 6,5 (J. Coulton, **vep. cit.,** 107, 108). Ka mundësi që në këtë raport të ketë influencuar dhe raporti i kollonave të shetitores së parë të Apollonisë e cila bashkëjetoi me të. Në të vërtetë në shekujt e V p.e.s. dhe ndoshta fillimin e shek. IV p.e.s. kollonat ishin mjaft më të ngjeshura.

36. s.v. **Golden Section.** Encyclopaedia Britannica, 1970, vol. 10.

tores[37] (Tab. I). Në mbarim të tij shihen gjurmët e vendosjes së një gjysëm kollone. Në anën jugore gjurmët nuk janë të qarta dhe stilobati ka shkarë pak përpara, por sidoqoftë kuptohet se shetitorja ka qënë e mbyllur dhe në këtë anë. Ndoshta këtu gjendej një dhëmbëzim ku mund të ketë qënë vendosur shkalla për në katin e dytë.[38]) Në të vërtetë ky do të qe edhe vendi më i përshtatshëm. Në të kundërt shkalla do kërkuar në skajin tjetër, atë verior.

Mbyllja e mësipërme kishte një sërë të mirash. Së pari, dhe mendojmë se kjo ishte kryesorja, shmangeshin korrentet e ajrit mjaft të bezdisura në stinët e ftohta, korente që do ndiheshin mirë, pasi i hapur mbetej pikërisht veriu prej nga fryjnë ernat e këtyre stinëve. Nga ana tjetër kjo trajtë i jepet shetitore një strukturë më të mbyllur, statikisht më të qën drueshme. Së fundi ajo e përvizonte më qartë skaji e saj verior duke i vendosur një kufi shikimit.

Muri i pasëm 76.10 m i gjatë nuk vijon i drejtë si në tërë shetitoret e botës antike,[39]) por gjymtyri zohet në 17 nike absidale dhe 18 pilastra. (Tab. I Niket përshkojnë një gjysmë rrethi me diametër 3.00 -3.10 m. Deri në 1.50 m lartësi ato vijojnë cilindrik me faqe vertikale (fig. 21, 22) ndërsa më tej mbulo hen me një çerek sfere, duke fituar një trajtë abs dale dhe lartësi disa centimetra më shumë ose m pak se 3 m (fig. 18, 19). Duke i sthuar asaj lartë



Fig. 19

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

sinë e ballit të harkut 0.60 m fitohet një lartësi e njëjtë me kollonat e katit të I, 3.65 m.

Në të vërtetë mbulesa nuk paraqet një çerek sfere të plotë pasi balli i harkuar i nikeve nis 0.45 m më brenda diametrit të rrethit, duke i lënë vend pilastrave 1,20-1.27 m të gjerë (fig. 20). Pilastrat të përvizuara prej një blloku paksa të dalë në formë kornize, janë të paisur në skajet me vija peshimi. Përveç krijimit të një strukture më të qëndrueshme, pilastrat e inkuadrojnë niken në një kontur të mbyllur. Prej saj ata lënë në pah tërë vëllimin e absidës, por e ndërpresin në fillimet pamjen e harkut të qemerit [40] (fig. 19).

Blloqet e tre rreshtave të parë (0.5-1.2 x 0.5 x x 0.6 m), në pjesën cilindrike janë punuar të harkuar si brenda ashtu dhe jashtë (fig. 18, 21, 22). Mbi ta, në mes, janë vendosur dy blloqe paralelopipedë, i pari rreth 1.9 x 0.75 x 0.6 m dhe i sipërmi më i vogël, të zgavruar në pjesën e dukshme sipas kurbaturës së sferës.[41]) (fig 18, 23). Nëntë bloqe të tjerë prizmatikë, të rrafshët në faqet e bashkimit, të harkuar nga balli dhe të punuar sipas kurbaturës së sferës në pjesën e brendshme, i mbështeten në formë pykash blloqeve

37. Në se mbyllja e anëve me ante është një dukuri e zakonshme, vazhdimi i murit në ballë është më i rrallë dhe haset kryesisht në stoat e Greqisë Veriperëndimore (Stoat e Kassopesë, Molykreionit, Nea Pleuronit, stoat lindore dhe të mesme të Thermonit) e të Azisë së Vogël Veriore (J. Coulton, **vep. cit.,** f. 81).

38. Këtu bazamenti i kollonës së brendshme gjendet vetëm 0.60 m larg murit dhe ky i fundit duket se është ringritur, ndoshta nga L. Rey, duke mbuluar gjurmët ekzistuese.

39. Dy nike, në trajtë eksedrash (5.76 m) ka vetëm një shetitore, ajo në temenosin e Artemis Lafrias në Kalidon, që daton në shek. III-II p.e.s. Por eksedrat cilindrike gjenden vetëm në skajet e shetitores dhe mund të kenë shërbyer për kafazin e shkallëve. Sidoqë të jetë ky është rasti i vetëm i përdorimit të kësaj forme në shetitoret greke, të çdo tipi, kohe dhe vendi.

40. Lart mbi harkun dhe pilastrat duket se vazhdonte një tra gjatësor i cili shërbente si jastëk për trarët e tërthortë të tavanit. Më tej këta trarë mbështeteshin në arkitraun e kollonave të mesit dhe ballit. Në të kundërt në se një tra i tillë do mungonte, trarët e tërthortë duhet të vazhdonin drejtpërdrejtë mbi kollonat e rreshtit të mesit dhe ato të ballit, gjë e pamundur pasi mbi to gjendej detyrimisht arkitrau i gurtë.

41. Në pjesën e pasme të tyre kanë qënë vendosur blloqe të marrë nga një ndërtim i vjetër, me fashatura të rrafshta dhe mese të thadruar, të njëjtë me ato të murit mbajtës (fig. 23).

DO NOT COPY

19). Me këtë mënyrë vendosje nëntë
mësipërm punojnë si qemer konik. Ven-
e nikeve sjell baraspeshimin e një pjese
horizontale ndërsa pjesa tjetër i jepet
nëse kjo zgjidhje do të qe e mangët
të lirë, ajo është e goditur për një mur
Komponentja horizontale e peshës së
ës sferike dhe murit të katit të sipërm i
shtytjes së terrenit (fig. 19).

i i shtytjes së terrenit nuk ka qënë i
e për ndërtuesit e shetitoreve të tjera.
zgjeruar muri i pasëm, janë ndërtuar
ıga pas, ose paralel me murin e pasëm,
një mur tarracimi, zgjidhje këto që kër-
m të shumtë materiali, masa për drena-
ërave dhe që nuk janë gjithnjë të arri-
kundërt ndërtuesit e shetitores së Apo-
ınë zgjidhur këtë problem në mënyrë
krejt vetjake, duke ndërthurur më së
tetike me anën konstruktive. Kështu struk-
uar e murit, kontrafortimi nga pilastrat
ɔrca horizontale e mbulesës, në të kun-
tytjen e terrenit, krijonin një strukturë
ër të qëndrueshme ndaj lëkundjeve siz-
eve dhe shtytjes së terrenit, zgjidhje kjo
'shme nga ato të ndërtimeve të tjera
e.

li, muret duket se nuk kanë qënë të
është shtresa e suvatimit të mëvonshëm,
mirë në niken e tempullit të shekullit I.
të kish arsye që të mos ruhej ndonjë
ıdo i vogël, në tërë niket e tjera.[42])

i shetitores ka vetëm një këmbë shkallë,
rahu jugor, dukuri kjo ndonse jo dhe aq
jo e panjohur për shetitoret.

, i njësuar dhe në këtë rast me euthyn-
on gjatë tërë gjatësisë së saj. Kjo mundë-
ıë terreni përpara shetitores është krejt
ë shikim të parë kjo duket e dyshimtë,
qendra pjerrët ndaj veriut.[43]) Por kjo
ıgohet lehtë në se marrim parasysh se
etitores së parë nuk u prish por u ruajt,
olin e një muri tarracimi.

që përbëhet prej bllloqesh të latuar
ëlqeror, karakteristik për Akrokeraunet



Fig. 22 ,



Fig. 23



Fig. 24

DO NOT COPY

–

është suvatuar me një shtresë llaçi me pluhur tulle (0.5-1 cm). Rregu-
ërjashtime (stoa e Perahorës dhe ajo e Atalit në Delf), muret e stoave
të suvatuara (J. Coulton, **vep. cit.,** f. 139).
t e monumentit të Agonotetëve, vetëm 14,80 m të gjata nisin me 5 për
me 7 këmbë.



Fig. 25



Fig. 26

(rreth 1.20 x 0.75 x 0,33 m)[44] mbështetet mbi një themel prej tre blloqesh ranorë, por të punuar më ashpër, veçanërisht nga balli. Blloqet që lidheshin me kllapa të hekurta me njeri tjetrin janë ngrënë në brinjën e ballit për nga 5 cm nga këmbët e frekuentuesve. Në të kundërt afër shtyllave blloqet kanë brinjë të rreguílta. Siç kuptohet nga gjurmët e kollonave (fig. 21) këto të fundit gjendeshin mbi syprinën e bllokut por pa ndonjë vendosje të rregullt.[45] Përsa i përket dyshemesë së katit të parë s'mund të thuhet me saktësi në se ka qënë e mbuluar me dhé, si zakonisht, ose me pllaka guri. Te niket shihet se dyshemeja e tyre ka qënë shtruar me pllaka,[46] (fig. 25) por në to vendoseshin shtatoret, kështu që kjo dysheme mund të ketë qënë pjesore. Mendimi për një dysheme pllakash fiton gjasë nga që shetitor-



Fig. 27



Fig. 28

44. Blloqet e stilobatit ruhen vetëm përballë nikes së IV. Por një numër i madh i tyre, siç e pamë gjendet në perëndim të monumentit të Agonotetëve.
45. Kollonat siç shihet nga gjurmët e mbetura në stilobatin e shetitores dhe stilobatin në jug të monumentit të Agonotetëve zënë çfarëdo pozicioni brenda bllokut. Në shetitoret greke ato mund të jenë vendosur në meset, fugat, ose kudo brenda bllokut si në Apolloni (J. Coulton, **vep, cit.,** f. 110).
46. L. Rey. **vep. cit.,** Nr. 2, fig. 6.

DO NOT COPY



Fig. 29

ja e parë ka qënë e shtruar dhe se blloqet e stilobatit dhe bazamentet e kollonave kanë faqe të drejta.

Antablatura. Prej antablaturës së katit I, në afërsi të shetitores ruhet pjesërisht një fragment kornize jonike me dentikula (fig. 26). Nga fragmenti, thuajse i njëjtë si trajtim me kornizat e katit II, ruhet vetëm pjesa ballore ndërsa pjesa e pasme është thyer. Lartësia, e tij është 0.31 m, ndërsa gjerësia dhe gjatësia s'kapen dot të plota. Arkitrau dhe frizi mungojnë, gjasisht të larguar prej L. Rejit pasi do kenë qënë të thjeshtë, pa zbukurime.

Kanali. Para stilobatit u gjendën blloqe guri (0,80 x 0,53 m) në mesin e të cilëve është gdhendur një kanal harkor (27 x 10 cm). Blloqet i përkisnin një kanali sipërfaqsor (fig. 27) i cili shërbente për grumbullimin e ujërave të shiut dhe përcjelljen e tyre në kanalin e nëndheshëm, në skajin verior të shetitores. Fillimi i pusetës së tij në një vijë me ballin e shetitores (Tab. I) tregon se blloqet e kanalit gjendeshin ngjitur me stilobatin. Kjo të le të kuptosh se pas blloqeve të kanalit vijonin blloqe të tjerë.[47]

Në kanalin kryesor duket se grumbullohej dhe uji që rridhte nga flegra e pasme e çatisë së shetitores. Gjurmët e këtij sistemi sot nuk kapen, por seksioni i madh i kanalit tregon se ai shërbente për një prurje të konsiderueshme. Si anët ashtu dhe kapakët e kanalit janë prej rrasash të mëdha guri ranor (fig. 28). Ai vijon thuajse perpendikular me ballin e shetitores për 39,50 m, deri sa has stilobatin e shetitores së parë, të kthyer në mur tarracimi. Këtu ai rizvogëlohet në seksion, ndryshon në teknikë dhe vazhdon perpendikular me këtë mur.[48] Kuptohet pra se kanali i shetitores së re shfrytëzonte më tej kanalin e shetitores së vjetër.

Kati II. Ballin e katit të II-të e krijonte kollonada me gjysmëkollona të stilit jonik, të një tipi të veçantë, parapetet, antablaturat, prej së cilës ruhet korniza, dhe në anën veriore muri ballor, i cili si në tërë shetitoret e tjera duhet të lartësohej mbi murin përkatës të katit të parë (Tab. II).

Trajtimi planimetrik. Përsa i takon zhvillimit planimetrik mendojmë se ky kat përbëhej prej një rruge ballore, dhe ambienteve në anën e pasme që duhet të kenë shërbyer si salla qëndrimi dhe ndejtje. Arrijmë në këtë përfundim pasi dendësia e kollonave të rreshtit të brendshëm që nuk e hasim në asnjë shetitore tjetër dhe që sjell një ndarje të panevojshme të dy rrugëve nga njera tjetra mund të shpjegohet ve-

48. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 2, f. 12 shkruan se kanali ngushtohet aq sa në të nuk kalohet dot më. Sidoqoftë ky problem mbetet për t'u sqaruar se llogjika kërkon zmadhimin dhe jo ngushtimin e seksionit. Paralelet e këtij kanali L. Rej i gjen në Delos dhe Shën Triadhë në Athinë.

47. Në të kundërt uji i grumbulluar në ullukët dhe që përshkonte një farë harku që nga qejzonet, grykat e derdhjes, do derdhej në tokë duke e grryer atë e mbushur kanalin.

DO NOT COPY



Fig. 30



Fig. 31

DO NOT COPY

tëm me praninë e një arkitrau të gurtë mbi to. Në të kundërt në se interkolumni i tyre do të ishte sa dyfishi i interkolumnit të jashtëm (4.30 m), si në tërë shetitoret e tjera, mbi kollonat mund të vendosej fare lehtë një arkitra druri, por në asnjë mënyrë guri. Kjo tregon se mbi këtë arkitra ndodhej një ndërtim i përhershëm, një ngarkesë e shpërndarë dhe jo e përqëndruar që mund t'u kalonte drejt për drejt kollonave, përkatësisht një mur gjatë tërë gjatësisë së shetitores dhe jo kollona. Ç'është e vërteta ngarkesën e tij dhe të kulmit të çatisë që mbahej prej tij mund ta përballonte dhe një arkitra i drunjtë. Por kur ky të kalbej me kohë dhe të paraqitej nevoja e zëvendësimit do duhej të çmontohej dhe i tërë muri mbi vete dhe çatia. Krahas kësaj kapakët e shumtë të amforave, fragmentet e vazove dhe kryesorja të mangallëve të gjetur prej L. Rejit[49] (fig. 29), mund të shpjegohen vetëm me praninë e ambienteve të tillë. A ishte ky mur dhe i pasmi prej qerpiçi[50]) ose guri, këtë nuk e themi dot me siguri, por numri i madh i blloqeve të drejtë të rrëzuar, të hequr prej L. Rejit[51]) na shtyn të mendojmë se këta mure kanë qënë me blloqe guri.

Kollonada. Gjysëmkollonat e saj përbëhen prej trupit 1.73 m të lartë dhe kapitelit 0.22 m (fig. 30). Kështu lartësia e plotë e kollonave është 1.95 m, dhe raporti ndërmjet diametrit të kollonës dhe lartësisë 1 : 7.22, mjaft më i vogël se i kollonave të zakonshme

49. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 14-17.
50. Praninë e një numri të madh shetitoresh me qerpiç mbi xokol guri e ve në dukje J. Coulton **(vep. cit.,** f. 58, 141-143).
51. Kjo shihet në një foto të L. Rejit **(vep. cit.,** Nr. 2, f. 9)

DO NOT COPY



Fig. 32



Fig. 33



Fig. 34

jonike.[52] Raporti tjetër ai me lartësinë e kollonave të poshtme (3.65 m) del 2/3.7. Ky raport më i vogël se ai i shtitoreve të tjera, ku lëviz nga 2/3-4/5, si dhe nga ai që jep Vitruvi 3/4,[53] krijonte përshtypjen sikur ky kat ishte ngjeshur mirë nga pesha e çatisë.

Gjysëm kollonat (34 x 42 cm) kanë trajtën e një gjysëm rrethi, të bashkuar me një drejtkëndësh (fig. 30; 31, 32). Përsa i takon gjerësisë në to ndiqet parimi i kërkuar i konicitetit, që e përmend dhe Vitruvi,[54] sipas të cilit diametri i poshtëm i kollonës së rreshtit të sipërm duhet të jetë sa diametri që do të arrinte kollona e rreshtit të poshtëm, në se ajo do të vazhdonte të ngushtohej dhe gjatë antablaturës.[55] Por në se ky parim zbatohet për gjerësinë, ai shkelet plotësisht për ballin i cili ka një diametër prej vetëm 34 cm. Në ballin rrethor të gjysmë kollonave janë gdhendur 9 kanelyra të thella, ndërmjet të cilave vijojnë stegat e rrafshta. Në disa prej tyre janë kanelyrë e cekët dhe e hollë shënon ndarjen e balli rrethor nga pjesa e pasme e rrafshtë (fig. 30, 31). Në pjesën e poshtme, por vetëm në ballë, gjendet një bazë e thjeshtë e cila shërbente njëkohësisht për mbajtjen e parapetit (fig. 30, 31). Në disa pre kollonave në faqet anësore është gdhendur një kanal (15 x 2.5 cm) i cili shërbente për inkastrimin e parapetit (fig. 33, 34). Prania e tij në disa kollonc dhe mungesa te të tjerat shpjegohet lehtë me kërkesat e montimit.[56] Ndalimi i këtij kanali 11 cm mbi fundin tregon dhe se dyshemeja e këtij kat gjendej pa kaq lart nga fundi i kollonave.

Trajta e gjysëm kollonave rrethore nga balli dhe e drejtë anash e nga pas, ka një sërë përparësish

52. Ky raport luhat nga 1 : 9.45 në stoan jugore të Korinthit në 1 : 8.2. Përjashtim bën vetëm stoa e Athalit në Athinë ku në kollonadën e poshtme të brendshme arrin në 1 : 7.75 (J. Coulton, **vep. cit.**, f. 120).

53. J. Collton, **vep. cit.**, f. 130: **Vitruv. de Archit.** 5. 1. 3. 5. Megjithëkëtë në tërë ndërtimet romake vihet re se orderat e mbivënë kanë lartësi të njëjtë.

54. Vitruv, **de Architt.** 5. 1. 3.

55. Kollonat e katit të I kanë një ngushtim afërsisht 3 cm për metër. Në se lartësisë së kapitelit i shtojmë një antablaturë rreth 0.5-0.6 m do kemi një ngushtim prej 2.5 cm. Përkatësisht diametri i sipërm i kollonës së katit të parë do ngushtohej nga 44.5 në 42, aq sa është dhe gjerësia e gjysmë kollonës së mësipërme.

56. Në se të dy anët do kishin kanale dhe parapeti do kish një gjërësi sa largësia në mes kanaleve atëherë kollonat do mund të montoheshin pas vendosjes së parapetit, gjë që s'ka llogjikë, pasi një dëmtim ose zëvendësim eventual i parapetit do kërkonte çmontimin e kollonave, të dyja këto të pamundura. Rrjedhimisht parapeti inkastrohej nga njëra anë, mbështetej te baza e kollonës nga të dy anët dhe mbërthehej në kunja në kornizën e antablaturës.

lejon vendosjen e lehtë dhe lidhjen e sigurtë të parapetit, sjell një paraqitje estetike të kollonadës, rrethore e të ngushtë, dhe njëkohësisht siguron një qëndrueshmëri të mirë të tyren dhe antablementit, në sajë të gjerësisë së konsiderueshme. Këtë tip gjysmë kollone dhe thuajse me po këto përmasa (32.5 x 46) e gjejmë dhe në shetitoren e Perahorës (e fundit të shekullit IV p.e.s.), në ballin e hyrjes së Zeusit dhe Herës në Thasos (e viteve 325-300 p.e.s.) dhe në stoan veripërendimore të Korinthit, të vitit 300.[57])



Fig. 35



Fig. 36

Kapitelet janë trajtuar dhe ata me dy fytyra, si trupi (fig. 35). Pilastrit drejtkëndësh i përgjigjet një trajtim i thjeshtë që duket sikur rreh të rijapë të skematizuar antablaturën jonike nëpërmjet bre-



Fig. 37

57. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 126-127, 131. Ekzemplarin e fundit autori e sheh të lidhur me shtesën e fundit të shekullit I p.e.s. por ka mundësi që këtu të kemi të bëjmë me një ripërdorim të këtyre elementeve.

DO NOT COPY

zash të profiluar (fig. 35, 36). Në të kundërt gjysmës së kollonës i përgjigjet një trajtim si i kapiteleve jonikë, por krejt i veçantë (fig. 36, 37, 38). Ajo që e baskon me ta janë volutat, por kapiteli është zhveshur nga tërë zbukurimet karakteristike, vezët, perlat, kymat, si poshtë ku lidhet me kollonën ashtu dhe lartë në pjesën e abakut. Po aq volutat anash nuk trajtohen si jastëkët të shtypur. Vendin e tyre e ze një gonxhe zambaku uji, kupa e të cilit e parë nga balli s'është gjë tjetër veçse voluta e kapitelit. Në fund të gonxhes nis një kërcell i hollë i cili pasi lakohet anash me një kurbë të hajthme del në ballë në trajtën e një gajtani të drejtë. Një gajtan tjetër që lidh dy meset e volutave dhe një lule e zbukurojnë pa e rënduar ballin e kapitelit. Kapitelet e gjetur ndryshojnë nga njeri tjetri në nuanca të vogla: në lulet, të cilat janë me 4 (fig. 36) ose 6 petale (fig. 38) ose dhe 4 petale e 4 bisqe, si dhe mungesën (fig. 36) ose praninë në fund të një cungu kollone (fig. 38). Kjo e fundit tregon dhe punimin e kapitelit njëdorazi me trupin e kollonës.

Parapetet e ballit të katit II[58] janë punuar prej pllakash guri 0.935 m të larta, të gjera sa për një interkolumn (fig. 39). Pllakat e parapetit ndodheshin ndërmjet dy faqesh anësore të gjysmëkollonave njëra nga të cilat e thelluar në trajtë kanali, ndërsa tjetra e sheshtë. Kapja e tyre dhe sigurimi nga moslëvizja kryhej në kornizën e antablementit me anën e kunjave të poshtme, ndërsa nga njera anë futej në kanalin përkatës. Po kështu ato siguroheshin nga lëvizja para dhe prej bazave të pjesës së përparme të gjysëm kollonave.

Sipërfaqja e jashtme e parapeteve ndahet në dy panele katrorë dhe një bazament të profiluar poshtë (fig. 40). Në njerin prej paneleve janë gdhendur rombe të vendosur vertikalisht të ndarë me listela nga njeri tjetri. Në panelin tjetër janë gdhendur «luspa peshku» me hark të mprehtë. Përdorimi i parapeteve në katet e dyta është një domosdoshmëri dhe praktikë e njohur,[59] por motivet e mësipërm i gjejmë



Fig. 38



Fig. 39



Fig. 40

58. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 14, shkruan se nga parapetet janë gjetur copëra të shumta dhe disa panele të plotë. Një prej këtyre paneleve që ai e paraqet në fotografi, **po aty.** fig. 6, gjendet brenda në muze.

59. J. Coulton, **vep cit.,** f. 127-128, Lartësia 0.935 m e parapetit të mësipërm është brenda caqeve fundore prej 1,14 m në stoan verilindore të temenosit të Athinës në Pergam (190-180 p.e.s.) dhe 0,72 m të stoas veriperëndimoretë Aigait (shek. II p.e.s.).

POZITOCOPY

vetëm në shetitoret që datojnë në shekullin II p.e.s.[60] dhe mjaft të përhapur në ndërtimet e shekujve I-II të erës sonë.[61] Pllaka të tilla gjenden dhe në Apolloni, në banesën në sektorin «G». Edhe në se do të mendonim se përdorimi i saj është një rastësi dhe ajo mund të jetë marrë fare mirë nga shetitorja, një urnë e po kësaj kohe paraqet një ndërtim rrethor, ku ndërmjet kollonave shihen parapete po të tillë (fig. 41). A kemi të bëjmë në rastin e shetitores me një rindërhyrje në shekujt I-II ose kjo formë më e hershme, e shekullit II p.e.s. dhe ndoshta dhe shekullit III p.e.s., u bë e parapëlqyer në shekujt në vazhdim, këtë nuk e përcaktojmë dot.

Antablatura. L. Rej na bën të ditur për fragmente të shumtë pllakash me zbukurime perlash dhe vezësh si dhe boton fotografinë e një kyme jonike e cila duket se i përkiste simës[62]) (fig. 42). Krahas tyre në shetitore ruhen disa fragmente kornize jonike me dentikula 0.23 m të larta (fig. 43, 44, 45). Pjesa e tyre e poshtme 34,5 cm e gjerë, sa gjysëm



Fig. 42



Fig. 43



Fig. 41



Fig. 44

60. Parapete me zbukurime të tillë kanë stoa e Eumenit (180-160 p.e.s.) dhe Atalit në Athinë (159-138 p.e.s) (J. Coulton, **vep. cit.,** f. 128). Në këtë të fundit siç shihet nga fig. 28, kombinohen interkolumnet dy panelëshe me rombe me ata me luspa.

61. L. Rej (**vep. cit.,** Nr. 3, f. 14) ve në dukje se fragmente të tillë janë gjetur në Pompej, Solunt, theatrin e Segestes, Termes dhe në Pisidi.

62. L. Rey, **vep. cit..**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 45



Fig. 46

kollonat, është lënë e papunuar. Njeri prej fragmen teve është thyer dhe bashkuar më tej me ganxho Kjo si dhe mos përpunimi i sipërfaqes së poshtmë tregon se këta fragmente nuk mbështeteshin mbi ko llonat por mbi një element tjetër horizontal. Ng përpara fragmentet kanë një brez të shpërvjelur ja shtë, (fig. 43, 45) nën të cilën pas një profilizimi t lehtë, nisin dentikulat, dhëmbëzimet. Nga pas traj timi është më i thjeshtë. Pas një profili nis brez i shpërvjelur (fig. 44, 45), çka tregon se dhe kjo pjes është e llogaritur për vështrim dhe si pasojë trarë e çatisë ndodheshin mbi të. Rrjedhimisht kjo nu ishte pjesa më e sipërme. Si pasojë antablementi e mendojmë me një arkitra të thjeshtë të ndarë n dy ose tre breza, siç janë zakonisht arkitrarët orderit jonik. Një pjesë e tillë, e cila me sa duke i takon antablaturës së pasme, e ndarë, në dy bre za dhe që e shohim në një fotografi të L. Rejit gjen det pranë shetitores.[63]) (fig. 46). Mbi të munde drejtpërdrejtë ose i ndarë me një rrip të holl me astragalë, vezë e perla, vijonte korniza e më sipërme[64]) dhe më lart gjendej kyma jonike e cil mbante trarët e çatisë dhe tjegullat.

Mbulesa. L. Rej ve në dukje se «fragmentet e qe ramikës që formojnë aty këtu një shtrat të vërtetë tregojnë se mbulesa ka qënë me tjegulla».[65])

Shtatoret. Afër nikeve L. Rej zbuloi 5 shtatore mermeri, 5 krerë dhe shumë fragmente të ndryshme që u përkasin të paktën 9 shtatoreve (Tab. III). Pje sët e plota u gjetën të përqëndruara ndërmjet nike ve 5-6 dhe 8-9 ndërsa fragmentet të shpërndara.[66] Kjo tregon se ato kush e di për çfarë arsye u për qëndruan në këto vende. Gjasa më e madhe është që ato të jenë hequr nga bazamentet e tyre jashtë shetitores[67]) ose brenda saj, me forcimin e kristianiz mit, nga fundi i shekullit IV ose më tej, dhe janë he dhur e fshehur në brendi të shetitores pas ndonjë muri. Dy nga shtatoret paraqesin muzat (Tab. III 1, 2 dhe njera Ceresin (Tab. III 3), të punuara sipas pro totipeve të shekullit IV p.e.s., pra të datueshme më vështirësi. Po prototip të hershëm të kësaj kohe, ri sjell dhe një shtatore burri me tunikë. Të tjerat një djalosh, i veshur me togën e madhe (Tab. III 5), dy krerë grash dhe dy burrash. (Tab. III 6, 7, 8) datojnë në shekullin e I të e.s. Të tëra shtatoret, krerët, ashtu dhe fragmentet dallojnë për një punim të përsosur prej mjeshtri. Ajo që të bie në sy është se ato janë punuar po me aq kujdes sa para dhe prapa. Po kjo do të ishte jashtë llogjikës në se këto shtatore do qenë punuar në vend dhe pikërisht për niket, ku pjesa e pasme nuk duket.[68])

Teknika dhe materiali i ndërtimit. Ndërsa stiloba-

63. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 2, fig. 9. Arkitrau ka dy fasho. Mbi fashon e sipërme blloku



Fig. 47



Fig. 48

ti dhe themelet janë punuar prej guri ranor, të njëjtë me murin e pasëm të shetitores së parë, me sa duket të nxjerrë në vend, niket ashtu si dhe pilastrat janë punuar prej blloqesh konglomerati të fortë, në të cilin formacionet ranore përzihen me gëlqerorët dhe guackat e molusqeve (fig. 18, 20). Vendi i nxjerrjes së këtij konglomerati poroz në ngjyrë gri e me nuanca të kuqërremta, nuk dihet.

Pjesët e tjera: kollonat, parapetet dhe antablaturat janë punuar me gur dolomit të nxjerrë në guroret e Karaburunit.[69] Sipërfaqja e kollonave të katit I është punuar mjaft mirë, me daltë të sheshtë, gjurmët e lehta të së cilës ndihen në faqet (fig. 11). Gjurmët në pjesën fundore të trungjeve të kollonës



Fig. 49



Fig. 50

është i pjerrët, i papunuar mirë. Mbi të duket se mbështeteshin tjegullat,

64. Një antamblement të tillë ka erekteioni në Athinë, i vitit 410 p.e.s., i punuar po sipas orderit jonik.

65. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 14.

66. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 2, f. 16 dhe Nr. 3, f. 18-31.

67. Këto bazamente shihen me shumicë në **interkolumnet** e krahut jugor. Tre të tillë gjenden dhe para shetitores.

68. Kështu shtatoret e Apollonit dhe Dionisit në Butrint, që gjendeshin në nymfe, nga prapa janë të papunuara. Punimi i shtatoreve të Apollonisë me përjashtim të asaj të Ceres, prej të njejtit mermer të bardhë të le të mendosh më tepër se ato janë punuar në Apolloni por nuk i përkisnin nikeve.

69. N. Ceka, **Gurorja e Karaburunit,** (dorëshkrim në arkivin Q.K.A).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 51



Fig. 52

e tregojnë qartë procesin e përgatitjes. Pas rrafshimit të pjesës së poshtme, mbështetjes, në bllokun e gurit vizohej me kompas një rreth me diametër të kërkuar (fig. 47), në të cilin jashtëshkruhej tetëkëndëshi. Këtë vizim e shohim dhe në pjesën e sipërme të abakut, madje dy vizime me që në fillim është gabuar masa (fig. 15). Mungesa e këtyre gjurmëve në rrafshin e sipërm të trungut tregon se diametri i sipërm arrihej duke i punuar faqet me pjerrësinë e kërkuar.

Në dy prej blloqeve, në të dy rrafshet, shihen të gdhendura inicialet «Θ» (Th) (fig. 48) dhe «ΓΗ» (GE) (fig. 49, 50) me sa duket të mjeshtrave gdhendës. Shënimi në të dy anët duket se tregonte dhe lidhjen me trungun tjetër përkatës, pra krijimin e një kompleti. Por në disa prej blloqeve këto iniciale mungojnë.

Në pjesën e poshtme të trungut të parë ka qënë gdhendur që në fillim gropëza katrore e vendosjes së kunjit të lidhjes me bazamentin, por ndërtuesit nuk e panë të mjaftueshme lidhjen me një kunj qendror dhe e zevëndësuan atë me dy kunja anësore (fig. 50), duke arritur kështu një stabilitet më të madh dhe lehtësi në derdhjen e plumbit. Hapja e vrimave për këto kunja s'mund të thuhet se ka rregullsinë e vrimës së parë. Në të kundërt ato janë të shrregullta. Lidhja e trungjeve me njeri tjetrin (fig. 49) dhe kapitelin është kryer po me nga dy kunja hekuri të fiksuara në trungjet e sipërm me plumb, të cilëve u përgjigjen dy foletë përkatëse në trungjet e posh tëm.

Në blloqet e mbështetjes përpunimi i sipërfaq është arritur duke vizuar së pari dy boshte (fig. 5 dhe sipas tyre janë vizuar konturi i kollonës, vend e vrimave të bashkimit dhe kanalet e derdhjes plumbit. Në një prej bazamenteve pas montim është parë e nevojshme që veç kunjave të bashkim të vendosen dhe 4 pllaka anësore për fiksimin më mirë të trungut (fig. 52).

Vendosja në trungjet e inicialeve dhe hapja p raprake e vrimës qendrore, të zevëndësuara gja montimit me vrimat anësore, tregon se koll nat arritën të parapërgatitura që më parë dh vetëm sa u montuan në vend. Kjo si dhe gjetja trungjeve të tillë në Durrës, Nikae, Bylis, Butrint Finiq,[70] tregon se në Karaburun nuk kishte vetë kavo për nxjerrjen e gurit, por dhe punishte p përpunimin e tij, sipas porosive.

Vlerësimi urbanistik dhe arkitektonik. Ndërtim i shetitores së re solli një riformulim urbanistik qendrës së Apollonisë. Nga trajta e rregullt dhe di e kufizuar e sheshit u kalua në një formë të lirë m të hapur. Ky trajtim i ri solli një ndryshueshmëri pan jesh sipas rakursit të shikimit dhe thyerjen e mon tonisë. Kjo thyerje e linjave të rregullta nuk u kuf zua vetëm në plan, por u zgjerua dhe në hapësir Në se përpara sheshi drejtkëndësh i nënshtrohej n pjerrësie të caktuar tani ai, pësoi një thyerje dh

70. Trungu i gjetur në Durrës ruhet në muzeun arkeologjik. I Nikaes u gjet në afërsi të theatrit. Për Bylisin, C. Praschniker, **vep. cit.,** f. 80 Trungu i Butrintit është botuar nga L. Ugolini, **L'Acropoli di Butrinto,** Roma 1942, f. 179. Ai ka diametër 49 cm, faqe 19 cm dhe ngushtim 1 cm/1 m. Në faqe është punuar një trekëndësh në reliev. Trungu i gjetur në Finiq merret gabimisht nga Ugolini si mesjetar, pjesë përbërëse e kishës në akropol (L. Ugolini, **L'acropoli di Fenice,** Milano-Roma, 1932).

shkallëzim në cakun e konturit të vjetër, në lindje, dhe një zgjerim e hapje me kënd nga kjo anë. Shetitorja e parë paraqitej e njëtrajtshme në formë e vëllim, ndërsa shetitorja e re ose më mirë ansambli i shetitoreve, përbëhet prej dy korpuseve të veçantë, krahut të vjetër jugor dhe korpusit të ri, të ndërlidhur me traktin ndërmjetës me njeri tjetrin, me një linjë të thyer e të lirë. E gjithë kjo e bënte sheshin më të zhdërvjellët më pak rigoroz e monoton.

Në se krahu jugor mbeti po ai, trakti ndërmjetës iu përshtat si arkitekturë të dyve duke krijuar një hallkë zbutëse. Në trajtimin arkitektonik të shetitores së re të mirëfilltë vihet re qartë inovacioni por dhe mbështetja te tradita. Ashtu si në shetitoren e vjetër i tërë ai mur i pasëm pashmangërisht i gjatë e monoton, u thye në një ritëm të vazhdueshëm formash të lakuara dhe ballesh të drejtë, me një lojë opake drite dhe hieje. Veçse niket nuk janë më gjeometrikisht të prera, cilindrike, por trajtohen më butë, të lakuara dhe lart, absidale. Këto absida të mbyllura në vetvehte inkuadronin si kornizat e një kuadri shtatoret, të cilat pa ndërhyrë dhe pa e penguar lëvizjen e gjallëronin, hijeshonin dhe pasuronin artistikisht shetitoren.

Këtë trajtim të ndryshëm nuk e vemë re vetëm në format planimetrike dhe vëllimore por dhe në kollonat e të dy kateve.

Ndërhyrjet e mëvonshme. Deri nga fundi i shekullit I p.e.s. sheshi qendror i qytetit, agoraja, nuk pësoi ndonjë ndryshim. Por më tej ai iu nënshtrua një riformulimi sipas kërkesave të reja, riformulim që duket se i përket periudhës së hershme perandorake. Së pari në njërën prej nikeve të traktit ndërmjetës u ngrit një tempull i vogël (fig. 1). Kapitelet e tij jonikë, të ulët dhe me jastëkë anësorë në formë tufe dafinash, datojnë deri në gjysmën e shekullit të II.[71] Faqja e papunuar e Odeonit në vendin ku ai prek tempullin tregon se Odeoni, i mesit të shekullit II, ishte i mëvonshëm se ky tempull.[72] Po në këtë kohë ndërmjet kollonave të krahut jugor të shetitores së I si dhe para stilobatit të shetitores së II u shtuan bazamente të ngjashëm me ata të tempullit për shtatore kalorësish[73] dhe bazamente më të vegjël, me sa dukej për shtatore me figura njerëzish (Tab. I).

Ngritja e mëtejshme e harkut të triumfit nisi të



Fig. 53

cënojë terësinë e krahut jugor, ndërsa ndërtimi pasues i Odeonit dhe monumentit të Agonotetëve, të dy të mesit të shekullit II,[74] e prishën tërësinë e sheshit si dhe tërësinë e krahut jugor të shetitores dhe traktit ndërmjetës. Së fundi ngritja e së quajturës bibliotekë ia humbi përfundimisht funksionin krahut jugor.

Jeta e korpusit të ri, shetitores së II, ishte më e gjatë. Ndërhyrjet në të i përkasin një kohe më të vonë, shekujve V-VI. Gjurmët e këtyre ndërhyrjeve: mbushja e 7 nikeve të para me mur tulle me llaç (fig. 53), ndarjet tërthor shetitores (Tab. I), kollonat helikoidale dhe kapitelet e stilit kompozitë, të gjetura prej L. Rejit.[75] tregojnë për një ripërshtatje për qëllime kulti. Por ripërdorimi masiv i blloqeve në anën veriore tregon se kjo pjesë ishte e rrëzuar në shekujt V-VI. Ky ishte dhe fundi i shetitores.

SHETITORJA E BYLISIT

Shetitorja e Bylisit bën pjesë së bashku me theatrin, stadiumin dhe një sërë ndërtimesh të tjera shoqërore në qendrën e qytetit, agoranë (fig. 54). Kjo e fundit ndodhet në skajin jugperëndimor të qytetit, në një terren jo dhe aq të lehtë për krijimin e një kompleksi urbanistik. Por megjithëkëtë ndërtuesit i

71. E. Mercklin, **Antike Figuralkapitelle,** Berlin, 1962, Nr. 217.
72. L. Rey, **L'Odeon,** «Albania» Nr. 6, 1939, f. 13.
73. L. Rey, **Po aty.**
74. L. Rey, **Fouilles de la mission archéologique Français a Apollonie d'Illyrie,** «Albania» 5. Paris 1939, f. 11-12: A. Bruhi, **L'inscription du monument des Agonothetes.** «Albania», 5, Paris 1935, f. 46) e cakton të shek. II, pas reformave të Septim Severit.
75. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 3, f. 15.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 54



Fig. 55



Fig. 56

kanë shfrytëzuar në të mirë vështirësitë e terrenit, duke arritur një zgjidhje urbanistike harmonike e njëkohësisht të veçantë.

Qendra u zhvillua në dy rrafshe me lartësi të ndryshme. Nga jugu lidhjen e tyre e kryente theatri, skena e të cilit ndodhej në rrafshin e poshtëm, ndërsa shkallarja arrin deri në rrafshin e sipërm. Ky rrafsh, në anën verilindore zihej nga shetitorja. Midis saj dhe theatrit gjenden disa ndërtime të tjera shoqërore. Në veriperëndim shetitorja kufizohej prej një ndërtimi, gjasisht prej një tempulli, mbi të cilin më vonë u ngrit një bazilikë paleokristiane. Ky ndërtim e lidhte sheshin dhe me stadiumin, boshti gjatësor i të cilit ndodhet në kënd të drejtë me krahun verior të shetitores.

Këto ndërtime janë vendosur në mënyrë që shikimit si nga shkallët e theatrit ashtu dhe shetitorja t'i hapej panorama më e bukur, lugina e Vjosës dhe lumi me gjarpërimet e tij.

Përshkrimi i parë i shetitores, i bazuar në sondazhet e kryera nga G. Faiti, është i C. Praschnikerit.[75/1]) Sipas tij shetitorja që i mbështetej një muri mbajtës ishte dy rrugëshe, gjasisht dykatëshe dhe rrethonte sheshin kuadratik të agorasë ose gjimnazit. Sondazhi, që sipas planimetrisë u krye në skajin verior të krahut lindor, nxorri në dritë dy kollonada dhe murin e pasëm të shetitores, të vendosur në një largësi 5 m nga njeri tjetri (fig. 54). Kollonat, sipas skicës 8 copë, ruheshin deri në 1.80 m lar tësi dhe kishin seksion tetëkëndësh.

Gjatë gërmimit të bazilikës paleokristiane, n vitin 1981 u zbulua në një gjatësi 30 m dhe sti lobati i skajit perëndimor të krahut verior (fig. 55 Stilobati ka qënë me tre shkallë (0.29, 0.32 m). Pre tij shkallët e para ruhen në tërë gjatësinë ndërsi nga shkalla e sipërme ruhet «in situ» një bllok vetëm (1.10 x 0.90 m) me gjurmë të një kollon dorike (b = 57 cm), por shenja kunji ndërlidhë nuk ka. Shkallët e stilobatit, të mbështetura mbi nj themel blloqesh të papërpunuar, janë prej bllo

75/1. C. Praschniker, **vep. cit.,** f. 80.

qesh drejtkëndësh, të latuar rrafsh. Në faqen e tyre të jashtme, si në shetitoren e I të Apollonisë, janë lënë në reliev trekëndësha apotropeikë.

Shetitorja ka një gjerësi prej 11.30 m, nga shkalla e sipërme e stilobatit deri te muri i pasëm. Ky i fundit, prej blloqesh të latuar mirë, në pjesën e poshtme shërben si mur tarracimi për dyshemenë e shetitores, kurse lart si mur i pasëm i saj.

Përgjatë shetitores u gjetën një sërë trungje kollonash me seksion tetëkëndësh. Por në ndryshim me kollonat e Apollonisë seksioni i tyre nuk është barabrinjës, por ka një trajtë të përzgjatur ($b_1 = 50$; $b_2 = 54$ cm)[76] (fig. 56). Lidhja e tij me trungjet e tjerë kryhej me kunja, të vendosur afër brinjës anësore.

Prashniker na bën të ditur dhe për gjetjen e një shtatoreje tip Atis dhe një sërë monedhash që nisin me ato të Bylisit dhe arrijnë deri tek bizantinet.[77] Por autori nuk e përcakton pozicionin e tyre stratigrafik, kështu që ato mbeten të dyshimta për datimin e shetitores.

Duke i rigrupuar këto të dhëna mund të themi se shetitorja e Bylisit kishte formën e shkronjës L me krahun verior 47 m të gjatë dhe lindorin 53 m. Shetitorja 11, 53 m e gjerë ndahej në dy rrugë prej dy sërë kollonash ndërsa nga pas muri vijonte i drejtë. Kollonat e brendshme kishin seksion tetëkëndësh, paksa të përzgjatur, ndërsa kollonat e jashtme, po të nisemi nga gjurma «in situ», duket se ishin dorike.[78] Interkolumni midis tyre, në se do ta pranojmë gjatësinë e bllokut të euthynteries (1.10 m) si standarte, ishte rreth 2.20 m, sa interkolumni i shetitoreve të Apollonisë. Në se planimetria e Prashnikerit është e rregullt dhe interkolumnet e të dy rradhëve të kollonave qenë të barabarta zgjidhja planimetrike e saj do të ishte e njëjtë me atë të shetitores II të Apollonisë. Kjo do dëshmonte dhe për një kat të II të ndarë në mes prej një muri blloqesh në një koridor kalimi. Në fakt Prashnikeri na bën të ditur dhe për trungje kollonash të sheshta, që sipas tij i takonin katit të dytë.

Së fundi shetitorja mbulohej me një çati tjegullash prej të cilave Prashniker ka gjetur të tilla me vulat ΔΑΜΟΣΙΟΣ (të shtetit) dhe ΦΙΛ,ω N[79]) Datimi i këtyre vulave në fund të shekullit III p.e.s. fillim të shekullit II p.e.s., na jep si «terminus antequem» për ndërtimin e shetitores pikërisht këtë kohë.[80]

Sidoqë të jetë pamjen përfundimtare të shetitores do ta zgjidhin gërmimet e ardhshme.



Fig. 57

76. Brinjët e tij janë anësoret 30, balloret 24 dhe ndërmjetëset 18 cm. Lartësia e plotë është 1,28 m, si në shetitoren e II të Apollonisë.

77. Shtatorja ka lartësi 0.75 m, pa kokën e cila i mungon. Monedhat janë të Bylisit. Amanties, dinarë të Brutit, Kaskës, Hadrianit, Mark Aurelit dhe bizantine, që autori nuk i saktëson të kujt kohe (C. Praschniker, **vep. cit.**, f. 203).

78. Një farë dyshimi lind nga që kollona nuk lidhej me euthynterien me kunj, se Prashniker shkruan se dhe kollonada e jashtme ishte me kollona tetëkëndëshe **(vep. cit.,** f. 80) dhe se shetitorja e Apollonisë i kishte të dy rradhët të njëjta, po me kollona tetëkëndëshe.

79. C. Praschniker, **vep. cit.,** f. 203.

80. L. Papajani, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në qytetin ilir në fshatin Klos të Mallakastrës,** «Buletin Arkeologjik» 4, 1974, f. 99 (vula ka trajtën ΔΑΜΟΣΙΑ); N. Ceka, **Vula mbi tjegulla në trevën midis Aosit dhe Genusit,** Iliria 1, 1981 (në shtyp).

PO NOT COPY



Fig. 58



Fig. 59

Shetitorja e Bylisit ka mjaft pika të afërta me shetitoren e II të Apollonisë, gjerësinë, ndarjen në dy rrugë po aq të gjera, interkolumin e barabartë të dy kollonadave dhe formën tetëkëndëshe të kollonave. Prej saj ajo dallon nga trajta në formë L-je, por duke marrë parasysh përdorimin e krahut jugor të shetitores I në Apolloni mund të themi se i tërë kompleksi në Apolloni kishte formë L-je. Muri i pasëm në Apolloni me nike, në Bylis është i drejtë. Por në se në Apolloni këtij muri i duhej të mbante presionin e shpatit, në Bylis ai ngrihej i lirë. Megjithkëtë ky trajtim, vërtet më i thjeshtë dhe më i lirë, është dhe më pak estetik.

SHETITORJA E NIKAIES

Qendra shoqërore e Nikaes duket se ka qënë vendosur në anën veriore të qytetit (fig. 57). Prej saj deri sot njohim theatrin e qytetit dhe një ndërtim tjetër shoqëror,[81]) por me destinacion jo dhe aq të qartë. Hyrja e theatrit, parodosi, vazhdon drejt lindies me një mur mbajtës. Por mbas 25 metrash muri kthehet në kënd të drejtë, duke ia lënë vendin dy rrafsheve të gjatë (rreth 80 x 10 m) të cilët vijojnë drejt jugut, paralel me boshtin gjatësor të theatrit. Herë pas here në këtë vend janë gjetur kapitele dhe pjesë kollonash: Një trung kollone dorike me 21 kanelyra (L = 0.95 b = 0.44 m), dy trungje kollonash dorike me kanelyra të përvizuara por të pathelluara (i ploti L =1.07 b = 0.40 m) dhe dy trungje kollonash tetëkëndëshe të përzgjatura, si ato të Bylisit (L = 0.82 b_1 = 0.53 b_2 = 0.45)[82]) (fig. 58). Trungjet e mësipërm janë punuar prej guri gëlqeror të nxjerrë në vend. Përveç kollonave po në këtë vend janë gjetur dhe katër kapitele. Prej tyre njeri është dorik me ndarje të ekinit nga trupi i kollonës nëpërmjet dy unazash në reliev (b = 0.33 m H = 0.29 B = 0.40 m), njeri jonik (b = 0.35 m H = 0.25 m) me ekin të zbukuruar me brez kymash e astragalësh dhe fushat e abakut me rozeta. Dy kapitele të tjerë, që i përgjigjen trungjeve të kollonave tetëkëndëshe (H = 0.34 m), e kanë ekinin po tetëkëndësh e të përzgjatur dhe abakun drejtkëndësh (B = 0.55) (fig. 59).

Forma e përzgjatur e rrafsheve dhe orientimi i rregullt ndaj theatrit e bëjnë mjaft të mundur praninë në to të një shetitoreje. Në të vërtetë përmasat e rrafsheve të njëjta me ato të shetitores së II në Apolloni dhe asaj të Bylisit, dhe prania e kolionave tetëkëndëshe, e shtojnë së tepërmi këtë mundësi, duke e kthyer thuajse në fakt.

Në tarracën e poshtme në mesin e saj L. Papajani ka zbuluar rrënojat e një ndërtimi duke e ndjekur atë për 40 m. I bazuar në gjurmët dhe fragmentet arkitektonike ai arrin në rikonstruksionin e një portiku 10 m të gjerë, njëkatësh, me dy rrugë,

81. Për qytetin e Nikaes dhe identifikimin e tij L. Papajani, **Qyteti ilir në Klos,** «Kuvendi i I i studimeve ilire», Tiranë 1974; për theatrin dhe ndërtimet e tjera L. Papajani, **Disa monumente të arkitekturës në qytetin antik në Klos,** Monumentet» 11.

82. Brinjët e kollonës në pjesën e sipërme, janë anësoret 27 cm ballorja 19 cm dhe ndërmjetësja 18 cm.

DO NOT COPY

me kollonadë dorike në ballë dhe në mes dhe me mur të pasëm të drejtë.[83]

Por nga vrojtimi në vend dalin një varg vështirësish të cilat e komplikojnë problemin. Në të vërtetë këtu nuk kemi të bëjmë me një ndërtim unik, njëdorësh, por me tre ndërtime të veçanta të vendosura përgjatë një boshti gjatësor (fig. 60). Së pari, në veri është zbuluar skaji i një ndërtese me muraturë me blloqe. Pas saj vjen një hajat i hapur, po kaq i gjerë, dhe 5.65 m i gjatë, i paisur me një stilobat treshkallësh në mesin e të cilit ruhet një bazament me gjurmët e një kollone dorike (b = 0.48 m). Mbas hajatit nis ndërtimi i tretë, 9.50 m i gjerë[84] i ndarë në mes nga një sërë bazamentesh. Në ballë ndodhet një mur 0,90 m i gjerë,[85] ndërsa mbrapa vazhdonte muri i pasëm që kishte dhe rolin e një muri të tarracimit. Në takimin e këtij ndërtimi me hajatin gjenden një sërë blloqesh që shënonin cakun e kësaj ane.



Fig. 60



Fig. 61

DO NOT COPY

83. L. Papajani, **Disa monumente...**, f. 28.

84. Ky ndërtim është 1.20 më i ngushtë se i pari, veriori.

85. Muri përbëhet prej dy blloqesh të vënë së gjati, të shkëmbyer çdo 1.80 m me blloqe të vënë së gjeri (L. Papajani, **Po aty**).

Bazamentet gjenden përkatësisht 2.65 m larg skajit verior dhe vijojnë 1.90; 2.25 dhe 1.95 m larg njeri tjetrit, bosht në bosht. Këtu shihet një farë ç'rregullsie por në se kollonat mbi bazamentet e III e të IV do çvendosen 10 cm më në skaj interkolumnit, përjashtuar atë të anës, 2.65 m që edhe mund të justifikohet, interkolumnet e tjerë do ishin 2.00, 2.05, 2.05 m, të afërt me interkolumnet e shetitoreve të Apollonisë.

Hajati që përmendëm më sipër, i shtuar në një fazë të dytë, do të ketë shërbyer për kalimin në këtë ndërtim nga ana perëndimore me që muri nga balli ishte i lartë, ndoshta dhe i mbyllur. Sidoqë të jetë përcaktimi i funksionit të këtij ndërtimi sot për sot është i vështirë dhe ai mund të jetë po aq mirë sa shetitore, dhe një ndërtim tjetër i mbyllur.



Fig. 62

SHETITORET E DIMALIT

Shetitorja e I. Në anën juglindore të akropolit të Dimalit Prashnikeri pati dalluar një monument të paisur me nishe,[86]) i cili u gërmua në vitin 1964 nga B. Dautaj. Autori i gërmimit e përshkruan si një shetitore me gjatësi 29.40 m, me shtatë nike gjysmë rrethore me diametër 2.98 m dhe thellësi 1.47 m dhe ballin ndërmjet tyre 0.98 m të gjerë. Sipas autorit shetitorja e ngjashme me atë të Apollonisë daton në shekullin IV p.e.s. (fig. 61, 62.)[87])

Shetitorja e Dimalit përsa i përket përmasave dhe teknikës është e njëjtë me shetitoren e II të Apollonisë: Niket kanë po atë diametër e thellësi, pilastrat janë thuajse po aq të gjera dhe rrjedhimisht interkolumni është thuajse po ai (2.22 ndaj 2.15 m). Veç kësaj muratura është po izodomike me blloqe konglomerati me faqe të rrafshta, ndërsa në skajet e pilastrave gjenden të njëjtat vija peshimi. Por nga ana tjetër shetitorja e Dimalit ka trajtim të njëjtë hapsinor si shetitorja e I e Apollonisë. Niket nuk kanë formë absidale, por vazhdojnë cilindrike[88]) dhe shetitorja nuk ka qënë dy por një rrugëshe. Kjo kuptohet nga që ana lindore e shetitores mbyllet prej një ndërtimi në formë kulle i cili projektohet rreth 5 m nga muri i pasëm i shetitores. Kjo largësi e pamjaftueshme për dy rrugë shënon dhe gjerësinë e saj. Në brendi të nikeve, siç e tregon shtrimi i dyshemesë së tyre me pllaka, gjendeshin shtatore, sot të humbura.

Në se shetitorja ka pasur një ose dy kate kjo nuk përcaktohet dot. Por duke marrë parasysh nivelin e lartë të terrenit të pasëm dhe formën cilindrike të nikeve, të papërshtatur estetikisht për një kat, do anonim më shumë nga një shëtitore dykatëshe.

Në bazë të këtyre të dhënave shetitorja e Dimalit i përket së njëjtës gjeneratë me shetitoren e II të Apollonisë, shekullit III p.e.s., por duke qënë Dimali një qendër më pak e fuqishme se Apollonia dhe shetitorja është trajtuar më e thjeshtë dhe me përmasa më të vogla.

86. C. Praschniker, **vep. cit.**.
87. B. Dautaj, **Zbulimi i qytetit Ilir Dimal,** «Studime historike» 2, 1965, f. 96. Skicat dhe fotot janë po të tijat.
88. Deri në një lartësi prej katër rreshtash në to nuk shihet fillimi i qemerit.

DO NOT COPY

Shetitorja e II. Gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1974 po B. Dautaj zbuloi më tepër se gjysmën e një shetitoreje të dytë, në anën veriperëndimore të akropolit të Dimalit (fig. 62). Ajo është e lidhur me krijimin e një qendre të re të jetës shoqërore në këtë qytet, që përveç shetitores parashikonte ndërtimin e një rruge që të çonte prej saj në një tarracë të dytë në verilindje të saj.



Fig. 63

Shetitorja gjendej mbi një tarracë të hapur për këtë qëllim mbi sheshin prapa murit rrethues të anës veriperëndimore të akropolit. Autori i gërmimit e përshkruan atë si një ndërtim me gjatësi 50 m dhe gjerësi 7.80 m, me dy radhë bazamentesh për kollona (fig. 63). Ai mendon se pas rreshtit të dytë ishin vendosur dyqane dhe punishte të ndara me parete dërrasash dhe se ndërtimi lidhet me periudhën e shekujve II-I p.e.s. Fundin e përdorimit të saj autori e përcakton nga një thesar monedhash apolloniate të gjysmës së dytë të shekullit I p.e.s. të gjetura nën rrënojat e çatisë së djegur të godinës.[89])

Shetitorja njëkrahëshe dhe dy rrugëshe, (fig. 64), ndodhet krejt afër rënies së kodrës duke lënë para vetes një hapësirë të kufizuar. Rrjedhimisht hyrja për në të kryhej nga shpina nëpërmjet një rruge të gjerë, në mes të saj. Elementët përbërës të shetitores janë kollonada, çatia dhe muri i pasëm që anash kthehet me ante. Në pjesën ku kalon rruga muri e shoqëron atë, nga të dy anët. Ky mur i ndërtuar me blloqe të vegjël guri ranor luante njëkohësisht dhe rolin e një muri tarracimi.

Terreni këtu nuk ka qënë dhe aq i përshtatshëm për ndërtimin e shetitores. Për këtë arsye ai është prerë në shpinë, ndërsa dheu i gërmuar është hedhur para duke krijuar një tarracë artificiale. Në pjesën e përparme shetitorja nuk kufizohet prej ndonjë stilobati dhe tabani i saj paraqet thjesht vazhdimin e platformës së vogël para.

Gjurmët rrethore në bazamentet dhe mungesa e kunjave metalikë në to tregojnë se kollonada ka qënë prej druri. Interkolumni prej tre metrash, si i kollonadës së jashtme ashtu dhe të brendshme, tregon se dhe antablementi ka qënë i drunjtë. Kjo vërtetohet dhe më mirë nga që në mes, atje ku kalonte rruga, mungon një bazament i brendshëm. Kjo tregon gjithashtu se kalimi në shetitore kryhej nga pas, dhe balli i shërbente vetëm për soditje. Kjo dëshmon tërthorazi dhe se ky portik nuk ishte treg por shetitore. Nga ana tjetër kollonat rrethore nuk lejonin një ndarje në kthina për dyqane, siç mendon autori i gërmimit. Për më tepër dyqanet e kësaj kohe ose gjendeshin bashkë me banesat si në Antigone, ose ishin ndërtime të forta prej guri, si në Alinda ose Heraklea.[90])

Shetitorja e II e Dimalit paraqet një ndërtim të realizuar thjeshtë (fig. 64). Në të mungon përdorimi i gurit në elementet arkitektonikë, që i jep monumentalitetin godinave të këtij lloji. Për këto arsye kjo shetitore përbënte një zgjidhje tepër të thjeshtë, por mjaft praktike. Në njerën anë ajo ruan traditat arkitektonike të një tipi të formuar mirë në zonën prapa Apollonisë dhe e zhvillon atë më tej me elemente funksionale. Në anën tjetër për vetë mundësitë e kufizuara ekonomike, në kushtet që kalonte qyteti ilir në shekujt II-I p.e.s., shetitorja e II e Dimalit mban edhe shenjat e rënies në fushën e ndërtimeve shoqërore. Përveç vlerave arkitektonike,

89. B. Dautoj, **Rezultatet e gërmimeve të vitit 1974 në Dimal,** «Buletin arkeologjik» 5, 1975, f. 26-27.

90. F. Krischen, **Die Stadtmauer von Herakleia am Latmos.**

DO NOT COPY

kjo shetitore, e datuar mirë nga prania e një shtrese kulturore të shekujve II-I p.e.s. dhe thesarit të monedhave apolloniate të gjysmës së dytë të shekullit I p.e.s., nën rrënojat e saj, na shërben si «terminus ante quem» edhe për stoat e tjera të zonës. Në radhë të parë ajo tregon se shetitorja e I e qytetit, e ndërtuar sipas modelit të shetitores së II të Apollonisë, duhet të jetë e shekullit III p.e.s.

SHETITORJA E BUTRINTIT

Qendra shoqërore e Butrintit ndodhej në jug, në rrëzë të shkëmbit të lartë të akropolit. Këtu ndërmjet shkëmbit dhe murit rrethues, të fundit të shekullit III p.e.s.[91]), krijohej një rrafsh jo dhe aq i gjerë, ku të fuste njera nga hyrjet kryesore. Në këtë hapërsirë ndodheshin ndërtimet shoqërore të qytetit prej të cilave njohim dy tempuj, shetitoren[92]) dhe theatrin.

Shetitorja i ngjeshet shkëmbit të thikët dhe vijon paralel me të (fig. 65). Elementët e saj qenë më se të thjeshtë: një mur ballor 4 m para shkëmbit dhe një çati. Si mur i pasëm shërbente vetë shkëmbi i rrafshuar për këtë qëllim.

Muri i përparshëm është punuar me blloqe të l
tuar prej guri gëlqeror të nxjerrë në vend. Blloq
janë drejtkëndësh me faqe të rrafshta dhe lartësi
njëjtë. Muri nuk vijon i pandërprerë por në çd
3.80 m ai përçahet nga kalime 4.20 m të gje
(fig. 67). Gjerësia e tij është e vogël sa e n
blloku, por qëndrueshmëria e tij është rritur ng
punimi i pjesëve të plota në formë pilastrash kryq
me brinjë 3.8 dhe 2 m. Për të arritur një struktu
kompakte blloqet e brinjëve të pilastrave ndërthure
në drejtim gjatësor dhe tërthor (fig. 68).

Në pjesën ku shetitorja i mbështetet murit anë
sor të theatrit lartësia arrin deri në 3,55 m (fig. 69
Këtu shpatulla e kalimit vijon e drejtë deri n
2,90 m, por pas kësaj lartësie, pas një themr
të sheshtë 0,72 m ajo kthen me 45°. Po kësht
dhe blloqet që e kanë mbushur më von
këtë hapësirë e kanë në shumicën e tyre nj
brinjë të prerë me 45°. Kjo tregon se kalimet mbulo
heshin me harqe të rremë. Në një lartësi 4,10 m ng
tabani shihet se shkëmbi është gdhendur për t
krijuar mbështetjen për çatinë e cila pa dyshi
ka qënë me një kullim, me derdhje nga balli. N



Fig. 64

91. Për linjën dhe datimin e murit N. Ceka, **Fortifikimi antik i Butrintit,** Monumentet 11; f. 27-48.

92. Shetitorja është gërmuar nga misioni italian, por ajo nuk u botua. Përshkrimi i parë tek A. Baçe, **vep. cit.,** f. 100.

DO NOT COPY



Fig. 65

se do të pranonim, si zakonisht për këtë kohë, një çati me pjerrësi 20%, muri ballor do ishte rreth 3,70 m i lartë.[93] Kjo lartësi nuk lejon mbulimin e kalimeve me hark në formë trekëndëshi barabrinjës, por kërkon prerjen e tij lart duke i dhënë harkut një trajtë trapezi, formë kjo e njohur nga ndërtimet arkaike, kryesisht të Kretës.

Duke marrë për nivel të sheshit dyshemenë e tempullit të Eskulapit del se tabani i shetitores gjendej rreth 1 m mbi sheshin. Rrjedhimisht për kalimin në të duhej një stilobat treshkallësh, prania e të cilit dëshmonte tërthoras nga prerja pjerrtas e shkëmbit para shetitores (fig. 66). Vetë tabani i saj, sot i paniveluar e shkëmbor, ka qënë i mbushur me dhé, i cili si zakonisht ngjishej.

Në lindje gërmimi i shetitores nuk është çuar deri në fund, kurse nga perëndimi shihet qartë se muri i theatrit e ka ndërprerë atë në fillimin e njerit prej kalimeve (fig. 69). Siç kuptohet nga gjurmët në shkëmbin mbi shkallaren e theatrit, shetitorja vazhdonte nga kjo anë. Për të vazhduar më tej asaj do t'i duhej të dhëmbëzohej ose kthehej në formë të shkronjës L duke u puqur kështu me tempullin e poshtëm. Kjo afri me tempullin e Asklepit na shtyn të mendojmë se ajo ka qënë shetitore tempulli (ἐγκοιμητήρια).[94]

Siç e pamë hyrja për në qytet gjendej në një bosht me tempullin. Vendosja e saj në këtë vend u kushtëzua nga synimi që shikimit t'i hapet që në çastin e hyrjes parspektiva e qendrës. Në trajtimin e saj është marrë parasysh në radhë të parë sfondi. Monumentet që e përbëjnë qendrën: shetitorja, thearti, tempujt janë trajtuar me vëllime të mbyllura, me muraturë prej blloqesh masivë guri, në jehonë të shkëmbit të lartë e të ashpër të akropolit. Syri në të nuk tërhiqet nga kompozime të veçanta aksiale, por nga kompozime asimetrike që shkrihen me sfondin natyral në një shpërndarje të studiuar vëllimesh.

Nga shekulli I-II para shetitores, thuajse ngjitur me të, u ndërtua një banesë me oborr peristil e cila ia mbuloi asaj pamjen. Por shetitorja duket

93. Për 4 m largësi kjo pjerrësi do sillte një ulje prej 0,80 m. Duke ja zbritur lartësisë së shkëmbit nga tabani deri tek gdhendja, del se muri ballor duhet të ketë qënë 3,70 m i lartë.

94. Shetitore të tilla të Asklepit janë ato në Amfiaraia, Epidaur dhe Athinë (shih për këtë Ch. Daremberg - E. Saglio, **vep. cit.,** IV f. 585 dhe P.W.R.E. **s. v. stoa)**

DO NOT COPY



Fig. 66



Fig. 67



Fig. 68

DO NOT COPY

se vazhdoi në një farë mase funksionin e parë. Nga ana tjetër arkitektura e shetitores, ndikoi dhe në trajtimin e ndërtimeve të shekujve të parë të erës sonë. Kështu harqet e dritareve të tempullit të Asklepit, harqet e hyrjeve të ballit të skenës së theatrit dhe dritarja e prefurnit të banjës qendrore, ndërtime këto të shekujve I-II, kanë trajtim të afërt me harqet e kalimeve: Pas shpatullës së drejtë vijon themra horizontale e më tej nis harku. Po kështu tempulli dhe pjesa e skenës së theatrit kanë vëllime të ngurta dhe faqe të rafshta të thyera po me kontraforte, që krijojnë po atë efekt si pilastrat kryqe të murit të shetitores.

Dyrrahu. Së fundi në Dyrrah në muzeun arkeologjik ruhet një trung kollone tetëkëndëshe ballit të së cilës gjenden 6 kanelyra. Përmasat e trungut (L = 100 cm b = 60 cm) tregojnë se ai i përkiste një kolone të fuqishme, përkatësisht një ndërtimi më të madh se ata që shqyrtuam. Veç kësaj në të ruhet dhe një fragment bariere, si i shetitores së II të Apollonisë, me dy fusha, njera me rombe dhe tjetra me luspa. Ka mundësi që dy fragmentet e mësipërm t'i përkisnin një shetitoreje.

PËRFUNDIME

Megjithë numrin ende të kufizuar të shetitoreve të njohura në vendin tonë, mund të vendoset një lidhje midis tyre dhe të nxirren përfundime për tipologjinë dhe datimin.

Në radhë të parë shetitorja paraqitet si një nga elementet përbërës të shesheve qendrore, agorave, ku ajo ze një vend të veçantë. Në konceptimin urbanistik ajo shërben për të trajtuar hapësirën e qendrës së qytetit duke e kufizuar në një ose dy anë dhe njëkohësisht me radhët e kollonadave krijon përshtypjen e zgjerimit të kësaj hapësire.

Zgjidhja arkitektonike e shetitoreve si ndërtime të zgjatura dhe të hapura, lejonte hyrjen ose largimin e lirshëm në çdo çast. Ky funksion i lidh ato edhe me theatrot, në mënyrë që të mund të shfrytëzoheshin nga spektatorët gjatë pushimeve. Një vendosje të tillë kanë shetitoret e Butrintit (fig. 65), Apollonisë (Tab. I) Nikaes (fig. 57) dhe deri në një farë mase Bylisit (fig. 54). Duket se një pjesë e tyre (Apolloni, Bylis, Nikae) paraqesin zgjidhje të njëkohëshme me teatrot në planin urbanistik të agorave, ndërsa në Butrint teatri është ndërtuar më vonë.

Vendosja e shetitoreve në afërsi të teatrit ka qënë një parim i njohur në urbanistikën antike, që rekomandohej nga Vitruvi dhe që është zbatuar në disa agora. Rastet e njohur i përkasin shekujve III-II p.e.s., por me përjashtim të Pergamit, ato nuk janë ndërtime të njëkohëshme. Në të kundërt në shetitoret e arealit iliro-epirot ky kombinim është në pjesën më të madhe i njëkohëshëm dhe duket qartë se kjo përvojë ishte kthyer këtu në një parim urbanistik.

Tipologjia. Në numrin e shetitoreve që shqyrtuam mund të bëjmë një grupim në bazë të planimetrisë si dhe të zgjidhjes konstruktive.

Shetitoret e Apollonisë na japin në këtë prizëm dy ndarjet kryesore: me një radhë kollonash dhe me dy radhë (tab. I). Brenda këtyre ndarjeve kryesore qëndrojnë të gjitha shetitoret e tjera, megjithse jo gjithmonë në raport të njëjtë kronologjik me shetitoret apolloniate. Kështu ajo e Dimalit (fig. 62) është trajtuar me një radhë shtyllash, megjithse prototip i saji ka qënë shetitorja dyradhëshe e Apollonisë. Si shetitore të mirëfilltë njëradhëshe kemi atë të Butrintit, të zgjidhur në mënyrë origjinale, me një hapësirë gjysëm të mbyllur (fig. 67).

Shetitoret me një radhë kolonash janë të njohura në Greqi po aq herët sa ato me dy radhë dhe ndarja e tyre nuk ka një bazë kronologjike. Shetitorja e I e Apollonisë paraqet një variant të zhvilluar të këtij tipi për vetë përdorimin e formës «L», e cila lidhet me zbatimin e sistemit ortogonal. Në një kriter të tillë ky tip shetitoreje gjen përdorim të gjerë në agoratë e qyteteve të Azisë së Vogël gjatë periudhës helenistike, ndërsa në Greqinë Kontinentale njihet vetëm një stoa e mirëfilltë e këtij tipi, në Perahora, pranë Korinthit, ku datohet në shekullin e IV p.e.s. Fakti se në Apolloni drejtimi i krahëve të stoas i përshtatet plotësisht sistemit ortogonal të qytetit dëshmon se ky monument përbënte një nga bazat e para të zgjidhjes së këtij sistemi.

Elementët arkitektonikë. Kollonat e kateve të parë të shetitoreve të Apollonisë, Bylisit, Nikaies, janë shumëkëndëshe (fig. 11-13, 56, 58). Kollona të tilla siç e pamë janë gjetur në Dyrrah, Finiq dhe Butrint. Forma shumëkëndëshe nuk është e panjohur dhe në shetitoret e Greqisë. Kështu veç shetitoreve arkaike atë e gjejmë në stoan veriore të Assosit, stoan verilindore të temenosit të Athinës në Pergam dhe stoan në formë L-je në Agoranë e Delosit.[95]) Por në to kjo formë mund të shihet me

95. E para e vitit 190-180 p.e.s., e dyta e vitit 187-173 p.e.s. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 111-112, Praninë e kësaj forme e ve në dukje Vitruvi i cili shkruan se kollonat pa kanelyra mund të jenë jonike ose dorike, kurse poligonalet janë dorike **(De Architet.** 4.3.9).

BOTIMET

origjinë nga doriku i hershëm kur nuk gdhendeshin kanelyrat, kështu që ato janë 16 këndëshe dhe kapitelin e kanë dorik. Por kryesorja është se këto shetitore janë mjaft më të vona, të shekullit II p.e.s. Ndryshe prej tyre kollonat e shetitores së Apollonisë nuk janë 16 por tetëkëndëshe dhe për më tepër synimi për krijimin e një forme të re shihet dhe në trajtimin e kapitelit. Edhe në se abaku mbetet abak dhe ekini ekin, ky i fundit nuk ka trajtë trung konike por trungpiramidale dhe ndarja e trupit nga kapiteli nuk përvizohet nga kanale, por prej një torusi. Kështu ndonse kollona ende ruan disa tipare të dorikut, mund të themi se ajo shkëputet cilësisht duke krijuar një tip më vete.

Në disa prej shetitoreve helenistike të fillimit të shekullit II u përdorën kapitelet lotus dhe palmë.[96] Shetitore këto me të cilat e II e Apollonisë ka mjaft anë të përbashkëta si orderin jonik në katin e sipërm, parapetet rombikë etj. Kështu që nuk do të ishte e pamundur që dhe ky tip kollone të ketë pasur parasysh «protodorikun» egjiptian me të cilin trungu i kollonës ka afri.

Në shetitoret e mësipërme kollonat palmë ose lotus fshihen brenda, ndërsa jashtë gjenden vetëm kollonat klasike, dorike ose jonike. Në të kundërt në Apolloni stili i ri del me guxim në reshtin e jashtëm, konseguent për vlerat e tij estetike (Tab. II); gjë që tregon se këtu nuk kemi të bëjmë me një zgjidhje rasti po me një kërkim të vetdijshëm formash dhe tipash. Mungesa e këtij tipi kollone në çdo vend tjetër të botës tregon për zhvillimin e një shkolle më vete arkitekturale.

L. Rej e ka tërhequr vëmendjen ndaj kapitelit jonik, por ai disi gabon duke parë si kryesore thjeshtësinë e formës, duke ia gjetur paralelet në Palaticë në Maqedoni, Olympie etj.[97] Ajo që e karakterizon këtë kapitel dhe që e dallon cilësisht nga shembujt e Maqedonisë[98] nuk është trajtimi i thjeshtë, i ngurtë dhe palëvizje në plan si në kapitelet e mësipërm. Në të kundërt në të tërë elemente e syprinat ai u nënshtrohet lakimeve të lehtë, elegantë që nuk e shqetësojnë syrin dhe shmangin thatësinë e formave (fig. 36). Kapiteli është padyshim nga dora e një artisti me shije. I bazuar në elemente të thjeshtë florealë, gonxhe, kërcenj, lule me lëvizje të lehta ai ka arritur të krijojë një dekor të përsosur arkitektonik. Gjetja në Apolloni e kapiteleve të tjerë, të cilët nuk i përkasin shetitores,[99] tregon se këtu s'kemi të bëjmë me një rast të veçuar por me një dukuri që nuk duhet të hezitojmë të quajmë tip më vete.

Trajtimi planimetrik. Interkolumni i barabartë i sërës së jashtme të kollonave të shetitores së II të Apollonisë dhe Bylisit, me atë të sërës së brendshme është një dukuri e zakontë për shetitoret para shekullit të IV p.e.s., ku antablatura ishte e drunjtë.[100] Më tej këtë dukuri e hasim vetëm në stoan lindore të gjimnazit në Olympie të shekullit II p.e.s. dhe atë të Nea Pleuronit, të padatuar, por dhe këto me antablaturë druri. Zhdukja e kësaj dukurie pas shekullit IV p.e.s.[101] shpjegohet me zevendësimin e antablaturës së drunjtë me të gurtën, e cila nuk duronte interkolumne më të mëdhenj se 3 m. Si pasojë kollonat e jashtme u shpeshtuan, kurse të brendshmet ruajtën hapin e parë. Synimi i ndërtuesve në këtë rast nuk ishte ndarja e shetitores në dy rrugë të veçanta, por mbajtja e strukturës së tavanit ose çatisë, me kollona të rralla. Në të kundërt në shetitoren e Apollonisë synimi është krejt tjetër. Në të interkolumni i jashtëm i vogël, reflektohet krejtësisht në të brendshmin (Tab. I). Por siç e pamë mbi të shkarkohej një ngarkesë e paheqshme muri, ndarja e katit të sipërm. Megjithkëtë duhet vënë në dukje se ndërtuesit nuk ju shmangën ndarjes së qartë të dy rrugëve nga njera tjetra nëpërmjet interkolumnit të ngjeshur.

96. Kapiteli lotus në stoan jugore të temenosit të Demetrit në Pergam, (fillimit shek. II p.e.s.) dhe palmë në stoan e temenosit të Athinës në Pergam (viti 190-180 p.e.s.), stoan e Athalit në Athinë (viti 159-138 p.e.s.), stoan e Eumenit në Athinë (viti 180-160 p.e.s.) (J. Coulton **vep. cit.,** f. 101, 107). Ward Perkins (JRS, 38 (1948) f. 69) cituar te J. Coulton, (**vep. cit.,** f. 123) e sheh origjinën e kapiteleve lotus nga Aleksandria, ndërsa B. Wesenberg (**Kapitele und Basen,** 1971, f. 48-49) e mendon kapitelin palmë të ardhur nëpërmjet influencës së tërthortë minoike-mikene gjë që na duket e vështirë pasi gjurmët e kësaj kulture kishin humbur në shek. II kurse në Egjiptin helenistik ato kishin zhvillim të plotë. Për më tepër kjo ishte dhe koha e këmbimit më intensiv të formave arkitektonike.

97. L. Rey, **vep. cit.,** Nr. 2, f. 23.

98. L. Heuzey-H. Daument, **Mission archeologique de Macedoine,** Paris, 1876.

99. Në muze gjendet një kapitel i tillë, më i vogël dhe me zhvillim të dyanshëm, i cili kuptohet se nuk i takonte shetitores.

100. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 76.

101. A. Mallëita, **Olympia und seine Bauten,** 1972, f. 284-289; W. Gell, **The itinerary of Greece,** London, 1819, f. 299.

102. J. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 77.

DOKTORATË

Një nga dallimet e shetitores së I të Apollonisë nga simotrat e saja antike, është trajtimi i sfondit në formën e një muri me nike. Nikeja është një formë e përdorur rrallë në arkitekturën greke, për më tepër në Greqi ato nuk ishin të paisura me kolonada dhe nuk funksiononin si shetitore. E vetmja shetitore antike ku gjen përdorim nikeja është agoraja e italianeve.[103]) Por ajo nuk krijon një sfond të rregullt dhe kombinohet me pjesë të drejta dhe futje katërkëndëshe të murit fundor. Krahas kësaj, ajo që është kryesore, shetitorja e Apollonisë e shekullit IV ka përparësi në kohë ndaj stoas së italianeve që datohet rreth viteve 110-88 p.e.s.

Dy eksedra gjenden dhe në stoan e Kalydonit por ato gjenden skajeve të monumentit dhe nuk kishin atë koncept të qartë arkitektonik: thyerjen e monotonisë së një muri të gjatë dhe krijimin e një strukture më të qëndrueshme. Po kështu dhe stoa e Kalydonit, e shekujve III-II p.e.s., është 1-2 shekuj më e vonë se shetitorja e I e Apollonisë.

Së fundi mbulimin e nikeve me kalota sferike, ndonse jo të mirëfillta, nuk e kemi hasur në ndonjë vend tjetër. Në se kjo është e bazuar atëhere Apollonia është dhe vendi i parë ku u përdorën format absidale.

Tipi i shetitores dykatëshe njihet në Athinë që në çerekun e dytë të shekullit IV p.e.s. kur ndërtohet stoa e Asklepionit, por paralelet më të theksuara me Apolloninë shihen me stoan e Perahorës, pranë Korinthit, të ndërtuar rreth viteve 300 p.e.s. Aty gjejmë të njëjtin kombinim të dorikut, në katin e poshtëm, me jonikun, në të sipërmin, dhe përdorimin e gjysmëkollonave dhe parapeteve prej pllakash me reliev rombesh. Rastet e tjera lidhen me shkollën e Pergamit dhe i takojnë shekullit II p.e.s.[104]) Kulltoni shënon një boshllëk për këtë tip monumenti në Magna Grecia dhe Maqedoni.

Shetitorja e II e Apollonisë tregon për një lidhdhje të drejtpërdrejtë me shetitoret korinthase të shekullit IV-III p.e.s. dhe kjo është plotësisht e kuptueshme në raportet kulturore midis një metropoli dhe apoikie.[105]) Vetëm se nuk kemi të bëjmë me një imitim por me trajtime krijuese mbi bazën e një tradite arkitektonike. Këtu në radhë të parë kemi parasysh zhvillimin e mëtejshëm të sfondit me nike nga format cilindrike në ato absidale, të cilat krijonin një strukturë të qëndrueshme dhe estetike.

Veçoritë. Shetitorja e Apollonisë ka shërbyer si model për shetitoret e qyteteve ilire në shpinë të saj. Më afër qëndron ajo e Dimalit e cila është thuajse një përsëritje në miniaturë veçanërisht për sfondin arkitektonik me nishe.

Shetitorja e Bylisit (fig. 54) ka përvetësuar nga shetitorja e I e Apollonisë skemën planimetrike me dy krahë, në formë L-je, dhe nga e II-ta përdorimin e kollonave tetëkëndëshe. Vetëm se në Bylis këto kollona janë të zgjatura. Kjo dukuri përsëritet edhe në Nikaie.

Shetitorja e II e Dimalit (fig. 63) paraqet një zhvillim të vonë, pa ndjekur kriterin e monumentalitetit. Megjithse pa vlera të veçanta arkitektonike kjo shetitore dëshmon se ky tip monumenti u bë pjesë e fondit arkitektonik të qyteteve ilire.

Shetitorja e Butrintit përbën një tip më vete, të panjohur në ndonjë vend tjetër. Elementet e saj janë të thjeshtë, disi arkaikë, të përngjashëm për nga ashpërsia me muret e fortifikimit. Por në të kemi të bëjmë me një zgjidhje të studiuar arkitektonike ku ana estetike përputhet më së miri me anën funksionale dhe statike. Rrafshi i gjatë e pa jetë i murit thyhet prej pilastrave kryq të cilat, krahas anës statike, e gjymtyrizonin atë nëpërmjet efektit dritë-hije në një varg seksionesh. Zvogëlimi i tyre në perspektivë, ritmi i krijuar prej shkëmbimit të hapësirave të zbrazta me ato të plota, i sipërfaqeve me dritë dhe atyre me hije krijonte një lëvizje që humbiste monotoninë e sipërfaqes së gjatë e të rrafshët dhe ngurtësinë e vëllimeve.

Datimi. Shetitorja e II e Dimalit e ndërtuar në shekullin II p.e.s., e datoi shetitoren e I të paktën në shekullin e III p.e.s., Kjo shërben si pikënisje dhe për datimin e shetitoreve të tjera.

Në Bylis shetitorja është e lidhur me murin e agorasë, pra me një kompleks ndërtimesh të tjera ndër të cilët theatri dhe stadiumi datohen nga shtresat kulturore në shekullin e III p.e.s.[106]) Vetë muri i agorasë që përdoret në sfondin e saj me trajtimin me fashatura anësore të blloqeve përkon me përdorimin e këtij stili në shekullin III p.e.s.

Në Butrint shetitorja datohet para theatrit, sepse pjesa perëndimore e saj u prish gjatë ndërtimit të këtij të fundit (fig. 69). Nëqoftëse mbishkrimet e analemës së theatrit, që datohen në shekullin e II

103. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 231, fig 60.
104. J. Coulton, **vep. cit.,** f. 56, 89-90, 124; f. 60, 90.
105. Një përtëritje e lidhjeve me Korinthin në fund të shek. IV p.e.s. vihet re edhe në përdorimin e staterit të tipit korinthas nga Apollonia (H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë, 1965. f. 31).
106. N. Ceka, **Raport mbi gërmimet në theatrin e Bylisit,** 1979, 80, 81, Arkivi Q.K.A.

COPY

p.e.s. shërbejnë si «terminus ante quem» për ndërtimin e theatrit, ky i fundit është vetë i tillë për shetitoren duke e datuar atë të paktën në shekullin e III p.e.s.

La seconde stoa de Dimal présente une construction réalisée simplement (fig. 64). Mais elle conserve les traditions architectoniques d'un type bien formé dans la zone devant Apollonia et le développe davantage par des éléments fonctionnels. D'autre part, en raison des possibilités économiques limitées, dans les conditions de la crise sociale et politique que passait la ville illyrienne au cours du IIe et Ier siècles av.n.ére, la econde stoa de Dimal porte les signes de la déchéance dans la domaine des constructions sociales. Cette stoa, située dans le temps par la présence d'une couche culturelle du IIe et Ier siècles av.n.ère et le trésor de monnaies d'Apollonia de la seconde moitié du Ier siècle av.n.ére découvert sous ses ruines, sert de «terminus ante quem» pour les stoas d'autres zones aussi. Tout d'abord elle atteste que la premiére stoa de la ville doit être du IIIe siècle av.n.ére.

LA STOA DE BUTRINT

Le centre social de Butrint se situait dans le Sud, aux pieds du haut rocher de l'acropole. Entre le rocher et le mur d'enceinte de la fin du IIIe siècle av.n.ére, se creait un plan non tellement large, où menait l'une des entrées principales. Dans cet espace, s'élevaient les constructions sociales de la ville, dont on connait deux temples, la stoa et le théâtre (fig. 65).

La stoa s'appuie contre le rocher, tombant à pic et continue parallélement à lui (fig. 66). Ses éléments étaient plus que simples un mur frontal, devant le rocher, et un toit. C'est le rocher taillé expressément qui servait de mur arriére.

Le mur frontal est fait de blocs rectangles avec des faces plates et de hauteur égale. Tour les 3.80 m le mur est percé par des passages larges de 4.20 m (fig. 67). Sa résistance s'est accrue par le travail des parties intégrales en forme de croix (fig. 68).

Les passages étaient couverts d'arcs faux. A une certaine hauteur le rocher ou aperçoit qu'il a été gravé en vue de créer un appui pour le toit (fig. 70), qui a, sans dout, en un seul versant donnant vers le front. Si l'on admettait, comme d'habitude pour cette époque-là, un toit d'une pente de 20%, le mur frontal serait haut de 3,75 m. Cette hauteur ne permet pas la couverture des passages avec des arcs en forme triangle équilatéral, mais exige sa coupe en haut, en donnant à l'arc une forme de trapéze connue dans les constructions archaiques.

En considérant comme niveau de la place, celui du plancher du temple il ressort que pour le passage dans la stoa il fallait un stylobate de trois marches, dont la présence est témoigné indirectement par la coupe en pente du rocher devant la stoa (fig. 66).

L'entrée de la ville se situait sur le même axe que le temple. Sa situation à cet endroit a été conditionnée par la visée consistant à ouvrir la perspective du centre au regard au moment d'entrer. Dans son traitement on a tenu en considération tout d'abord le fond.

Ces monuments constituant le centre: la stoa, le théâtre, les temples sont traités avec des volumes termés, des murs de blocs de pierre massif, en concordance avec du haut rocher de l'acropole, le regard n'y est pas attire par des compositions particuliéres axiales, mais par des compositions assimétriques, se fondant avec le sfond naturel dans une distribution étudiée de volumes.

Vers le Ier et IIe siècles, devant la stoa, presque jointe à elle, a été construite une habitation à cours peristyle qui lui a couvert la vue. D'autre part, l'architecture de la stoa, influa aussi sur le traitement des constructions des premiers siècles de notre ére. Ainsi, les arcs de fenêtres du temple d'Asclépios, les arcs d'entrées de front de la scène du théâtre et la ouverture du proefurnium des bains centraux, constructions du Ier et IIe siècles ont un traitement similaire aux arcs des passages. De même le temple et la partie de la scène du théâtre ont des volumes de pierre et des faces plates avec des contreforts, créant le même effet que les pilastres en forme de croix du mur de la stoa.

Dyrrah. A Dyrrah, dans le musée archéologique ou conserve un tronc de colonne octoangulaire, sur le front de laquelle se trouvent des cannelures (fig. 72). Les dimensions du tronc montrent qu'il a appartenu à une colonne puissante, et respectivement à un bâtiment plus grand que ceux qu'on a examinés. A part cela, on y conserve aussi un fragment de barriére, comme celui de la seconde stoa d'Apollonia, avec deux plans, l'un avec des losanges et l'autre avec des écailles. Il est possible que deux des fragments ci-dessus aient appartenu à une stoa.

DO NOT COPY

CONCLUSIONS

La stoa apparait comme un des éléments constituants des agoras, où elle occupe une place particuliére. Dans la conception urbaine, elle sert à traiter l'espace du centre de la ville, en le limitant par un ou deux côtés.

La situation des stoas dans le voisinage du théâtre a été un principe connu dans l'urbanisme antique, recommandé par Vitruve et qui a été appliqué dans certaines agoras. Les cas connus appartiennent au IIIe et I siècles av.n.ére, mais à l'exception de Pergame, ce ne sont pas des constructions de même époque. Au contraire dans les stoas d'Illyrie et Epire, cette combinaison est dans la plus grande partie de même époque et l'on voit que cette expérience était ici transformée en un principe d'urbanisme.

La typologie Les stoas d'Apollonia présentent dans ce prisme les deux divisions principales: à une rangée de colonnes et à deux (Tab. I). A l'intérieur de ces divisions principales se classent toutes les autres stoas, bien que non toujours dans un même rapport chronologique avec les stoas d'Apollonia. Ainsi, celle de Dimal (fig. 62) a été traitée avec une rangée de colonnes, bien que son prototype ait été la stoa à deux rangées d'Apollonia. Comme stoa à une rangée à proprement parler, on a celle de Butrint, résolue de façon originale, avec un espace semi-fermé (fig. 67).

Les stoas à une rangée de colonnes sont connues en Gréce, aussi tôt que celles à deux rangées et leur division n'a pas de base chronologique. La premiére stoa d'Apollonia représente une variante évoluée de ce type, par l'emploi même de la forme «L», qui est liée avec l'application du stystéme octogonal. Ce type de stoa est largement utilisée dans les agoras des villes d'Asie-Mineure, durant la période helleniques, tandis que dans la Gréce continentale ou connait une stoa de ce type a proprement parler, à Perahora, près de Corinthe. Elle est datée du IVe siècle av.n.ére. Le fait qu'à Apollonia, la direction des ailes s'adapte tout à fait au systéme octogonal de la ville, témoigne que ce monument constituait l'une des premiéres bases de la solution de ce systéme.

Les éléments architectoniques. Les colonnes de premier étage des stoas d'Apollonia, Bylis, Nikae, sont polygonales. De telles colonnes, comme ou l'a déjà vu, ont été découvertes à Dyrrah, Phoinice et Buthrot. La forme polygonale est connue aussi dans les stoas de Gréce. Ainsi, à part les stoas archaiques on la trouve aussi dans la stoa du Nord d'Assos, dans la stoa du Nord-Est du temenos d'Athénes à Pergam et la stoa en forme de «L» dans l'agora de Délos. Mais en elles cette forme peut être considérée d'origine de l'ordre dorique ancien, lorsqu'on ne gravait pas de cannelures ainsi elles sont de seize angles et ont un chapiteau dorique, et ce qui est essentiel c'est que ces stoas sont moins anciennes, elles datent du IIe siècle. Différement à elles, les colonnes d'Apollonia sont octogonales et non pas de seize angles et en plus la visée de créer une forme nouvelle se voit même dans le traitement du chapiteau. Même si l'abaque reste un abaque et l'échine une échine, cette derniére n'a pas la forme de tronc conique mais pyramidal et l séparation du corps par le chapiteau n'est par indiquée pc des canaux mais par torus. Ainsi, bien que la colonne conserv encore quelques traits de l'ordre dorique, on peut dire qu'ell s'en dettache qualitativement pour créer un type à part. Dan certaines des stoas helleniques du début du IIe siècle, on utilisé des chapiteaux lotus et palmes. Ce sont des stoas, ave lesquelles la seconde stoa d'Apollonia a assez de côtés com muns, comme l'odre ionique à l'étage supérieur, les parapet en forme de losange etc. Ainsi, il ne serait pas imposible qu même ce type de colonne ait pris en considération le «pro todorique» égyptien, avec lequel le tronc de la colonne pré sente des similarités.

Dans les stoas ci-dessus les colonnes, palmes ou lotus, s cachent à l'intérieur, tandis qu'à l'extérieur se trouvent unique ment des colonnes classiques, doriques ou ioniques. Au con traire, à Apollonia le nouveau style, apparait avec courage dans la rangée extérieure, conséquent à ses valeurs esthétique (Tab. II), ce qui montre qu'on n'y a pas à faire à une solutior due au hasard, mais à une recherche consciente de formes e de types.

L. Rey a attiré l'attention vers le chapiteau ionique, mai en considérant pour principal la simplicité de forme, en trou vant des paralleles à Patice en Macédoine, Olympie etc. Ce qui caractérise ce chapiteau et qui le distingue qualitativemen des exemples de Macédoine, ce n'est pas le traitement simple rigide et sans mouvement comme les chapiteaux ci-dessus. Au contraire dans tous les éléments, et parties supérieures, il se soumet aux inclinaisons légéres, élégantes qui ne dérangen pas le regard et évitent la séchéresse des formes (fig. 36). Le chapiteau est sans doute réalisé par les mains d'un artiste qui a eu du goût. Basé sur de simples éléments floraux, bourgeans, rameaux, fleurs, avec de légers mouvement il a réussi à créer un décor reussi architectonique.

L'intercolumnus de la rangée extérieure de colonnes de la seconde stoa d'Apollonia et de Bylis, égal à celui de la rangée intérieur est un phénoméne habituel pour les stoas, datant d'avant le IVe siècle av.n.ère où l'entablement était de bois. Par la suite, nous rencontrons ce phénoméne seulement à la stoa Est du gymnase d'Olympie, datant du IIe siècle av.n.ère. La disparition de ce phénoméne aprés le IVe siècle av.n.ére, s'explique par le remplacement de l'entablement de bois par celui de pierre, qui ne pouvait supporter des intercolumn plus grands que 3 m. En conséquence les colonnes extérieures se multipliérent, tandis que les intérieures gardérent leur premier pas. Le but des constructeurs, dans ce cas, n'était pas la division de la stoa en deux pistes particuliéres, mais il consistait à soutenir la structure du plafond ou bien du toit, au moyen de colonnes rares. Au contraire, dans la stoa d'Apollonia, on visait tout un autre but, son petit intercolumnus extérieur, est reflété complétement sur celui intérieur (Tab. I). Mais comme on l'a déjà vu, au-dessus de lui s'exerçait une charge stable de mur: la séparation de l'étage supérieur. Toutefois, il faut mettre en relief que les constructeurs n'ont pas dévie de la

séparation claire des deux pistes de l'une l'autre, au moyen de l'intercolumnus bien tassé.

L'un des traits distinctifs de la premiére stoa d'Apollonia de ses pareilles antiques, est le traitement du fond en forme d'un mur à niches. La niche est une forme rarement utilisée dans l'architecture grecque. La seule stoa antique où l'on utilise la niche est la stoa des italiennes. Mais elle ne crée pas un fond régulier et se combine avec des parties droites et des creux quadrangulaires du mur de fond. De pair avec cela, ce qui est principal, c'est que la stoa d'Apollonia du IVe siècle a la priorité dans le temps à l'égard de la stoa des italiens, datée des années 110-88 environ. Deux exedres se trouvent aussi à la stoa de Celydon mais elle se situent sur la extrémités du monument et n'ont pas cette conception claire architectonique comme à Apollonia, consistant à briser la monotonie d'un long mur et créer un structure plus stable. De même stoa de Calydon, du IIIe et IIe siècles av.n.ère, date 1-2 siècles plus tard que la premiére stoa d'Apollonia. Enfin la couverture des niches par des colattes sphériques, bien que non à proprement parler, on ne l'a rencontre nulle part ailleurs. Ceci montre qu'Apollonia est l'un des premiers endroits où lon a fait usage de formes absidales.

La seconde stoa contient des éléments du développement complet de ce type de monument, comme c'est l'utilisation de deux rangées de colonnes et la construction à étage supérieur. Le type de stoa à étage supérieur est connu à Athénes des le second quart du IV siècle av.n.ére, lorsqu'on construit la stoa d'Ascleption, mais les paralléles les plus soulignées avec Apollonia, se trouvent dans la stoa de Perahora, prés de Corinthe, construite vers les années 300 av.n.ére environ. On y trouve la même combinaison du dorique à l'étage intérieur, et du ionique à l'étage supérieur et l'usage de semi-colonnes et de parapet à plaques en reliefs de losanges et crosilliones. Les autres cas se liens avec l'école de Pergam et appartiennent au IIe siècle av.n.ére.

La seconde stoa d'Apollonia, témoigne d'un lien direct avec les stoas corinthiennes du IVe siècle av.n.ère, et cela est tout à fait compréhensible dans les rapports culturels entre un métropole et une colonie. Seulemest on n'y a pas à faire à une imitation mais à des traitements créateurs sur la base d'une tradition architectonique. On y prend en considération tout à niches, des formes cylindriques à celles absidales, qui créaient une structure stable et esthétique.

La stoa d'Apollonia a servi de modéle aux stoas des cités illyriennes. Plus prés c'est celle de Dimal, qui est presque une reprise en miniature particuliérement en ce qui concerne le sfond architectonique à niches. La stoa de Bylis (fig. 54) s'est approprié de la première stoa d'Apollonia le schéma planimétrique à deux ailes, en forme de «L», et de la seconde, l'usage de colonnes octogonales. Seulement à Bylis ces colonnes sont allongées. Ce phénoméne se répéte à Nikae.

La seconde stoa de Dimal (fig. 63) présente le développement ultérieur des stoas sans suivre le critére de monumentalité. Bien que sans valeurs architectoniques particulieres, cette stoa témoigne que ce type de monument devint partie du fond architectonique des villes illyriennes.

La stoa de Butrint constitue un type à part inconnu ailleurs. Ses éléments sont simples. Mais on y a à faire à une solution architectonique étudiée, où le côté esthétique est conforme au côté fonctionnel et statique. Le plan long et sans vie du mur est brisé par des pilastres en croix qui, à part le côté statique, le démembraient, au moyen de l'effet ombre-lumiére, en une série de sections. Leur diminution en perspetive, le rythme crée par le rocher des espaces vides et ceux pleins, des surface éclairées et celles dans l'ombre, créait un mouvement qui perdait la monotonie de la surface longue et plate et la rigidité des volumes.

Datation. La stoa de Dimal construite au IIe siècle av.n.ére, en datant la première stoa au moins du IIIe siècle av.n.ére, sert de point de départ même à la datation d'autres stoas.

A Bylis, la stoa est jointe au mur de l'agora, donc à un complexe d'autres constructions, entre autres le théâtre et le stade datant des couches culturelles du IIIe siècles av.n.ére. Le mur de l'agora même utilisé dans son fond, par le traitement a bandes latérales des blocs, correspond à l'emploi de ce style au IIIe siècle av.n.ére.

A Butrint, la stoa est datée avant le théâtre, parce que sa partie ocidentale a été détruite au cours de la construction de ce dernier (fig. 69). Si les inscriptions du théâtre, datant du IIe siècle av.n.ére, servent de «terminus ante quem» pour la construction du théâtre, ce dernier est la même chose pour la stoa qui doit être construite au moins au IIIe siècle av.n.ére.

Les stoas d'Apollonia ont seulement un rapport chronologique relatif entre elles. Les fouilles n'ont pas fourni une base certaine de datation et nous pouvons uniquement nous eppuyer sur l'analyse architectonique. Les comparaisons avec les stoas du monde antique mettent en évidence un parallélisme clair avec la stoa de Perahora datée de la fin du IVe siècle av.n.ére. On comprend bien aussi que la seconde stoa d'Apollonia a une priorité chronologique sur celles de Dimal et Bylis, qui s'approprient des éléments planimétriques et architectoniques d'elle. Elle peut être située pour cette raison dans les limites de la première moitié du IIIe siècle av.n.ére. Même la technique de construction avec des blocs des conglomerait poreux avec des fossiles correspond avec cette époque. Avec cette espéce de pierre, en faisant usage du style à faces plates et coupe des côtés des blocs est construit le mur d'enceinte sur le côté Est d'Apollonia, datant du IVe siècle av.n.ére. Dans les constructions de la seconde moitié du IIIe siècle av.n.ére, comme le mur du souténement du côté oriental ou nymphaeum entre en usage la pierre sablomeuse traité avec les bandes latérales ou l'on utilise le monogramme de Damosias. Ceci peut nous servir de «terminus ante quem» pour la seconde stoa d'Apollonia.

La première stoa d'Apollonia constitue dans ce rapport la construction le plus ancienne de ce type de monument connu dans notre pays. Elle doit être detée du Ve siècle av.n.ère, plutôt

DOKTORAT

de la seconde moitié de ce siècle, comme le témoignent l'utilisation de la colonnade dorique de type héllénique et le rapport chronologique à l'égard de la seconde.

Place des stoas dans la vie sociale. La plus grande partie des stoas connues dans notre pays appartiennent à la seconde moitié du IVe siècle et au IIIe siècle av.n.ére. C'est aussi la période de l'épanouissement économique et politique de ces centres, du développement de la vie sociale sur la base d'un démocratie esclaviste. Leur construction est liée précisément aux besoins d'une vie urbaine. La création de volume spacieux couverts à Apollonia, Bylis, Dimal etc. donnait lieu au déploiement d'activités politiques culturelles et économiques d'une large masse de citadins, comme on l'entend par la taille de ces monuments. C'est aussi le temps de la stabilité économique et p litique en Illyrie, du renforcement de l'Etat illyrien et de l'incl sion dans son sein de Dyrrah et peut-être d'Apolloni. Même l cités illyriennes, ou cours de côté période connaissent u période de renforcement économique, de frappe de mo naies autonomes et de formation d'institutions politiqu urbaines. C'est à cette période qu'appartiennent aussi l constructions principales urbaines: murs d'enceinte, tomb monumentales et bâtiments sociaux. Parmi ces dernie le stoas occupent une place particuliére. Elles sont liées l'une l'autre en vue d'exploiter un fond commun architectoniqu où la créativite d'Apolloni joue un rôle de premiers ordre.

DO NOT COPY

HALIL MYRTO

DO NOT COPY

I. HARTË E MONUMENTEVE DHE E GJURMËVE ANTIKE E MESJETARE TË RRETHIT TË DURRËSIT *)

Qyteti antik i Durrësit ka tërhequr vëmendjen e studiuesve kryesisht që mbas mesit të shekullit të kaluar, ndonëse ndonjë informatë për të kanë lënë edhe udhëtarë, historianë e gjeografë të mëparshëm. Ndër studiuesit e huaj, të shekullit të kaluar dhe të këtij shekulli, që kanë lënë përshkrime e kanë kryer studime për topografinë dhe monumentet e njohura antike të këtij qyteti dhe rrethinave të tij, shquhen Han, Hezej, Prashniker e Shober, Fajt, Rej, Sestieri.

Deri para çlirimit, megjithatë, harta arkeologjike e këtij rrethi do të paraqitej tepër e varfër. Arkeologët e huaj, që krahas Durrësit u kushtuan vëmendje edhe monumenteve e zbulimeve të rastit të bëra në pastokën e tij, arritën ta njihnin vetëm pak tablonë e vërtetë arkeologjike të kësaj zone. Ata mundën të vrojtonin vetëm atë çka u kishte shpëtuar rrebesheve të shekujve dhe që gjendej në vende të dukshme. Por nëntoka këtu ruante mjaft të panjohura që i shfaqi vetëm pas çlirimit të vendit. Në fillim për këtë kontribuan shpyllëzimet, bonifikimet e punimet e thella me mekanizma bujqësore, që përdoreshin për herë të parë në vendin tonë.

Muzeu Arkeologjik i Durrësit, megjithë angazhimin e tij në zbulimet e mëdha, si amfiteatri, termet, nekropoli antik etj.[1]) mori masa që në fillim dhe për kontrollin e punimeve me karakter joarkeologjik dhe për shpëtimin e objekteve me interes. Ky kujdes nuk u kufizua vetëm brenda qytetit, por u shtri edhe në periferinë e tij dhe në të gjithë rrethin. Në rrethin e Durrësit janë organizuar ekspedita përnjohëse e ndonjë gërmim edhe nga Muzeu Arkeologjik dhe Etnografik i Tiranës, me pjesëmarrjen e arkeologëve Hasan Ceka e Skënder Anamali. Po ashtu këtu janë kryer punime restauruese dhe studime, sidomos për monumentet e mesjetës, nga ana e punonjësve të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Pirro Thomo Gjerak Karaiskaj e Aleksandër Meksi.

Që nga viti 1971 ekspeditat përnjohëse që janë organizuar nga Muzeu Arkeologjik i Durrësit, tej qytetit, në rrethin e tij, kanë pasur si qëllim të veçantë përpilimin e një harte të monumenteve dhe gjurmëve të kulturës materiale. Në këtë artikull do të përmbledhim pikërisht rezultatet e gjurmimeve të bëra në këtë rreth (duke përjashtuar qytetin dhe periferinë e tij) gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit. Materiali që do të trajtojmë është përftuar kryesisht nga gjetje rasti, nga operacione shpëtimi dhe nga ndonjë gërmim-provë. Do të përfshijmë këtu shkurt dhe monumentet e njohura më parë.

+). Në këtë artikull janë përfshirë zona e Ishmit, zona fushore e Erzenit të poshtëm dhe zona kodrinore e Shijaut. Zona e Kavajës, do të jepet në numrin e ardhshëm.

1. V. Toçi, **Të dhëna mbi topografinë dhe elementin ilir në Dyrrah nën dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike, Nëntor 1962, Tiranë 1965; **Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahit,** B.Sh.Sh. 1962, 2; **Të dhëna mbi elementin ilir në Dyrrah në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** St. hist. 1972, 2.

Para se të fillojmë përshkrimin e pikave që kemi vizituar dhe të objekteve të njohura apo të zbuluara rishtaz, le t'i hedhim zonës një vështrim të shkurtër gjeografik.

Zona që kemi në studim, bën pjesë në ultësirën Perëndimore të vendit tonë.[2]) Nga pikëpamja gjenetike, kjo është një ultësirë sedimentare që ka filluar të formohet qysh në miocenin e mesëm, ka marrë pak a shumë trajtë në pliocenin e poshtëm në kurriz të detit dhe është në zhvilim e sipër. Kjo është kryesisht një zonë fushore e përshkruar nga kurrize të ulëta kodrinore. Në të vërehen lëvizje uljeje dhe ngritjeje.

Kodrat janë të përbëra prej rranorësh, konglomeratësh dhe argjilesh neogjenike. Ato paraqiten në formë vargjesh me drejtim veriperëndim-juglindje. Midis tyre zgjaten brazda të gjera në formë luginash. Faqet e kodrave janë të veshura me shkurre dhe dushkaja. Karakteristikë e tyre është dukuria e shpeshtë e rrëshqitjes.

Në këtë rreth dallohen tri zona kodrinore. (HARTA 1). Zona e parë është ajo lindore, që fillon me Kepin e Rodonit edhe që duke vazhduar në drejtim të juglindjes, përfshin malësinë e Krrabës në rrethin e Tiranës.

Kjo zonë kodrinore përçahet tërthor prej katër luginash, që në të njëjtën kohë përbëjnë dhe rrugë kalimi të favorshme për lidhjen e bregdetit me zonat e brendshme. Lugina e parë e tërthortë ndodhet përballë Krujës dhe është një shtrat i vjetër i lumit të Zezës, që dikur derdhej në Erzen. E dyta gjendet përballë Tiranës. Kjo dikur ka qënë shtrat i lumit të Tiranës, që po ashtu derdhej në Erzen. Luginën e tretë tërthor këtyre kodrave e formon lumi i Erzenit, kurse lugina e katërt është ajo e Shkumbinit të Poshtëm.

Zona e dytë kodrinore ndodhet në perëndim të së parës dhe ka më tepër drejtim veri-jug. Ajo përfshin Bishtin e Pallës (71 m lartësi), malin e Durrësit (188 m) dhe, pas një ndërprerje në gjirin e Durrësit, vazhdon me kodrat e Kryevidhit apo Kepin e Lagjit.

Midis këtyre dy zonave kodrinore ndodhet ajo e kodrave në perëndim të Erzenit të Poshtëm, që arrin lartësinë absolute 450 m. Te kjo përfshihen dhe kodrat e Kavajës.

Gjithë zona fushore e rrethit të Durrësit gjeografikisht ndahet në dy fusha të vogla: ajo e Erzenit të Poshtëm dhe ajo e Kavajës. Fusha e Erzenit t Poshtëm ka një pjerrësi të lehtë në drejtim të deti Është krejtësisht e sheshtë, me vetëm disa kodr të ulëta e të buta, si kodrat e Shijakut (105 m) n lindje të Erzenit dhe një antiklinal kodrinor (35 i lartë) në perëndim të lumit. Ky përfshin kodra e Shënavlashit, të Rrashbullit dhe të Arapajt. Toka janë të hinjta-kafe-livadhore dhe aluviale-livadhore

Fusha e Kavajës kufizohet nga veriu dh lindja prej kodrave të Kavajës. Nga perëndimi aj kufizohet pjesërisht prej detit Adriatik dhe kodrav të Kryevidhit, kurse në jug atë e ndan, si nj nënjësi më vehte brenda fushës së Myzeqesë, lum i Shkumbinit. Në pjesën veriore kjo fushë ndahe prej lumit të Darçit dhe prej përroit të Kavajës (ap Leshniqes).

Bregu i detit në pjesën më të madhe është vazhdim i zonës së ulët dhe si i tillë paraqitet sheshtë. Ai ndërtohet nga rëra të kohës së sotme të cilat përbëjnë ranishte me gjerësi 100-200 m Gjatë bregut shtriheshin dikur laguna, si ajo Durrësit dhe si këneta e Bishtarakës në grykë derdhjen e Erzenit. Në bregdet vërehen dhe rrip rëre e duna. Si rezultat i aktivitetit të madh depo zitonjës të detit dhe i prurjeve të shumta të lu menjve, vija bregdetare ndryshon me shpejtësi. K fenomen favorizohet dhe nga amplituda e dobë e mareve. Në këtë mënyrë, është llogaritur p.sh se zona e veprimit të grykëderdhjes së Shkumbini gjatë këtyre 70 vjetëve të fundit është zgjerua në kurriz të detit me një mesatare vjetore pre 5-6 m.[3])

Me rëndësi për hartën arkeologjike të kësa zone është diskutimi i rrjedhjes së lumenjve. T gjithë studiuesit që janë marrë me këtë problem pajtohen me mendimin se vijat e rrjedhjes së lu menjve në Ultësirën Perëndimore dhe grykëderdhje e tyre kanë pësuar dhe pësojnë ndryshime vazh dimisht. Kjo është një dukuri e shpjegueshme ng vetë karakteri i ultësirës, i vijës bregdetare dhe veprimit mbushës së lumenjve në grykëderdhjet tyre.

Përsa i përket kahjes së spostimit, nuk duke e pranueshme teza se këta lumenj në drejtimin derdhjes së tyre për në det kanë pësuar spostim vetëm nga e djathta në të majtë;[4]) spostime kan

2. Të dhënat mbi gjeografinë dhe gjeologjinë e zonës i kemi kryesisht simbas. P. Geço, **Gjeografia fizike e Shqipërisë,** Tiranë 1973 dhe **Gjeologjia e Shqipërisë,** tekst shoqërues i hartës gjeologjike të Shqipërisë, Tiranë, 1970.

3. S. Boçi, **Studim topografik i dinamikës së vijës bregdetare nga Vjosa në Mat,** disertacion në Katedrën e Gjeologjisë të U.SH.T. 1981.

4. G. Veith, **Der Feldzug von Dyrrhachium Zëschen Caesar und Pompeius,** Wien, 1920, f. 31.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


HARTE
E MONUMENTEVE DHE E GJURMEVE ANTIKE E MESJETARE TE RRETHIT TE DURRESIT.
DETI ADRIATIK
DURRESI
KAVAJA
RRETHI I TIRANES
RRETHI I ELBASANIT
RRETHI I LUSHNJES
ARDUZHINA
Shpjegim
TUME ILIRE
FORTIFIKIM ILIR
GJETJE TE RASTIT
GJURME RRENOJASH
DETAJ ARKITEKTONIK
MBISHKRIM
VARRE ANTIKE
TRAKT I RRUGES EGNATIA
TRAKT I UJESJELLESIT ANTIK
PUSETA TE TUNELIT TE UJESJELLESIT ANTIK
KALA MESJETARE
URE
KISHE OSE RRENOJA KISHE

ndodhur edhe në drejtimin e kundërt.[5]) Gjurmët dhe radha e këtyre spostimeve gjeologjikisht janë të vërtetuara, herë herë ato janë edhe të dukshme, por datimi i tyre është ende i diskutueshëm.

Rrjedha e Shkumbinit është diskutuar më tepër. Në të kaluarën është shfaqur mendimi se Shkumbini në periudhën antike kalonte nëpër fushën e Kavajës, njësohej me Darçin për t'u derdhur në gjirin e Durrësit dhe se spostimi i tij në shtratin e sotëm ka ndodhur në periudhën e vonë antike.[6]) Ky mendim ka pasur pasonjës,[7]) ka edhe në ditët tona.[8])

Me anë të sondimeve është gjetur me të vërtetë një shtrat i vjetër i Shkumbinit, apo i një dege të tij, deri në afërsi të Luzit.[9]) Por më tej kjo nuk provohet. Këtu duhet vënë në dukje edhe fakti se lumi i Darçit ka shtratin e vet dhe nuk rrjedh në shtratin e ndonjë lumi më të vjetër.[10])

Pa vënë në dyshim rolin e Shkumbinit në formimin e fushës së Kavajës në periudhat prehistorike, kalimi i tij në këtë fushë në periudhën antike nuk na duket i provuar. Jemi më tepër për mendimin se ai edhe në antikitet deri pranë Bashtovës ka kaluar në shtratin e tij të sotëm.[11]) Këtu, natyrisht nuk mund të kundërshtohet ndonjë bryl i tij në drejtim të fushës së Kavajës, rezultat i të cilit në antikitetin e vonë mund të ketë qënë p.sh. këneta e Zhabjakut.

Për mbështetjen e mendimit se shtrati i vërtetuar i Shkumbinit deri pranë Luzit i përket periudhave prehistorike, vlejnë edhe të dhënat arkeologjike. Kështu, shtresat kulturore të shekujve të parë të erës sonë në Luzin e Vogël, në Luzin e Madh e në Rogozhinë arrijnë 1-1.80 m (shih më poshtë), ndërsa ngritja që ka pësuar fusha në vendin e kthesës së rrjedhjes së dikurshme arrin 5 m.[12])

«Shtrati i vdekur» i Shkumbinit që evidentohet në veriperëndim të kalasë së Bashtovës, jo shumë larg rrëzës së kodrave, në drejtim të kënetës së Rreth-Grethit (Harta 2), mendojmë se përfaqëson rrjedhjen e tij në kohën antike.[13]) Me këtë përfundim duket se pajtohen edhe të dhënat e gjeografit të lashtë, Ptolemeut, i cili distancën e gjerësisë gjeografike të grykëderdhjes së lumit Panaysos (që duhet të jetë Genusi) e cakton baraz me 15' nga Dyrrahi.[14]) Në hartat tona gjerësia gjeografike e kënetës së Rreth-Grethit është 41° e 5', kurse ajo e Durrësit 41° e 20'. Po ashtu 15' minutat e Ptolemeut, duke qënë afërsisht baraz me 16 milie romake, që bëjnë 24 km, na japin përsëri distancën në vijë të drejtë prej Durrësit deri në afërsi të kënetës së Rreth-Grethit.

Në lindje të kalasë që nga shekulli III e.s. shtrati i Shkumbinit nuk duhet të ketë pësuar ndryshime.

Përroi i Leshniqes, që njihet gjithashtu me emrin «Përroi i Kavajës», duket se nuk e justifikon veten për t'u identifikuar me lumin Palamnus,[15]) që përmend Skylaksi në jug të Durrësit.[16]) Megjithatë një përrua i vogël pranë fshatit Tilaj, disa kilometra më në veri, që thërritet «Palamà», na duket me interes nga kjo pikëpamje. Ndoshta ky përrua derdhej dikur në Leshniqe, që mund të ketë pasur rrjedhën e vet më nga veriu, dhe atëhere hidronimi «Palamà» ruan vetë emrin e Leshniqes së lashtë.

Relievi i rrethit të Durrësit pas çlirimit ka pësuar mjaft ndryshime, sidomos nga një numër veprash bonifikuese dhe ujitëse. Ndër këto mund të përmendim tharjen e kënetës së Durrësit, kanalin ujitës Peqin-Kavajë, liqenet artificiale dhe rezervuaret, si ai i Okshtunit, i Shkallmurit, i Rubjekës, i Tarinit etj.

Nga pikëpamja e komunikimit tokësor, të gjitha pikat e këtij rrethi janë të arritshme pa vështirësi. Rrugët tradicionalisht ndjekin rrëzën e kodrave, por nuk mungojnë të dhënat edhe për rrugë të vjetra

5. N. Luli, S. Boçi, **Studim i lëvizjes së vijës bregdetare nga pikëpamja topografike,** Bul. Shk. Nat. 1966, 2, f. 119-120; shih dhe **disertacionin e sipërpërmendur** të S. Beçit, veçanërisht lidhur me rrjedhjen e Shkumbinit.
6. G. Veith, **vep. cit.,** f. 38.
7. C. Praschniker, **Musakhia und Malakastra,** Wien 1920, f. 125-126.
8. N. G. L. Hamnod, **A history of Macedonia,** vol. I, Oxford 1972, f. 23, 26, po ashtu N. Luli, S. Beçi, **vep. cit.**
9. S. Beçi, **vep. cit.**
10. Për këtë shih dhe G. Veith, **vep. cit.,** f. 36-37.
11. H. Ceka, Dega, **Dega jugore e rrugës Egnatia,** «Monumentet» 2, Tiranë 1971, f. 29.
12. N. Luli, S. Beçi, **Vep. cit.,** f. 116.
13. Për ekzistencën e një shtrati të tillë, shih S. Boçi, **vep. cit.** (rrjedhja nr. 5 në hartën e tij) si dhe Gj. Karaiskaj **Kështjella e Bashtovës,** «Monumentet», 5-6, 1973, f. 59.
14. Ptolemeu, **Geographia,** III, 12, 2.
15. G. Veith, **vep. cit.,** f. 39.
16. Skylaksi, **Periplus,** 26.

DO NOT COPY

përmes fushave. Vendkalimet më të lehta për të kapërcyer vargjet e kodrave që e mbyllin këtë zonë, janë ato të brazdave luginore që i përmendëm më lart. Por ekzistojnë edhe rrugë të tjera të dorës së dytë që përshkojnë kurrizin e kodrave.

Nga përshkrimi gjeografik që paraqitëm më lart, treva ku kemi kryer gjurmimet tona duket se përbën pikërisht atë çka do të mund të quhej pastoka e mirëfilltë e Dyrrahut antik. Për këtë siç duket ekziston edhe një traditë, që vërtetohet me të dhëna nga topografia antike. Asparagu, qytezë mbi Genus (Shkumbin) quhet Asparagium Dyrrhachinorum.[17] Po ashtu edhe Ishmi në antikitet quhet Isamnus Dyrrhachinorum.[15]

Me këtë, nuk kemi për qëllim të theksojmë se kufijtë administrativë të rrethit të sotëm të Durrësit përcaktojnë një zonë që ka qënë gjithmonë e lidhur politikisht me qytetin. Në periudha të ndryshme historike kufijtë e pushtetit politik të Durrësit kanë qënë shumë më të ngushta. Po ashtu, ka pasur periudha historike që krahina me qendër administrative Durrësin ka qënë shtrirë shumë më tej këtyre kufijve. Por nga ana ekonomike kjo është zona që vetë të dhënat gjeografike ia kanë kushtëzuar më tepër lidhjen me qytetin dhe anasjelltas.

PËRSHKRIMI I MONUMENTEVE DHE I GJURMËVE ARKEOLOGJIKE ZONA E ISHMIT

Kjo zonë përfshin vargun e kodrave që ngrihen në krahun e majtë të rrjedhjes së poshtme të Ishmit dhe që zgjaten drejt veriperëndimit për të formuar kepin e Rodonit. Toka e butë e këtyre kodrave, lugina e Ishmit bashkë me të mirat e tjera të lumit si dhe bregu i detit kanë përbërë këtu gjithmonë kushte të favorshme për jetën njerëzore. Kepi i Rodonit, nga ana e tij, i futur thellë në det midis gjirit të Drinit dhe atij të Lalzës, merr një pozitë kontrolluese mbi bregdet dhe ia shton rëndësinë gjithë zonës. Përkshrimin e vrojtimeve tona do ta fillojmë pikërisht nga pika më ekstreme e kepit.

1. KALAJA E SKËNDERBEUT

Njoftimin e parë mbi ndërtimin e kësaj kalaje e kemi prej Barletit.[19] Një skicë e thjeshtë e planimetrisë së saj është dhënë prej Coronelit, kartograf i Republikës së Venedikut (Tab. I, 3).[20]. Sipas kësaj skice planimetrike, kalaja ka pasur një formë drejtkëndëshe, me katër kulla katrore në qoshe dhe me nga një në mesin e mureve gjatësorë. Më pas kalanë dhe vendin e ngritjes së saj, «Currila» e përmendin disa autorë.[21] Një vëmendje të veçantë gjithë qendra të banuara mesjetare të kepit të Rodonit u ka kushtuar prof. Alen Dyselje.[22]



17. Caes. **B. Civ.**, III, 30, 76.

18. Vibius Sequester, Cituar nga S. Anamali në kumtesën «Mbi toponominë antike në rrethin e Durrësit» majtur në sesionin shkencor të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, 1979.

19. M. Barleti, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë 1964, f. 483.

20. M. V. Coronelli, M. Vincenze, **Citta, fortezze ed altri luoghi principali dell'Albania, Epiro e Livodia.**

21. Relacion anonim mbi Shqipërinë (1570) **Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë,** vëll. IV, Tiranë 1967, f. 108-140; L. Rey, **Albania,** 4, f. 94-95; F. Noli, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë 1962, f. 74, 88, 99.

22. A. Ducullier, **La façade maritime de la principaute des Kastriotes de la fin** dhe Konf. e dytë e Stud. Alb. I, Tiranë 1969, f. 121-153; **Gjendja e kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumentave raguzane,** «St. Hist», 1977, f. 123-132.

DO NOT COPY

Sot nga kjo fortesë ka mbetur vetëm një pjesë e vogël e mureve dhe pirgu (kryekulla) me lartësi 10 m (Tab. I 1, 2). Disa vjet më parë mbi këto mbetje ka paraqitur një studim Pirro Thomo.[23] Autori i mbështetur në burimet historike dhe në të dhënat arkitektonike, e daton ndërtimin e kalasë nga Skënderbeu pas rrethimit të parë të Krujës, d.m.th. aty nga viti 1451. Ajo shkatërrohet më 1467 nga sulltan Mehmeti II dhe rindërtohet nga venecianët 33 vjet më pas më 1500. Në atë studim shfaqet mendimi se është vështirë që kalaja të jetë ngritur mbi një bazë të hershme.[24]

2. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE

Jo më tepër se 300 m në verilindje të kalasë, mbi shpatin e lartë që ngrihet thikë mbi det, kemi konstatuar një pjesë të vogël muri të ndërtuar me tulla katrore (0.44 x 0.44 x 0.085 m) të lidhura me baltë. Aty kemi mbledhur fragmente tullash e tjegullash solene (Tab. I, 5), fragmente enësh tryeze me vernik kafe si dhe një lakrimore balte të tipit boshtor (Tab. I, 4) objekte këto që mendojmë se u përkasin shekujve III-I p.e.s.

Tulla me përmasat që përmendëm dhe prej së njëjtës baltë e pjekje janë dhe disa nga ato që formojnë kornizat e kluasonazhit në muret e kalasë. Mendimi ynë është se këto janë material i ripërdorur prej mbetjeve të një konstruksioni antik.

Ka mundësi, gjithashtu, të ripërdorura të jenë edhe disa blloqe kuadratike, që shihen në radhët e poshtme të mureve të kësaj kalaje, sidomos pranë portave (Tab. I, 6). Ndër këto blloqe ka me përmasa 0.68 x 0.68 x 0.59 m. Karakteristikë e tyre është se paraqesin një rryp apo kornizë të skalitur anash, ndërsa pjesën qëndrore e kanë gufmuar, teknikë kjo e njohur në kalatë e afërta ilire të Zgërdheshit e të Lezhës.

3. KISHA E SHËN NDOUT. Ndodhet rreth 1 km në juglindje të kalasë, pranë bregut të detit. Ajo qëndron ende në këmbë. Është një kishë njënefshe, me planimetri katërkëndëshe. Nga stili i afrohet ndërtimeve romanike,[25] kurse një sërë elementesh të veçantë arkitektonikë e lidhin atë me ndërtimet bizantine.[26]

4. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Pranë kishës së Shën Ndout dhe rreth 80 m prej bregut të detit, në thellësinë 0.50 m shihet faqja e sipërme e një pjese muri, të ndërtuar me blloqe të mëdhenj e mesatarë, pa llaç. Ky e ka gjerësinë 2 m dhe duket se zgjatet në drejtimin veri-jug paralele me vijën e bregut.[27]

Si përfundim, themi pa ngurim se zona më ekstreme e kepit, Muzhla, siç quhet nga vendasit, ka qënë e banuar në antikitet. Pa bërë gërmime, natyrisht nuk mund të jepet një gjykim i saktë mbi karakterin e ndërtimeve që përfaqësohen nga gjurmët që përshkruam. Megjithatë, pozicioni strategjik i vendit na lejon të supozojmë se duhet të ketë qënë i fortifikuar edhe në antikitet, sikurse në mesjetë.[28]

Mendimi i shfaqur nga arkeologu H. Ceka se toponimi i këtushëm ruan emrin e një hyu ilir, ndoshta emrin e hyut të detit,[29] i përforcuar dhe nga një mbishkrim i zbuluar në Salento të Italisë që përmend paralelisht emrat e dy anijeve ilire «Medaur» dhe «Redon»,[30] na lejon të bëjmë edhe një supozim tjetër.

Gjurmët e ndërtimeve antike që përmendëm më lart, sidomos ato mbi shpatën e thiktë të bregut pranë kalasë, një pozicion ky që sheh një horizont të gjerë mbi det, mund të përfaqësojnë ndoshta mbetje të një tempulli. Kishat e ngritura këtu në mesjetë, veçanërisht ajo e Shën Kollit (mbrojtësi i detarëve dhe i lundrimit), na duket gjithashtu se mëshojnë në një traditë të hershme kulti.

SHETAJ (Fshati më skajor mbi kepin e Rodonit)

23. P. Thomo, **Kalaja e Skënderbeut në kepin e Rodonit,** «St. Hist». 1967.
24. **Po aty,** f. 147.
25. K. Jireçek. **Po. aty.**
26. P. Thomo, **Art. cit.**
27. Në faqet e një kanali me thellësi 1.20 m, që nis jo larg këtij trakti muri dhe që u afrohet deri 7-8 m mureve të kishës, vërehen dy shtresa të qarta kulturore: e poshtmja, me trashësi rreth 0.40 m, përmban fragmente tjegullash, amforash e enësh të tjera antike. Mbi këtë dallohet një shtresë dheu me mbeturina të theksuara djegje e kocka njerëzish. Shtresa e sipërme që ka një trashësi mesatare prej 0.50 m, përmban fragmente qeramikash mesjetare. (Për objektet arkeologjike të mesjetës së hershme shqiptare, të gjetura në kepin e Rodonit, shih **Historia e Shqipërisë,** Tiranë 1959, f. 167).
28. Për mendimin se Skëndrebeu nuk bëri veçse shtesa mbi një kala më të hershme, shih I. Zamputi, **Kontribut për historinë e Shqipërisë,** shek. XVI, «St. Hist». 1964/I
29. H. Ceka, **Bust i mbretit Gent apo figurë mitologjike ilire,** «Iliria» VI, 1976, f. 142.
30. Pagliara, **La grotta Percinara al Capo di S. Maria di Leuca-I: Le iscrizioni** — estratte da annali dell 'Universita di Lecce vol. VI, Salentina-Calatina 1973 f. 27-28.

Provoret

DO NOT COPY

5. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE

Mbi shpinën e një kodre të butë, që njihet me emrin Kodra e Lulit dhe që ndodhet ndërmjet këtij fshatit e kalasë së Skënderbeut, vihen re disa blloqe të mëdhenj gurësh. Shpina e kodrës është e zhveshur pa ndonjë kreshtë shkëmbore dhe vendosja e tyre nuk duket pa ndonjë kriter. Blloqet janë prej gurë shtufi gjysmë të punuar. Ndonjeri arrin përmasat deri 3.35 x 0.65 x 0.35 m.

Pak më poshtë, në faqen jugperëndimore evidentohet linja e një muri që zgjatet poshtë kodrës deri 5 m. Ky është prej gurësh të vegjël dhe mesatarë. Një bllok kuadratik i latuar, që shihet këtu, ka përmasat 1.20 x 0.40 x 0.35 m. Në këtë faqe të kodrës si dhe në faqen verilindore gjenden dhe fragmente të rralla qeramike antike. Në anën verilindore kemi gjetur një kionisk prej guri gëlqeror, mbishkrimi i të cilit është fshirë.

6. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Një kilometër e gjysëm nga Kodra e Lulit, në bregun e detit formohet një gji i vogël, që mbrohet nga veriu prej vetë kepit. Këtu, rreth 300 m nga bregu, mbi një faqe kodre që vendasit e thërrasin «Kulmëri», vërehen mjaft fragmente qeramike të shekujve të parë të e.s. Pak më poshtë, por të lëvizur prej asaj pike, shihen dy blloqe të mëdhenj shtufi gjysëm të punuar, njeri prej të cilëve është 2.15 m i gjatë.

7. KISHA E SHËN KOLLIT DHE AJO E SHËN MËRISË

Mbi një majë të rrumbullakët kodre, jo larg nga Kodra e Lulit, gjenden rrënojat e kishës së Shën Kollit, e njohur në shekujt XIV-XV. Rrënojat e kishës së Shën Mërisë,[31]) kemi mundur t'i identifikojmë kohët e fundit në perëndim të kodrës së Lulit, te vendi i quajtur Kodra e Keqit.



Fig. 1

8. STELA E KRITODAMIT (Fig. 1)[32])

Është një stele varri jo e plotë, e përbërë nga tri pjesë të thyera. Pjesën e tretë (që përmban kokën e gruas) e gjetëm në vitin 1971,[33]) ku disa vjet më parë, nga punonjësit e Muzeut Arkeologjik të Durrësit ishin gjetur edhe dy pjesët e tjera.

31. Shih A. Ducellier, **vep. cit.** dhe literaturën e cituar prej tij. Mbetet ende për t'u identifikuar vendgjetja e kishës së Shën Anastasisë.

32. Kjo stele është ekspozuar në njerën nga sallat e Muzeut.

33. Vendgjetja është një faqe kodre e punueshme. Megjithë kërkimet tona të imta rreth e qark, nuk rezultoi asnjë gjurmë tjetër antike. Bashkohemi, prandaj, me inendimin e vendasve se ajo është çuar në atë kodrinë më 1916 nga forcat austro-hungareze, që u dislokua aty përkohësisht. Ka mundësi që të jetë gjetur në ndonjë nga rrënojat e kishave të lashta të këtij fshati ose gjetiu dhe është mbajtur pranë kampit ushtarak të përkohëshëm austro-hungarez me qëllim për t'u mbartur, gjë që, siç duket në rrethana lufte nuk është realizuar.

Është prej mermeri të bardhë me rremba të zi. Lartësinë maksimale (megjithë frontonin) e ka 0.60 m, gjerësinë 0.45 m dhe trashësinë 0.06 m.

Nën fronton, brenda kornizës, është paraqitur në reliev një skenë lamtumire. Në të majtë shihet një grua e ulur mbi një katedrë. Ajo është veshur me kiton e himation, një këmbë të të cilit e ka të hedhur mbi kokë, duke i lënë zbuluar flokët përpara.

Para gjunjëve të saj qëndron më këmbë një djalë i vogël lakuriq. Djalit i mungon koka, njerën e ka të mbështetur mbi kofshët e gruas. Në të djathtë është paraqitur një burrë në këmbë, veshur me himation që i le zbuluar gjoksin. Duart i ka lidhur përpara. Flokët kaçurrele puqen me mjekrën e tij të shkurtër e po ashtu kaçurrele.

Në fronton, mbi një kornizë pak të ngritur shihet në të djathtë, mbishkrimi: ΚΡΙΤΟΔΑΜΟΥ

Shkronjat janë realizuar me incizim. Ato nuk karakterizohen nga realizimi i lartë artistik i këtij relievi.

Figura e Kritodamit dhe në tërësi steleja ka ngjashmëri me fragmente relievesh nga nekropoli i Durrësit, të datuara në shekujt V-III p.e.s.[34])

9. TORS E NJË GRUAJE[35])

Është gjetur para shumë vjetësh në rrënojat e kishës së Shën Kryqit.
Tani ruhet në Muzeun Arkeologjik të Tiranës.

Është prej mermeri të bardhë. Lartësinë e ka 0.35 m, gjerësinë 0.30 m.

Gruaja është e veshur me kiton dhe me një jelek me mëngë të shkurtra, të shtrënguara me një rryp në mes. Ka mundësi që të ketë pasur dhe një pelerinë ose llabane të hedhur mbi kokë, që i evidentohet në pjesën e pasme. Jeleku karakteristik, e bën të krahasueshme veshjen e saj me veshje grash ilire të zbuluar në Durrës.[36])

Draç (fshat pranë Shetajt)

10. DY KIONISKË DHE OBJEKTE TË TJERA SEPULKRALE

Në Muzeun Historik të Ishmit ruhen dy kioniskë të fragmentuar. Para se të vendoseshin në këtë muze i kemi parë në shkollën 8 vjeçare të Draçit.

Të dy janë prej guri gëlqeror. Njeri, me tru cilindrik e bazament paralelopiped, e ka lartësinë përgjithshme 0.47 m (lartësinë e bazamentit 0.26 m Në pjesën cilindrike lexohet mbishkrimi:

ΘΕΟΔΩΡΙΔΑΣ
ΑΡΜΙΩΝΟΥ
ΧΑΙΡΕ

Tjetri nuk është i plotë, i mungon pjesa e sipërme Prandaj dhe mbishkrimi është i mangët:

ΧΑΙΡΕ

Nga karakteri i shkronjave dhe punimi i tyre këta gurë varresh ngjasojnë me objekte të tilla të zbuluara në Durrës dhe të datuara në shekuj III-I p.e.s.[37])

Në Muzeun Historik të Ishmit, me prejardhje nga Draçi, ruhen dhe dy fragmente pllakash varr me mbishkrime të pjesëshme: në njerën prej tyre lexohet ΑΔΕΣ kurse në tjetrën ΕΣΤΟΗΙC

Përveç këtyre është dhe një arkëzë hiri (urnë ci nerare) me trajtë paralelopipedi, si dhe një putër gdhendur në mermer.

11. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Në faqen jugore të kodrave të këtij fshati, jo më larg se 1 km nga rrënojat e kishës së Shër Pjetrit, shihet një trakt themeli apo xokolature ndërtuar me gurë të çrregullt. Gjerësinë e ka 0.60 m. Përreth shihen mori fragmente kalipteresh me kurriz të harkuar dhe tjegullash solene me buzë pak të profiluara të shekujve të parë të e.s.

ISHËM

Vetë fshati që mban këtë emër përbëhet në fakt nga tre fshatra të vegjël (ose lagje): Kapidanaj Kertushaj, Likmetaj. Këto shtrihen gjatë faqes veriore dhe shpinës së kodrave që ngrihen menjëherë mbi bregun e lumit, paralel rrjedhjes së tij.

34. V. Toçi, **Mbishkrime e relieve...**, f. 74, 114.
35. P. Nuraj, **Një fragment statuje vajze nga kepi i Rodonit,** Adriatiku, 14 Maj 1978.
36. S. Anamali, **Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apolloni,** B.SH.SH. 1956, 1, f. 33-35.
37. V. Toçi, **vep. cit.,** f. 74-80.

DO NOT COPY



Fig. 2

12. KALAJA E ISHMIT[38]) (Fig. 2)

Ndodhet mbi një breg në lindje të qendrës së këtij fshati. Ka një planimetri drejtkëndëshe pak a shumë të çrregullt 100 x 40 me drejtimin e faqeve të ngushta veriperëndim-juglindje. Është një kala mesjetare, e ndërtuar ndërmjet viteve 1572-1574.

Nga vrojtimet tona nuk kemi konstatuar gjurmë më të hershme, në të, as dhe në afërsi.

Në anën e majtë të luginës, në fushën e vogël që formohet midis kodrave dhe bregut të lumit, si dhe pranë grykëderdhjes nuk kemi hasur gjurmë rrënojash antike dhe mesjetare. Po të kemi parasysh ngritjet e nivelit të kësaj pjese, si rezultat i mbushjeve që bën lumi me vërshimet e tij, kjo gjë duket e shpjegueshme. Një provë për të mbështetur këtë mendim kemi në Likmetaj, jo larg bregut të lumit. Këtu në faqet dhe në tabanin e një kanali me thellësi 1.80 m kemi vrejtur themele guri dhe tjegulla të vona (Tab. III, 1, 2).

GJURICAJ

12. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE, DETAJE ARKITEKTONIKE

Rreth 4 km në juglindje të kalasë së Ishmit, rrëzë vargut të kodrave që këtu i afrohen bregut të lumit deri 500 m, është një bregore e ulët që njihet me mikrotoponimin «Pazare». Vendasit e moshuar thonë se në këtë vend janë ndeshur rastësisht me mure të vjetra që 40 vjet më parë. Këtë pikë ne e kemi vizituar për herë të parë në vitin 1971.[39])

Sot aty në një sipërfaqe prej afërsisht 4 ha shihen kryesisht fragmente të vogla tullash e tjegullash, gurë të përdorur në ndërtime dhe copëra pllakash mermeri. Në anën lindore të kësaj sipërfaqeje shihet dhe një trakt muri i ndërtuar me tulla si dhe një kolonë jo e plotë mermeri (Tab. II, 3). Nga «Pazareja» e kanë prejardhjen edhe dy kapitele mermeri dhe një kapitel — impost me kryq, që ruhen në muzeun e fshatit (Tab. II, 1, 2).

Trakti i murit që është zbuluar nga një rrëke uji, ka një gjatësi prej 2.5 m dhe lartësi 0.70 m. Atij i shihet vetëm njera faqe, që duket e ndërtuar me tulla dhe llaç gëlqereje. Tullat janë me përmasa 37 x 29 x 4 cm, 35 x 29 x 4 cm dhe 34 x 28 x 4 cm. Llaçi është bërë me rërë të trashë e copëra të thërmuara tullash. Ai formon fugatura horizontale me trashësi prej 4-5 cm. Tjegullat e përdorura në këtë qendër, duke gjykuar nga fragmentet që shihen në sipërfaqe, janë të tipit solene, të sheshta, me buzë të kthyera në formë «kokë zogu». Shpinën e kanë të zbukuruar me tufa brezash të valëzuara.

Teknika e ndërtimit të këtij muri, përafërsisht edhe tullat, kanë ngjasim me ato të murit jugperëndimor të kalasë së Durrësit, të ndërtuar në fundin

38. Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Ishmit,** «Monumentet » 15-16. 1978.

39. H. Myrto, **Relacion mbi vrojtimet arkeologjike në zonën e Ishmit** datë 20 Tetor 1971 (ruhet në Muzeun Arkeologjik të Durrësit).

DO NOT COPY

e shekullit V dhe fillimin e shekullit të VI të e.s.[40]) Edhe tipet e tjegullave që përmendëm kanë paralelizma në monumente të shekujve V-VI.[41]) Por një tip tjetër tullash që ndeshen më rrallë, duket më i hershëm. Këto janë tulla katrore, **sesquipedales,** 0.444 x 0.444. Në ndërtimet romake, në Itali e gjetiu, kjo formë tulle është preferuar në përgjithësi në periudhën e Domicit e të Adrianit, por është përdorur edhe gjatë shekullit III.[42]) Po ashtu, ndonëse rrallë, vërehen edhe fragmente tullash trekëndshe.

Kolona është prej mermeri të bardhë me gjatësi 1.5 m dhe diametër 0.30 m. Kapitelet (Tab. II, 1) janë identike. Ato janë punuar prej një mermeri të bardhë dhe zbukuruar me dy radhë gjethesh akanthi që dalin nga një kurorëz e mbështjellë në periferinë e bazës. Përmasat e tyre janë: B. 0.43 x 0.50 m; diametri i b. 0.265 m; lartësia 0.30 m.

Trakti i murit dhe objektet e tjera arkitektonike të gjetura këtu mendojmë se i përkasin një kishe të shekujve V-VI, që ndoshta mund të ketë qënë e rethuar edhe me mure mbrojtëse. Por siç e pamë aty janë gjetur edhe tulla karakteristike për periudhën e mëparshme të shekujve II-IV. Nga ana tjetër, sipërfaqja prej 4 ha, në të cilën shihen të shpërndara materialet që përshkruam, tregon se nuk është fjala për një godinë të vetme, por për një njësi godinash, ose dhe më tepër.

14. MBETURINA TË NJË URE

Pothuaj një kilometër e gjysëm nga kjo pikë, aty ku kapërcehet lumi i Ishmit për t'u hedhur në katundin Sukth-Vendas (mbi një kodër të vogël) të Fushë-Krujës, deri në vitin 1971 mund të shiheshin ende mbeturinat e këmbëve të një ure të ndërtuar me gurë të çrregullt e llaç. Kjo urë ka pasur gjithsej tri këmbë, njerën në mesin e lumit dhe nga një në secilin breg. Këto në një gjendje natyrisht më të plotë, i ka parë në fillim të këtij shekulli Ippen dhe i ka vlerësuar si «mbeturina nga kohë më të mira».[43] Për mendimin tonë kjo urë nuk ka qënë bashkë kohëse me ndërtimet që vërtetohen në «Pazare»; aj do t'i ketë përkitur rrugës që lidhte në mesjetë kalanë e Ishmit me Krujën dhe Lezhën.

Përsa i përket «Pazares», me gjurmë ndërtimesh prej shekujve II-IV të e.s., e ndodhur pothuaj në breg të lumit të Ishmit dhe pranë një vendkalimi tradicional të tij, duket se përmban disa kushte për t'u identifikuar me Pistumin antik.[44])

Në kohën kur arkeologët Prashniker dhe Shober, në kërkim të këtij stacioni, vizituan Ishmin,[45]) këto gjurmë të antikitetit nuk njiheshin. Kurse zbulimi i një ndërtese antike e pajisur siç duket edhe me terme, në fshatin Burizanaj të Fushë-Krujës[46]) nuk na duket se i plotëson kushtet për t'u identifikuar me këtë stacion. Burizania, së pari, ndodhet larg bregut të lumit, ndërsa në itineraret dhe në Tabula Peuntigeriana kuptohet se stacione të tilla si Apsi, Genusi, Pistumi etj. kanë qënë ngritur në brigjet e lumenjve. Së dyti, gjurmët që vërehen sot për sot në atë fshat zenë një sipërfaqe të kufizuar, dhe mund të merren si mbeturina të ndonjë vile.

Në se do të pranohej identifikimi i «Pazares» së Gjuricajt me Pistumin, megjithëse mungojnë prova bindëse, atëhere rruga që vinte nga Dyrrahi në drejtim të Lisit jemi të mendimit se deri në Vorë do të ketë ndjekur pak a shumë drejtimin e rrugës së sotme. Nga Vora rruga do të ketë kaluar rrëzë kodrave të Ishmit, anës veriore të tyre, deri në «Pazare», ku siç duket e kapërcente lumin afërsisht aty ku shihen mbeturinat e urës mesjetare.

Në mbarim të vështrimit tonë mbi zonën e Ishmit duke e marrë këtë si një nënnjësi prej Kepit të Rodonit deri në Gjuricaj, do të thoshnim se kjo përbën një trevë, shumë premtuese për gjurmimin e vazhdimësisë së kulturës ilire në atë shqiptare. Përveç të dhënave historike dhe toponomastike, dëshmi për këtë janë edhe gjurmët arkeologjike që evidentohen këtu dhe që përfaqësojnë periudhën

40. Gj. Karaiskaj, A. Baçe, **Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë,** «Monumentet» 9, 1975, f. 8.

41. N. Ceka, **Fortifikime të vona antike panë rrugë Egnatia.** «Monumentet» 7-8, 1974, f. 75 dhe 81.

42. G. Lugli, **La tecnica edilizzia romana,** Roma 1957, f. 547, shih dhe ndërtimet nga Elagabali deri te Probi.

43. Th. Ippen, **Scutari und die Nordalbanische Küstenebene** Sarajevë 1901.

44. T.P. **Miller IR** Col. 462-471, hartë kjo që mendohet se është përpiluar në gjysmën e parë të shek. III dhe anonimi i Ravenës **(Rev)** Cosmografisë së të cilit mendohet se i ka shërbyer si model ndonjë hartë e shek. V-VI.

45. C. Praschniker-A Shober, **Archeologische Forschungen in Albania und Montenegro,** Wien 1919, f. 46 dhe 85.

46. L. Papajani-G. Pani, **Rrugët dhe banjat pranë tyre në antikitet** «Tradita në arkitekturë dhe art», Tiranë 1978.

DO NOT COPY

e qytetërimit ilir, atë të shekujve të parë të e.s., periudhën e antikitetit të vonë, atë të mesjetës së hershme shqiptare, si dhe periudhën e mesjetës së mesme.

II. ZONA FUSHORE E ERZENIT TË POSHTËM

HAMALLAJ

15. GJURMË NDËRTIMESH ANTIKE

Kjo pikë arkeologjike gjendet në fushë, në sektorin e Hamallajt të N.B.Sukthit, jo më larg se 500-600 m nga buza e detit dhe dy km nga bregu i Erzenit. Vendasit e njohin me mikrotoponimin «Kërpi» dhe dëshmojnë se para se të shpyllëzohej, aty ishte një kodërz.

Në një sipërfaqe prej 400 m^2 vërehen të shpërndara mbeturina materialesh ndërtimi dhe fragmente qeramike antike. Së pari, të bien në sy gurë lumi me madhësi mesatare që duket sikur formojnë pak a shumë një rreth.

Në sipërfaqe kemi mbledhur fragmente tullash me trashësi 7 cm, fragmente tjegullash solene, fragmente amforash e enësh balte të përdorimit të përditshëm, peshore konike etj.

Solenet janë të tipit me buzë konvekse dhe me kanalin anësor nga brenda tyre. Një fragment soleneje (Tab. II, 4) ruan një vulë epigrafike:

ΕΠΙΚΑΛΛΗ...

Duke u nisur nga kjo vulë, mendojmë se solenet e përdorura në këtë pikë janë prodhuar në punishten shtetërore të Dyrrahut.[47]) Siç duket kjo mban emrin e prytanit eponym Καλληνος. Prytanë eponymë të Dyrrahit me këtë emër njihen në monedhat e këtij qyteti të viteve 250-168 p.e.s.[48])

SHKAFANE

16. TUMË (?)

Në afërsi të Shkafanes, brenda luginës që përshkohet nga përroi i Thelbit, tek vendi që njihet me mikrotoponimin «Rrahi i Ibrës», dy kodërza të vogla na bëjnë të dyshojmë për tuma. Në atë vend lugina ka një gjerësi prej 50-60 m dhe përroi i kalon anash. Njera prej kodërzave ka formë gjysmësferike, me diametër rreth 7 m e lartësi 3 m. Pranë saj ngrihet një kurriz tjetër gjysmëoval, me lartësi rreth 1.5 m dhe gjatësi 10 m.

17. TUMA[49])

Vite më parë në fushën e Sukthit, jo larg brigjeve të Erzenit, si dhe në pyllin e fshatit Hamallaj janë evidentuar tuma ilire.

ARMATH

18. ENËZ BRONXI

Në kodrën e Valmit, ku janë konstatuar varre të vjetra, është gjetur një brokëzë e vogël bronxi me lartësi 4 cm. Për analogji datohet në periudhën e hershme të hekurit, në shekujt VII-VI p.e.s.[50])

19. QERAMIKË ANTIKE E STOLI BRONXI

Me një sondazh që u krye këtu në një kodër jo larg shkollës tetëvjeçare të fshatit, është zbuluar qeramikë e periudhës qytetare ilire: gryka, vegje e funde amforash, buzë pjatash, vegje filxhanësh kupa të lyera me vernik të zi, fragmente enësh me pikturim me figura të kuqe si dhe një gjilpërë dyshe bronxi me kokë në trajtë omege 51).

20. NJË FRAGMENT TULLE DHE NJË MONEDHË ROMAKE

Në muzeun e shkollës 8 vjeçare të fshatit ruhet një fragment tulle me trashësi 4.5 cm, që ka një vulë në reliev në trajtën e një ylli pesë cepash, po ashtu dhe një monedhë bronxi e Antonin Piut. Thuhet se këto objekte janë gjetur në vendin e quajtur Palush Fushë.

47. Parafjala ΕΠΙ, që shoqëron pothuaj gjithë emrat që janë regjistruar në vulat e tjegullave të këtij qyteti për kohën që ishte i pavarur, duket se tregon që këto emra janë emra të prytanëve eponymë. Këtë gje e provon edhe fakti se ato përputhen me emrat e shpinës së monedhave (shih H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë 1965, f. 52).

48. H. Ceka, **Datimi i drahmeve të Dyrrahut dhe Apollonisë,** St. hist. 1966, 3; **Thesari i Jubicës,** Iliria I, f. 86, 94.

49. H. Ceka, **Elementi ilir në qytetet Dyrrachium dhe Apolloni,** B.SH.SH. nr. 3-4, Tiranë 1951; S. Anamali, **Të dhëna mbi elementin ilir të qyteteve Epidamn dhe Apolloni,** B.SH.SH. 1, 1956, f. 12.

50. F. Prendi, **Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit,** Iliria III, 1974, f. 114, Tab. V, 1.

51. S. Hidri, **Gjurmime arkeologjike në zonën e Armathit,** Drita, 14.x.1973.

DO NOT COPY



Fig. 3

MANËZ

21. ÇEKAN GURI

Në afërsi të rezervuarit të Manzës është gjetur një çekan guri, i lëmuar dhe me brimë në mes.[52] Sikurse çekanët-sopata, edhe çekanët e biruar, datohen në periudhën e neolitit të vonë, të eneolitit dhe deri në periudhën e bronxit të mesëm ose të vonë.[53]

22. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Në qendrën e fshatit të Manzës (i vjetri) ng
punimet e cekta bujqësore kanë dalë në sipërfaq
materiale që e bëjnë këtë pikë me interes arkeolo
gjik. Këto janë: një pjesë kolone dritareje me sek
sion eliptik prej guri gëlqeror, një pjesë tjetër kolo
ne po prej guri gëlqeror, por e rrumbullakët (m
diametër 0.27 m) tulla, copëra pllakash mermer
fragmente enësh balte dhe gurë mozaiku.

Tullat janë drejtkëndëshe me përmasa 0.27
x 0.23 m, por ka edhe katrore me kanale diago
nale në sipërfaqe. Nga qeramika e këtushme për
mendim një fragment kupe «pseudoterrasigillato
në ngjyrë të kuqe. Janë gjetur gjithashtu copër
qelqi të hollë, transparent, me një nuancë të leht
jeshile. Gurët e mozaikut janë deri diku kubik
prej brumi qelqi opak në ngjyrat blu dhe jeshile.

Mendojmë se këto materiale dëshmojnë pë
ekzistencën në këtë vend të rrënojave të një kish
paleokristiane.

BORÇË

23. DY SOPATA BRONXI (Fig. 3)

Fshati Borçë ndodhet mbi një bregore të rrum
bullakët nën fushë, jo larg Manzës. Në rrëzën jugor
të kësaj kodre, te vendi i quajtur «Radhenjtë» jan
gjetur dy sopata bronxi.[54] Ato kanë dalë nga pu
nimi i tokës, një vit njera pas tjetrës. I përkasi
tipit «shqiptaro-dalmat» që datohet në periudhë
e vonë të bronxit, siç duket në shekullin e XIII p.e.s.[5

RRUSHKULL

24. SOPATË BRONXI

Një tjetër sopatë bronxi e tipit «shqiptaro
-dalmat» është gjetur në fshatin Rrushkull në vi
tin 1965, jo më tepër se 3-4 km nga Borça. Kj
sopatë ruhet në fondet e Muzeut Arkeologjik t
Tiranës.

52. Ky është thjeshtë çekan, me të dyja anët për rrahje. Bira është e rrumbullakët dhe e lëmuar nga brenda, me diametrin 2.3 cm.

53. F. Prendi, **La civilation prehistorique de Maliq,** Studia Albanica 1, 1966, f. 255; F. Prendi, S. Alia, **Vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik,** Iliria I, 1971, f. 61; N.G.L. Hammond, **Epirus,** Oxford 1967, f. 314, 317, (fig. 18) dhe **A history of Macedony,** Vol. I, Oxford 1972, f. 235; P. Detev e R. Baçkova-Morova, **La site prehistorique du village** Ruen arr. de Plevdiv (Résumé). 1, 1969, f. 57.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

RUBJEKË

25. NJË DETAL ARKITEKTONIK DHE NJË VARREZË ANTIKE

Në një gurore në afërsi të këtij fshati kohët e fundit u zbulua rastësisht një bllok guri paralelopiped, i latuar, me përmasat 3.12 x 1.10 x 0.35 m. Për kohën e punimit të tij dhe destinacionin (që duket se nuk e ka mbritur) nuk mund të themi asgjë të sigurtë.

Jo shumë larg te kodra e Sallakut, në të majtë të rrugës që vjen nga Maminasi për në Manzë, u kryen punime të thella bujqësore dhe me këtë rast u zbuluan disa varre. Si objekte të ruajtura nga inventari i këtyre varreve, na dorëzuan një majë shtize hekuri dhe një kanë të vogël me vernik të zi (Tab. III, 3, 4). Kana (Tab. III, 3) ka qënë lyer si nga brenda edhe nga jashtë me vernik të zi të trashë pa shkëlqim, që vende vende është rjepur.

Si tip, me zbulimet e deritanishme në Durrës, me sa jemi në dijeni edhe në qendrat e tjera antike të vendit tonë, qëndron unikal. Mendojmë se i përket shekujve IV-III p.e.s.

Maja e shtizës ka trajtën e një gjetheje të gjatë, me kurriz qendror nga të dyja anët e fletës.

26. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Një pikë me interes arkeologjik është evidentuar rreth 1.5 km në jugperëndim të qendrës së këtij fshati dhe jo më tepër se 2.5 km nga stacioni hekurudhor i Sukthit. Vendi quhet Kodra e Zhurit. Këtu, mbi faqen e një kodre të ulët rrëzë fushës së Sukthit, shihen fragmente të shumta tullash e tjegullash dhe enësh balte tepër të copëtuara nga punimet e përsëritura bujqësore. Vërehen gjithashtu dhe gurë të mëdhenj e mesatarë të përdorur për ndërtim.

Fragmentet e tjegullave tregojnë se këto janë të sheshta dhe me buzë të tipit «kokë-zogu» (Tab. III. 6, 7). Tullat janë prej balte të kuqe-rozë me trashësi 4 dhe 5 cm. Ato kanë qënë të lidhura me llaç gëlqereje të shkërmoqshëm, që përmban thërmija të imta tullash.

Një fragment qafe amfore (Tab. III, 8) është zbukuruar me vija të valëzuara, të bëra me incizim para pjekjes, dhe me një sërë drejtkëndëshash të vegjël të mbushur me pika.

Këto të dhëna, ndonëse të pakta, mendojmë se mund të provojnë që këtu ka ekzistuar një ndërtesë në shekujt IV-VI të e.s. Mungesa deri tani e ndonjë dëshmie karakteristike për arkitekturën dhe dekoracionin e kishave na bën të mendojmë se këto gjurmë duhen lidhur më tepër me ndonjë godinë laike, si ndonjë vilë. Pozicioni i kësaj pike rrëzë fushës së gjerë e pjellore të Sukthit e favorizon një mendim të tillë.

MAMINAS

27. QERAMIKË E PERIUDHËS QYTETARE ILIRE

Në vitin 1960, me rastin e hapjes së themeleve të dyqaneve të sotme, në të djathtë të rrugës që shkon për në Tiranë, dolën enë balte të periudhës qytetare ilire.

QERRET

28. MBETURINA TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Brenda këndit që formohet nga rruga Xhafzotaj-Sektori i Fllakës dhe kthesës që bën kjo në drejtim të fshatit Qerret e Katundit të Ri, ekziston një qendër me material antik mjaft të evidentuar. Vendi është fushë. Dikur toka ka qënë pak e ngritur. Që me fillimin e punimeve, këtu u panë mure të ndërtuara me tulla, si dhe disa dhoma e një koridor i ngushtë.

Sot këtu shihet një material i dendur qeramik i shpërndarë në një sipërfaqe prej afërsisht 6000 m^2.

---

54. H. Myrto, **Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit,** kumtesë mbajtur në Sesionin shkencor të Muzeut Arkeologjik të Durrësit, Nëntor 1979, dorëzuar për botim në Iliria.

55. F. Prendi, **Sopata të pabotuara të epokës së bronxit të zbuluara në Shqipëri,** B.SH.SH. 1958/1, f. 207; R. Vulpe, **Edhe një herë mbi sopatat e bronxit** iliro-shqiptare, B.SH.SH. 1960/2.

Të dyja sopatat e Borçës janë identike nga trajta, me tri brinjët e gufmuara karakteristike dhe me zgjatimin në formë mamuzeje. Përmasat kryesore i kanë të barabarta: gjatësinë 25 cm, gjerësinë 10.5 cm. Megjithatë ato paraqesin edhe ndryshime: akset gjatësorë të tyre nuk qëndrojnë në të njëjtin kënd ndaj vijës së presës, tek e dyta zgjatimi në formë mamuzeje është 1 cm më i gjatë se tek sopata e parë, ndërsa te kjo mungon brima e zakonshme transversale e tunit.

Ndërmjet këtij materiali bien në sy fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të e.s., po ashtu dhe fragmente enësh balte. Në sasi të konsiderueshme janë fragmentet e pitosave dhe të amforave.[56])

Ky material mendojmë se dëshmon për ekzistencën këtu të një ndërtese, ose të një njësie ndërtesash, të shekujve I-II e.s.

FLLAKË

29. MBETURINA TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Ndonjë kilometër e gjysmë në perëndim të qendrës së sektorit të N.B. të Fllakës, dallohen përsëri mbeturina materiali ndërtimi të ngjashme me ato që përmendëm në qendrën e mësipërme. Vendasit flasin për një kalldrëm të hasur në thellësinë 1 m, që duket se lidhte këto dy qendra.

KOXHAS

30. MBETJE NDËRTIMESH ANTIKE[57])

Në të djathtë të rrugës automobilistike Sukth-Maminas, materialet që përfaqësojnë ekzistencën e një ndërtese ose disa ndërtimeve të shekullit I të e.s. janë tulla katrore dhe katërkëndëshe, pllaka mermeri të bardhë, fragmente vazosh qelqi, qyngje plumbi etj.

SALIMONAJ

31. GUR MILIAR[58])

Më se një shekull më parë në këtë fshat, mb bregun e Erzenit jo larg Shijakut, është gjetur nj gur miliar, që duket se përcakton milien e VIII të rru gës prej Dyrrahut në Lis.[59])

VRRIN (SHËNEVLASH)

32. VARREZË E SHEKUJVE IV-III P.E.S.[60])

Me një sondazh që filloi në vitin 1972 dhe q vijoi edhe në vitin pasonjës e mori karakterin e nj gërmimi të rregullt, te vendi i quajtur «Djerri Qishës», u zbulua një varrezë antike.

Këtu u gërmua një sipërfaqe prej 150 m² dhe zbuluan 22 varre. Varret ishin pa asnjë lloj konstruk sioni dhe mbanin brenda nga një skelet, me përjo shtim të varrit Nr. 1, që kishte dy skelete në krah t njeri-tjetrit, po ashtu dhe të varrit nr. 22. Te ky i fun dit skeletet u gjetën njeri mbi tjetrin, me kokat në dre time të kundërta, veri jug.[61])

Si inventar, u gjetën enë balte, vorba e ojneh një lekyt me figurë të kuqe, një fibulë dhe dy unaz bronxi. Mbi varre ishin hedhur monedha bronxi t Dyrrahit të tipit Herakli – armë dhe copëra enës balte të thyera.

---

56. Karakteristikë janë vegjet shiritore me hulliza në kurriz, vegjet me prerje elipsoidale të lyera me vernik të kuq e të zbukuruara me kanelyra në kurriz, vegjet dyshe me prerje në trajtë ∞ , si dhe vegjet brinake me vernik të kuq në kafe.

Një shishe e vogël dhe gati e plotë balte (Tab. III, 5) me fund të sheshtë dhe trup të vogël vezak, është e lyer me vernik të kuq nga brenda; qafa edhe nga jashtë. Po ashtu janë gjetur dhe peshore konike prej balte, fragmente **terrasigillata,** copëra qelqi transparent bojë qielli në jeshil dhe një instrument hekuri i papërcaktuar.

57. F. Tartari, **Gjurmë të lashta ndërtimesh,** «Bashkimi» 9 gusht 75.

58. C.I.L., I-170; Heuzey-Daumet, **Mission archeologique de Macedonie,** Paris 1876, f. 389, nr. 174; P.C. Sestieri, **Mbishkrime latine të Shqipërisë,** Në «Studime e tekste-Dega e dytë arkeologjike» nr. 1, Tiranë 1943.

59. Përmbajtja e mbishkrimit sipas P.C. Sestierit (art. cit.) është

DIIS GENITISET
DEORVM CREATORIBVS
ISAVGG
Λ VIII
ΛN VIII

60. H. Myrto, **Rezultatet e një gërmimi në nekropolin e shek. IV-III p.e.s. të fshatit Vrin (Shënevlash) të Durrësit,** dorëzuar për botim në «Iliria».

61. Gërmimi u krye në vendin e gjetjes së rastësishme të një fibule të mesjetës së hershme shqiptare (S. Anamali – M. Korkuti. **Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve në dritën e kërkimeve arkeologjike shqiptare.** Në «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve», Tiranë 1969, f. 35; S. Anamali, **Mbi kulturën e hershme shqiptare, po aty,** f. 194; **Shqipëria arkeologjike,** Album, Tiranë 71.

Një pjesë e skeleteve ishin të vendosura në shpinë, me gjymtyrët të shtrira drejt anash trupit, kurse një pjesë ishin vendosur brinjazi. Te këta të fundit u vu re një dukuri interesante. Në varret nr. 1 (A), 5, 9, 14, dhe 16 të varrosurit kanë qënë shtirë brinjazi në krahun e djathtë ose të majtë, me njërën këmbë të zgjatur drejt, kurse tjetrën të përthyer thellë te gjuri. Shputa e këmbës së përthyer, që formonte një kënd të theksuar përpara, futej pastaj poshtë kërcirit të këmbës tjetër. Duart në këto raste janë të puqura mbi gjoks, ose njera e ngritur në drejtim të kokës.

DO NOT COPY

Duke u mbështetur në inventarin dhe veçanërisht në monedhat, që nuk mbajnë emrin e monetarit apo të prytanit eponym, këtë varrezë e kemi datuar në fundin e shekullit IV dhe fillimin e shekullit III p.e.s.

Nga tipi i varreve, riti i varrimit dhe inventari, duket se të varrosurit i përkisnin shtresës së ulët të një vendbanimi (fshati) të afërt me Dyrrahun, që e njihte kulturën e qytetit të madh-koloni, por që ruante edhe tipare të një kulture origjinale vendase.

33. DY FRAGMENTE KOLONASH

Jo larg vendit të kishës së Shënevlashit kemi gjetur një fragment kolone të stilit dorik, me kanelyra që është prej guri gëlqeror si dhe një fragment kolone graniti.

34. NJË MONEDHË VENECIANE

Ndonjë kilometër në lindje të Vrrinit pranë bregut të majtë të kanalit të Jubës, është gjetur një monedhë argjendi veneciane.[62]

ARAPAJ[63])

35. PLLAKË ME MBISHKRIME E UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

Një pllakë me mbishkrim, që bën fjalë për riparimet e bëra në ujësjellësin e Dyrrahut, të ndërtuar në kohën e Adrianit, nga ana e nipit të tij, perandorit Aleksandër Severi, përmendet së pari prej Hanit.[64]) Më pas për këtë u interesua Leon Hezei i cili e çoi në Luvër (ku ndodhet) dhe e botoi.[65])



Fig. 4

ARAPAJ–RRASHBULL

36. PUSETAT E TUNELIT TË UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

Nga Çezma e Arapajt deri në afërsi të daljes së tunelit hekurudhor të Rrashbullit (në anën e Shkozetit) janë evidentuar 14 puseta të ujësjellësit antik të Durrësit.[66]) Këto janë në një linjë dhe paraqesin karakteristika të përbashkëta si nga materiali i ndërtimit, edhe përsa i përket teknikës (Fig. 4). Distanca e tyre nga njeri tjetri rregullisht është 70 m (që bëjnë 240 këmbë – dy aktus).[67])

62. Ka të dhëna gojore se pranë kësaj pike më 1940 punëtorët e shoqërisë kapitaliste «E.I.A.A.» hasën, në thellësinë e 2-3 m, në disa enë të mëdha balte. Sipas tyre autoritetet italiane i larguan punëtorët shqiptarë nga vendi i gërmimit dhe i nisën me nxitim enët e gjetura për në Durrës. Punëtorët shqiptarë protestuan sepse dyshuan në këtë rast për grabitjen e një thesari. Ka gjithashtu informata gojore se mbas çlirimit po në këtë pikë vullnetarët e rinisë që punonin për hapjen e kanalit të Jubës kanë hasur në qeramikë të vjetër.

Monedha paraqet në faqe Shën Markun duke i dhënë flamurin dorzhëve dhe në të djathtë: S.M. Veneti. Datohet ndërmjet viteve 1275 e 1280; Papadopuli, **Le monete di Venezia** Venezia 1893, f. 118.

63. Nuk kam përfshirë këtu zbulimin e një kishe në afërsi të Plazhit, që mendojmë se i përket më tepër periferisë së qytetit.

64. J.G. Hahn, **Studime shqiptare,** (përkthim në **Arshivën** e Institutit të Historisë të Tiranës) A-III-6), f. 118-119.

65. L. Heuzey, H. Daumet, **vep. cit.**

66. F. Miraj – H. Myrto, **Ujësjellësi antik i Durrësit,** Artikull i dorëzuar në Iliria; kumtesë në sesionin shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Dhjetor 1976 dhe **Tuneli i ujësjellësit antik të Durrësit,** në «Shkenca dhe jeta» nr. 6 1979 67. Shih Plini, **Nat, hist.,** XXXI,, 31 dhe XXXVI, 24.

DO NOT COPY



Fig. 5

III. ZONA KODRINORE E SHIJAKUT

SHIJAK

37. PREFËSE STRALLI

Në faqen juglindore të kodrës së Shijakut, ku është ndërtuar depozita e ujësjellësit, janë gjetur një thikë dhe një kruese stralli me retushim.

Me një gërmim provë, që u organizua një vit më pas në atë pikë nga ana e Muzeut Arkeologjik të Durrësit, nuk u has ndonjë shtresë apo objekt i kulturave prehistorike.[69])

Veglat prej stralli të Shijakut kanë ngjashmëri të plotë me objekte të tilla të zbuluara në stacionet neolitike të Maliqit[70]) dhe të Cakranit.[71])

38. RELIEV I HERAKLIUT (Fig. 5)[72])

Është zbuluar në vitin 1950 rrëzë përroit të Gjyshit, me rastin e rihapjes së një pusi. Monumenti tani ruhet në Muzeun Historik të Shijakut.

Është një pllakë guri gëlqeror në formë trapezi, e profiluar në bazë për të krijuar një mbështetëse. Gjatësitë e bazave janë respektivisht 20 dhe 16 cm, lartësia 25 cm.

Mbi të është gdhendur në reliev të lartë figura lakuriq e një burri. Ai qëndron në këmbë, në profil, me gjoksin përballë dhe me këmbën e majtë të nxjerrë përpara. Krahun e djathtë e ka të ngritur mbi kokë, kurse të majtin të shtrirë përpara. Duket se, si në dorën e djathtë edhe në të majtën, ai mbante nga një objekt, që janë thyer. Është thyer dhe mungon edhe pjesa e përparame e fytyrës. Megjithatë duket se ka qënë me mjekër të shkurtër dhe flokët i ka pasur të lidhura ndoshta me një kordele.

Përpara figurës, poshtë dorës së majtë, ka një mbishkrim nga lart poshtë, të realizuar me gërvishje në albafetin arkaik të Korinthit.



Një mbishkrim i realizuar po në këtë mënyrë vërehet edhe në kornizën e profiluar të bazës:



Korniza ka një thyerje në vendin e një shkronje dhe shkronjat e fundit paraqiten shumë të fshira. Figura mendojmë se duhet identifikuar me Herakliun. Në një pozicion të përafërt e shohim

69. Gërmimi u drejtua nga F. Tartari, asistoi dhe autori i këtij shkrimi. Raporti ruhet në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.

70. F. Prendi, **Art. cit.,** «Studia Albanica» 1966, 1; **Tiparet e neolitit të vonë në Shqipëri në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike,** (Kultura e Maliq-Kamnikut), St. hist. 1972/2, f. 83.

71. M. Korkuti – Zh. Andrea, **Vendbanimi neolitik i Cakranit,** «St. hist». 1972/2, f. 147.

72. M. Zeqo – H. Myrto, **Një monument me figurën e Herakliut dhe me mbishkrim arkaik,** «Bashkimi», «Adriatiku» 14 Shkurt 1980.

DO NOT COPY

Herakliun të figuruar në luftim me Gerionin në një kupë të Eufronit të fundit të shekullit VI p.e.s. (Mynyh).[73]) Por edhe më tepër ngjashmëri vërehet me një vizatim në një vazo etruske me mbishkrim, ku është paraqitur me mëzdrakun të ngritur mbi kokë dhe me krahun të zgjatur përpara, në një pozicion identik të krahëve me këtë që shihet në figurën tonë.[74]) Pozicioni i Herakliut, me këmbët të hapura dhe me njërën dorë duke tendosur harkun përpara, ndërsa me tjetrën duke mbajtur mëzdrakun mbi kokë, është i njohur në periudhën arkaike edhe në shekullin V p.e.s.[75])

Mbishkrimi para figurës mendojmë se duhet lexuar: περικαλλος τοῦ Ἡρακλέος dhe siç duket duhet marrë si një përshëndetje falenderimi drejtuar «gjithëmirësisë» së Herakliut. Në mbishkrimin e poshtëm dallojmë vetëm një emër njeriu, që mund të jetë dedikuesi, Ιστατος. . .

Objekti jemi të mendimit se është një ex-voto[76]) dhe duhet datuar në shekujt VI-V p.e.s.

Zbulimi i këtij monumenti në pastokën e afërt të Durrësit, koloni e Korintit dhe e Korkyrës, nga njera anë është i shpjegueshëm me vetë faktin që në autorët e lashtë themelimin e këtij qyteti e gjejmë të lidhur me emrin dhe bëmat e Herakliut,[77]) si dhe me faktin e njohur në jetën e Herakliut që flet për zbritjen e tij në tokën ilire.[78]) Nga ana tjetër përhapja e kultit të Herakliut qoftë edhe 12 km në brendësi të tokës ilire, ta zemë që në shekullin e VI p.e.s., nuk mund të jetë thjeshtë si pasojë e ndikimit helen; mendojmë se do të ishte më e arsyeshme në këtë rast të kemi të bëjmë me një adoptim të kultit helen të Herakliut ndaj një hyu vendas me atribute të përafërta.

Si mbishkrim arkaik, ky mund të quhet i pari i zbuluar në Durrës me rrethinat e tij. Gjetja e këtij mbishkrimi në brendësi të vendit flet për një nivel të lartë të zhvillimit kulturor dhe sinjalizon për të dhëna premtuese në sqarimin e jetës së ilirëve që jetonin në afërsi të Dyrrahut, dhe të marrëdhënieve të tyre me qytetin e madh-koloni të bregdetit.

TEREZIE

39. VARREZË ANTIKE

Në fshatin Terezie, pranë Shijakut, mbi kodrën e Tales janë hasur varre antike. Në to janë gjetur një ketyle dhe një kupë me vernik të zi, që ruhen në Muzeun Historik të Shijakut.

KËNETË

40. MBETJE TË NJË NDËRTESE ANTIKE

Mbi një kodrinë të rrumbullakët, në bregun lindor të rezervuarit të fshatit Kënetë (një orë e gjysëm nga Shijaku) nga punimet bujqësore kanë dalë në sipërfaqe mbeturina që dëshmojnë për ekzistencën e një ndërtese antike. Gjurmët e themeleve të japin idenë e një planimetrie drejtkëndëshe 60 x 40 m.

Në majën e kodrinës (siç duket një cep i mbetur i ndërtesës) vërehet një grumbull gurësh shtufi me formë pak a shumë të rregullt dhe pranë tyre fragmente tullash e tjegullash karakteristike për shekujt e parë të erës sonë.

Na u tha se në vend janë nxjerrë 8 pllaka të mëdha drejtkëndëshe pragjesh. Njerën prej tyre e gjetëm në afërsi. Ajo është prej guri gëlqeror e lëmuar dhe ka përmasat 1.60 x 0.33 x 0.10 m. Në qendër është e paisur me një gropëz të vogël, po ashtu dhe në njerën nga anët e ngushta ku ruhen gjurmë plumbi.

HARDHISHTË

41. GJURMË RRËNOJASH ANTIKE

Brenda territorit të këtij fshati, që shtrihet në të djathtë të Erzenit, rreth 5 km në lindje të Shijakut, gjurmë ndërtimesh antike ruhen në dy pika. Njera nga këto ndodhet në fushë, jo më tepër se 200 m në veri të qendrës së sektorit të kooperativës. Këtu para disa vjetësh nga hapja e një kanali doli një trakt muri i ndërtuar me tulla e llaç. Muri ka

73. E. Bucher, **Griesische Vasenmalerei.** Munchen 1925, f. 100 dhe Georges Nicole, **La peinture des vases grecs,** Paris et Bruxelles 1926, f. 23.

74. Z. Majani, **Fundi i misterit etrusk,** Tiranë 1973, f. 211.

75. Ch. Daremberg et E. Saglio, **Diactionnaire des antiquités et romaines** Paris 1887 (Shih **Hercules**).

76. Njihen mbishkrime e relieve apo statuja antike të gjetura në burime uji e kroje që i shprehin mirënjohje Herakliut, nimfave dhe Eskulapit (shih Daremberg et Saglio, **vep. cit., s.v.** Aquae).

77. Tukididi, I, 24, 2; Straboni VI, 269; Apiani, **Bel. civ.,** II, 39.

78. Apollodori, **Bibliotheca,** f. 75, II, 114 (5, II, 3).

DO NOT COPY

drejtimin lindje-perëndim dhe një gjerësi prej 0.60 m. Tullat dhe llaçi duken të shekujve të parë të e.s.

Pika tjetër ndodhet në lindje të shkollës tetëvjeçare, në faqen «Lakuqe» të kodrës Breggjeta. Edhe këtu shihen fragmente tullash e tjegullash të shekujve të parë të e.s.

42.VARR I NDËRTUAR ME TULLA

Në oborrin e shkollës 8 vjeçare të fshatit, që ndodhet mbi një bregore jo larg bregut të Erzenit, me kohë mësuesve u kishte tërhequr vëmendjen dukja në sipërfaqe e një konstruksioni me formë katërkëndëshe, ndërtuar me tulla. Me një sondazh që kryem aty në verën e vitit 1980, u sqarua se ai konstruksion ishte një varr i madh, i rrënuar në pjesën e sipërme dhe i grabitur (Tab. IV).

Varri ka këto përmasa të jashtme: gjatësi 3.10 m, gjerësi 2.05 m dhe lartësi (në gjendjen që u gjet) 1.35 m. Muri i tij nga të katër anët është i ndërtuar me tulla të plota katërkëndëshe (29-30 x 23-24 x x 3.5-4 cm) dhe gjysmëtullash. Këto janë vendosur në rreshta të rregullta horizontale dhe janë lidhur me llaç të fortë, të gatuar me gëlqere dhe rërë të trashë lumi. Trashësia e mureve është 0.40 m. Në pjesën e poshtme të faqeve të tyre të jashtëme vërehen dhe copëra tjegullash e tullash të ngjitura në mënyrë të çrregullt dhe me shumë llaç.

Arka e varrit është 2.30 m e gjatë, 1.43 m e gjerë dhe (në gjendjen e mbetur) 0.55 m e lartë (Tab. IV, b). Ajo u gjet e mbushur me dhe në ngjyrë të errët, ndryshe nga dheu argjilor jashtë varrit. Brenda në të u gjetën disa kocka njeriu, por në nivele të ndryshme e pa ndonjë sistem, copëra tullash e tjegullash, fragmente enësh balte (Tab. IV, c), një fragment i vogël shisheje qelqi e thëngjij. Një kupë e vogël u gjet pothuaj e plotë. Në një fund amfore u gjet një lëndë e mpiksur si dyll.

Karakteristikë e veçantë e këtij varri është dyshemeja me një konstruksion solid dhe me një trashësi të jashtëzakonshme, prej 0.80 m. Në të është aplikuar një teknikë e rrallë, që alternon disa shtresa (Tab. IV. á). Shtresa e sipërme me trashësi 0.13 m është prej llaçi të fortë gëlqereje të përzier me copëra të vogla tullash e tjegullash të shtypura. Në tërë anën e poshtme ajo ka një shtresë prej copa të vogla tjegullash me pak distancë nga njera tjetra, që janë të ngjitura pjerrtas pas saj. (Një rast i ngjashëm është parë edhe në dyshemetë e termave të Ad Quintum).[79]) Të vendosura në këtë ato krijonin ndaj shtresës tjetër, që vjen poshtë një shtresëz ndarëse prej xhepash të vegjël. Ngjitur në copat e tjegullave vërehet një lloj gëlqereje e pastër me ngjyrë të bardhë në krem.

Shtresa e dytë që vjen më poshtë, konsiston nga dy shtroje tullash me përmasa si ato të mureve, por me ngjyrë më të kuqe. Këto janë vendosur horizontalisht, puqur njera me tjetrën, në tërë gjerësinë e varrit. Shtroja e sipërme ndahet prej shtrojës së poshtme të tullave prej një shtrese llaçi me trashësi sa vetë trashësia e tyre. Të dyja këto shtroje tullash vazhdojnë të shtrihen pa ndërprerje edhe brenda mureve anësore të varrit.

Shtresa e tretë, më poshtë, që ka një trashësi prej 0.37 m, konsiston nga një mbushje solide prej gurësh të vegjël përzier me llaç të bollshëm, **opus caementicium.** Nën këtë vjen një shtresë tjetër me trashësi 10 cm, që ka të njëjtin ndërtim si shtresa e parë. Edhe kjo po ashtu, përfundon nga poshtë me copëra të vogla tjegullash të ngjitura pjerrtas, që kanë pak distancë nga njera tjetra. Shtresa e fundit me trashësi 0.12 m, është e njëllojtë me shtresën e tretë, **opus caementicium.** Në qendër të dyshemesë ishte lënë një gropëz gjysmësferike me diametër 0.40 m dhe thellësi 0.25 m. (Tab. IV).

Jashtë varrit, në anën verilindore (ku kryem sondazhe), u vërejtën të shpërndara deri 2.5 m largësi dhe 0.40 m thellësi, fragmente tullash e tjegullash dhe fragmente enësh balte. Midis tyre u vërejtën fragmente pitosi e amfore, si dhe fragmente **terra sigillata,** që duket se u përkasin të njëjtave enë si ato që u gjetën brenda varrit. Në këtë anë dolën dhe mjaft blloqe të mëdha guri, që mund t'i kenë përkitur mbulesës së varrit dhe mbistrukturës së tij, në se ka pasur.

Duke u mbështetur në teknikën dhe në materialin e ndërtimit si dhe në qeramikën që u gjet brenda dhe jashtë varrit, mendojmë se ky u përket shekujve II-IV të e.s., së njëjtës kohë me varret e zbuluara në Durrës, në rrugën e Vilës.[80]) Por si formë arkitektonike dhe si përmasa, varre të tillë familjarë në vendin tonë njihen që në periudhën e mëparshme, shekujt IV-I p.e.s.[81])

79. N. Ceka, **Ad Quintum,** «Iliria» VI. 1976, f. 290.

80. F. Tartari, **Arkitektura e disa varreve të shek. II-IV në Dyrrah** «Monumentet» 15-16, 1978, f. 65.

81.N. Ceka, **Ndërtimet supulkrale të qyteteve ilire,** «Monumentet» 9, 1979, f. 36, 38, 44.

DO NOT COPY

Përsa i përket dyshemesë së këtij varri, të ndërtuar me teknikën që përshkruam më lart, mund të themi me rezervë se do të jetë bërë për të izoluar atë prej lagështirës nga ana e poshtme. Kjo ndoshta lidhur me inventarin e veçantë që do të ketë pasur.

MEMJE

43. TRAKTE TË UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

Përkundrejt Hardhishtës, në këmbët e kodrave që zbresin mbi bregun e majtë të Erzenit, në të djathtë të rrugës Romanat-Durrës, ruhen trakte dhe gjurmë të ujësjellësit antik të Durrësit.[82)]

Një trakt i kanalit ujëprurës (Fig. 6) është parë në krahun e djathtë të përroit të Memajt, jo më larg se 15 m nga bregu, i lumit. Ky trakt i zbuluar prej vetë përroit, paraqet parete të ndërtuara me tulla trekëndëshe 28 x 14 cm dhe trashësi 3.5 cm. Nga jashtë paretet prej tullash të kanalit janë veshur me një muresë tjetër prej gurësh të çrregullt të lidhur me llaç. Lartësia e mbetur e kanalit këtu është 0.90 m, gjerësia 0.59 m.

Një pjesë e murit të kanalit shihet edhe pranë çezmës së Memajt, në anën e majtë të përroit të Gërxhoit, vetë kjo çezëm duke qënë e adoptuar në një trakt të kanalit të ujësjellësit.[83)]

Prerja e plotë e kanalit ujëprurës shihet përballë kësaj çezme, në anën tjetër të përroit. Këtu duket që ky është i mbuluar me një qemer cilindrik. Lartësia e kanalit me gjithë qemerin është 1.35 m.



Fig. 6

DO NOT COPY

82. F. Miraj – H. Myrto, **Art. cit.**

83. Shih dhe Ing. J. Adam, **Pas gjurmëve të ujësjellësit antik të Durrësit,** B.SH.SH., 1950, I.

DO NOT COPY





1



3

2



4

5



6





1



2



3





4

0 1 2

DO NOT COPY

DO NOT COPY



1



2



3



4

0 3 6 cm.



5



6



7



8



0 1 2 cm

0 2 4 cm



PRERJE GJATESORE a





DO NOT COPY

Halil MYRTO

DO NOT COPY

CARTE DES MONUMENTS DE LA RÉGION DE DURRËS

RESUME

La contrée où nous avons effectué nos recherches constitue justement ce qu'on pourrait appeler l'emplacement authentique de Durrah antique. Il paraît qu'il existe pour cela même une tradition, attestée par des données de la topographie antique: Asparag, petite ville sur Genus (Shkumbin) se nomme «Asparagium Dyrrhachinorum». De même Ishëm dans l'antiquité s'appelle «Isamnus Dyrrhachinorum».

Dans de différentes périodes historiques, les confins du pouvoir politique de Durrës ont été beaucoup plus étroits. De même, il y a eu des périodes historiques, où la région, dont le centre administratif était Durrës, s'étendait loin au delà de ces confins. Mais du point de vue économique c'est la zone dont les liens avec la ville et vice versa ont été conditionnés encore plus par les conditions géographiques.

La zonë d'Ishëm

1. *La forteresse de Scanderbeg, construite en 1451, démolie par le Sultan Mehmet II en 1467 et reconstruite en 1500 par les vénétiens.*
2. *300 m au Nord-Est de la forteresse, un mur en briques, tuiles et céramique du IIIème siècle av.n.è.*
3. *1 km au Sud-Est de la forteresse, près du bord de la mer, l'église à nef unique de Saint-Ndue, de planimétrie rectangulaire et aux traits romains et gothiques.*
4. *Près de l'église, un mur en blocs de pierres sèches.*

Shetaj

5. *Blocs Shetaj de pierre ponce semi-taillés, fragments de céramique antique.*
6. *Au bord de la mer, céramique des premiers siècles et blocs de pierre ponce semi-taillés.*
7. *Ruines de l'église de Sainte-Marie du XIVe-XVe siècles.*
8. *Stèle de marbre du IIIe siècle av.n.è., scène d'adieu sur le fronton l'inscription: . . . . . .*
9. *Torse de femme en marbre, vêtue de lithan et d'un gilet.*

Draç

10. *Deux cionisques-cylindriques du IIIe et Ier siècles av.n*
11. *Fragment de fondation e solens des premiers siècles.*

Ishëm

12. *Forteresse construite en 1571-1574, 100 x 40 m.*

Gjuricaj

13. *Sur une superficie de 4 hectares: briques, tuiles, mur briques du Ie — IVe siècles, chapiteau imposte avec cro du Ve — VIe siècles.*

Shkafanë

16,17. *Tumulus de 7-10 m de diamètre.*

Armath

18. *Récipient en bronze du VIIe-VIe siècles av.n.è.*
19. *Céramique antique, aiguilles en bronze.*
20. *Monnaie d'Antonin-Piu.*

Manëz

21. *Marteau en pierre.*
22. *Colonnes de fenêtre, briques, morceaux de marbre, fra ments de récipients, mosaïque, église paléo-crétienne?*

Borçë

23. *Deux haches en bronze de type albanodalmate (XII siècle av.n.è.).*

Rushkull

24. *Hache en bronze «albano-dalmate».*

Rubjek

25. *Tombes à inventaire du IVe-IIIe siècles av.n.è.*
26. *Fragments de briques, tuiles, récipients du IVe-VIe siècles*

Maminas

27. *Fragments de récipients antiques.*

Qerret

28. Matériel de céramique, briques, tuiles, récipients amphores, sur une superficie de 6000 m². Traces de constructions du Ier – IIe siècles.

Flakë

29. Matériaux de construction du Ie et IIe siècles.

Kashar

30. Fragments de briques, de tuiles en plomb, de récipients en verre. Probablement, une construction du Ier siècle.

Sallmanaj

31. Borne kilométrique miliar du milier VIII de la route Dyrrah-Lis.

Shënavlash

32. 22 tombes du IVe-IIIe siècles av.n.è. avec inventaire des récipients, monnaies de Dyrrah. Herakli-armes.
33. Fragments de colonne dorique.
34. Monnaie de Venise (1275-1280).

Arapaj

35. Plaque avec l'inscription de la réparation de l'aqueduc de Dyrrah par Alexander Sever.

Arapaj-Rashbull

36. 14 puits de contrôle de l'aqueduc antique placé à 70 m loin l'un de l'autre.

Shijak

37. Outil de silex.
38. Relief d'Héraclès.

Une plaque de pierre calcaire en forme de trapèze profilé à la base afin de créer un appui (20, 16, 25 cm).

Sur elle, en haut relief c'est la figure d'un homme nu debout, vu de profil. Son bras droit est levé au-dessus de sa tête, tandis que le bras gauche de même que dans sa main droite il tenait des objets qui se sont cassés. Bien que le visage de l'homme manque, on se rend compte qu'il a eu une barbe courte et des cheveux attachés peut-être au moyen d'un ruban.

Au-dessous de sa main gauche il y a une inscription allant du haut en bas, gravée en alphabet arcaïque corinthien.

Une inscription réalisée de la même façon s'aperçoit même à la corniche profilée de la base.

La corniche comporte une cassure à l'emplacement d'une lettre et les dernières lettres sont presque effacées. Nous pensons que cette figure doit être identifiée à Héraclès. Il s'agit d'une ex-voto du VIe-Ve siècle a.n.è.

Terezie

39. Tombes antiques avec inventaire.

Kënetë

40. Fragments de briques et de tuiles du premier siècle de notre ère.

Hardhishte

41. Fgraments de mur en briques du premier siècle de notre ère.
42. Tombe en briques du IIe-IVe siècle.

Memje

43. Cannal de l'aqueduc de Dyrrah couvert d'une voûte cylindrique d'une hauteur de 1,35 m.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

FREDERIK STAMATI

RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I EPITAFIT TË LASHOVËS

Një nga rastet e vështirë të trajtimit të tekstileve të vjetra në laboratorin e Institutit të Kulturës Popullore është konservimi dhe restaurimi i epitafit të kishës së Lashovës të Përmetit. Epitafi u suall në laborator në fund të vitit 1979 dhe u pregatit për ekspozim muzeal. Përshtypjen e parë të vjetërimit të tij dhe të nevojës për një trajtim laboratorik e dhanë copat e vogla të tekstilit të shkëputura nga astari vende-vende. Puna për konservimin e tij filloi menjëherë dhe me një kujdes të veçantë.

Së pari u shqyrtua gjendja fizike e epitafit. Epitafi me gjatësi 67 cm dhe gjerësi 55 cm përbëhet nga dy copa tekstili të vendosura njera mbi tjetrën. E sipërmja, një kadife e shkëlqyer me ngjyrë të bukur, shërben si sfond i goditur për qëndismat me fije ari, argjendi dhe tekstili. Pluhuri i madh i grumbulluar prej kohe, si dhe pikimet e shumta nga qirinjtë e kishin mbuluar pothuajse të gjithë sipërfaqen dhe e kishin ndyrë aq keq epitafin, sa që çdo konceptim i qartë i figurave të qëndisura aty ishte i pamundur. Në pjesën e sipërme e kish dëmtuar tepër një e djegur në formë shiriti, e shkaktuar me sa duket nga flaka e ndonjë qiriu të vendosur pranë. Me sa duket ky epitaf dikur ka pasë qënë ekspozuar në pozicion vertikal. Këtë e dëshmon jo vetëm e djegura nga flaka e qiriut, por edhe mbeturina e një koke prej bronxi, të një thumbi tashmë të humbur, si dhe çpimet e gozhdave prej hekuri përdorimi i të cilave faktohet nga brimat e mëdha të mbetura midis qëndismave prej fijesh metalike dhe tekstili, si dhe gjurmave të ndryshkut rreth këtyre brimave. Tekstili në njollat e ndryshkut ishte dobësuar shumë, bile vende-vende ishte zhdukur. Duke analizuar shkallën e kalbjes të shkaktuar ndoshta nga roli katalitik i oksidit të hekurit ndaj gazit sulfuror arritëm në konkluzionin se ky epitaf është mjaft i vjetër. Disa dëmtime të tjera vihen re në bordurë, si edhe në thekët prej fijesh ari. Astari ndodhej në një gjendje tepër të rëndë. Edhe ajo pjesë e mbetur ishte e kalbur aq sa fibrat nuk duronin dot as edhe tërheqjen më të vogël.

Puna e pastrimit filloi nga largimi i njollave të qirinjve. Për këtë u veprua me letra filtri dhe hekur për hekurosje të ngrohur jo aq shumë. Natyrisht që njollat tashmë të hapura më tepër, si edhe shtypja e pushit krijuan një gjendje të përkohëshme shëmtimi më të madh. Por ky proçes është i domosdoshëm për të shkurtuar kohën e pastrimit. Largimi i mëtejshëm i njollave të qirinjve u realizua me tetrakloretilen. Për këtë u pregatit një banjë prej fletësh polietileni. Trajtimi zgjati gjashtë orë. Brenda kësaj periudhe tretësi u ndrrua dy herë. Veprimi u ndihmua me fërkime të lehta me anë të një peneli të butë. Por një pjesë e njollave të qirinjve, me sa duket dyll bletësh, nuk u largua me këtë proces. Pastrimi i plotë i këtyre papastërtive organike u krye me eter etilik për një kohë fare të shkurtër.

Mbas këtyre proceseve u vu re edhe dëmtimi që kanë lënë pikimet e qirinjve mbi kadife. Në njollat më të reja ka një venitje të ngjyrës, ndërsa tek të vjetrat pushi i kadifes ishte zhdukur si rezultat i veprimit metabolik të mikroorganizmave. Meqënëse papastërtitë inorganike nuk ishin larguar u mendua për një pastrim të dytë, por kësaj radhe me detergentë. Përpara se të kryhej ky proces u veprua për largimin e njollave të ndryshkut. Për këtë qëllim u përdorën tubeta «Heksen», U



Fig. 1

konstatua se ngjyra vishnje e kadifes nuk i reziston-te shumë veprimit të pastruesit.

Banja përfundimtare u përgatit me një çezme ku u shtuan 4 gr/1 sandopan që është një detergent jo jonik. Pastrimi zgjati rreth 30 minuta në 40°C. Pastrimi u ndihmua me anë të fërkimit të lehtë me penel në drejtim të përdredhjes së fijeve të arit dhe argjendit. Shpëlarja u krye me ujë të boll-shëm dhe në fund me ujë të distiluar. Tharja u bë natyrale.

Tani ky rezultat ishte plotësisht i kënaqshëm. Ky epitaf i regjeneruar e rimori freskinë e arit dhe argjendit si dhe të ngjyrave të tekstilit. E gjithë mje-shtëria e përdorur gjatë përgatitjes së tij tani shfaqej në forcën e saj. Kombinimi i ngjyrave, i fi-jeve dy ngjyrëshe të përdredhura, ndërfutja e arit dhe e argjendit humbasin çdo monotoni dhe i japin kompozimit gjallëri (fig. 1).

Epitafi i Lashovës, përbën një realizim artistik të mjeshtërit popullor.[1]) Nga mënyra e punimit dhe nga ornamentika ai i takon shekullit XVIII-XIX. Skena e vajtimit të Krishtit e paraqitur simbas zakonit zë gati të gjithë fushën prej kadifeje. Kompozimi për-bëhet nga figura e vendosur në qendër e Krishtit të vdekur të shtrirë në shtrat, nga Shën Mëria që e vajton, si edhe nga dy vajtonjëse. Varianti me shumë figura nuk është pëlqyer si duket për shkak të dimensionit të vogël të epitafit. Në sfond, nën një hark të madh është qëndisur një arkadë me tri harqe të vegjël dhe në mes të saj kryqi me sim-bolet e mundimit të Krishtit. Anash, nga dy harqet e vegjël që paraqesin në mënyrë skematike ambien-tin e arkitekturës varen dy kandilë të njëllojtë, në mënyrë simetrike. Kompozimin e shtjelluar në sfon-din e arkitekturës e mbyllin në të katër qoshet katër koka engjëjsh me gjashtë fletë. Fusha kufi-

DO NOT COPY

zohet nga një bordurë dhe thekët e dendura që varen anash.

Restaurimi i mëtejshëm i epitafit u përqëndrua në punime forcimi dhe qëndistari artistike. Ato pak fije ari e argjendi që ishin shkëputur pjesërisht nga baza prej kartoni u kapën me një fije nailoni shumë të hollë dhe të tejdukshme. Një copë kadife me ngjyrë pothuajse të njëjtë me atë origjinale u vendos veref në dy vende për të mbushur pjesën e djegur, ndërsa plotësimi i qëndismave në këto pjesë, si dhe i thekëve në dy vende u realizua në Ndërmarrjen Artistike «Migjeni» me imitacione ari e argjendi me përmbajtje bakri dhe alumini përkatësisht. Vendet e plotësuara dallohen qartë për të shmangur çdo keqkuptim në vërtetësinë e objektit.

Për ta forcuar, epitafit i u ngjit nga mbrapa me hekur të ngrohtë një tekstil sintetik me po të njëjtën madhësi.

Tani ky epitaf ruhet i ekspozuar në Muzeun e Artit Mesjetar Shqiptar dhe përfaqëson atje një nga qëndismat më të realizuara

DO NOT COPY

1) Për përshkrimin e epitafit na ndihmoi doc. **Dh. Dhamo,** të cilën e falenderojmë për ndihmën e dhënë.

Frederik STAMATI

DO NOT COPY

RESTAURATION ET CONSERVATION DE L'ÉPITAPHE LE LASHOVE

RESUME

L'un des cas difficile du traitement des textiles anciens dans le laboratoire de l'Institut de la Culture Populaire est présenté par la conservation et la restauration de l'épitaphe de l'église de Lashove, à Përmet.

La première impression de son vieillissement et du besoin de traitement au laboratoire furent présentés par les petites morceaux de textile détachées de la doublure, par ci par là.

Tout d'abord on examina l'état physique de l'épitaphe. L'épitaphe, ayant 67 cm de long et 55 cm de large, est composée de deux morceaux de textile placés l'un sur l'autre. Le morceau de dessus, du velours brillant de belle couleur, sert de fond réussi aux broderies appliquées avec des fils d'or, d'argent et de textile. La poussière accumulée en grande quantité depuis longtemps, ainsi que les taches multiples causées par les bougies, avaient presque entièrement couvert la surface et avaient tellement sali l'épitaphe que la conception des figures brodées était impossible. Dans sa partie supérieure, l'épitaphe était endommagée par une brûlure en forme de ruban.

Le travail de nettoyage commença par ôter les taches de bougie. Pour ce faire, on s'est servi de filtres en papier et de fer à repasser pas trop chauffé. C'est au moyen de tétraclorétilène qu'on a continué plus tard à faire disparaître les taches. Pour ce faire, on prépara un bain avec des feuilles de poliétilène. Le traitement dura six heures. Le nettoyage complet des malpropretés organiques fut fait avec de l'éther éthylique pour un temps trop court.

Après ces processus, on s'est rendu compte aussi de l'endommagement, caussé par les gouttes de bougie, sur le velours. Aux endroits des taches récentes la couleur s'est atténuée, tandis qu'à celles des anciennes le duvet du velours avait disparu à la suite de l'action méthabolique des micro-organismes. Puisque les malpropretés inorganiques n'étaient pas suprimées on a pensé à un second nettoyage, mais cette fois en usant de détergents. Avant d'entreprendre ce processus, on a travaillé pour supprimer les taches de rouille. Dans ce but on a fait usage de tubes «Hexen». Il fut constaté que la couleur carmin du velours ne résistait pas assez au détergent.

Le bain final fut préparé avec de l'eau, où l'on a ajouté 4 gr/l de sandopan, étant un détergent non ionique. Le lavage dura 30 minutes à 40°C. Le lavage fut aide, on frottant avec un pinceau dans le sens des fils d'or et d'argent. Le rinçage fut fait avec de l'eau en abondance et enfin avec de l'eau distillé. Le séchage fut naturel.

A présent le résultat était satisfaisant. Cette épitaphe regénérée reprit la fraicheur de l'or et de l'argent ainsi que des couleurs du textile.

L'épitaphe de Lashove constitue une réalisation artistique du maitre populaire. Par le mode d'exécution et l'art ornemental, elle appartient au XVIIIe-XIXe siècle. La scène du deuil du Christ, présentée selon l'habitude, occupe presque toute la surface du velours. La composition est constituée au centre par la figure du Christ mort et couché sur un lit, par la Sainte-Marie qui le pleure, ainsi que par deux pleureuses. Dans le fond, sous un grand arc, est brodée une arcade à trois petits arcs et au centre d'elle la croix aux symboles de la peine du Christ. Sur les côtés, sur les deux petits arcs, représentant de façon schématique le volume de l'architecture, sont suspendus, de façon symétrique, deux veilleuses identiques.

A présent, cet épitaphe est conservée au Musée de l'Art Médiéval Albanais en y représentant l'une des broderies les plus réussie.

DO NOT COPY

SHUAIP MANE

VËSHTRIM MBI VEPRAT HIDRIKE NË BERATIN MESJETAR

Objekti i këtij kumtimi është pikërisht që të paraqesim rezultatet e vëzhgimeve në fushën e ndërtimit të veprave hidrike në Beratin mesjetar dhe konsideratat lidhur me to. Burimet e shkruara nuk na njohin drejtpërdrejt me ndërtimet hidrike, por, duke na dhënë një pasqyrë të gjerë të jetës ekonomike-shoqërore dhe kulturore të qytetit ato plotësojnë kuadrin e nevojshëm për të analizuar këto ndërtime. Duke vështruar lagjen Mangalem të lindin një sërë pyetjesh. Si kanë qënë ndërtesat publike e dyqanet? Si bëhej furnizimi me ujë i qytetit, a ka patur sistem kanalizimesh si dhe të çfarë lloji?

Në burimet historike mund të gjejmë edhe numrin e disa prej këtyre ndërtimeve dhe sidomos për dyqanet e zejeve dhe ato të tregtisë. Në shekullin XVII pazari i Beratit mendohet të ketë pasur 900 dyqane dhe një sërë ndërtimesh inxhinierike, dy hamame, kulla sahati mullinj për bluarjen e drithit dhe orizit si dhe mengra të shumta për vaj ulliri, etj.[1] Në shekullin XVII, Berati ka pasur bezistenin e vet.[2] Ky zhvillim që Berati arriti gjatë shekujve XVII-XVIII i mbështetur në faktorët e brendshëm, u ngadalsua nga gjysma e dytë e shekullit XIX duke pasur një rënie relative në krahasim me qytetet e tjerë shqiptarë. Në vitet 30 të këtij shekulli Berati e humbi rolin e tij të dikurshëm si një nga qytetet më të rëndësishëm të vendit tonë.

Në jetën e një qyteti krahas kujdesit që tregohej për ndërtimin e banesave, rrugëve dhe ndërtesave social-ekonomike vijnë dhe veprat hidrike si ato për furnizimin me ujë të banjave publike, kanale për largimin e ujërave të bardha, kanalizime të ujërave të zeza, ura, mure mbrojtëse nga lumi, për vaditje, etj. Qyteti i Beratit për relievin dhe pozitën e vet gjeografike, kushtëzuar gjithashtu edhe nga faktorët e tjerë, edhe në këtë drejtim ka specifikën e vet. Pa dyshim në tërë këtë kompleks vend me rëndësi ze furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm. Mënyra më e përhapur e furnizimit me ujë brenda qytetit të Beratit ka qënë ajo me puse. Me përjashtim të lagjes «Kala», pjesës së sipërme të lagjeve «13 Shtatori», «Partizani» dhe «Kodra e Sulmit», gjithë territori tjetër është i përshtatshëm për ndërtim pusesh. Për këtë arsye puset kanë qënë gjithmonë në një numër të konsiderueshëm. Ku të thellë e ku të cekët ata gjenden kudo në zona kodrinore, në përrenj në fundet e kodrave, në toka të buta apo të forta. Në mjaft puse uji ka qënë i mirë dhe i ftohtë. Uji i tyre përdorej për të pirë, për të gatuar, si dhe për nevoja të tjera sanitare dhe deri për vaditje të kopshteve.

Puset me kuotë më të lartë kanë qënë ato pranë Kalasë së Biftës, nga të cilët sipas të thënave merrej uji për furnizimin e çezmës së Minollait, të mbiquajtur më vonë Çezmë e Novës. Këta puse ndoshta

1. Z. Shkodra, **Esnafet shqiptare,** 1973, f. 67.
2. **Po aty,** f. 74.

furnizonin edhe një lagje të vogël në shpatin perëndimor të Kalasë. Pusi më i lartë që ruhet sot është ai i Shëndëlliut, i cili ndodhet në rrëzë të një kodre gjatë rrugës nga qafa e Kalasë për në Shëndëlli. Pusi ruhet mirë me përjashtim të pjesës mbitokësore.

Mjeshtëria e ndërtimit të puseve ka qënë mjaft e përhapur. Kjo vërtetohet nga numëri i madh i puseve si dhe kujdesi me të cilin ndërtoheshin. Deri më sot numërohen mbi 150 puse, të ndërtuar para shekullit XX. Në raste të rralla ka dhe puse të ndërtuar gjatë 40 vjetëve të parë të shekullit tonë. Gjatë 40 vjetëve të fundit puset nuk ndërtohen më dhe për këtë mjeshtëri po flitet gjithmonë e më rrallë për shkak të ndërtimit të ujësjellësve.

Teknika e përdorur në ndërtimin e puseve është pothuaj e njëjtë. Gërmimi bëhej gjithmonë duke ruajtur formën rrethore. Paretet e brendshme visheshin me mur guri, ndërsa fundi i pusit, krahas themelit të murit anësor, shtrohej me kalldrëm e zhavor për të mbajtur ujë të pastër. Po kështu gryka ngrihej kurdoherë nga toka si për mënjanimin e rreziqeve, ashtu dhe për t i mbajtur ata pastër. Mbi grykë vendosej një kapak dërrase, mbi të cilin mbi dy shtylla vendosej çikriku. Jo rrallë, puset mbuloheshin edhe me çati. Puset janë ngritur kryesisht në oborret e shtëpive ose në kopshtet, por ka pasur edhe puse publike që shërbenin për lagjen, dhe për udhëtarët. I tillë është pusi me çati në lagjen «Kushtrimi», dy puse në qendër të qytetit, etj.

Terreni i qytetit mbi reliev të thyer kodrinor dhe vende vende shkëmbor nuk lejon të hapen kudo puse uji. Në këto raste sigurimi i ujit është arritur nga depozitimi i ujit në stera.

Kjo mënyrë furnizimi me ujë ka një traditë të vjetër. Në lagjen «Kala» stera të tilla ruhen edhe sot me shumicë. Më të pakta janë ato në lagjet «13 Shtatori» e «Partizani», ndonse mjaft të rralla ato nuk mungojnë dhe në zonat e tjera të lagjeve kodrinore si «8 Nëntori», «10 Korriku», «Barrikada», etj.

Furnizimi i sterave me ujë bëhej me dy rrugë. Për të gjitha sterat, të vogla apo të mëdha, uji i shiut i cili mblidhej me një sistem të veçantë ulluqesh nga çatia, përbënte burimin kryesor. Por duke qënë se shirat nuk janë të bollshëm për çdo stinë, rëndësi ka pasur edhe furnizimi i tyre me ujë të bartur me kafshë nga burimet apo çezmat e qytetit.

Sterat gjenden kryesisht ngjitur me banesat. Në vartësi nga tipi i banesës ato gjenden nën shkallë, në ambientet e brendshme të katit përdhe, si dhe oborrin e tyre.

Mjeshtërit popullorë duke shfrytëzuar terrenin dhe mundësitë konkrete të porositësit, kanë dhënë zgjidhje mjaft interesante. Shpesh stera ndërtohet nën nivelin e sipërfaqes së tokës dhe mbi të ngrihet një grykë e ngjashme me ato të puseve. Madje në rastet kur stera ndodhet në oborr, mbi këtë vendose dhe çikriku dhe nxjerrja e ujit bëhet me kova. Teknika e ndërtimit është pothuaj kudo e njëllojtë: mure guri me llaç të zakonshëm ose harasan, ndërsa hidroizolimi është realizuar në të gjitha rastet me llaç harasan të fortë të patinuar mirë. Harasani përmban dy pjesë grimca guri smërçi, dy pjesë gëlqere, një pjesë pluhur tulle dhe pak rërë të larë ose pluhur guri. Hidroizolimi është kryer me sukses jo vetëm në sterat me volume të vogla por edhe në sterat me volume relativisht të mëdha, siç janë ato të Kalasë. Stera e madhe e Kalasë, saranxha, ndodhet në pjesën më të lartë të akropolit, brenda rrethimit të tretë. Mbi të ngrihej selia feudale e më tej e komandantit të kështjellës. Sot ajo gjendet nën taban, por gjatë pastrimeve është zbuluar se nga ana veriore ka një xokol me dritare. Planimetria e saj paraqet një sallë katërkëndëshe kënddrejtë, e cila përshkohet me drejtimin gjatësor nga kolona të cilat bashkohen në lartësi me njera tjetrën me harqe. Në Kala brenda rrethimit të dytë vitet e fundit janë zbuluar dy stera, njera pranë tjetrës. Ndërtimi i tyre duhet të lidhet me ndërtimet gjatë kohës së pasha-llëqeve të mëdha shqiptare të fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX.

Njera nga këto stera është e mbështetur te porta jugore e akropolit. Për këtë, porta është mbyllur dhe suvatuar me llaç harasan nga brenda. Kjo sterë ka vëllim paralelopiped me bazë 5.7 x 10 m, të mbuluar me qemer nga sipër. Jo më larg se 3 m në drejtimin verior, ndodhet stera tjetër me përmasa 17 x 4.15 m dhe thellësi 2.7 m. Dy pilastra në anët gjatësore, duket se mbanin nervaturën e qemerit. Në faqen e jashtme nga ana perëndimore, ruhet vendi i marrjes së ujit në formë çezme.

Në raste rrethimi si rrugë për furnizimin me ujë të Kalasë përdorej edhe galeria që të çonte në lumë, afër urës së Goricës. Gjurmët e kësaj galerie ruhen edhe sot.

Për lagjen «Kala» dhe pjesërisht për lagjet kodrinore veç sterave, furnizimi me ujë, kryhej me kafshë. Njerzit që transportonin ujë quheshin ujarë. Uji ngarkohej në bucela prej druri të cilat mbarteshin nga kafshë ngarkese. Këtë lloj pune, zakonisht e kryenin njerzit e shtresave më të varfëra.

Në qytetin e Beratit veç sterave, puseve dhe furnizimit me ujë nëpërmjet transportit me kafshë, janë përdorur edhe burime e çezma. Burimet janë të shumta, meqë të gjitha kodrat ku ngrihet Berati zbresin drejt Osumit.

Të përmendur janë burimi i Goricës, disa dhjetra metra në perëndim të urës së Goricës anës lumit, që kishte ujë mali të bollshëm dhe u shërbente

BOTIMET

jo vetëm banorëve të lagjes Goricë por edhe banorëve të lagjeve më të afërta të cilët mbushnin ujë me kafshë ose me krahë; burimi pranë kishës së Shën Mërisë anës lumit, i cili përdorej kryesisht nga dyqanxhinjtë e shumtë dyqanet e të cilëve radhiteshin në krahun e majtë të kishës në drejtim të lagjes Mangalem. Ky burim përmendet për ujë të ftohtë dhe mjaft të preferuar. Gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës në vitin 1979 ky burim u kap. Ujërat e tij kishin një prurje rreth 2 l/sek. Burimet janë shfrytëzuar në gjendje krejt natyrale, me gravitet si dhe të sistemuara me derdhje në formë çurke. Në qytet ka pasur dhe çezma. Këto ndërtohen në dy mënyra:

a. Duke shfrytëzuar ujin e puseve. Në këtë rast grumbullohet uji i disa puseve, i cili me një tubacion çohej në kuotë të ulët, në vende më të përshtatshme.

b. Nëpërmjet ujësjellësve. Këta janë me prurje të ndryshme dhe gjatësi relativisht të shkurtër nga kapja e ujit e deri te çezma.

Lëvizja e ujit sigurohej me tuba qeramike ose kanale të patinuara me llaç harasan dhe të mbuluar. Në jug-lindje të Kalasë aty ku ka qënë lundra, dhe ku sot ndodhen mbeturinat e një kulle të rrethimit mesjetar, ka qënë një çezëm e rregullt me grykë dhe ndoshta dhe me rezervuarin e ujit që ka mundësi të mblidhej nga burimet. Në krye në lagjen «Përroi» është edhe sot çezma e Avramit, por e braktisur. Gjendja e sotme i përket një rindërtimi pa shumë vlerë. Edhe kjo çezëm furnizohej nga burimet. Pak më poshtë Çezmës së Avramit, pranë Muzeut Etnografik, ka qënë një çezëm tjetër e quajtur Çezma e Shpofit. Edhe kjo u braktis vetëm pasi u vendos rrjeti i ujësjellësit në lagje. Çezma të tilla ka pasur dhe në lagje të tjera si ajo në lagjen «10 Korriku», Çezma e çurkut, Çezma e xha Tafilit, etj.

Në lagjen «Çlirim», afër Sahatit, ndodhej çezma më e frekuentueshme e cila i shërbente lagjeve «Çlirimi», «Barrikadë Nr. 1» dhe Nr. 2 si dhe lagjes «Kala». Në këtë çezëm ujarët mbushnin bucelat për të furnizuar popullatën e Kalasë. Çezma përbëhej prej pesë lëfytash të vendosura në dy faqe, të cilat bashkoheshin në një kënd 90°. Në fund gjendej ulluku që largonte ujërat. Edhe kjo çezëm ka shërbyer deri vonë. Nuk e dimë ende nëse ky është një burim i kapur në atë vend ku ngrihej çezma apo uji sillej nga ndonjë pikë tjetër. Por me bllokimin e çezmave nga dherat, uji ka dalë 50-60 m më në veri në një kopësht.

Ujësjellësi, gjurmët e të cilit ndeshen sot në lagjen «8 Nëntori» duhet të ketë qënë një vepër me rëndësi. Fragmenti që ruhet sot më i plotë, është rreth 30 m ndërsa gjurmët e dukshme kapen në një gjatësi rreth 70 m. Duke kërkuar drejtimin nga vjen ky ujësjellës hasëm në dy burime të mundshme. Duke u nisur nga fragmente tubash të gjetura në pjesën jug-perëndimore të Uznovës, fillimisht menduam se burimi duhej kërkuar në luginën e përroit të Vodicës ose në Uznovë. Kërkimet e mëtejshme nxorën në dritë se burimin ky ujësjellës e ka pasur në Duhanas. Fragmente të plota të këtij ujësjellësi u gjetën në fushën e Uznovës me drejtimin Duhanas-Berat. Në fragmentin e ruajtur në Berat ujësjellësi është ndërtuar mbi një mur të ngritur. Kanali ka formën e shkronjës «U» që vjen poshtë duke u mbledhur dhe përfundon në 26 cm ndërsa në krye është rreth 32 cm. Paretet e tij janë të suvatuara dhe patinuara me llaç harasan ndërsa sipër është i mbuluar me pllaka guri të puthitura. Në vendet e aksidentuara kapërcimi është bërë me urë. Një e tillë njëhapësirëshe i ka të dy shpatullat në kapërcyellin midis lagjes «10 Korriku» dhe «8 Nëntori». Hapësira e dritës është 10 m, gjerësia e mureve 120 cm ndërsa sot, pjesa e sipërme e harkut është e shembur.

Udhëtari turk Evlia Çelebiu, ndërmjet të tjerash theksonte se në Berat ndodhen edhe dy çezma të ndërtuara me mjeshtëri të rrallë, por ato nuk ruhen as edhe në kujtesën e të moshuarve. Çelebiu flet edhe për banjot publike[3]) rrënojat e të cilave ruhen ende sot. Në afërsi të tyre kalonte dhe ujësjellësi i mësipërm. Për rrjedhim, ekzistenca e ujësjellësit në mënyrë tërthorazi provon praninë e çezmave. Deri tani kemi hasur dy gjurmë çezmash të vjetra, njera në lagjen «8 Nëntori» në afërsi të hamameve. Këtu ndodhet e ngulitur në mur një pllakë mermeri e gdhendur me një motiv floreal. Në mesin e lules ndodhet një birë nëpër të cilën është fiksuar një tub hekuri si lëfyt i çesmës. Gjurma e çesmës tjetër është pranë xhamisë Mbret. Këtu anës rrugës mbështetur në mur duket një nike e cekët e mbuluar me hark. Harku dhe paturat janë ndërtuar me tulla e gurë, teknikë që ngjason me atë të minaresë së xhamisë së afërt.

Nuk jemi të mendimet se këto janë çesmat për të cilat bën fjalë Çelebiu, mjaft të thjeshta për t'ia tërhequr vëmendjen. Por nga ana tjetër kjo dëshmon se çesmat kanë qënë të shpeshta, sidomos për qendrën e qytetit, gjë që shpjegon më së miri edhe aftësinë relativisht të madhe ujëprurëse të ujësjellësit.

3. E. Çelebi, **Sejethatnamesi**, V. VIII

DOKTORATURE

Në Palikesht, Velabisht dhe pranë lagjes Partizani ka dëshmi se janë parë gjurmë ujësjellësi, tuba qeramike, ç'ka tregon për qënien e një ujësjellësi që sillte ujërat e burimeve të Mbreshtanit. Një ujësjellës i tillë kërkonte jo vetëm fuqi ekonomike, por edhe aftësi teknike e zbatuese për t'u realizuar. Ky ujësjellës mund të ngrihej vetëm i shoqëruar me vepra arti, të cilat kërkonin njohuri inxhinierike. Gjurmë të tjera ujësjellësi janë ato që ndodhen aty ku fillon Barrikadë, duke iu veshur shpatit perëndimor të Kalasë, i afrohet asaj më shumë. Këtu deri vitet e fundit kishte gjurmë ndërtimesh masive që flisnin për një pjesë të zhvilluar të lagjes Dalibeg. Aty veç banesave ka pasur një furrë dhe një burim. Kur iky i fundit u prish, doli në shesh një tubacion qeramike. Drejtimi i këtij tubacioni është nga Qafa e Kalasë. Ky ujësjellës ka mundësi të sillte ujin e ndonjë burimi aty afër, sot të zhdukur, apo si vepër marrje të ketë pasur puset e biftës për të cilat u fol më sipër.

Qyteti i Beratit ka pasur dhe një numër kanalesh si ato të mbyllurat për tërheqjen e ujërave të larta dhe ujërave të zeza nga disa lagje si dhe kanale të hapura që e sillnin ujin në mullinjtë e bluarjes dhe për vaditje të kopshteve. Deri vonë janë ruajtur gjurmë të kanalit (remës) të lagjeve Kushtrim dhe Barrikadë. Ngritja mekanike e ujit për vaditje realizohej me çikrik druri të vendosur në aksin e remës. Çikriku përfaqësonte një disk prej dërrase me diametër rreth 3 m, të pajisur me fletë dërrase vendosur tërthor me perimetrin e diskut. Në faqet e tij vendoseshin kova të fiksuara. Disku vendosej mbi një aks tërthor me kanalin, dhe paralel me të vendoseshin ku derdheshin kovat. Prej këndej, me një lug uji kalonte në breg ku shpërndahej me rrjetin e kanaleve vaditës.

Nga kanalizimet e ujërave të zeza të cilat ndërtoheshin me gurë dhe mbuloheshin me pllaka e si për tyre me kalldrëm, gjurmët më të plota ruhen në lagjet 13 Shtatori dhe Kala. Në lagjen 13 Shtatori është realizuar një rrjet kanalesh me mjeshtëri të lartë. Terreni i pjerrët dhe plotësisht shkëmbor nuk ka penguar mjeshtërit që kur nuk mund të ndiqnin rrjetin rrugor t'i kalonin këto kanale ndën banesat. Nga këto kanale një pjesë është e lidhur me kanalizimin e ri, një pjesë e tyre ka mbetur pa funksion, ndërsa pjesa tjetër është prishur.

Nga kanalet e ujërave të bardha, ai që grumbullon ujërat e përroit të lagjes 1 Maji ka qënë i mbuluar me qemer dhe paraqet interes të veçantë. Ky kanal me gjerësi 3 m, dhe lartësi vende vende deri 6 m, kalon mes për mes qendrës mesjetare të qytetit, dhe në shumë pika mbi të ngrihen ndërtime të ndryshme. Këtu duhet vënë në dukje jo vetëm kapaciteti shumë i madh i këtij kanali, por edhe kujdesi me të cilin është ndërtuar dhe mënyra si është maskuar.

Nga sa parashtruam më sipër mund të themi me bindje se ndërtimet e shumta dhe të larmishme flasin qartë për nivele të larta në artin e të ndërtuarit dhe në veprat hidrike të qytetit të Beratit.

DO NOT COPY

Shuaip MANE

DO NOT COPY

REGARD SUR LES OUVRAGES HYDRAULIQUES DU BERAT MEDIEVAL

RESUME

Le mode d'approvisionnement en eau le plus répandu à Berat a été celui au moyen de puits. Profonds ou peu profonds ils se trouvent partout dans les zones de collines, dans les ruisseaux, aux pieds de collines, dans de différents sols. L'eau d'assez de puits a été bonne et fraiche. Elle était employée à boire, ainsi qu'à satisfaire des besoins sanitaires, ou même à irriguer les jardins.

Les puits à la côte la plus élevée ont été ceux qui se situaient près de la Citadelle de Bifte, où, selon des témoignages orales, on puisait l'eau, fournissant la fontaine de Minolla. plus tard surnomée la fontaine de Nove. Ces puits approvisionnaient d'eau, probablement, un petit quartier aussi, se trouvant sur le versant occidental de la Citadelle. Le puits le plus élevé conservé encore de nos jours est celui de Shëndelli, se situant aux pieds d'une colline sur la route allant du col de la Citadelle à Shëndelli. Ce puits est bien conservé à l'exception de la partie superficielle.

Le métier de construction de puits a été assez répandu. Ceci est attesté par le grand nombre de puits, ainsi que par les soins avec lesquels on les construisait. Jusqu'à ce jour on compte plus de 150 puits, construits avant le XXe siècle. Dans des cas rares, on trouve des puits construits durant les 40 premières années de ce siècle. Pendant ces 40 dernières années on l'a plus construit de puits, et l'on parle toujours moins de ce métier, à cause de la construction d'aqueducs.

La technique de construction de puits est presque la même. Le creusage se faisait toujours en gardant la forme circulaire. Les parois intérieurs étaient de mur en pierres, alors que le fond du puits en même temps que les fondements du mur latéral était, couverts de pavés et de gravier afin d'accumuler de l'eau pure. Les parois des puits étaient élevés au-dessus du niveau du sol afin d'éviter le danger et de les tenir propres. Le trou était couvert d'un couvercle en bois et dessus on installait le treuil sur deux supports. Suvent les puits étaient couverts d'un toit même. Les puits sont principalement construits dans les cours de maisons ou dans les jardins mais il a existé aussi de puits publiques servant à tout un quartier et aux passants.

Le terrain accidenté de colline et par ci par là rocheux de la ville ne permet pas de creuser partout des puits. Dans ces cas l'eau était accumulée dans des réservoirs.

L'approvisionnement en eau des réservoirs était fait de deux façons. Pour tous les réservoirs, grands ou petits l'eau des pluies, accumulées par un système particulier de conduits et provenant du toit, constituait la source principale. Mais puisque les précipitations ne sont pas abondantes en toute saison, leur approvisionnement en eau, transportée au moyen d'animaux et provenant des sources ou des fontaines de la ville, était d'importance.

Les réservoirs sont généralement jointes aux habitations. Conformément au type d'habitation, ils se trouvent sous l'escalier, dans les volumes intérieurs du rez-de-chaussée, ainsi que dans leurs cours.

Souvent le réservoir est construit au-dessous du niveau de la surface du sol, ayant un rebord pareil à celui des puits. Lorsque le réservoir se trouve dans la cour, sur elle on installe le rouet et l'eau est tirée au moyen de seaux. La technique de construction est presque partout pareille: mur de pierre, avec du mortier ordinaire ou du crépi, alors que la hydro-isolation a été réalisée, dans tous les cas, avec du crépi dur. Le crépi contient deux parts de grains de pierre, deux de chaux, une de poudre de tuile et un peu de sable lavé ou de poudre de pierre. La hydro-isolation s'est effectuée avec succès non seulement dans les citernes de petit volume relativement grand, comme celles de la Citadelle. La grande citerne de la Citadelle se trouve dans la partie la plus élevée de l'acropole, à l'intérieur du troisième mur d'enceinte. Au-dessus d'elle s'élevait le siège féodal et plus loin celui du commandant de la Citadelle. Actuellement, elle se trouve sous les assises, mais au cours des néttoyages, on a découvert, un soubassement avec fenêtres. Sa planimétrie présente une salle rectangulaire où, dans le sens de sa longueur, s'élèvent des colonnes, qui s'unissent à une certaine hauteur au moyen d'arcs. Dans la Citadelle à l'intérieur du second mur d'enceinte, ces dernières années on a découvert deux citernes, l'une près de l'autre. Leur construction est liée aux autres constructions entreprises

pendant l'époque des grands pachaliks albanais de la fin du XVIIIe siècle et du début du XIXe siècle.

L'une de ces citernes s'appuie contre la porte méridionale de l'acropole. Pour ce faire, la porte a été bouchée et crépie de l'intérieur. Cette citerne a un volume en forme de parallélépipède, ayant une base de 5,7 x 10 m, et couverte d'une voûte. Non plus loin de 3 m dans le sens Nord, se trouve l'autre citerne aux dimensions de 17 x 4.15 m et de 2.7 m de profondeur. Deux piliers s'élevant aux côtés longitudinaux, semblent avoir supporté les ogives de la voûte. Sur la face extérieur dans le côté occidental, il est conservé l'endroit où l'on puisait l'eau, en forme de fontaine.

En cas de siège, pour fournir d'eau la citadelle, on servait aussi de la galerie, qui menait à la rivière, près du pont de Gorice. Les traces de cette galerie sont conservées encore de nos jours.

Dans le quartier de «Kala» et en partie dans les quartiers de collines, à part les citernes, l'approvisionnement en eau, se faisait au moyen d'animaux. Les personnes qui transportaient de l'eau s'appelaient «ujarë» (transporteurs d'eau). L'eau était transportée en barilets de bois portés par des animaux de somme. D'habitude ce travail était fait par des gens provenant des couches les plus pauvres.

A Berat, à part les citernes, les puits et la fourniture en eau au moyen d'animaux, on s'est aussi servi de sources et de fontaines. Les sources sont nombreuses, puisque toutes les collines, sur lesquelles s'élève Berat, descendent sur Osum.

L'eau coulait dans des tubes de céramique ou dans des canaux crépis et couverts. Au Sud-Est de la Citadelle, la tour de siège médiévale, a été une bonne fontaine, avec rebord et peut-être avec un réservoir recueillant l'eau des sources.

Le viaduc, dont les traces se trouvent de nos jours dans le quartier «8 Novembre», a dû être un ouvrage d'importance. Le fragment le plus complet, qu'on conserve encore aujourd'hui, a environ 30 m de long, alors que les traces visibles atteignent une longueur d'environ 70 m. La source de ce viaduc a été découverte dans la plaine d'Uznove, dans la direction Duhanes-Berat. Dans le fragment conservé à Berat, le viaduc est construit sur un mur élevé. Le canal a la forme de la lettre «U» qui devient étroit au fond ayant 26 cm tandis qu'à la partie supérieur il a 32 cm. Ses parois sont crépis et il est couvert de dalles de pierre conjointes. Là où le terrain était accidenté on avait construit des ponts.

Le voyageur turc Evlia Çelebi, entre autres soulignait qu'à Berat il y avait deux fontaines construites avec une rare maestria, mais elles ne sont plus présentes, même dans la mémoire des plus âgés,

A Palikesht, à Velabisht et près du quartier «Partizani», il existe des témoignages de traces de viaduc, de tubes de céramique, ce qui démontre l'existence d'un viaduc qui transportait l'eau des sources de Mbreshtan. La construction d'un tel viaduc exigeait non seulement de la puissance économique, mais aussi des aptitudes techniques et d'application.

La ville de Berat a aussi en un certain nombre de canaux comme ceux couverts, destinés à l'écoulement des eaux abondantes ou des eaux noires de certaines quartiers, ainsi que des cannaux découverts qui conduisaient l'eau aux moulins, et transportait l'eau destinée à l'irrigation des jardins. Jusqu'à bien tard, on a conservé les traces du canal des quartiers «Kushtrim» et «Barrikade». L'élévation mécanique de l'eau destinée à l'irrigation se réalisait au moyen d'un rouet de bois installé sur l'axe du canal. Le rouet était représenté par un disque de planches, au diamètre d'environ 3 m, doté de feuilles de planches placées transversalement au périmètre du disque. Sur ses faces on mettait des seaux fixés. Le disque était placé sur un axe transversal au canal et parallèlement à lui s'versaient les seaux. De là l'eau, au moyen d'un conduit, passait sur la berge et coulait dans le réseau de canaux d'irrigation.

Parmi les canaux d'eaux pures, celui qui accueille les eaux du ruisseau du quartier «1 Mai» a été couvert et présente de l'intérêt particulier. Ce canal, d'une largeur de 3 m et d'une hauteur, ci là, de jusqu'à 6 m, traverse le centre médiéval de la ville, et à de multiples points, au-dessus de lui s'élèvent de différentes constructions.

Il faut là mettre en évidence non seulement la très grande capacité de ce canal, mais aussi le soin avec lequel, il a été construit et la façon avec laquelle, il a été masqué.

De ce qui a été plus haut, l'on peut dire que les constructions multiples et variées témoignent clairement de hauts niveaux de l'art de construction et des ouvrages hydrauliques de la ville de Berat.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

STILIAN ADHAMI

SHTJEFËN GJEÇOVI NJË NDËR PIONIERËT E MBROJTJES DHE GJURMIMIT TË MONUMENTEVE

Dokumentacioni mjaft i pasur që është grumbulluar në Arkivin Qendror të Shtetit për patriotin dhe shkencëtarin tonë të tri dekadave të para të këtij shekulli Shtjefën Gjeçov Kryeziun, ka dhënë mundësi që vitet e fundit të studiohet e zbërthehet më gjerë kontributi i vyer dhe i gjithanshëm që ai ka dhënë në fusha të ndryshme të shkencave albanologjike. Veçanërisht me rastin e 50 vjetorit të vrasjes së tij tragjike u zhvilluan një sërë aktivitetesh dhe u botuan disa artikuj, për të nxjerrë më në pah jetën dhe veprën e kësaj figure të shquar.[1]). Megjithatë Gjeçovi mund të radhitet në atë varg personalitetesh poliedrike për të cilët, sado që të shkruhet, prapseprapë mbetet diçka për të thënë.

Qëllimi i këtyre radhëve është jo vetëm për të vënë theksin mbi disa anë të veprimtarisë së këtij hulumtuesi të palodhur të kulturës sonë popullore, por sidomos për të trajtuar edhe atë kontribut sado të vogël të tij, pak ose aspak të njohur, në fushën e gjurmimit dhe mbrojtjes së monumenteve tona të kulturës.

Tanimë njihet prirja dhe interesimi i veçantë i Gjeçovit për kulturën materiale të popullit tonë, gjë që pasqyrohet qartë dhe në motivacionin e dekorimit të tij, ku cilësohet «më i pari arkeolog shqiptar». Në të vërtetë kërkimet e para në këto fusha të kryera gjatë këtij shekulli në vendin tonë nga një shqiptar janë të lidhura me emrin e Gjeçovit.

Megjithëse jetoi në kohë të turbullta, kur të drejtat e kombit tonë merreshin nëpër këmbë nga pushtuesit e huaj dhe veglat e tyre që sundonin vendin Gjeçovi jo vetëm që nuk u pajtua me politikën antikombëtare të tyre, por me sa mundi i stigmatizoi këto forca të errëta dhe u rreshtua kurdoherë përkrah popullit, në interes të të cilit vuri gjithë veprimtarinë e tij patriotike e shkencore dhe gjithshka që zotëronte. Pasqyrë për këtë janë ndjekjet e vazhdueshme, kërcënimet dhe dënimet që ai pati nga pushtuesit turq, italianë, austro-hungarezë, serbë etj. dhe më në fund vrasja tragjike e tij nga serbomëdhenjtë atë 14 Tetor të vitit 1929.

Shoku Enver, duke vlerësuar lart veprën e këtij atdhetari, midis të tjerave ka thënë: «Shtjefën Gjeçovi ka qënë frat por patriot, i cili vinte mbi të gjë-

---

1) Duke lënë mënjanë artikujt e shumtë të botuar në organet e shtypit të përditëshëm, vlejnë të përmenden disa nga punimet studimore kryesore të botuara në shtypin shkencor e letrar: V. Kamsi. **Fillimet e arkeologjisë shqiptare dhe kontributi i Shtjefën K. Gjeçov–Kryeziut,** «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», nr. 4, 1966; A. Cetta. **Shtjefën Konstatin Gjeçovi,** «Gjurmime albanologjike», folklor dhe etnologji, IV-1974, Prishtinë 1976; A. Buda **Sh. K. Gjeçovi 1874-1929. Nga jeta dhe veprimtaria e tij,** «Studime historike» nr. 4, 1979; S. Islami. **Shtjefën Gjeçovi si arkeolog,** «Studime historike» nr. 4, 1979; Rrok Zojzi. **Shtjefën Konstandin Gjeçovi – patriot dhe studiues i shquar i kulturës popullore,** «Kultura popullore», 1980/1; S. Adhami, **Shtjefën Gjeçovi – hulumtues i shquar i kulturës sonë kombëtare.** «Nëntori» 1, 1981.

tha interesat e Shqipërisë e jo të Austro-Hungarisë, të Vatikanit e të Musolinit».[2]) Gjeçovi ishte kundërshtar i rreptë që vlerat e kulturës sonë materiale të bëheshin plaçkë tregu. Ai gjithashtu, shquhej kundër koncensioneve arkeologjike të të huajve, duke i quajtur gjurmimet dhe gërmimet si detyrë të vetë shqiptarëve, sepse siç arsyetonte me të drejtë, asnjë i huaj, qoftë edhe dashamirës, nuk mund ta trajtonte me vërtetësi e në mënyrë të plotë historinë dhe kulturën e të parëve tanë.

Duke u nisur nga teza se «një popull që nuk ka histori të vetën, zihet si i vdekur» edhe Gjeçovin, si gjithë rilindësit tanë e interesonte shumë e kaluara e popullit tonë dhe gjithë vlerat e historisë së tij, duke përfshirë edhe monumentet e lëvizshëm e të palëvizshëm. Ai ishte i vetëdijshëm se për ta njohur shkencërisht historinë e popullit nevojitej, veç të tjerave, edhe një bazë materiale shkencore; pikërisht për këtë Gjeçovi kërkonte formimin e një arkivi historik dhe të një muzeu arkeologjik. Dhe punoi në këtë drejtim. Ai arriti të formulojë mendimin e drejtë, se jeta e vërtetë e popullit nuk mund të gjendej vetëm në dokumentet e vendeve sunduese të huaja. Sipas tij «visari ynë i vërtetë kombëtar gjendet i mbuluar nën dhé ose në kujtesën e popullit»; prandaj ai zhvilloi një veprimtari të dendur për t'i vjelur sistematikisht këto thesare.[3])

Gjeçovit iu desh të merrej me gjurmimin e monumenteve tona i nxitur nga nevoja dhe detyra e lartë patriotike për të vërtetuar se populli ynë është një nga popujt më të vjetër të Ballkanit e të Europës, pasardhës i ilirëve dhe autokton, jo i ardhur në trojet e veta, të vërteta historike këto që kërkonin t'ia mohonin armiqtë, të cilët viheshin në garë dhe për t'i grabitur pasuritë e mëdha të kulturës së tij.

Duke kryer vetë gërmime në shumë pika të vendit tonë dhe duke grumbulluar e krijuar të parin koleksion arkeologjik në Shqipëri, ai jo vetëm u përpoq që të nxjerrë në shesh historinë e popullit tonë, por njëkohësisht u tregua një mbrojtës i flakët i monumenteve tona, që dëshmojnë për kulturën dhe historinë e të parëve tanë.

Në shkrimin e tij të vitit 1920, me titull «Një argëtim arkeologjik», në të cilin jep dhe kumtimin e parë mbi rezultatet e kërkimeve dhe sondazheve të tij të bëra në afërsi të fshatit Troshan të Zadrimës dhe në krahinat fqinje shohim se Gjeçovin e interesojnë edhe monumentet e palëvizshme. Pikërisht në këtë shkrim ai jep njoftime të vlefshme edhe mbi dy qyteza të vjetra që gjenden para Troshanit ajo e Lapës dhe Kodra Gjytazë, si dhe për numrin e madh të tumave që ai kishte vërejtur.[4])

Duke kaluar nëpër duar disa dorëshkrime të Gjeçovit, si atë me titull «Vjetërsorja» të shkruar në Gomsiqe më 1914 apo skemën e një artikulli «Të huajt e arkeologjia e jonë», që nuk janë botuar por që kanë përbërë skeletin e artikullit të mësipërm, nuk është vështirë të nxirren disa përfundime e vlerësime mbi përgatitjen, aftësitë dhe horizontin kulturor të këtij dijetari edhe në këtë fushë të shkencave albanologjike. Ai ka njohuri të mira rreth kulturave Hallshta, La Tène, Glasinac etj. Është i informuar për zbulimet e Trojës, Kretës, Tirintit, Mikenës etj. njeh edhe albanologët e ndryshëm që janë marrë me historinë tonë. Ai është vetëdijshëm për vlerën e studimeve dhe punës kërkimore të thellë historiko-filologjike të bërë nga Hani e deri tek Majeri, Nopça etj. sipas të cilëve populli shqiptar mbahet për popull më i pari që banoi në Gadishullin Ballkanik.

Gjeçovi tregon shqetësim për fatin e visareve të mbledhura në tokën tonë. Sipas tij, përpos disa çikërrimave që gjenden në Berlin e në Hofmuseum të Vjenës shumica kanë mbaruar në duar private. Por gjen ngushëllim e disi lehtësohet kur mendon se ato gërmime e grabitje «u banë atëhere ku shqyptari nuk ishte zót si shpie të vet».

Duke vlerësuar fushën e Shtoit (Shkodër) si një ndër qendrat më të pasura në kulturë materiale (sipas Traeger me 250 tuma). Gjeçovi indinjohet ndaj klikave të shtetit shqiptar të atëhershëm, që këtë truall ua lëshojmë me qira të huajve, «t'cilët ndo shta me nji tumul mundet me nxjerrë t'tana pare e veta». Varfërimin e vendit nga visaret më të çmueshme, si janë «vjetërsiet», Gjeçovi e konsideron si mjerimin më të madh për vendin, pra tregon një vlerësim të merituar për këto pasuri kulturore.

Si një studies i dhënë pas kulturës materiale të popullit, ai tregon mjaft interesim për monumentet e trashëguara nga e kaluara. Me një letër që dërgon nga Rubiku më 17.6.1921 në Monte Cassino (Itali), Gjeçovi kërkon që në bazë dokumentash t'i jepen njoftime për një numër manastiresh e kishash të rrënuara tek ne, me qëllim që «të vërtetonte tradita e popullit tonë». Konkretisht Gjeçovit i interesojnë të dhëna, «për t'i vënë në pah në organe e shtypit» për manastiret-rrënojë të Rubikut, Oro

2. Enver Hoxha, **Tërmeti lëkund malet por jo Shqiptarin,** Tiranë 1979, f. 92.
3. Aleks Buda, **Vep. cit.**
4. Sh. Gjeçovi, **Një argëtim arkeologjik,** «ZSHN» 1920, nr. 4, 8, 9.

DO NOT COPY

shit, Ndërfandit, Shatit, Pogut, Rrashit, Dervendit, Bokjanit, Kurbinit etj. Dhe si njohës i tyre, ai u përshkruan gjendjen e tyre, duke u ndalur më gjatë tek manastiri i Rubikut. Para ndërtimit të këtij manastiri (vitit 1896), Gjeçovi përmend se ekzistonte një kapelë (kishëzë) dhe një shtëpi stacionare. Kapela kishte të vetmin altar absidën, që edhe sot është ruajtur e paprekur edhe pse u ndërtua më vonë një kishë e madhe mbi të. Gjeçovi jep të renditura një nga një pikturat e absidës së vjetër, që sipas tij, duhet të jetë pikturuar nga ndonjë benediktin, si edhe flet për mbishkrimin me vitin e themelimit (1250). Në këtë material gjen të dhëna edhe për një monument tjetër me vlerë, rrënojat e të cilit janë vënë në mbrojtje shtetërore. Është fjala për kishën e Shën Mërisë në fshatin me të njëjtin emër, tre orë larg Krujës. Për këtë faltore Gjeçovi thotë se ka qënë me tri anijata, prej të cilave absida e anijatës qendrore ka qënë e pikturuar duke qënë e ndarë me katër kate.[5])

Këtij hulumtuesi të apasionar i tërheq vëmendjen çdo gjë me interes për kulturën materiale dhe historinë e popullit tonë: një rrasë e thyer tek altari i kishës së Shtjefnit në Blinisht (dhe nuk mungon ta skicojë këtë), «Burgu i jetës», ku përfund sarajeve të Zogollit «të parët e Ahmet Zogut burgosshin fajtorët ad vitam», disa kulla të 5 oxhaqeve të dëgjuara të Matit (Kurshari, Patin, Klos). Në këtë të fundit, ai thotë se «është në zë oxhaku i Skneri-t, një rrem i fisit të Skënderbegut (Skënderi-Skneri)». Ndoshta një sinjalizim i tillë prej tij mund të mos jetë pa interes që të cytë ndonjë gjurmues të ardhshëm. Vlerat që paraqesin kullat e malësisë ndër ne si nga ana historike ashtu edhe arkitektonike nuk kanë ngelur jashtë vëzhgimit të këtij dijetari. Madje në shënimet e tij gjen edhe ndonjë vizatim kulle apo shpjegime të termës «kullë» të krahasuar dhe me gjuhë të tjera.[6])

Në rolin e një mbrojtësi të flaktë të pasurive tona kulturore na paraqitet Gjeçovi kur ngre zërin e shprehet: «Sa rrënime, faltoresh të vjetra janë dërmue prej të huejsh, sa vorre suka e qytete janë çilë e shkapërderdhur që sot s'u dihet ma fije; sa suka (tumuli) 3000-4000 vjeçe janë të rrafshueme; sa rrasa, shtylla e kaptej e kso tjerash qi kan ndje në gjumë të ambël deri parvjet, e sod s'i gjen ma aty». Ofshamje të tilla të shprehura botërisht në shtypin e vitit 1920, vërejmë të dalin prej tij edhe për qendrën arkeologjike aq të përmendur Apollonisë që «në tri vjet e tekndej a ba gropa-gropa, visare të vjetra të sajë janë bajtë ndër vende të huaja me qerre e vagona». Dhe nuk mjafton me kaq; thirrjet e tij vazhdojnë: «Të njitena kah Durrësi, kah Tirana e Krueja, kah Lezhja e Shkodra, kah Kopliku e Vuksanlakaj, kah Komani e Duzhmani e do të shofim prej gropash se sa visare janë nxjerrë e bajt prej të huejsh». Në të vërtetë gjatë luftës së parë botërore na janë bërë mjaft grabitje e dëmtime të pasurisë kulturore. Duke qortuar edhe veten për mungesën e përkujdesjes që të gjurmoheshin e mblidheshin ato pasuri kulturore që na i ka ruajtur toka mëmë, Gjeçovi stigmatizon përsëri të huajt «që na shtiheshin si miq» dhe që grabitnin e dhunonin këto pasuri bash në sytë tona dhe më mund e djersë tonat» duke sjellë si shembull përveç të tjerave, tumat në krye të fushës së Shtoit.[7])

Këmba e Gjeçovit ka shkelur krahina të tëra të Atdheut tonë dhe syri i tij ka vëzhguar monumente të shumta. Ka të dhëna se më 1924 ai shetiti në mjaft vise të Elbasanit për të vëzhguar kalatë e moçme dhe së andejmi kaloi në Belësh, ku i ra anembanë Gradishtës së atjeshme për të parë gjurmë muresh të lashta, mbledhi copëza qeramike, gurë stralli etj., pyeti barinjtë për gjetje arkeologjike dhe u hodh drejt Sulovës përtej Devollit, për të vizituar një qytezë tjetër të lashtë. Në një kënd rradhoi Gjeçovi ka shënuar se në verën e vitit 1924 në kishën e Shën Kollit të Elbasanit, brenda në kungë, kishte parë tre këmbana, njera prej të cilave ka qënë e Sopotit të Bërzeshtës e që i përkiste shekullit XV.[8])

Nëqoftëse ne sot ruajmë me përkujdesje të veçantë në Muzeun e Skënderbeut në Krujë, si një objekt origjinal të epokës së tij, këmbanën e vitit 1452, nëpërmjet së cilës kush e di sa herë janë dhënë kushtrime për beteja apo lajme fitoresh të armëve shqiptare të asaj kohe, kjo i detyrohet kryesisht edhe interesimit e përpjekjeve të bëra nga Gjeçovi ynë. Në një skicë të kësaj këmbane, që ky na ka lënë në fondin e tij dokumentar, ka dhënë disa shënime mbi lëvizjet dhe historikun e këtij objekti me rëndësi të veçantë për ne, ku midis të tjerave lexojmë: «Kjo kumonë ash kenë e marrun prej kumonares s'kishës s'Shën Nureut n'Krue. Unë ja morra Ibrahim Kaloshit t'Kmetanit edhe i dhash 15 napolona...».[9])

5. **AQH i RPSSH,** fondi 58, D. 20.
6. **AQH i RPSSH,** fondi 58, D. 94/2
7. **AQH i RPSSH,** fondi 58, D. 32.
8. DH. S. Shuteriqi, **60 tregime në një,** Tiranë 1979, f. 214-218.
9. **AQH i RPSSH,** fondi 58, D. 3.

Do not copy

Midis dokumentave të shumta që bëjnë pjesë në epistolarin e Gjeçovit, gjendet edhe letërkëmbimi i albanologut F. Nopça zhvilluar me Gjeçovin që nga viti 1909 deri në 1914, kur Gjeçovi i prish marrëdhëniet me të. Mjerisht gjenden vetëm letrat e Nopçës dërguar Gjeçovit dhe jo të këtij të fundit, i cili diku jep vetëm ndonjë shënim përbri letrave. Letërkëmbimi është i lidhur me gërmimet e gjetjet arkeologjike në Shqipëri nga të dy palët. Madje në një letër Nopça e përshëndet dhe e përgëzon Gjeçovin për zbulimet e tij që ka bërë në Shurdhah.

Fati i gërmimeve arkeologjike e interesonte Gjeçovin edhe kur ndodhej jashtë kufijve të Shqipërisë. Këtë e vërejmë, ndër të tjera, në një letërkëmbim të tij të vitit 1926, ku flitet për gërmimet e Pojanit. Këto gërmime e kishin interesuar mjaft sidomos kur u transferua në Vlorë më 1920. Kjo shprehet qartë dhe në një letër tjetër të vitit 1927 që i drejtonte përsëri një patrioti vlonjat, ku midis të tjerave shprehej: «Unë mendova se po i largohem Shkodrës tue ardhë andej kah ju kah Vlora e mandej në Pojan, ku eshitën (dalin sheshit–S.A.) hit e ilirëve e të Romakëvet me rmime arkeologjike qi po bahen atje».[10])

Prej disa vizatimeve e skicave, të bëra me dorën e Gjeçovit, si p.sh. të kullave të Matit, të Kambanës së Krujës, të një unaze dhe të një mbërthecke etj. duket se ky gjurmues i apasionuar zotëronte dhe aftësinë për të vizatuar vetë.

Shfletojmë këtë dokumentacion të pasur rreth veprimtarisë së gjerë të këtij patrioti e shkencëtari të shquar dhe nuk mund të mos rrëmbehemi nga një entuziazëm legjitim kur vrojtojmë se shumë dekada përpara Gjeçovi arrin të formulojë një sërë mendimesh thellësisht patriotike e shkencore jo vetëm për atë kohë, që çelën shtigje të reja në fusha të ndryshme deri atëhere të palavruara nga shqiptarët, por që edhe sot disa prej tyre tingëllojnë aktuale, pavarësisht nga niveli i lartë që kanë arritur shkencat albanologjike. E shohim, pra, me vend që, qoftë dhe përmbledhtas, të parashtrojmë disa nga parimet mbi të cilat mbështetej puna e tij shumëvjeçare, si edhe të vëmë theksin mbi disa momente nga veprimtaria e tij, që na duken me interes e që lidhen me gjurmimin dhe mbrojtjen e monumenteve tona apo të «visarit kombëtar» siç shprehej ai vetë.

Mendimet e Gjeçovit vërtiteshin pak a shumë rreth idesë që edhe nëqoftëse ilirët nuk na kanë lënë vepra të shkruara, por ata kanë zhvilluar një veprimtari ndërtimtare e fortifikuese, mbeturinat e të cilave vërehen në sipërfaqe apo i ka mbuluar dheu. Dhe jo vetëm kaq; ata kanë prodhuar sende që u nevojiteshin për jetën e tyre të përditëshme për ushqim e për veshje, për gjueti e për luftë, për të punuar e për marrëdhënie ekonomike etj. Prandaj të gjitha këto duhet t'i rrëmojmë e t'i nxjerrim në dritë që me studimin e tyre të nxjerrim përfundimet e duhura në interes të hartimit dhe pasurimit të historisë sonë të kaluar. Sigurisht ky interesim i Gjeçovit për këto pasuri kulturore nuk qe diçka që i lindi rastësisht, por është i lidhur me edukimin dhe brumosjen e tij me idetë patriotike të rilindësve tanë, duke e quajtur arkeologjinë si një fushë që mund të kontribuonte shumë në ndriçimin e historisë kombëtare.[11])

Në shkrimin e tij «Nji argëtim arkeologjik», ku Gjeçovi parashtron parimet e shkencës arkeologjike, metodat dhe teknikën e punës së arkeologut, nuk mund të mos vërejmë pozitat e përparuara, demokratike e kombëtare të tij. Pasi trajton gjerë rëndësinë e vlerave që kanë pasuritë tona kulturore të trashëguara nga një brez në tjetrin, Gjeçovi bën thirrje që të organizohen kërkimet arkeologjike shqiptare, gjë që – siç thotë ai vetë – do të çonte së shpejti në krijimin e një muzeu kombëtar ... e sendet e gjetura kishin me i dhanë shkas qortimit të disa pikave të historisë botërore», të cilat kanë mbet deri në ditët tona të pazhdervillueme e si një kash e lashë për kah të endunit e kombeve të lashta».

Me shumë interes është dhe mendimi tjetër pozitiv i Gjeçovit mbi paprekshmërinë e mos cënimit të monumenteve tona. Kur ai bën krahasim midis letërsisë dhe arkeologjisë me shumë të drejtë shtron problemin se rreziqeve që i kanosen letërsisë e gjuhësisë mund t'i gjendet zgjidhja e riparimit të tyre, kurse «arkeologjia sa asht e lakmueshme aq e ma gjendet në rrezik... Mjafton një kuletë e mbushur me sende të vjetra, të gjetura në tokën tonë prej një të huajit për me na lanë në terr ndoi pikë historiet». Pikërisht për këtë arsye Gjeçovi shtron me tërë seriozitetin e duhur problemin e mbrojtjes së këtyre vlerave, sidomos nga grabitja në masë që po u bëhej nga të huajt. Ai tërheq vëmendjen e bashkëatdhetarëve për t'i bërë të vetëdijshëm për pasurinë e madhe të monumenteve historike të vendit, i cili është aq i pasur me kësi vlerash «sa nuk

10. Letër e Gjeçovit dërguar Ibrahim Shytit në Vlorë, në familjen e të cilit ajo ruhet.

11. S. Islami, **vep. cit.**

DO NOT COPY

mund të bëjë njeriu dy hapa pa i ndeshë syri e kamba... në të metuna të motnueme (sende të moçme – S.A) dhe jo vetëm në disa krahina po në tërë Shqipërinë sa është e gjerë dhe e gjatë».

Duke u mësuar bashkëudhëtarëve të vet mënyrën e nxjerrjes në dritë të mbledhjes e të ruajtjes së objekteve arkeologjike, Gjeçovi bën edhe një vlerësim të drejtë të pasurive të kulturës sonë materiale. Ai ka një koncept të drejtë kur thekson se jo vetëm sendet e arta e të argjenta kanë vlerë, por edhe ato prej hekuri apo prej bakri, të cilat në disa raste për nga vlera historike ua kalojnë edhe sendeve të arta e të argjenta.

Në studimin e monumenteve tona ky shkencëtar përdorte metodën krahasuese ose – siç thoshte ai – «tuj i krahasue sendet e gjetura prej kohëve të lashta për vleftësim të historisë kombëtare». Me sa dimë ne Gjeçovi është ndër të parët që vuri re ngjashmërinë që kishin etruskët me të parët tanë në mënyrën e varrimit të të vdekurve, në mënyrën e hapjes e të mbulimit të vendvarrimeve etj.

Ky shkencëtar patriot ndjen një shqetësim të madh për visarin kombëtar dhe historinë tonë kombëtare, ndaj të cilave në kohën e tij klasat sunduese tregonin mospërfillje. Dhe gjen rastin të flasë me pasion për vlerat që bartin gjurmët që të parët tanë kanë lënë «në ndërtesat e madhnueshme e ledhet vigane që shihen nëpër Shqipëri e nëpër vende ku kanë pas banue e kalue këta». Nga ana tjetër dënon qëndrimin antikombëtar të atyre që lejonin ose bënin tregëti me pasuritë kulturore të popullit tonë. Sepse, siç vëren ai me të drejtë «kti visarit mbi të cilin pshtetet jeta e kombit tonë mbasi na vetë s'i bim mrapa, të huejt ja kan bajtë kujdesin qysh kah mot për me na lanë ne pa të».

Në këtë vepër fisnike të tij për gjurmimin e mbrojtjen e monumenteve është për t'u vënë në pah lufta dhe përpjekjet që ai bëri për të përballuar pengesat e shumta herë të hapura e herë të fshehta që i nxirrnin ata që nuk donin që historia jonë të dilte në dritë. Nuk po përmendim këtu dhe vështirësitë e tjera materiale që i duhej të kapërcente.

Gjurmët e veprimtarisë kërkimore të Gjeçovit i gjejmë në Laç e Troshan, në Koman e Shtoj, në Gajtan e Shurdhah dhe gjetkë e gjetkë; por të gjitha monumentet, vendbanimet e pikat arkeologjike ku ai bëri gërmime nuk mund të themi se njihen plotësisht.

Së fundi mendojmë se nuk është pa vlerë të sjellim nja dy shembuj për të treguar pastërtinë morale të tij në grumbullimin e thesareve kombëtare, për të cilat nisej vetëm e vetëm nga interesat e larta të Atdheut dhe aspak nga lakmia për përfitime personale.

Gjeçovi koleksionin e vet prej 500 objektesh arkeologjike ia la trashëgim kulturës sonë kombëtare. Le të kujtojmë rastin e unazës që më 1905 ia kërkoi për ta blerë arkeologu gjerman Dr. P. Traeger, por Gjeçovi që dënonte matrapazllëqet me vlerat kulturore dhe që nuk ishte kërkues thesaresh për t'u pasuruar, nuk mund ta njolloste veten dhe nuk mund të bënte tregti me këtë pasuri të përbashkët të popullit. Emri i tij zuri vend në historinë e Shqipërisë si njeri që i kushtoi kulturës autoktone arkeologjike koleksonin e tij me vlerë.[12])

Çështjen e gjurmimit dhe mbrojtjen e monumenteve Shtjefën Gjeçovi nuk e shikon si monopol të një pakice njerëzish të ditur, por kërkon që në këtë fushë të ndihmojnë të gjithë shqiptarët. Pra, do të thoshim se në këtë drejtim kemi të bëjmë përsëri me pikëpamje demokratike të tij. Në të vërtetë ai na paraqitet si pararendës i masivizimit të shkencës. Nga metoda e punës së tij kanë ç'të mësojnë edhe studiuesit e sotëm të monumenteve. Ai u jepte rëndësi të veçantë kontakteve të ngushta me popullin, bashkëbisedimeve me të për të hetuar se çfarë ruan kujtesa popullore mbi këto vlera. Ai vërtet vlerësonte çdo të dhënë që dilte nga populli, çdo dëshmi gojore ose pamore të njerëzve të moshuar, por të gjitha këto ia nënshtronte verifikimit, krahasimit dhe studimit të imtë të të dhënave të grumbulluara. Në këtë përfundim arrijmë duke lexuar shkrimet e veta; kështu p.sh. ai tregon se si shkoi në vend në kodrën e quajtur «Kodra Kuveth», ku «mbas diftimit të një burri të vjetër të Troshanit mledheshin gjindja herët për me ba kuvende». Gjeçovi nuk ishte njeri i teorizimeve boshe, por duke i rënë kryq e tërthor vendit ai dha shembull konkret për kohën që jetoi se si kërkimet dhe studimet e historisë shqiptare duhet të ishin frut i vetë shqiptarëve dhe jo i të huajve. Shumë domethënëse dhe mjaft natyrshëm del nga goja e tij shprehja tanimë e njohur «mjaft na asht gjymtue historia prej të huejsh».

12. **Historia e Shqipërisë**, Tiranë 1958, f. 19.

ZVKTSH

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

SHTJEFËN GJEÇOVI L'UN DES PIONNIERS DE LA PROTECTION ET DE LA RECHERCHE DES MONUMENTS

RESUME

Les premiers travaux, dans le domaine de la recherche et de la protection de nos monuments de culture, au cours de ce siècle, dans notre pays, èffectués par des albanais, sont liés au nom de Gjeçovi.

Bien qu'il ait vécu en temps trouble, où les droits de notre nation étaient refoulés aux pieds, Gjeçovi, non seulement il ne s'est pas conformé à la politique antinationale, mais tant qu'il put, il stigmatisa les forces obscures et se rangea toujours à côté du peuple, au service duquel il mit toute son activité patriotique et tout ce qu'il pos édait. Ceci est temoigné par les poursuites continuelles, les menaces et les condamnations que les occupants lui infligèrent et finalement son assassinat tragique par les mégalomanes serbes, le 14 octobre de l'année 1929. Partant de la thèse qu'«un peuple qui n'a pas sa propre histoire, est considéré comme mort» Gjeçovi, tout comme les autres patriotes de notre Renaissance, était beaucoup intéressé par le passé de notre peuple et par toutes les valeurs de son histoire, y compris les monuments mobiles et immobiles. Il était conscient que pour connaître scientifiquement l'histoire du peuple il était nécessaire, à part les autres choses, d'avoir même une base matérielle scientifique; c'est justement dans ce but que Gjeçovi exigeait la formation d'archives historiques et d'un musée archéologique. Et il travailla dans ce sens.

En entreprenant lui-même des fouilles dans plusieurs points du pays et en collectant et en créant la première collection archéologique en Albanie, non seulement il s'efforça de mettre à jour l'histoire de notre peuple, mais il s'est montré aussi un protecteur ardent de nos monuments, qui témoignent de la culture et de l'histoire de nos ancêtres.

Dans son écrit de l'année 1920, intitulé «Une distraction archéologique», il fournit des informations de valeur même sur deux sites antiques, se trouvant avant Torshan, celle de Lape et la colline de Gjytazë ainsi que sur le grand nombre de tumulus qu'il avait remarqués.

En examinant quelques manuscrits de Gjeçovi, comme celui intitulé «Vjetërsorja» (Antiquités), écrit à Gomsiqe, en 1914, ou bien le schéma de l'articles «Les étrangers et notre archéologie», qui n'ont pas été publiés, il n'est pas difficile d'en tirer quelques conclusions et appréciations sur la formation, les aptitudes et l'horizon culturel de ce savant même dans le domaine des sciences albanologiques. Il a de bonnes connaissances sur les cultures de Hollstatt, La tène, Glasina etc. Il connait les différents albanologues qui se sont occupé de notre histoire. Il est conscient de la valeur des études e du profond travail de recherche historique et philologique ef fectués par Hahn et jusqu'à Mayer, Nopçsa, etc.

En estimant la plaine de Shtoi (Shkodra) comme l'un de centres les plus riches en culture matérielle (avec 250 tumulu selon Traeger), Gjeçovi, s'indigne contre les cliques de l'Eta albanais d'alors, d'avoir loué ce terrain aux étrangers. L'appro vissement du pays, en ce qui concerne les trésors les plu précieux, Gjeçovi le considère comme la plus grande misère du pays, donc il porte une estimation méritée sur ces ri chesses culturelles.

Avec une lettre qu'il envoie de Rubik le 17.6.1921 à Monte Cassino (Italie), Gjeçovi demande des informations su un certain nombre de monastères et églises ruinés chez nous en vue de «certifier les traditions de notre peuple». En parlant du monatère de Rubik, Gjeçovi mentionne une chapelle ayant existé avant la construction de ce monastère (année 1896), qui avait une abside seulement et qui est conservé intacte, bien qu'une grande église ait été batie au-dessus d'elle. Gjeçovi énumère une à une les peintures de l'abside ancienne, lesquelles, selon lui, ont du être peintes par quelque bénédictin, et parle aussi de l'inscription avec l'année de fondation (1250). Dans ce matériel on trouve des données même sur un autre monument de valeur, dont les ruines ont été mises sous la protection de l'Etat. Il est question de l'église de Sainte-Marie du village de même nom, à trois heures de Krujë. De ce temple Gjeçovi dit qu'il a eu trois nefs, dont l'abside de la nef centrale était peinte en trois rangées.

Les valeurs que présentent les manoirs de la région montagneuse chez nous, soit du point de vue historique, soit architectonique n'ont pas échappé à l'observation de ce savant. Dans ses notes, on trouve même quelque dessin de manoir ou des explications du mot «kullë» (manoir) en comparaison avec d'autres langues aussi. Gjeçovi a parcouru des régions entières de la Patrie et son oeil a observé de nombreux monuments. Il y a des données qu'en 1924, il erra dans la région d'Elbasan afin d'examiner les forteresses anciennes et de là il passa à Belsh et continua vers Sulovë, au-delà du Devoll, pour visiter un autre site antique.

Gjeçovi a noté quelque part, que, pendant l'été de l'année 1924, dans l'église du Saint Koll d'Elbasan, à l'intérieur du baptistère, il avait appartenu à Sopot de Bërzeshtë et datait du XVe siècle.

Si, de nos jours, on conserve, avec des soins particuliers, dans le Musée de Scanderbeg à Krujë, en tant qu'objet original d'époque, la cloche de l'année 1462 ceci est dû surtout à l'intérêt que Gjeçovi y a porté et aux efforts qu'il a déployés. Sur une esquisse de cette cloche, que Gjeçovi a laissé dans ses fonds documentaires, il fournit quelques notes sur les dépiacements et l'histoire de cet objet d'importance particulière pour nous.

Parmi les nombreux documents constituants l'oeuvre écrite de Gjeçovi, on trouve aussi la correspondance de l'albanologue F. Noptcha avec Gjeçovi, de l'année 1909 à 1914. Malheureusement on n'y trouve que les lettres de Nopçsa envoyées à Gjeçovi et non celles de ce dernier, qui parfois a écrit quelque note sur la marge de ces lettres. La correspondance est liée aux fouilles et aux documents archéologiques en Albanie, effectuées par les deux parties. Voire, dans une lettre Nopçsa salue et félicité Gjeçovi de ses découvertes faites à Shurdhah.

Le sort des fouilles archéologiques intéressait Gjeçovi même lorsqu'il était en dehors des frontières d'Albanie. Nous constatons ceci, entre autres, dans sa correspondance de l'année 1926, où l'on parle des fouilles de Pojan. Les fouilles l'avaient assez intéressé surtout quand il fut transféré à Vlorë, en 1920. Cela s'exprime clairement aussi dans une autre lettre de l'année 1927.

Gjeçovi arrive à formuler une série d'idées profondément patriotiques et scientifiques non seulement pour ce temps-là, qui frayèrent de nouveaux chemins dans de différents domaines jusqu-là inexplorés par les albanais, mais dont une partie, même de nos jours, semble actuelles indépendamment du niveau atteint par les sciences albanologiques.

Les pensées de Gjeçovi tournaient plus au moins autour de l'idée que même si les illyriens ne nous ont pas laissé d'oeuvres écrites, ils ont déployé une activité de construction et de fortification, dont les vestiges s'aperçoivent encore en surface, ou bien sont ensevelis sous terre. Ainsi nous devons fouiller et les mettre à jour, pour que, après les avoir examinés, nous en tirions les conclusions requises dans l'intérêt de l'élaboration et de l'enrichissement de notre histoire du passé. Certes l'intérêt, que Gjeçovi portait à ces richesses culturelles n'était pas dû à l'hasard, ma à son éducation et à son pétrissage avec les idées patriotiques de nos militants de la Renaissance, considérant l'archéologie comme un domaine qui pouvait contribuer beaucoup à éclairer notre histoire nationale.

Dans son écrit «Une distraction archéologique», Gjeçovi lance un appel, pour qu'on organise des fouilles albanaises, ce qui comme il dit, mènerait bientôt à la création d'un musée national. . . . . et les objets trouvés donneraient lieu à la correction de certains points de l'histoire mondiale».

Il attire l'attention de ses compatriotes afin de les rendre conscients de la grande richesse que représentaient les monuments historiques de notre pays.

Dans l'étude de nos monuments, ce scientifique utilisait la méthode comparative ou – comme il disait – «en comparant les objets trouvés, provenant des temps anciens, en vue d'apprécier l'histoire nationale». A notre connaissance, Gjeçovi est l'un des premiers à s'être aperçu de la ressemblance des étrusques avec nos ancêtres dans le mode d'enterrement des morts, dans le mode de creuser et de couvrir les lieux d'enterrement etc.

Ce scientifique patriote éprouve une grande inquiétude pour les trésors nationaux et notre histoire nationale, dont les classes dominantes de l'époque ne faisaient aucun cas. Et il trouve l'occasion de parler avec passion des valeurs, que comportent les traces que nos ancêtres ont laissées «dans les bâtiments grandioses et les remparts géants qu'on voit en Albanie et dans d'autres pays où ils ont habité où par où ils ont passé». D'autre part, il condamne l'attitude antinationale de ceux qui permettaient de faire ou faisaient du commerce avec les richesses culturelles de notre peuple.

Les traces de l'activité de recherche de Gjeçovi, nous les trouvons, à Laç et Troshan, à Koman et à Shtoj, à Gajtan et à Shurdhah et ailleurs encore; mais nous ne pouvons dire que tous les monuments, sites et points archéologiques où il a effectué des fouilles sont complètement connus.

Finalement nous pensons qu'il est bien de souligner la pureté morale de Gjeçovi, qui dans l'accumulation des trésors nationaux, partait uniquement des hauts intérêts de la Patrie et pas du tout de la convoitise des profits personnels. Son nom prit place dans l'histoire d'Albanie, comme d'un homme qui consacra sa collection de valeur à la culture autochtone archéologique.

La question de la recherche et de la protection des monuments, Shtjefën Gjeçovi ne la considère pas comme le monopole d'une minorité d'hommes savants, mais il exige que tous les albanais aident dans ce domaine. Donc, nous pourrions dire que dans ce sens nous avons à faire encore à des points de vue démocratiques. En réalité il se présente comme un précurseur de l'idée de participation des masses dans la science. Les hommes d'études d'aujourd'hui ont de quoi profiter de sa méthode de travail. Il accordait une importance particulière aux contacts étroits avec le peuple, aux conversations avec lui, en vue de découvrir ce que la mémoire populaire conserve sur ces valeurs. Il est vrai qu'il appréciait toute donnée provenant du peuple, tout témoignage oral au visuel des hommes âgés, mais il soumettait tout cela à la vérification, à la comparaison et à l'étude minutieuse des données accumulées. Gjeçovi n'était pas un homme d'érgoteries dénuées de sens mais en parcourent tous les pays, il donna un exemple concret pour le temps où il vecut, de ce que les recherches et études de l'histoire albanaise devaient être le fruit des albanais eux-mêmes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI – Pirro THOMO

ARKITEKTURA PASBIZANTINE NË SHQIPËRI[1]

(përfundime)

Pushtimi osman i vendosur pas një shekulli luftrash e kryengritjesh që kulmojnë me rezistencën shqiptare nën drejtimin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe shkatërrimet që e shoqëruan patën pasoja në zhvillimin kulturor të vendit. Ky pushtim shënon dhe mbylljen e një periudhe të gjatë arkitektonike me tiparet e veta specifike që kishte arritur një nivel të lartë gjatë shekujve XI-XV, sidomos në Shqipërinë Jugore e të Mesme. Zhvillimi i kësaj arkitekture në këtë periudhë, siç dëshmohet nga numri jo i vogël i monumenteve të mbetura deri në ditët tona, me larminë tipologjike, shtrirjen dhe vlerat e tyre, kishin krijuar një traditë të fortë ndërtimore në vendin tonë. Kështu që, duke filluar nga shekulli XVI, krahas ndërtimeve të kultit të ri mysliman që u fut nga pushtuesi, filluan të ngrihen dhe faltore të krishtera.

Sikundër në pikturë, edhe në arkitekturën e kultit të kësaj periudhe, ndonëse janë trashëguar mjaft parime estetike e konstruktive të arkitekturës bizantine, kemi një interpretim më të lirë të tipeve dhe formave, një përpunim të tyre në përshtatje me kushtet e reja ekonomike-shoqërore të krijuara, duke arritur në mjaft raste në konceptime arkitekturore të veçanta. Kemi të bëjmë pra me një periudhë të veçantë arkitektonike, e njohur me emrin arkitektura pasbizantine, e cila ndjek rrugën e vet të zhvillimit.

Megjithë kushtet e vështira të pushtimit turk, në gjysmën e parë të shekullit XVI rifillojnë të ndërtohen faltore të kultit të krishterë. Por ndërsa në qytete arkitektura e kultit mysliman arrin nivele të larta,[2] si rezultat i dallimit fetar, kishat që ndërtohen janë të thjeshta e të varfëra dhe i takojmë në zona të thella e të largëta. Në të njëjtën kohë rindërtohen mjaft kisha të rrënuara siç janë Shën Kolli në Shelcan (para 1554), Shën Todri në Berat, Shën Kolli në Kurjan (1570), Shën Mëri Vllaherna në Berat (1578), Shën Mëria në Zervat (1585) etj. Lejimi i rindërtimit të kishave në disa qytete, tregon për një politikë më tolerante nga ana e pushtuesit që ka rrjedhur siguricht nga rritja e rolit të popullsisë vendase ende të pa islamizuar në jetën e vendit. Megjithë këtë, ndryshimi i madh në nivelin e ndërtimeve të kishave të këtij shekulli në qytet me ndërtimet e kultit mysliman tregon se nuk janë të njëjtat atelje që i ndërtojnë ato.

Por shkallë-shkallë duke filluar nga këto forma të thjeshta të kësaj kohe, arkitektura pasbizantine nis një rrugë të gjatë zhvillimi, përdor tipe ndërtimesh të shumëllojshme dhe arrin nivelin më të lartë gjatë shekullit XVIII.

Shqyrtimi i kishave pasbizantine të Shqipërisë, në aspektin tipologjik përbën një problem më vehte, thellimi i të cilit në të gjitha drejtimet e mundshme do të ndriçojë së tepërmi anët e ndryshme të kësaj arkitekture, lidhjet e krahinave dhe ateljeve të ndryshme me njera tjetrën dhe me vendet fqinje, ecurinë në kohë të saj etj.

---

1. Kjo trajtesë është përfundimi i tre artikujve të mëparshëm të botuar në numrat 19 dhe 20, 1980 dhe 21, 1981, të kësaj reviste, në të cilat trajtohen pjesa më përfaqësuese e këtyre ndërtimeve.
2. A. Meksi, **Ndërtimet e kultit mysliman në Shqipëri,** Studimet historike 1, 1980, f.

Numri mjaft i madh i monumenteve të trashëguara, shumëllojshmëria e zgjidhjeve të tyre, e bënin të domosdoshëm shqyrtimin e materialit sipas një kriteri të caktuar. Ndër mjaft kritere të mundshme kemi zgjedhur klasifikimin e bazuar në kompozimin planimetrik e volumor, i cili, sipas mendimit tonë, shpreh më mirë tiparet thelbësore arkitektonike e konstruktive të ndërtimeve dhe e bën më të kapshme zhvillimin e ndryshimin e tyre. Në bazë të këtij klasifikimi monumentet e kësaj periudhe janë ndarë në tre grupe të mëdhenj: kishat njënefëshe, ato me strukturë në formë kryqi me kupolë dhe bazilikat. Brenda këtyre grupeve të mëdhenj tipologjikë janë veçuar nëngrupe dhe variante të ndryshme, të cilat pa u shkëputur nga zgjidhja e përgjithshme planimetriko-volumore, shfaqin disa herë ndryshime në përbërës të tjerë tipologjikë, ose paraqesin shkallë të ndryshme përpunimi arkitektonik e konstruktiv.

Kështu kishat njënefëshe, karakteristikë e përbashkët e të cilave është salla drejtkëndëshe me absidën në anën lindore, nga ndryshimet në strukturën e mbulesës i kemi ndarë në tre nëngrupe: kishat e mbuluara me çati druri, kishat e mbuluara me sistem qemeresh, kishat e tipit sallë me kupolë. Kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë kanë karakteristikë të përbashkët mbulimin me sistem qemeresh që hapen ndaj pjesës qendrore ku ngrihet kupola e mbështetur në katër kolona. Veçanërisht në formulimin planimetrik kanë bërë që ato t'i ndajmë në dy nëngrupe: në kishat me një absidë dhe kishat me tre absida. Grupin e tretë, bazilikat, e kemi ndarë në tre nëngrupe: bazilikat me kupolë, bazilikat e mbuluara me sistem qemeresh dhe kësulash sferike dhe bazilikat me tavan të rrafshët, edhe këtu duke u nisur nga dallimet në organizimin e hapësirës së brendshme nëpërmjet strukturës së mbulesës.

Është e qartë që për shtrirjen e gjatë kohore prej katër shekujsh të kësaj arkitekture, veç këtyre tetë grupimeve kryesore do të ketë mjaft kisha që qëndrojnë deri në një farë mase veçmas prej tyre, si rezultat i zgjidhjes së veçantë, dukuri e kuptueshme në një numër të madh ndërtimesh dhe me një larmi të tillë tipologjike. Gjithashtu në një vështrim që do të merrte parasysh vendosjen dhe formën e ambienteve ndihmëse të kishës si narteksë, paraklise, hajate e këmbanare, do të kishim një numër të madh variantesh.

Ndër kishat njënefëshe, ato të mbuluara me çati druri, përbëjnë një grup të madh ndërtimesh për vetë lehtësinë e ndërtimit dhe takohen përgjithësisht gjatë të gjithë shekujve. Të tilla janë di kishat e para që ndërtohen në zona larg qendra kryesore pas pushtimit dhe që i takojnë viteve ' të shekullit XVI (Leshnicë, Poliçan, Pecë). Këto jan të vogla me ndonjë dritare mjaft të vogël në pjesë e sipërme të mureve dhe hajate të shtuara më von Në planimetri i afrohen katrorit. Me kohë fillojnë ndërtohen kisha me planimetri të stërgjatur, siç jan ato të Bregut të Detit Dhërmi, Vuno), me një teknik të ndërtimit të mureve tashmë më të rregullt. M interes është ndërtimi i dy kishave njënefshe mja të mëdha në Myzeqe në fund të shekullit XVI (Toshkëz e Vanaj), ndërkohë që tipi mbizotërues n këtë zonë është bazilika trenefëshe.

Zgjidhje më të shumëllojshme kanë kishat nëngrupit të dytë, ato me mbulesë qemeri. Ato mun të jenë të mbuluara me qemere cilindrike të vazhduc gjatë gjithë aksit gjatësor, Jorgucat (1586) qimite i Vithkuqit (1760), ose qemeri i tyre mund të ndër pritet nga harqe tërthorë, në rolin e brinjëve të qën drueshmërisë (Dhuvjan, Derviçan). Në këto të fundi struktura mbajtëse bëhet më e përbërë nga harqe mbajtës që ngrihen mbi pilastrat e dala në mure gjatësorë (Derviçan). Një sens dinamik në rritje fi ton hapësira e brendshme kur qemeri i mbulesë ndërtohet me shkallëzime (Seran Perat). Konceptim hapësinor shkon më tej në kishat me qemere t kryqëzuar (Çatistë 1584, Kardhikaq), strukturë e cil pasqyrohet dhe në kompozimin volumor të jashtëm Volumi tërthor ngrihet mbi çatinë gjatësore, ndërsa në pamjet veriore dhe jugore projektohet në formën e frontoneve trapezoidale. Por ndërsa në Kardhikaq ky volum sapo shkëputet nga masa tjetër e çatisë, në Çatistë ai ka fituar një hedhje në lartësi dhe një dallim të qartë si volum më vete. Kisha të tilla takohen edhe në zonat fqinje të Greqisë Veriore.[3]) Afria me kishat bizantine të të njëjtit tip është e dukshme në kishat me mbulesë qemeri dhe akoma më e madhe në ato me qemere të kryqëzuara.

Arritjet më të mira arkitektonike e konstruktive janë realizuar në kishat e nëngrupit të tretë, në ato në formë salle me kupolë. Dallimet ndërmjet kishave të këtij nëngrupi shfaqen, në radhë të parë në vendosjen e kupolës: ajo mund të ngrihet pa ndërmjetësinë e tamburit, ose të lartësohet mbi çati nëpërmjet tij. Karakteristikë e të parave është prania e një ose më shumë bërthamave katrore të formuara nga harqe të mbështetura mbi pilastra që dalin në muret anësore, të cilat janë të mbuluara me kupola ose kësula sferike. Ambienti i altarit, me për-

3. P.L. Vokotopoullos, **O naos ton Agjion Mina sto Monodendri ton Zagorian**, «Eklisies stin Elladha meta tin Allosi», Athina 1979, 111-120.

UNESCO

masa të vogla, mbulohet me qemere cilindrike. Më e vjetra ndër to, kisha e Barmashit (1616) mbas shtesave të mëvonëshme arrin në pesë bërthama të tilla të lidhura me njera tjetrën. Në aspektin arkitektonik më me interes janë kishat me kupolë mbi tambur, që përsërisin tipin e njëjtë bizantin «sallë me kupolë». Më e vjetra nga to është narteksi i kishës së manastirit të Çatistës (1627), që shëmbëllen me tipin bizantin në formë kryqi të brendashkruar pa mbështetje të lira. Të tjera, Dhivri (1736), Dema (shek. XVII-XVIII) dhe Selenica (shek. XVII-XIX), janë në formë salle me kupolë, nga të cilat ajo e Selenicës duket qartë që është frymëzuar nga kisha e Armenit (shek. XI-XII), e ndodhur jo larg saj. Kishat e këtij nëngrupi, megjithëse takohen gjatë tërë kohës, janë të pakta në numër edhe për shkak të vështirësive të ndërtimit.

Forma më e përdorur e absidave në kishat njënefshe është ajo gjysëm rrethore. Megjithkëtë ka raste në të cilat përdoret absida trefaqshe, madje dhe absida pesëfaqshe. Me interes janë përdorimi i dy absidave në faqen lindore në kishën e Shën Mitrit në Potkozhan. Ndërtimet njënefshe janë në mjaft raste kisha manastiresh dhe për këtë arsye disa janë treabsidale. Të tilla janë ato të dy nëngrupeve të fundit, me mbulesë qemeresh, (Dhrovjan, Çatistë, Jorgucat, Dhivër).

Nga kapela të vogla të ndërtuara me teknikë të varfër në shekujt e parë, ndryshe nga ndërtimet e tjera të kohës, ato fillojnë të ndërtohen me një teknikë të mirë në shekujt e fundit, ashtu si dhe ndërtimet e tjera bashkëkohëse.

Një grup mjaft i rëndësishëm për zgjidhjen planimetriko-vëllimore dhe ndërtimin struktural përbëjnë kishat në formë kryqi me kupolë. Ndërtimi i tyre flet qartë për një afri me kishat bizantine të tipit kryq i brendashkruar me kupolë, të cilat kanë shërbyer si modele për to. Duke qënë ndërtime të vështira dhe një pjesë e tyre me kërkesa arkitekturore, ato fillojnë të ndërtohen nga gjysma e dytë e shekulit të XVI, shtohen në numër në shekullin e XVII dhe pësojnë rënie në shekullin e XVIII, si nga numri ashtu dhe nga vlerat. Pjesa më e madhe e tyre janë kisha manastiresh, të ndërtuara në vende larg rrugëve të komunikimit dhe syrit të pushtuesit. Manastiret në këtë kohë janë dhe pronarë tokash e pasurish të tjera. Për këto arsye mjaft prej tyre janë krijime të vërteta arkitekturale, që dëshmojnë për mjeshtrinë e ndërtuesve dhe kërkesat e larta të porositësve.

Naosi i këtyre kishave ka në brendësi katër kolona, mbi të cilat ngrihet sistemi i qemereve përreth dhe kupola mbi tambur në pjesën qendrore. Vetëm kisha e Malçanit ka katër pilastra në vend të kolonave. Po kështu dallohen në to kishat e manastirit të Voskopojës dhe atij të Dhuvjanit, të cilat kanë në brendësi gjashtë mbështetje, duke formuar për bemën një hapësirë të pavarur të mbuluar me qemer, ndërmjet krahut lindor të kryqit dhe absidës. Kemi të bëjmë në këtë mënyrë me shembuj më të zhvilluar, të njëjta me ato të variantit kryeqytetas, apo të përbërë, të arkitekturës bizantine.

Kishat e këtij nëngrupi ndonëse paraqesin mjaft ngjashmëri me kishat bizantine të të njëjtit tip, ato shfaqin edhe tipare dalluese. Dallimi kryesor i kishave pasbizantine konsiston në ekzistencën e një aksi gjatësor tepër të dukshëm. Ky është arritur jo vetëm thjeshtë me zgjatjen e planimetrisë, por edhe nëpërmjet organizimit të hapësirës së brendshme dhe të ndërtimit volumor të jashtëm.

Në interierin e naosit nuk ndjehet mbizotërimi i bërthamës qendrore dhe i krahëve të kryqit ndaj ambienteve këndore, si te kishat bizantine. Në kishat në shqyrtim ambientet këndore mbulohen me qemere cilindrike me formuese veri-jug, që hapen ndaj aksit qendror, duke u njësuar në aspektin e hapësirës së brendshme me të, një dallim ky jo i vogël. Përjashtim bëjnë kishat e Zervatit, Dhuvjanit, Goranxisë, Malçanit dhe Tranoshishtit, që i takojnë fundit të shekullit XVI fillimit të shekullit XVII, ku ambientet këndore janë të mbuluara me kësula sferike ose me qemerë me formuese lindje-perëndim. Po kështu kishat e manastireve të Saraqinishtit e Kamenos kanë pjesërisht të përdorura kësulat sferike. Një kupolë e dytë që nuk del mbi çati me tambur është edhe në Shën Prodhrom të Voskopojës.

Gjithashtu struktura e mbulesës së brendshme nuk shfaqet jashtë, por është e fshehur nga çatia dyujëse, që i jep ndërtesës pamjen e një bazilike. Kjo pamje nuk thyhet as nga ngritja e tamburit në pjesën qendrore, që mbetet elementi i vetëm kryesor në formulimin arkitektonik të jashtëm. Ndryshojnë rastet kur në mbulesën e ndërtesës dalin volumet e veçanta të krahëve tërthore të kryqit, gjë që i jep kompozimit volumor të jashtëm më tepër thyerje e lëvizje, por pa arritur megjithatë në shkallëzimin piramidal tipik për kishat bizantine.

Aksi gjatësor bazilikal ka ndikuar edhe në realizimin konstruktiv. Ndryshe nga kishat bizantine ku mbështetjet e harqeve mbajtës të tamburit janë në këndet e një katrori, në mjaft raste të kishave pasbizantine për vetë planin e zgjatur në drejtimin lindje-perëndim, mbështetjet i kemi në këndet e një drejtkëndëshi. Për këtë nëpërmjet harqeve të dytë mbajtës në nivel më të lartë se qemeri i krahëve të kryqit, formohet baza katrore për tamburin cilindrik. Të tilla janë zgjidhjet e Shën Thanasit në Poliçan, Qeparoit, Stegopullit, Mingulit, Kakomesë

Do not copy

dhe Burimit Jetëdhënës në Derviçan. Në secilën prej tyre mjeshtrit ndërtues kanë përdorur mënyra të ndryshme me të njëjtin rezultat. Në dallim nga kishat e tjera, në kishën e manastrit të Kryeëngjëjve në Derviçan pjesa qendrore ndërmjet kolonave mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim në nivel më të lartë se qemeret e krahëve të kryqit.

Ndër shembujt e paraqitur një pjesë e mirë e tyre është me një absidë në anën lindore, ndërsa pjesa tjetër me tre absida, në faqen lindore, jugore dhe veriore. Ky është dhe dallimi kryesor ndërmjet tyre, që ka bërë të shqyrtohen veçmas në dy nëngrupe të ndryshëm. Përsa i përket formës në plan, përveç absidave gjysëm rethore në pamjen e jashtme, takohen dhe ato me tri dhe pesë faqe.

Përsa i përket vlerave arkitektonike, në vështrimin kronologjik të tyre, vihet re se më të arritura janë ndërtimet e ngritura në manastiret gjatë fundit të shekullit XVI dhe gjysmës së parë të shekullit XVII, ku ndjehet më tepër ndikimi i kishave bizantine të shekujve XIII-XIV. Këto kanë tamburet që mbajnë kupolat me proporcione të hedhura dhe të trajtuara në mënyrë të pasur. Faqet e tyre janë të zbukuruara me nike të shkallëzuara të ndërtuara me gurë e tulla dhe përfundojnë me kornizë në formë dhëmbë sharre. Me nike janë trajtuar gjithashtu dhe absidat shumëfaqshe apo rrethore. Kishat e tjera të mëvonëshme janë më të thjeshta dhe jo aq të arritura në proporcionet dhe vëllimet.

Grupi i tretë i kishave pasbizantine të Shqipërisë, bazilikat, për nga vlerat arkitekturale, shtrirjen territoriale, larminë e zgjidhjeve dhe përmasat e tyre, përbën një grup të rëndësishëm për studimin dhe vlerësimin e kësaj arkitekture. Prirjet për një zgjatje të aksit gjatësor, për trajtimin e pamjes së jashtme dhe për një lidhje më të mirë të hapësirës së brendshme janë vërejtur dhe në tipet e tjerë, por, më mirë se kudo, këto aspekte zgjidhen te bazilikat, ku arrijnë zhvillimin e tyre më të plotë. Me variantet e tyre të shumtë këto takohen gjatë shekujve XVIII--XIX si në qytete ashtu dhe në fshatra të mëdhenj dhe në manastire.

Në drejtim të ndërtimit struktural kemi dalluar tre nëngrupe kryesore: bazilikat me kupolë, bazilikat e mbuluara me sistem qemeresh e kësulash sferike dhe bazilikat me tavan të rrafshët.

Bazilikat me kupolë, dallohen nga kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë për numrin më të madh se katër të mbështetjeve të brendshme, duke i dhënë kishës një aks të qartë gjatësor, për një ndarje të dukshme në tre nefe, me nefin qendror më të gjerë e më të lartë se të tjerët si dhe, shpesh herë, për mungesën e nefit tërthor. Nefi qendror mbulohet me qemer cilindrik me formuese lindje perëndim, i cili mund të jetë i vazhduar ose i ndërprerë nga harqe tërthorë, në rolin e brinjëve të qëndrueshmërisë. Në pjesën qendrore krijohet një bërthamë, zakonisht katrore, e cila mbulohet me kupolë mbi një tambur të lartë. Në ndonjë rast si në Vithkuq, shkallëzimi i mbulesës së nefit qendror e bën më të rrjedhshëm kalimin për në bërthamën nën kupolë, duke e vlerësuar më tepër këtë element të rëndësishëm kompozicional. Në ndërtimet më të hershme, të fillimit të shekullit XVII (Vrahogoranxi, Poliçan), nefet anësorë vijojnë pa ndërprerje gjatë gjithë gjatësisë së naosit, gjë që i jep ndërtesës karakter të mirëfilltë bazilikal. Me prerjen në formën e një të katërtës së rrethit të këtyre qemereve, ato përbëjnë një veçori lokale. Në ndërtimet e mëvonëshme vazhdimi i mbulesës së nefeve anësore nuk përdoret më. Nefet anësorë fillojnë e konceptohen me bërthama të veçanta, të mbuluara me qemere që hapen ndaj nefit qendror, si në kishat e Bregut të Detit (Piqeras, Lukovë), në Nivan dhe në Postenan. Ndërsa në kisha të tjera të fundit të shekullit XVIII (Mingul, Leusë), nefet anësorë janë mbuluar me kësula sferike, të rreshtuara njera pas tjetrës. Në disa raste hapësira qendrore nuk arrin të ketë formë katrore në plan. Hapësirat ndërmjet kolonave ruajnë hapin e tyre më të vogël se hapësira e nefit qendror (Vrahogoranxi, Poliçan, Leusë). Në këto raste baza katrore për të kaluar në tamburin rrethor të brendashkruar krijohet me anë të harqeve ndihmëse që e rudh së tepërmi hapësirën qendrore. Në të kundërtën, bërthama qendrore e mbuluar me kupolë theksohet, kur ajo formohet si rezultat i ndërprerjes së nefit qendror me një nef tërthor (Kolkondas, Vithkuq), duke u afruar në këtë aspekt më kishat me strukturë në formë kryqi me kupolë.

Në anën e jashtme bazilikat e këtij nëngrupi dallohen për çatinë dyujëse me kupolën e lartë në pjesën qendrore, e cila shpesh nuk lidhet organikisht me volumin masiv të çatisë. Përjashtim bëjnë kishat e Kolkondasit dhe Vithkuqit, ku nefi tërthor shfaqet në kompozimin volumor të jashtëm dhe në trajtimin e pamjeve veriore e jugore, duke i dhënë ndërtesës më tepër lëvizje.

Në nëngrupin e dytë të bazilikave, me mbulesë një sistem qemeresh e kupolash apo kësulash sferike, ndeshen shembujt më të arritur të bazilikave. Në këta kisha takohet një larmi zgjidhjesh strukturale dhe figurative. Ndërtimet e këtij nëngrupi janë ngritur kryesisht gjatë shekullit të XVIII, i cili përkon me periudhën e lulëzimit dhe të rritjes së fuqisë ekonomike të qyteteve tona. Me kishat e këtij nëngrupi arkitektura pasbizantine në Shqipëri arrin nivelin më të lartë të zhvillimit.

FOTOCOPY

Veçantitë e ndërtimit struktural të tyre janë bërthamat e krijuara nga harqet që lidhen në të dy drejtimet kolonat dhe muret anësore, duke e ndërprerë në këtë mënyrë vijueshmërinë e mbulesës. Nga mënyra e grupimit dhe e mbulimit të këtyre bërthamave krijohen dhe zgjidhje të ndryshme të hapësirës së brendshme. Mund të thuhet gjithashtu se në kishat e këtij nëngrupi ndeshen struktura të kurbëzuara nga më të ndryshmet. Kështu në disa shembuj dy bërthama qendrore të mbuluara me kupolë, të mbështetur në katër qemere që hapen ndaj tyre, ndërpriten ndërmjet tyre, ndërsa bërthamat e tjera të vogla, të cilat mund t'i quajmë ambiente këndore, zakonisht mbulohen me kësula sferike (Voskopojë, Shipskë). Në ndryshim me kishat e Voskopojës katedralja e Beratit i ka kupolat të ngritura mbi tamburë, me sa duket e ndikuar nga kishat bizantine të qytetit.

Variant tjetër krijojnë kishat që të gjitha bërthamat i kanë të mbuluara me kësula sferike (Skore, Topovë, Përmet, Sopik). Nga to në kishën e Sopikut, çdo bërthame qendrore të mbuluar me kupolë i përket nga dy bërthama më të vogla në nefet anësore, Në këtë variant kishash mund të futet dhe kisha e Borovës, ku nefet anësore mbulohen me qemere si ato të variantit të parë. Një variant të tretë përbëjnë kishat që mbulohen me qemere në të tre nefet. Kisha e Nokovës ka qemere gjatësorë vetëm në nefin qendror, duke qënë dy të tjerat të mbuluara me çati druri. Kisha në Lipë të Përmetit i ka të tre nefet me qemere gjatësorë ndërsa ambienti i altarit mbulohet me kësula sferike. Kisha e Shën Sotirit në Gjirokastër ka nefet anësore me qemere gjatësorë gjatë gjithë gjatësisë së naosit, ndërsa nefi qendror në pjesën e narteksit dhe ambientit të altarit mbulohet me qemere tërthor nefit. Një zgjidhe të ndërmjetme ndërmjet dy varianteve e fundit paraqitet kisha e Shën Mëhillit në Gjirokastër, ku nefet anësore mbulohen me qemere gjatësorë, ndërsa nefi qendror me kupola.

Nëngrupi i tretë, bazilikat me tavan të rrafshët, janë me mbulesë me strukturë druri. Brendësia e tyre ndahet në tre nefe nëpërmjet dy rreshtave kolonash guri ose druri. Nga ndërtimi vëllimor i brendësisë këto bazilika shfaqen në dy variante. Në pjesën më të madhe të shembujve tavani i të tre nefeve ndodhet në të njëjtin nivel, ndërsa në dy raste (Karavasta dhe Profet Ilia në Voskopojë) nefi qendror është në nivel më të lartë duke dalë mbi çatinë e nefeve anësorë. Në të dy këto kisha kolonat lidhen në drejtimin gjatësor me arkada. Bazilikat e tjera janë ose me arkadë (Bishqethem, Vithkuq, Krutje, Kadipashaj), ose me tavan që mbështetet drejtëpërsëdrejti në shtyllat apo në trarët gjatësorë që i lidhin ato (Ardenicë, Nicë, Lashovë, Libofshë, Vuno, Kozarë).

Thuajse të gjitha kishat e këtij nëngrupi kanë përmasa të mëdha, por përsa i përket organizimit të hapësirës së brendshme ato mbeten pas shembujve të nëngrupeve të mësipërm. Kemi në këto kisha një thjeshtim të hapësirës së brendshme, një vëllim statik që kapet menjëherë dhe faqe të rrafshat. Kjo gjë ndjehet më pak në kishat me arkada dhe sidomos në ato ku nefi qendror është më i lartë. Pjesa më e madhe e tyre janë të shekullit XVIII, por ato vazhdojnë të ndërtohen dhe gjatë shekullit XIX, duke pësuar një rënie të vlerave arkitektonike.

Bazilikat zakonisht kanë një absidë në anën lindore, por takohen edhe raste me tre absida në këtë anë (Shën Mëhilli dhe Shën Sotiri në Gjirokastër, Sopik, Vithkuq, Borovë), madje dhe kisha treabsidale (Kolkondas, Nicë dhe Piqeras).

Hapësira e brendshme e kishave që paraqesin vlera arkitekturale duhet parë në kohë. Është më afër kishave bizantine, hapësira e brendshme e kishave me strukturë në formë kryqi me kupolë, me dallimet që parashtruam më lart lidhur me hapjen e ambienteve këndore ndaj nefit qendror, si dhe pranisë të një aksi gjatësor në shumicën e tyre, që flet qartë mbi fillimin e një shije të re arktitekturale, e cila zhvillohet më tej në bazilikat. Nuk është për të mos shikuar në këtë veçanti një lidhje me traditën ndërtimore për kishat bazilikale të vërejtur në periudhën e parapushtimit.

Brendësia karakterizohet nga ndriçimi i pakët, sidomos në periudhën e parë, ku dritaret janë në minimum dhe me përmasa sa më të vogla. Rol në të lot dhe piktura murale që njëson sipërfaqet e mureve, shpesh ajo është dhe në kolonat e kapitelet, duke kontribuar për një hapësirë unike. Në të gjitha kishat me mbulesa të harkuara, këto të fundit ndihmojnë për një hapësirë dinamike, së cilës harkadat i japin një sens gjatësor, ndërsa kupola qendrore (ku ka të tillë) një sens vertikal, duke nënvizuar një bërthamë qendrore në ndërtesë.

Tavanet e bazilikave dhe tribunat e narteksëve brenda naosit, zbukurohen me trajta dhe elemente që përdoren në arkitekturën popullore. Kjo shihet sidomos në bazilikat e Myzeqesë. Tavanet e tyre janë punë e të njëjtëve mjeshtrash popullorë, si gjithë gdhendjet e tjera në kishat. Një vend të veçantë zenë në to ikonostasët prej druri të gdhendur, mjaft prej të cilëve me vlera të dorës së parë, që së bashku me amvonet, fronat e peshkopëve, punë e të njëjtëve mjeshtër apo atelje, kontribuojnë së tepërmi në formulimin e brendshëm të kishës. Në kishat e Bregut të Detit takohen dhe ikonostase prej muri

Botim

të suvatuar dhe të pikturuar. Ata kanë vetëm dy hyrje për në ambientin e altarit, atë nga veriu dhe atë në qendër.

Dyshemtë në pjesën më të madhe të kishave janë të shtruara me pllaka guri të skuadruara. Në mjaft prej kishave qendra e naosit theksohet me ndonjë pjesë rrethore, të ndërtuar me gurë dhe tulla kuadratike e trekëndëshe. Po kështu dhe mjaft kisha kanë dyshemetë të ndërtuar me pllaka guri të çrregullta.

Në trajtimin e jashtëm të kishave pasbizantine, kanë indikuar së tepërmi dy faktorë. Së pari, niveli i ndërtimit dhe së dyti, rrethanat historike. Përsa i përket faktorit të parë, është e qartë se ndërtimet e rëndomta, të ndërtuara me materiale të varfëra, nuk kanë patur për qëllim arritjen e rezultatit artistik. Në këto raste kuptohet, sidomos për kishat e vogla njënefshe, se në pamjen e jashtme ato do të jenë pa më të voglin pretendim. Faktori i dytë, kushtet historike në të cilat është ndërtuar godina, ilustrohet mjaft mirë nga një vështrim i trajtimit të jashtëm arkitektural të kishave pasbizantine. Në shekullin e XVI, në tre çerekët e parë të tij, kishat ndërtohen njënefshe, me mure të rrafshta, pa më të voglin dekor arkitektural, me dritare të vogla si frengji, të hapura në pjesën e sipërme të mureve, ose dhe pa to, madje deri dhe pa dritare në absidë. Mungojnë kornizat, strehët janë të thjeshta, i vetmi zbukurim mund të jetë ndonjë nike mbi hyrjen për në kishë. Kishat me strukturë kryqi me kupolë, që ndërtohen në çerekun e fundit të shekullit XVI e fillimin e shekullit XVII, janë ndërtime për të cilat porositësit, në shumicën e rasteve manastiret, kanë patur kërkesa për vepra arkitekturale. Kjo vërehet në proporcionet e vëllimeve, trajtimin dekorativ të tambureve, absidave me nike, kornizat, punimin e mureve, dritaret e dyert. Sigurisht që krahas kishave të arritura si në Vanistë, Goranxi, Dhuvjan e Kameno kemi dhe të tjera si në Zervat, Tranoshisht, Poliçan, Koshovicë e gjetkë, që nuk janë në nivelin e të parave. Me interes janë kisha të tilla, si ajo e Malçanit, me një përpunim me gurë e tulla të tamburit, që dëshmon për shijen e mjeshtërave popullorë, e Stegopullit si për kupolën e lartë me nike të ngushta ashtu edhe për kalimet e lakuara të absidave po me nike në muret dhe në profilet e kornizave. Në këtë rast të fundit kemi të bëjmë me një shije jo të huaj për arkitekturën baroke të Europës Perëndimore, që le vend për hetime të mëtejshme.

Sidoqoftë, shumica e këtyre monumenteve kanë dritare të pakta e të vogla, mure të punuara pastër me gurë të paskuadruar por të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti.

Ndërtimet më të goditura shquhen për hedhjen vertikale, dëshmi e frymëzimit nga kishat e shekujve XIII-XIV, në të njëjtën kohë rezultat i një shije të caktuar arkitekturale. Kjo është arritur nëpërmjet tamburit të lartë, fragmentimit të faqeve vertikale të mureve nga absidat dhe faqet e shumta të këtyre të fundit, të paisura me nike të ngushta e të larta.

Në gjysmën e dytë të shekullit XVII, kishat me strukturë kryqi me kupolë nuk paraqesin më vlera arkitekturale si kishat e para. Janë bazilikat ato që gjatë shekullit XVIII bien shprehje të reja me përmasat e tyre të mëdha, dritaret e shumta, çatitë e mëdha dyujëse e portikët e harkuar. Të tilla janë bazilikat e Voskopojës dhe Vithkuqit. Më tej, si bazilikat me qemere e kësula, ashtu dhe ato me tavan të rrafshët, vazhdojnë në rrugën e tyre, duke shtuar lartësinë dhe përmasat e planit, por duke humbur shkallën në marrëdhëniet me elementet përbërës: absida, portikë e dritare, duke u kthyer nga fundi i shekullit e fillimi i shekullit XIX në ndërtime të ftohta e pa vlera. Ka ndër to edhe ndërtime me vlerë si Ardenica, Berati, Sopiku, Skoreja, Nica, ku ndërtuesit kanë njohur mirë mundësitë e tipit dhe kanë arritur proporcione të goditura në secilën me rrugë të ndryshme; në Ardenicë duke përdorur portikët dhe zbukurimin e absidës, në Berat nga portikët dhe kupolat mbi tambur, në Sopik e Skore me punën e mureve dhe arkadat e portikëve. Në Nicë, ku kemi një ndërtim të thjeshtë, nëpërmjet përmasave e vëllimin e absidave dhe strehës mbi qestekë që qarkon tërë kishën, është arritur një zgjidhje interesante, mjaft e afërt me arkitekturën popullore prej nga vijnë mjeshtrit ndërtues.

Në formulimin e jashtëm të ndërtesës ishin karakteristike muret e rrafshët. Ata përfundojnë gati kurdoherë me korniza të drejta. Në mjaft raste kornizat janë me rrasa guri apo gurë shtresorë të hollë të nxjerrë pak ndaj murit. Në raste të tjera ata janë me gurë të profiluar ose dhe të vendosur në formë dhëmbësh sharre, formë tradicionale e kornizave të kishave të periudhës para pushtimit turk. Mbi kornizat vjen çatia gati, kudo e mbuluar me rrasa guri. Çatitë siç pamë janë dyujëse, duke përfunduar në muret lindore e perëndimore me frontone. Mjaft prej frontonave të anës lindore përfundojnë në formë trapezi, duke patur në këtë mënyrë një flegër të vogël me rrjedhje uji nga ana lindore.

Të njëjtat fenomene në kohë vërehen edhe te teknika e ndërtimit. Kishat e para janë ndërtuar me mure guri e llaç gëlqere e, në mjaft raste, dhe me llaç balte, me breza druri në to. Gurët janë të papunuar dhe të vendosur pa ndonjë përkujdesje të veçantë. Më vonë muraturës i kushtohet vëmendje. Edhe pse muret nuk janë ndërtuar me gurë të skuadruar, vërehet një prirje e qartë e rreshtimit të tyre,

DO NOT COPY

që përcaktohet nga lloji i gurit të përdorur. Qoshet janë të punuara pastër, po kështu shpatullat e dyerve dhe dritareve, niket e shkallëzuara të absidave e kupolave, si dhe harqet që i mbulojnë. Megjithatë edhe në këtë kohë kemi ndërtime të varfëra, me teknikë jo të mirë që pasqyrojnë nivelin ekonomik të porositësve dhe afërsitë e ndërtuesve.

Sigurisht që për nivelin në përgjithësi të mjeshtërve shqiptarë duhet të gjykohet nga ndërtimet më të mira. Aftësitë e tyre si gurëgdhendës duken në Goranxi, ku, krahas teknikës me gurë në rreshta horizontale, kemi koloneta e harqe me gurë të gdhendur, që dëshmojnë për një njohje të mirë të teknikës. Aftësia teknike e mjeshtrave duket dhe në mos shmangjen nga zgjidhjet e vështira në kishat me mbulesa të harkuara. Përfundimet që mund të nxirren në lidhje me nivelin e lartë të këtyre ndërtimeve janë me mjaft vlerë. Këtu duhet të kemi parasysh përdorimin e gjerë dhe të shumëllojshëm të strukturave të harkuara, që dëshmojnë jo vetëm për një njohje të thellë të konstruksioneve, por edhe për një shkathtësi në zbatimin e tyre. Do të mjaftonte të numëronim llojet e qemereve, kupolave e këndsulave sferike, vendin e tyre në mbulesë dhe do të bindeshim për këtë. Kjo u vërejt edhe gjatë veçimit të varianteve të ndryshme të kishave ku pamë se nuk kemi një përsëritje shabllone nga kisha në kishë, madje edhe në të njëjtën qendër, në një periudhë të shkurtër kohe (Voskopojë). Zgjidhja e mbulesave i nënrendohet rastit konkret dhe idesë arkitekturore.

Parimin e përdorur në arkitekturën bizantine, për shkarkimin e ngarkesave nga lart poshtë, brenda strukturave të harkuara, e shohim të përdoret dhe në kishat pasbizantine. Si në ato me strukturë kryqi me kupolë, ashtu dhe në bazilikat e dy nëngrupeve të para, kjo është gjithnjë e arritur në cilindo variant të ndërtimit të mbulesave, apo në zgjidhjet e veçanta, çka flet për një përvetësim të teknikës së ndërtimit të mbulesave të harkuara.

Me interes është të shënojmë dy raste të veçanta të përdorimit të qemereve. Në kishën e Shën Mëhillit në Vithkuq mbi strukturën e mbulesës me qemere e kupola, kanë ndërtuar një qemer të dytë, me gurë çmërsi, themrat e të cilit mbështeten mbi arkadën që ndan nefet dhe mbulon pjesën e nefit qendror. Midis dy qemereve ka një largësi të vogël 0.80 m. Ky qemer i dytë mënjanon përdorimin e strukturave të mëdha prej druri, pra dhe rrezikun e zjarreve që me sa duket i preokuponte shumë.

Më me interes është struktura e bërthamës qendrore me kupolë në Shën Gjergjin e Demës. Nga baza e madhe katrore në kupolën e vogël e të lartë, kalohet nëpërmjet trompave në qoshe në pjesën e poshtme, që edhe ngushtojnë bazën, ndërsa më lart me trekëndësha sferike, që bëjnë të njëjtën gjë. Kjo të kujton idenë e lartësisë nëpërmjet ndjenjës së perspektivës, duke e ngritur edhe më lart kupolën e vogël. Përsa njohim te ne kjo është një zgjidhje unikale.

Për të lehtësuar peshat e mbulesës, është përdorur në to guri çmërs, i cili ka një peshë vëllimore mjaft të vogël. Këta gurë i gjejmë në të gjitha kishat, në mbulesa, tambure dhe në mjaft raste dhe në muraturë.

Studimi i kishave pasbizantine duhet shtrirë dhe në disa elemente përbërës të tyre, që sigurisht kanë karakteristikat e tyre në kohë dhe në shtrirje territoriale. Së pari kemi narteksin. Në kishat më të vjetra narteksi gati gjithnjë mungon dhe kjo është e kuptueshme për ato kohë të vështira. Megjithatë dhe shumicës së tyre në kohë iu shtohet narteksi qoftë përpara, qoftë nga ana jugore apo nga të tre anët. Edhe në kishat e tjera njënefshe ato me qemere e kupolë, narteksi fillimisht mungon. Ai shtohet më vonë duket për mundësi të kufizuara të ndërtesave në periudhën e parë të ndërtimit.

Përsa i përket kishave të grupit të dytë, atyre me strukturë në formë kryqi me kupolë, narteksi është i njëkohëshëm me kishën në 12 prej 21 kishave në shqyrtim. Kjo tregon që për këto kisha, që siç pamë janë me më shumë pretendime dhe më të arritura, prania e narteksit ka qënë një nevojë dhe një mundësi që në fillim. Edhe për kishat e tjera, në pjesën më të madhe të tyre, narteksi shtohet më vonë, duket për rolin e tij në anën funksionale të ndërtesës.

Edhe në bazilikat narteksin e takojmë gati gjithnjë. Në mjaft raste ai shtohet më vonë për vetë vëllimin e ndërtimeve. I tillë është rasti i narteksëve në mjaft kisha të Myzeqesë, në të cilat janë njëkohësisht dhe në rolin e hajateve, duke qarkuar kishën nga të tre anët. Në mjaft raste, narteksi përfshihet brenda vëllimit të naosit, duke qënë i ndarë me mure apo perde të drunjtë dhe me dritare me kafaze për shikim. Në të tjera raste këto dritare janë në murin që ndan narteksin nga naosi. Në këto shembuj ai shërben për gratë. Po kështu kemi dhe narteks dykatësh ose tribuna me ballkon në katin e dytë, mbi dysheme druri.

Në formulimin e jashtëm të kishave, një rol me rëndësi luajnë dhe hajatet apo portikët. Ata janë dyllojësh: me shtylla druri dhe me shtylla guri. Nuk mungojnë dhe rastet ku janë përdorur të dy llojet. Hajatet e rrethojnë kishën ose nga tre anët, ose në anët perëndimore e jugore ose në njërën

nga këto. Kemi dhe një rast të veçantë në Lipë, ku portiku i vonë shtohet edhe në anën lindore duke rrethuar dhe absidën. Portikët mbulohen ose me çati druri ose janë me kësula sferike apo qemere. Përgjithësisht kolonat qoftë të drunjta apo prej guri mbështeten mbi një mur bazament të ngritur nga toka, që ndërpritet përpara hyrjeve për në kishë. Kolonat e gurta përbëhen prej rrotullash guri lidhur me llaç, mbi të cilat vendosen kapitele guri në formë trung piramide të përmbysur. Harqet janë të ndërtuar kryesisht me gurë, por nuk mungojnë rastet e kombinimit të tullave me gurë. Fusha mbi harqet deri te korniza është ndërtuar me gurë, por në ndonjë rast, si në Shën Kollin e Voskopojës e gjetkë gjejmë përdorimin e zbukurimeve prej tulle, që e bëjnë mjaft të efektshëm pamjen e portikut. Harqet, si dhe në ndërtimet bizantine, janë futur më thellë nga faqja e murit. Në portikët prej druri kemi afrim të madh me arkitekturën popullore, në trajtimin e shtyllave dhe kapitelet mbi to. Zakonisht në anën lindore portikët janë të mbyllur me mure, që kanë edhe nga një nike të vogël të harkuar. Në mjaft raste portikët kanë të pikturuar murin që i takon kishës dhe mbulesës me kupola.

Një element tjetër me interes në kishat pasbizantine janë këmbanaret. Edhe këto nuk janë gjithnjë të një kohe me vetë kishën por janë shtuar dhe më vonë, në shumicën e rasteve bashkë me hajatet. Këmbanaret janë të ndërtuara me muraturë guri dhe kanë disa radhë harqesh njeri mbi tjetrin në faqet e jashtme. Ato në plan janë katrore. Këmbanaret zakonisht vendosen në anën perëndimore mbi hyrjen, në anën jugore ose, në ndonjë rast të rrallë, në këndin juglindor të ndërtesës. Me siluetën e tyre ato i japin një notë vertikaliteti me vlerë ndërtesës.

* * *

Shqyrtimi tërësor i monumenteve të grupuara sipas veçorive tipologjike flet për një arkitekturë me fytyrë të sajën, për një veprimtari ndërtimore të madhe duke filluar që nga shekulli XVI në të XIX-in. Rruga e kësaj arkitekture përputhet me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit gjatë shekujve të pushtimit osman.

Banesa tiranase, me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve, si epiqendra e kompozimit të mbarë varianteve të saj, siç dihet lidhet me familjen e madhe numerike, shumë kurorëshe, me mbeturina patriarkale. Për vetë karakterin e kësaj banese në zhvillimin e saj morfologjik nuk ndeshen banesa dyfamiljare. Megjithkëtë duhet mbajtur parasysh një dukuri që shfaqet rrallë në qytetin e Tiranës, ajo e ndërtimi përngjitur njëra tjetrës e dy dhe madje tre shtëpish arri. Një shembull tipik i kësaj zgjidhje është ai në rr. Ali Pashë Gucia. Nuk del e qartë nëse ndërtimet janë të njëkohshme, por nga sa mund të vrojtohet, ato janë ngritur njëra pas tjetrës. Në këtë rast kemi të bëjmë me variantin fillestar të banesës tiranase, me një ambient të vetëm banimi dhe ajo që është më e rëndësishme ndërtimi nuk tregon për një fazë të vetme ndërtimi, rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me banesa dyfamiljare, apo edhe trefamiljare të mirëfilltë.[1]

Banesa me hajat, mjaft e përhapur në Shqipërinë e Mesme e pranon konceptin dyfamiljar. Shembuj të tillë i gjejmë në Tiranë, Elbasan dhe Kavajë.

Banesa Nr. 1 ndërtuar rreth fillimit të shekullit XIX, në Tiranë[2] është një shembull i zhvilluar i banesës me hajat. Këtu parimi i simetrisë nuk është zbatuar rreptësisht, siç tregojnë qartë dy radhët e ambienteve anësore, në dallim nga pjesa qendrore ku simetria është e spikatur.

Banesa Nr. 2 në Kavajë[3] paraqet një shembull tipik të banesës dyfamiljare. Në të parimi i simetrisë është zbatuar me rreptësi të plotë deri në hollësi të tilla si vendi i sofave, vatrës, kamareve etj. Shtëpitë e zjarrit, ruajnë vendin kryesor në kompozim. Në dy shembujt e paraqitur të banesës dyfamiljare me hajat vërejmë se njësitë formuese paraqesin një shmangie nga tipologjia e zakonshme e kësaj banese. Kjo shihet në zgjatjen e një ambienti anësor përtej hajatit. Ky zhvillim që e bën kompozimin më kompakt, e gjen pararendësin në sofatë e dyta, të cilat dalin jashtë volumit të hajatit. Gjithashtu për t'u vërejtur është se në të dy banesat e mësipërme, ndarja ndërmjet dy njësive nuk është e plotë. Përveç ndërlidhjes së brendshme, ndërmjet dy njësive, në shembullin e Kavajës, hajati formon një volum të vetëm për mbarë banesën.

Banesa me çardak duke gjykuar nga shembujt që ruhen, nuk ndërtohej në kompozime dyfamiljare. Siç duket ndërtimi i këtyre banesave kryesisht nga shtresat e pronarëve të tokave, dhe vetë karakteri i banesës me volume të mëdha të hapura, shpjegojnë mospërhapjen e kompozimeve çifte në këtë tip banese. Sidoqoftë, disa shembuj e venë deri diku në dyshim pohimin e mësipërm.[4]

1. Një dukuri e tillë vërehet edhe në banesën krutane, ku ndeshen dy, tre e deri në pesë «kulla» ndërtuar në varg. K. Zhegu, **«Kulla krutane»,** në Konferenca e dytë e e studimeve albanologjike, vëll. II, Tiranë 1969.
2. E. Riza-K. Zheku, **«Banesa tiranase»,** Monumentet 2/1971, Shih banesën në Rr. «A. Rustemi», **Nr. 22.**
3. E. Riza, **«Banesa popullore në disa qendra qytetare të Shqipërisë së Mesme,** Monumentet 5-6, 1973, Shih banesën Nr. 5.
4. E. Riza, **«Banesa popullore në qytetin-muze të Berat»it,** Monumentet Nr. 21. Shih banesën Nr. 4.

Do not cop

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3

Në banesën gjirokastrite banesa dyfamiljare ka gjetur vend mirë, duke dhënë shembuj mjaft të goditur. Ata i përkasin kryesisht dyfishimit të varianteve të zhvilluar me një krah. Parimi i simetrisë në përgjithësi është zbatuar pa shmangie me rëndësi. Këto të tundit në shumicën e rasteve, kushtëzohen nga trualli i aksidentuar mbi të cilin ngrihen banesat e këtij qyteti. Banesa Nr. 3 (Tab. I) paraqet një prej shembujve të zhvilluar të banesave dyfamiljare. Parimi i simetrisë në këtë banesë është zbatuar rigorozisht. Disa mospërputhje shpjegohen me ndryshime të mëvonëshme që ka pësuar njësia e majtë. Banesa, duke gjykuar nga trajtimi i brendësisë, duhet të jetë ndërtuar rreth viteve 1870-1880. Ajo, në kompozimin dhe trajtimin arkitektonik i përmbahet karakteristikave të njohura të banesës gjirokastrite. Disa të dhëna të shtyjnë të mendosh se divani i katit II, ka qënë volum i hapur. Pranë kësaj banese ngrihet një banesë tjetër e madhe dyfamiljare ndërtuar më 1876, e cila dallohet në mes të tjerash nga shembulli i mësipërm, edhe për hyrjet dyfishe për çdo familje (fig. 1) nga kati përdhe dhe ai i parë.

Banesa Nr. 4 (Tab. II, fig. 2) përbën padyshim shembullin më të zhvilluar të banesës dyfamiljare. Ajo është ndërtuar në vitin 1881, duke dyfishuar banesën e njohur të variantit me një krah. Disa zhvillime jo paralele ndërmjet dy njësive simetrike duhen shpjeguar me truallin e aksidentuar dhe disa shtesa në banesën e majtë. Përpara bllokut harmonik të banesës ngrihet një ndërtim tepër i shtrirë dykatësh, odajashtat e të dy banesave. Oborri ndërmjet këtyre dy ndërtimeve është i përbashkët, ndërsa hyrjet për në oborr të veçanta, madje dyfishe siç ndërtohen në disa raste në Gjirokastër. Banesa së bashku me odajashtën formon një tërësi të vetme, që shquhet për drejtpeshimin e spikatur kompozicional i cili i lidhur mjeshtërisht me truallin luan një rol me rëndësi të veçantë në mbarë qendrën e Gjirokastrës.

5. K. Zheku, **Vep. cit.,** nga ky artikull është marrë edhe rilevimi i banesës Nr. 8.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

Banesa Nr. 5 (Tab. III, fig. 3) paraqet një zgjidhje të veçantë në grupin e banesës dyfamiljare, për arsye se ajo nuk i përmbahet aspak parimit të simetrisë në kompozim. Të dy njësitë formuese zhvillohen me shtrirje mjaft të lira, duke qënë qartësisht të ndara nga njëra tjetra. Ndryshimi prej dy vjetësh në datimet e dy portave kryesore, përkatësisht 1885 dhe 1887 të shtyn të mendosh për një ndërtim dyfamiljar jo origjinal, por vrojtimi i monumentit nuk të çon në këtë shpjegim.

Edhe në tipin e banesës korçare koncepti i banesës dyfamiljare është i njohur. Shembujt e këtyre zgjidhjeve i gjejmë veçanërisht në Tiranë, ku ky tip banese gjeti përhapje të gjerë pas çerekut të parë të shekullit tonë. Një shembull të thjeshtë të kësaj zgjidhje paraqet banesa Nr. 6 (Tab. IV) në qytetin e Tiranës. Ajo është trekatëshe, me kompozim të thjeshtë, rreptësisht simetrik. Në dallim nga tipet e tjerë të banesës qytetare shqiptare, ku kompozimi zhvillohet simetrikisht karshi planit të simetrisë, i cili është normal pamjes kryesore, në këtë tip banese gjejmë edhe ndërtime dyfamiljare të kompozuara nga dy njësi shpinë më shpinë. Në këto zgjidhje plani i simetrisë është paralel me dy pamjet kryesore. Kuptohet se në këto zgjidhje, ndarja ndërmjet të dy njësive formuese është më e qartë, sepse oborret janë krejtësisht të shkëputur, dhe madje në disa raste hyrjet për secilën familje kanë dalje në rrugë të ndryshme. Në shumicën e kompozimeve plani i simetrisë është një i vetëm, por nuk mungojnë dhe zgjidhje kur ndarja ndërmjet dy banesave arrihet në përmjet konturesh të thyera. Shembull i kësaj zgjidhje është banesa dyfamiljare Nr. 7, në Tiranë (Tab. IV) e cila në pjesën qendrore, ka të zhvilluara dy blloqet e shkallëve, respektivisht për secilën banesë. Në disa raste ndeshen banesa dyfamiljare (fig. 4), në të cilat pamja e jashtme me simetri të plotë, nuk i përgjigjet zhvillimit planimetrik i cili nuk i nënshtrohet këtij parimi.

Në shembujt e paraqitur mësipër, me ndonjë përjashtim, vërehet se banesa dyfamiljare paraqitet më së shumti si dyfishim i varianteve të zhvilluara të banesës qytetare shqiptare. Por nuk mungojnë krejtësisht edhe shembuj banesash dyfamiljare, që janë dyfishim i varianteve të thjeshtë. Një zgjidhje tipike të këtij lloji, e gjejmë në Krujë, në banesën Nr. 8[5] (Tab. V), ku ndërtimi përsërit dy herë banesën e njohur me gjysmëkat perpendikular. Shembuj të tjerë të këtij lloji rrallë janë ndërtuar edhe në Berat (fig. 5).

Mesa dimë, kjo banesë e njohur edhe në vende të tjera të Ballkanit,[6] nuk bart ndonjë emërtim të veçantë. Ndërtimi i saj në disa tipa të banesës qytetare shqiptare, që lidhen me formacionin feudal dhe atë kapitalist të shoqërisë si dhe përhapjes së saj edhe në fshat, tregon se banesa dyfamiljare ka një traditë të gjatë ndërtimi në vendin tonë, e cila ka në bazën e vet shkaqe shoqërore dhe ekonomike

6. G. Kojouharov, «Typologie de la masion des Rhodopes», në **Compte-rendu** du 2 ème colloque de l'iconos, Athenes 1979.

Nr 3

BANESE NE LAGJEN "HAZMURAT"
RR. "Alqi Kondi" Nr. 3-7
GJIROKASTER



PAMJE KRYESORE



KATI II

0 5m

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 4

BANESE NE LAGJEN "PALORTO"
Rr "K BELLA" Nr 1, 3, 11
GJIROKASTËR



PAMJE KRYESORE



KATI III



KATI II



Plani i përgjithshëm

Nr. 5

BANESE NE LAGJEN "PALORTO"
Rr "Sherif Zeneli" Nr 17
GJIROKASTER



PAMJE KRYESORE



KATI II

0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY

Nr 6,7

BANESE NE RRUGEN "ASIM VOKSHI„ Nr 141
TIRANE



PAMJE KRYESORE



KATI I

BANESE NE RRUGEN "SHINASI DISHNICA„ Nr 57
TIRANE



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE



KATI II

0 2 4 m

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 8

BANESE NE QYTETIN E KRUJES





Emin RIZA

DO NOT COPY

L'HABITATION URBAINE POUR DEUX FAMILLES

RESUME

L'habitation albanaise urbaine et rurale est presque toujours conçue pour une famille, donc elle est construite en vue d'abriter une seule famille, composée d'un seul couple ou de plusieurs. De pair avec elle, dans nos villes aussi, bien que dans nos campagnes on a bati des habitations pour deux familles. Ce sont ces dernières qui constituent l'objet de cet article. La famille représente une catégorie évoluant dans le temps, à la base des caractéristiques de laquelle demeurent les conditions économiques et sociales en général et l'appartenence de classe en particulier.

Dans cet article nous allons prendre en considération la situation urbaine pendant le XVIIIe-XIXe siècles jusqu'au début du XXème siècle parce que c'est à cette période qui appartiennent les exemples d'habitation pour deux familles conservées encore de nos jours. Dans les conditions du laps de temps en question, caractérisé par le développement économique inégal des différents centres urbains, les liens de parenté sont encore solides même en ville. Cela est plus évident à Gjirokastër et dans une certaine mesure même dans d'autres villes, où les familles descendant de même souche construisent des habitations l'une à côté de l'autre, formant une agglomération d'habitations plus ou moins grandes. L'habitation pour deux familles, dans ce contexte apparaît comme une solution assez convenable à laquelle s'ajoutent aussi des priorités de caractère économique. C'est le cas de noter que l'habitation pour deux familles est l'expression nette de la consolidation de la famille peu nombreuse, composée d'un couple ou de deux couples, à la différence des grandes familles avec des survivances patriarcales qui, comme nous allons le constater, restent loin de ces solutions.

Quant à l'habitation pour une famille, il faut prendre en considération un phénomène largement répandu dans l'habitation urbaine, celui des transformations subies par l'habitation initiale après la création de nouvelles familles descendant de la famille d'origine. Dans ces cas-là, l'habitation initiale pour une famille se divise et, en général se transforme du point de vue fonctionnel, en changeant aussi la destination d'une série de volumes. Souvent elle se voit ajouter des annexes en vue de créer les volumes indispensables à la vie quotidienne, lesquels au début étaient uniques. Il faut mentionner aussi u autre phénomène, celui de la construction d'une seconde ha bitation attenante à la première, formant ainsi un ensemble d deux habitations vraiment séparées, mais qui constituent un seule unité de construction. Ces solutions ont affaire essentie lement avec les variantes simples de l'habitation urbaine. Dan cet article nous n'allons pas traiter de ces cas qui numéri quement sont très nombreux et concernent la typologie en tière de l'habitation albanaise urbaine, mais nous allons nou arrêter aux exemples proprement dits de l'habitation pour deu familles, donc ceux qui dès le début sont construits comme tel

Sur le plan compositionnel, le principe de base, caracté ristique à l'habitation pour deux familles, est celui de la sy métrie. Les habitations de ce type sont le résultat du dédou blement mécanique de l'habitation pour une famille. Il es évident que l'habitation pour deux familles, du point de vu typologique ne présente pas de particularités, parce qu'elle fa partie de toute la typologie de l'habitation albanaise, con struite conforme à quelques types déterminés ayant à sa bas de différentes variantes de ces types. Quand on parle de l'ap plication du principe de symétrie dans ces compositions, il n faut pas l'absolutiser parce que dans certains cas, il n'est pa executé avec méticulosité, permettant même de petites dévia tions souvent conditionnées par le terrain de construction es carpé, comme le démontrent les exemples de Gjirokastër. Dan des cas très rares on rencontre des habitations pour deux fa milles de composition non simétrique.

En ce qui concerne le commencement de l'apparition de l'habitation pour deux familles, il manque les données pour pré ciser une limite temporelle. Les exemples datés conservés son peu nombreux et appartiennent à la fin du XIX siècle, ou bien au début du XX siècle, tandis que la plupart des exemples non datés semblent appartenir à la première moitié du XIXe siècle.

Il faut ajouter que l'habitation pour deux familles est trou vée convenable même ultérieurement dans l'architecture de l'habitation albanaise qui dépasse la sphère de la création po pulaire.

Jugeant des exemples conservés on s'aperçoit qu'en géné

ral les habitations pour deux familles sont liées aux couches moyennes et riches de la société urbaine.

L'habitation de Tirana, avec la maison du feu qui le long des deux étages, en tant qu'épicentre de toutes ses variantes, comme l'on sait, est liée à la famille nombreuse des plusieurs couples avec des survivances patriarcales. En raison du caractère même de cette habitation, dans son développement morphologique, on ne rencontre pas d'habitation pour deux familles.

L'habitation à porche, assez répandue dans l'Albanie centrale, agrée la conception pour deux familles. L'habitation à «tchardak» à en juger par les exemples conservés, n'est pas construite pour deux familles. Il paraît que, la construction de ces habitations principalement par les couches de propriétaires fonciers et le caractère même de l'habitation à grand volumes ouverts expliquent la non propagation des compositions doubles dans ce type d'habitation. De toute façon certains exemples mettent en doute dans une certaine mesure cette affirmation.

A Gjirokastër, l'habitation conçue pour deux familles a trouvé un bon terrain et fournit des exemples assez réussis. Ils apartiennent surtout au doublement des variantes développées sur un côté. Le principe de symétrie a été généralement appliqué sans déviations importantes. Ces dernières, dans la plupart des cas, sont dues au terrain accidenté sur lequel s'élevent les habitations de cette ville.

Même dans ce type d'habitation de Korça la conception de l'habitation pour deux familles est connue. Ces exemples de ces solutions se trouvent particulièrement à Tirana, où ce type d'habitation s'est largement répandu après le premier quart de ce siècle.

Autant que nous puissions savoir, cette habitation connue même dans d'autres pays des Balkans, ne porte pas d'appellation spéciale. Sa construction dans certains types d'habitation albanaise urbaine, liés au régime féodal et à celui capitaliste de la société, ainsi que sa propagation dans la campagne, témoignent que l'habitation pour deux familles a une longue tradition de construction dans notre pays, à la base de laquelle il y a des raisons sociales et économiques.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Fabian MIRAJ

DO NOT COPY

MBISHKRIMET PËR UJËSJELLËSIN E DURRËSIT

Një nga veprat më të mëdha të ndërtuara në vendin tonë në kohën antike është edhe Ujësjellësi i Dyrrahut.

Ujësjellësi përbëhet nga kanali i mbyllur me gjatësi rreth 7200 m, tuneli që me ndërprerje arrin afër 2200 m dhe kanali mbi urë nga kodra e Rrashbuellit deri në qytet 5600 m i gjatë.

Në vitin 1955, në afërsi të Parkut Sportiv në rrugën «Mujo Ulqinaku», në një thellësi 1.75 m u gjetën disa tuba prej plumbi (fistulae) të lidhur njeri me tjetrin. Nga këta tuba vetëm një ishte i plotë. Gjatësia e tij arrin në 91 cm d.m.th. afro tre këmbë me masën e vjetër. Trashësia e pllakës së plumbit ishte 1-1.5 cm, kurse diametri i tubit është 21 cm. Tubi ka një peshë prej 108 kg.

Në tre tuba dallohen mbishkrime.

Mbishkrimi i parë, ka tre rreshta. Dy rreshtat e parë me shkronja 30 mm kurse rreshti i tretë me 25 mm. Në rreshtin e parë mungojnë pikësimet për fjalët e shkurtuara dhe nuk është lënë hapësira në mes të fjalëve, kurse në rreshtin e dytë kemi pika para dhe prapa shkurtimit AQ, po kështu edhe në rreshtin e tretë mbas CVR. Mbas fjalës illi emrat në vazhdim nuk kanë hapësirë të ndërmjeme.

Mbishkrimi në reliev të ulët vijon si më poshtë:

COLIVLIAEAVGDYRRACHIN
.AQ. HADRIAN
CVR. ILLI. GALIETAVIDIOCAMVRIAN

që transkriptohet:

Col(oniae) Iuliae Aug(ustae) Dyrrachin(ae) Aq(uae) Hadri an(i)/ Cur(atores) illi Gali et Avidio Camurian(o) dhe përkthehet:

Për Koloninë Iulie Auguste të Dyrrahut
Ujërat e Hadrianit

Kujdestarët në këtë rast Gali dhe Avid Kamuriani. Këtu për herë të parë në këtë dokument epigrafik del emri i kolonisë së Dyrrahut Iulie Auguste që dëshmon themelimin e saj nga Augusti.

Nga ky emërtim kuptohet se në të nuk kishte përzierje kombësish, por ai ishte një emërtim administrativ. Po të kishte në koloninë e Dyrrahut përzierje kombësish me qytetarë romakë ajo nuk do ta kishte emërtimin «Iuliae Augustae» por do ta kishte «Colonia civium romanorum», koloni e qytetarëve romakë.

Mbishkrimi i dytë ka tre rreshta dhe madhësia e shkronjave është e njëllojtë, 24 mm.

AQVAE. . . . . .AN
COLIVL . AVG . DYRR
OFFIC . EVPYCH. . .P

Transkriptimi dhe përkthimi sipas nesh është:

Aquae (Hadri)an(i)/Col(oniae) Iul(iae) Aug(ustae) Dyrr(achi) / Offic(inis) Eupych(ius) p(ecunia p(ublica)?

Ujërat e Hadrianit
të kolonisë Iulie Auguste të Dyrrahit
Punishtet e Eupykius me shpenzime publike?)

Këtu kuptohet se tubat prej plumbi u prodhuan në punishtet vendase të Dyrrahut te pronari Eupykius me shpenzime publike.

Theksojmë se në tubin e dytë ky mbishkrim është përsëritur dy herë.

Mbishkrimi i tretë formohet vetëm nga një radhë shkronjash. Ato janë të ndara në grupe dhe me shenjat e pikësimit. Madhësia e tyre arrin në 31 mm. Për shkak të dëmtimit të madh kemi mundur të sqarojmë vetëm dy grupe:

. . . .SC . PR . EFA. . . . . .

Leximi ynë që ndoshta do të transkriptohej dhe përkthimi:

S(enatus) C(onsultum) P(ecunia) R (?) . .

Mbishkrimi i katërt është gjetur mbi një pllakë mermeri te burimi i Arapajt në vitin 1861[1] Meqënëse ka lidhje me mbishkrimet tona, po e ribotojmë:

Imperator Caesar
Marcus Aurelius Severus
Alexander Pius
Felix Augustus Aquae
ductum Divi
Hadriani Parentis
Suis liberalitate Dyrrachinise
Factum et vetustate pluribus
In locis vexatum restituit
Set et viam a Colonia par millia
passum quattuorvoraginibus.

Perandori Cezar Mark Aurel Severi, Aleksandri i përshpirtshëm (mëshirues), fatmadh, August, rimëkëmbi Ujësjellësin e ndërtuar për banorët e Dyrrahut nga bujaria e hyjnorit Hadrian, gjyshit të tij, por që koha e kishte dëmtuar në shumë vende, ai ka restauruar gjithashtu rrugën që niset nga kolonia dhe ndrequr në një gjatësi prej katërmijë hapa dëme të shkaktuara nga përrenjtë».

Ky mbishkrim tregon për riparimet e bëra afro mbas njëqind vjetëve nga ana e Aleksandër Severit nipit të Hadrianit.

Ujësjellësi i Dyrrahut u ndërtua në kohën e Hadrianit (117-138) dhe u riparua nga Aleksandër Severi (222-235).

Në të dy mbishkrimet e para për Ujësjellësin përdoret fjala «Aquae» d.m.th. Ujërat. Kjo vërtetohet edhe nëpër mbishkrimet e ujësjellësve të tjerë. Është për t'u vënë në dukje se në mbishkrimin e Aleksandër Severit është plotësuar emërtimi i Ujësjellësit me fjalën Aquae ductum.

Në mbishkrimin e dytë del edhe emri «Eupychius» emër i panjohur deri më sot, por mundet që kemi parë si «P» mund të ishte «T». Në këtë rast duhet të lexohet «Eutychius» emër i njohur edhe më parë.[2]

Në mbishkrim flitet edhe për «Curatores» që janë kujdestarë të veprës.

DO NOT COPY

1. Mbishkrimi jepet në CIL III 709 dhe L. Heuzey-H. Daumet, **Mission Archéologique de Macédoine,** Paris 1879, f. 387.
2. H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë 1965, f. 144-155 dhe 160 (Avtvhos).

Fabian MIRAJ

DO NOT COPY

TRANSCRIPTIONS SUR L'AQUEDUC DE DURRËS

RESUME

L'aqueduc de Dyrrah est aussi l'une des plus grandes oeuvres construites dans notre pays dans les temps antiques.

Cet aqueduc est composé d'un canal couvert, long de 7200 m environ, d'un tunnel interrompu qui atteint presque 2200 m le long d'un pont cannal d'une longueur de 5600 m allant de la colline de Rrashbull jusqu'à la ville.

En 1955, à proximité du Parc sportif, rue Mujo Ulqinaku» on a découvert dans une profondeur de 1,75 m, quelques tubes de plomb joints l'un à l'autre. De ces tubes, un seul était intégral. Sa longueur était de 91 cm, c.à.d. de presque trois pieds selon la mesure ancienne.

L'épaisseur du plomb était de 1 – 1,5 cm, tandis que le diamètre du tube était de 21 cm. Il pesait 108 kg. Sur trois tubes on distingue des inscriptions.

La première inscription est formée de trois lignes. Les deux premières lignes sont de lettres de 30 mm alors que la troisième est de lettres de 25 mm. Dans la première ligne manque la ponctuation pour les mots abrégés et il n'y a pas d'espace entre les mots, tandis que dans la seconde ligne, il y a des points avant et après l'abréviation A Q, de même dans la troisième ligne après CVR. Il n'y a pas d'espace intermédiaire entre les noms qui suivent le mot illi».

L'inscription en bas relief est comme suit:

COLIVLIAEAVGDYRRACHIN
.AQ. HADRIAN
CVR. ILLI. GALIETA VIDIOCAMVRRIAN

qui se transcrit:

Col (oniae) Juliae Aug (ustae) Dyrrachin (ae) / Aq (uae) Hadrian(i)/ cur (atores) illi Gali et Avidio Camurian (o).

C'est dans ce document épigraphique qu'apparait pour la première fois, le nom de la colonnie de Dyrrah Julie Auguste, témoignant de sa fondation par Auguste.

La deuxième inscription est composée de trois lignes dont les lettres ont les mêmes dimensions, 24 mm.

AQVAE. . . AN
COLIVL.AVG.DYRR
OFFIC.EUPYCH. . . P

la transcription est:

Aquae (Hadri)an (i) / col (oniae) / Iul(iae) Aug(ustae) Dyrr(achi) / (Offic(inis) Eupych(ius) pecunia p (ublica)?

On comprend de cette inscription que les tubes de plomb étaient produits dans les ateliers locaux de Dyrrah chez les propriétaires Eupychius, aux frais publics.

La troisième inscription est composée d'une seule ligne de lettres, divisées en groupes et accompagnées des signes de ponctuation nécessaires:

. . . . sc. P R. E F I A . . .

La quatrième a été découverte sur une dalle de marbre à la fontaine d'Arapaj, en 1861. Elle est citée par L. Heuzey et H. Daumet.

DO NOT COPY

Pëllumb NURE

DO NOT COPY

PALOKALAJA E JANJARIT

Rreth 1500 m në lindje të fshatit Janjar të rr. Sarandës, në të majtë të lumit Pavël dhe jo më tepër se 400-500 m larg bregut të tij, ngrihet kodra e Palokalasë. Kjo kodër dominuese në ambientin përreth ka një lartësi prej 500 m. Sot është veshur nga një pyll i dendur përralli dhe mareje. Nga lindja ajo bie thikë mbi fushën e Janjarit, kurse nga jugu e veriu terreni është shumë i pjerrët. Vetëm nga ana perëndimore kodra ka një zbritje të butë nga ku ngjitja për në majën e saj bëhet më e lehtë. Maja është e rrafshët dhe nuk i kalon 0.3 hektarët. Prej këtej vështrimi kap luginën e Pavllës, fushën e Janjarit nga lindja dhe përroin e Frrakullës nga veriu.

Pikërisht këtu duken gjurmët e një fortifikimi antik. Kështjella ka trajtë afërsisht katërkëndëshe me përmasa rreth 45 x 20 m, e orientuar nga jugu në veri (fig. 1). Në anën lindore kodra bie me shkëmbinj të thikët, kështu që ajo është lënë e parrethuar. Në veri dhe jug muret vazhdojnë të drejtë për rreth 45 m për t'u puqur me ballin perëndimor 20 m të gjatë. Bashkimi nuk është kryer me brinjë të drejta, por pëson një lakim me rreze rreth 3 m. Në mesin e ballit perëndimor shihen dhe gjurmët e një kulle katrore rreth 6 x 6 m e vendosur në mesin e murit. Nga kjo anë gjendej dhe pjesa me rënie më të butë e kodrës dhe po këtu duhet kërkuar hyrja. Ka gjasë që kjo të përshkonte mes për mes kullën a të kalonte brinjas saj.

Muret 2.10-2.20 m të gjerë janë punuar me rrasa guri (40 x 15 cm) të plotësuara në boshllëqet me gurë më të vegjël. Për nga teknika muret i shohim si të periudhës së parë të hekurit, ndërsa disa elemente, trajta planimetrike dhe forma e kullës janë më të



avancuara. Rrjedhimisht mendojmë se ky fortifikim, të cilit më për shtat do t'i vinte termi kështjellë ose kullë mbrojtëse, i përket kapërcyellit midis periudhës së I dhe të II të hekurit.

Afër kështjellës gjatë kërkimit të një burimi u zbulua dhe një hark ure i cili duket se i shërbente një rruge që kalon nga ana lindore, poshtë shkëmbit të kështjellës.

Në afërsi të kështjellës në anën jugore të kodrës, si dhe tek «Livadhet», jo më shumë se 1 km në veri të kodrës së Palokalasë, gjenden fragmente qeramike antike: solenë e kalipterë të periudhës helenistike, një fund lëfyti me vernik të zi, një vegje masive e zbukuruar me motiv gërsheti të dyfishtë, peshore konike dhe një fragment kupe me ornamente në reliev dhe e lyer me vernik të kuq.

Nga punimet bujqësore, janë hasur edhe varre të ndërtuara me rrasa guri, brenda të cilave, përveç skeleteve, janë gjetur lekyta me vernik të zi, lakrimore etj.

Nga vrojtimet themi se kodra e Palokalasë së Janjarit ruan gjurmët e një fortifikimi i cili duhet të ketë qënë i destinuar të kontrollonte një kalim të mundshëm prej luginës së Pavllës për në vise më të thella të Epirit, ndoshta dhe për në Dodonë.

Në raste luftërash ai ka shërbyer dhe si vend strehimi për banorët përreth. Lulëzimi i jetës këtu mendojmë se i përket shekullit IV-II p.e.s. Duke marrë parasysh se kjo pikë nuk ka rënë në sy të studionjësve që kanë, bërë kërkime në këtë zonë dëshirojmë që ky njoftim të shërbejë për nxitjen në të ardhmen të kërkimeve më sistematike në këtë pellg.

DO NOT COPY

Pëllumb NURE

DO NOT COPY

LA FORTERESSE DE JANJAR

RESUME

A 1500 m environ à l'Est du village de Janjar sur la gauche de la rivière de Pavël, s'élève la coolline de la forteresse, d'un hauteur de 500 m.

Du côté Ouest la colline est d'une pente douce. Le sommet est plat et ne dépasse pas 0,3 hectare.

C'est ici que sont conservées les traces d'une forteresse antique de forme à peu près rectangulaire, avec des dimensions de 45 x 20 m environ. Du côté Est de la colline, les rochers tombent à pic, ainsi elle n'a pas été entourée de mur d'enceinte.

Les murs Nord et Sud continuent tout droit sur 45 m environ pour se joindre à la partie frontale Ouest longue de 20 m. La jonction n'est pas effectuée au moyen des côtés droits mais elle subit une inclinaison au rayon de 3 m environ.

Au milieu de la partie frontale Ouest se voient les traces d'une tour carrée d'environ 6 x 6 m, située au milieu du mur. C'est ici qu'il faut chercher l'entrée.

Les murs d'une épaisseur de 2,10 – 2,20 m sont construits de dalles de pierre (40 x 15 cm) les intervalles entre lesquelles étant remplies de pierres plus petites.

Quant à la technique, les murs semblent appartenir à la première période du fer, tandis que quelques éléments, comme la forme planimétrique et celle de la tour, semblent plus avancés, par conséquent nous pensons que cette fortification appartient à la phase intérmédiaire entre la première et la seconde période du fer.

Non loin de la forteresse, on a découvert aussi une arche de pont, qui parait-il, appartenait à une route passant du côté Est, au-dessous du rocher de la forteresse.

Dans le voisinnage de la forteresse se trouvent des fragments de céramique antique.

En effectuant des travaux agricoles on a rencontré des tombes construites de dalles de pierre, ou l'on a découvert des lécythes revêtus de vernis noir, des vases lacrymaux etc.

D'après les observations nous disons que la colline de la forteresse Janjar conserve les traces d'une fortification, laquelle à dû être destinée à contrôler un passage possible de la vallée de Pavël vers d'autres régions plus reculées d'Epire, peut-être même vers Dodone.

DO NOT COPY

Andromaqi GJERGJI

DO NOT COPY

EMIN RIZA «QYTETI–MUZE I GJIROKASTRËS» (MONOGRAFI), Shtëpia Botuese «8 Nëntori», Tiranë 1981, 349 faqe me 181 fotografi dhe LIX tabela skicash e planimetrish

Arkitektura e Gjirokastrës i lë mbresa të thella kujtdo që e viziton këtë qytet. Ai tërheq vëmendjen me karakterin e veçantë të ndërtimeve, origjinalitetin e tyre, monumentalitetin e shumë ansambleve, zgjidhjet e goditura kompozicionale, lidhjet e përsosura me terrenin shumë të thyer ku janë vendosur e me shumë aspekte të tjera. Sa herë rikthehesh në Gjirokastër mund të zbulosh pamje e veçori të reja të banesave të saj, që nuk i ke vënë re më parë. Kështu, krejt natyrshëm, ky qytet me vlera të rralla arkitektonike, të zgjon kureshtjen dhe të shtyn të kërkosh të dish diçka më shumë për të.

Në këtë pikëpamje, monografia e studiuesit Emin Riza që synon të japë një paraqitje sistematike të vlerave arkitektonike të Gjirokastrës, është një vepër me vlera të shumanshme që e ndihmon lexuesin ta njohë e ta vlerësojë drejt këtë qytet.

Pas një hyrjeje të shkurtër ku jepet një vështrim kritik mbi bibliografinë ekzistuese mbi këtë problem dhe parashtrohen burimet mbi të cilat mbështetet studimi, autori na fut gradualisht në problemet që do të shqyrtojë, me kapitullin: **«Pozita dhe zhvillimi i qytetit në kohë»** (faqet 9-15 të veprës). Këtu flitet shkurt për terrenin, klimën dhe zhvillimin historik të Gjirokastrës, që nga fillimet e saj (shekulli XIII) deri në shekullin XIX. Me të drejtë autori vë në dukje si një tipar me rëndësi faktin se ky qytet deri në fund të shekullit XIX mbeti kryesisht një qendër administrative dhe këmbimi dhe jo aq qendër prodhimi.

Në kapitullin II, **«Urbanistika, kalaja dhe ndërtimet shoqërore»** (faqet 16-49 të veprës), duke e vlerësuar kompozimin e vendbanimit si një faktor që evoluon më ngadalë se arkitektura, e cila ka të bëjë me njësitë e veçanta ndërtimore dhe ndryshon më shpejt, autori parashtron një varg konstatimesh me interes mbi këto dy çështje. Ai vëren se në pikëpamje urbanistike Gjirokastra karakterizohet nga një rrjet rrugor i dendur dhe me banesa të ngjeshura. Ai tregon gjithashtu se si është pasqyruar diferencimi klasor i popullsisë, qoftë në tipologjinë e banesave, qoftë në diferencimin shoqëror të lagjeve.

Kontributi kryesor i kësaj vepre është padyshim kapitulli III i saj, i titulluar **«Banesa gjirokastrite, programi, tipologjia, elementet kompozicionale, arkitektonike e konstruktive»**, që është një parashtrim i gjerë (faqet 50-203 të veprës) e analitik i një materiali shumë të pasur dokumentar, i cili është klasifikuar qartë e bindshëm. Kapitulli përshkohet nga përpjekja për t'i parë faktorët përbërës të kësaj banese jo të shkëputur por në bashkëveprim, si shfaqje të një realiteti të caktuar historik. Me shumë interes është pjesa që flet mbi banesën si pasqyrim i mënyrës së jetesës. Autori provon qartë se si programi ashtu edhe kompozimi i saj përcaktohen nga mundësitë ekonomike dhe pozita shoqërore e familjes. «Numri i madh i varianteve të banesës gjirokastrite – shkruan ai – dallimet sasiore brenda një varianti si dhe trajtimet e ndryshme në planin dekorativ, pasqyrojnë pikërisht diferecimin klasor të popullsisë së qytetit» (faqe 51). Me mprehtësi ai zbulon ç'ka të veçantë në banesën gjirokastrite, ndryshe nga banesat e qyteteve të tjera, dhe i lidh këto ndryshime, në radhë të parë, me disa faktorë specifikë social-klasorë të këtij qyteti dhe pastaj me faktorë të terrenit, të klimës etj. Ky qytet ku, në shekujt XVIII-XIX klasa e funksionarëve dhe e pronarëve të tokave ishte jo vetëm shumë e fuqishme ekonomikisht, por edhe numerikisht më e madhe se në çdo qytet tjetër të Shqipërisë në atë kohë, me

banesat e saj të zhvilluara që kishin përmasa të konsiderueshme sa mund të quhen pallate të vërtetë dhe një arkitekturë monumentale, i kanë dhënë tonin pamjes së qytetit. Banesat e tyre tërheqin vëmendjen e vizitorit aq sa njeriu në kontaktin e parë mund të pyesë: po ku janë banesat e varfra në këtë qytet? Ato natyrisht janë por duhen zbuluar duke ecur ngadalë ose duke i kërkuar në periferitë e disa lagjeve. Në këtë pjesë autori flet gjithashtu për lidhjet e këtij qyteti me fshatin, për karakterin e mbyllur të ekonomisë familjare që pasqyrohet në të ndarat e posaçme të banesës për të ruajtur rezervat ushqimore, në katojtë për mbajtjen e kafshëve të ngarkesës, në ndërtimin e sterave të shumta për shkak të mungesës së ndieshme të ujit të pijshëm në qytet etj. Në përshkrimin që u bën oborreve të banesave e ndërtimeve ndihmëse në to, tërheq vëmendjen odajashta, një ndërtim i veçantë, i destinuar për mysafirë të dorës së dytë, për shërbëtorët e trimat e armatosur që mbanin familjet më të pasura, ndërtim i cili flet qartë për diferencimin klasor të shprehur tashmë edhe në rregullat e mikpritjes.

Vijmë pastaj në thelbin e problemeve të kësaj monografie, në pjesët kushtuar zhvillimit tipologjik dhe kronologjik të banesës gjirokastrite.

Në bazë të një njohjeje të thellë e të shumanëshme të materialit, ose më mirë të themi të vetë qytetit, Emin Riza, i bazuar në treguesin më solid që është kompozimi i banesës, ka arritur të veçojë njësinë bazë të kompozimit planimetrik-volumor të saj dhe variantet e zhvillimit të mëtejshëm të saj. Kjo njësi është varianti perpendikular me dy ose tre kate, me planimetri në formë katërkëndikënddrejtë, ku në katin përdhe është katoi ose stera, kati i parë ka një ambient të vetëm banimi, i cili, në format më të zhvilluara ndahet në tri njësi të vendosura radhazi. Zhvillimin e plotë ky variant e merr kur bëhet trekatësh, ku kati i sipërm banohet gjatë stinës së verës ose rezervohet për miq. E zhvilluar kështu në tre kate banesa fiton edhe disa tipare mbrojtëse. Kjo është forma që të kujton më fort banesat fshatare të zonave të Labërisë. Kuptohet se kjo lidhje ka rëndësi të madhe për gjenezën vendase të tipologjisë së banesës qytetare gjirokastrite.

Autori jep edhe kronologjinë e variantit dykatësh, duke e shtyrë atë në shekullin XIV, në bazë të analogjive që paraqet me ndërtimet rrënojë të fshatit të Kamenicës, në Shqipërinë e Jugut. Kurse për nënvariantin trekatësh ai mendon se duhet të jetë krijuar të paktën që në fillim të shekullit XVII (po të bazohemi në një pasazh të Çelebiut).

Pastaj autori shtjellon variantin e banesës me një krah, që është varianti më i përhapur; këtë variant ai e datoi në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Në të ai dallon tre nënvariante, në formulimin e të cilëve ndjehet qartë ndikimi i terrenit të aksidentuar.

Në variantin me dy krahë banesa gjirokastrite arrin format e saj më të zhvilluara, me një pamje të jashtme monumentale, sidomos në pjesën qendrore të fasadës kryesore. Edhe në këtë grup autori dallon tre nënvariante për të cilët jep karakteristikat kryesore që i dallojnë nga njëri tjetri.

E. Riza bën krahasime me interes, me banesat e qendrave të tjera qytetare të vendit, duke theksuar me këtë rast se, sidoqoftë «banesa gjirokastrite shquan për një tipologji të përcaktuar dallueshëm» (faqja 79 e veprës). Kështu të tre variantet e saj i bashkon një koncept i vetëm, sepse ato, vëren autori, përbëhen nga një njësi planimetriko-volumore konstante, që është e pranishme në të tre variantet. Një tjetër faktor i qëndrueshëm është funksioni i veçantë i çdo kati. Autori konstaton se në gjysmën e dytë të shekullit XIX banesa gjirokastrite shënon disa ndryshime që synojnë t'ia theksojnë karakterin qytetar, por megjithatë duket qartë se ajo e ka kryer tashmë ciklin e zhvillimit të saj.

Pasi ka analizuar të tre variantet kryesore të banesës gjirokastrite, autori kalon në shqyrtimin e ambienteve përbërës të saj. Ky shqyrtim paraqet interes të veçantë për etnografët me që flet shumë për mënyrën e jetesës. I rëndësishëm e shumë domethënës në këtë vështrim është p.sh. fakti që në variantet e zhvilluara të banesave të këtij qyteti gjejmë përgjithësisht disa ambiente me të njëjtin funksion e të tjerë me disa funksione. Banesat e Gjirokastrës, si shihet nga skemat e shumta planimetrike që janë sjellë për ilustrim, kanë një numër të madh të ndarash. Kështu shtëpia ka ambiente banimi për dimër, në katin e parë e për verë në katin e sipërm, gjë që flet për kërkesa të rritura. Me të ë kujdesin e duhur autori përshkruan shtëpinë e zjarrit ose «dimëroren», dhomat e banimit (që mund të jenë të shumta në numër, deri në 6-7 e më tepër, sipas shtresave shoqërore), dhomën e miqve, pajisjet e palëvizshme të tyre (si është kompleksi musëndër-dhipato), si edhe për ambientet e gatimit, divanet, kamerien, katojt etj.

Shqyrtimin e elementeve arkitektonikë e konstruktivë e fillon me përshkrimin e mureve, të harqeve e të qemerëve, të çative dhe të strehëve, të dyshemeve etj. Pastaj jep një karakterizim të hollësishëm të tavaneve, me një kronologji të dokumentuar mirë dhe bën një analizë mjaft të plotë të vlerave dekorative të tyre, duke u ndalur në kompozimet më me interes. Një analizë të ngjashme e bën më poshtë për dyert, dritaret dhe dollapët e murit, por nuk mungon të flasë edhe për një varg elementesh

BOTIM

të tjerë konstruktivë e arkitektonikë. Shkurt vëmendjes së autorit nuk i ka shpëtuar pothuaj asgjë.

Në kapitullin IV, **«Banesa gjirokastrite, karakteristikat dhe vendi i saj»** (faqet 205-230 të veprës) autori rrok me një vështrim përmbledhës rezultatet e analizës së hollësishme të parashtruar në kapitullin III, duke nxjerrë në pah karakteristikat më themelore të saj, në periudhën e arritjeve më të kristalizuara të saj (vitet 1800-1830).

Për mjeshtrat popullorë që ndërtuan Gjirokastrën, autori ka folur tepër pak dhe mendoj se duhet ta ndjejë veten ende borxhli ndaj tyre. Në të ardhmen ky problem duhet të gjejë zgjidhje më të plotë, sigurisht me kontributin e gjithë atyre studiuesve dhe gjurmuesve që punojnë në këto fusha.

Problemeve të rëndësishme që lidhen me klasifikimin e banesave qytetare shqiptare në shekujt XVIII-XIX, Emin Riza u ka kushtuar disa nga punimet e tij më me vlerë dhe kjo padyshim ia ka lehtësuar detyrën e përcaktimit të vendit që ze banesa gjirokastrite në arkitekturën e banesës shqiptare. Sipas tij kjo banesë përfaqëson një tip më vete, të kristalizuar mirë që paraqet njëkohësisht analogji e dallime me tipet e tjera, qoftë në planimetri, qoftë në elemente të kompozimit.

Në pjesën e fundit të kapitullit IV, duke folur për gjenezën e banesës gjirokastrite, autori hedh poshtë mendimet e Hahnit e të Shuflait që i kërkojnë rrënjët e saj në kullat mesjetare të Europës Perëndimore dhe thekson lidhjet e qarta të varianteve më të thjeshta të saj me banesën fshatare të zonave kodrinore e malore përqark (shih faqen 226 të veprës). Por ky pohim, me të drejtë, nuk e pengon aspak autorin që të verë në dukje aftësitë që ka konstatuar me banesat e disa zonave të Ballkanit Jugor edhe pse është i mendimit se në këtë drejtim mbetet ende shumë punë për të bërë.

Kapitulli kushtuar mbrojtjes dhe restaurimit të qytetit-muze të Gjirokastrës dëshmon më së miri për kujdesin e madh që tregon PPSH dhe pushteti popullor për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në anë tjetër ai tregon se në këtë fushë bëhet një punë serioze me kritere shkencore dhe puna restauruese konsiderohet një punë me përgjegjësi, së cilës duhet t'i paraprijë studimi i kujdesshëm i monumentit që do të restaurohet. Një dëshmi e fortë për këtë është vetë vepra për të cilën po flasim, me që autori i saj ka punuar për projektet e restaurimit e caktimin e banesave që duheshin vënë në mbrojtje.

Monografia mbyllet me dhënien e karakteristikave themelore për një varg banesash (rreth 50) që janë vënë në mbrojtje në këtë qytet.

Vepra «Qyteti-muze i Gjirokastrës» dëshmon për përgatitjen e thellë ideologjike e profesionale të autorit. Ai fenomenet e ndërtimit nuk i ka parë asnjëherë të shkëputura nga konteksti ekonomik-shoqëror i qytetit, por si një realitet lëndor që ka ndryshuar në kohë, realitet prej të cilit ai ka mundur të nxjerrë gjykime të vlefshme mbi shoqërinë qytetare të shekullit XIX, shkallën e emancipimit të saj, nivelin e kërkesave të jetesës etj.

E tërë monografia që po analizojmë dëshmon se autori e njeh shumë mirë materialin mbi të cilin shkruan, manovron lirshëm me të dhe kështu, duke shqyrtuar pjesët e veçanta ose elementet përbërës, nuk humbet nga syri të tërën, pas analizave të hollësishme vijnë pjesët sintetizuese.

Emin Riza vjen tek kjo monografi pas botimit të një vargu artikujsh studimorë në shtypin tonë shkencor, jo vetëm mbi Gjirokastrën por edhe mbi çështje të përgjithëshme të arkitekturës së qyteteve tona. Ndër to mund të përmendim: Banesa e fortifikuar gjirokastrite (1971), Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës (1972), së bashku me B. Strazimirin), Banesa popullore në Shkodër në shekujt XVIII-XIX (1972), Banesa qytetare në disa qendra të Shqipërisë së Mesme (1973), Banesa me gjysmëkat perpendikular (1974) dhe sidomos punimet sintetizuese: Tipollogjia e banesës qytetare shqiptare në shekujt XVIII-XIX (1976); Vështrim mbi urbanistikën e qytetit shqiptar në shekujt XIX-XX (1977) dhe Arkitektura në qytetet tona gjatë shekujve XVIII-XIX (1980). Këto studime në përgjithësi janë mirëpritur e vlerësuar nga kritika shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, po kështu edhe albumi i ilustruar mbi qytetin-muze të Gjirokastrës që, në një kuptim mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e monografisë që po shqyrtojmë. Të gjitha këto botime provojnë se kemi të bëjmë me një autor serioz e gjurmues të pasionuar të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, i cili me veprën e tij «Qyteti-muze i Gjirokastrës» sjell një kontribut të vlefshëm në studimin e banesës shqiptare.

DOKTORATURA

Andromaqi GJERGJI

DO NOT COPY

EMIN RIZA: «LA VILLE-MUSÉE DE GJIROKASTËR» (Monographie)
Maison d'édition «8 Nëntori», Tirana 1981, 348 pages avec 181 photos et LIX tableaux d'esquisses et de planimétries.

RESUME

L'architecture de Gjirokastër laisse des impressions profondes à quiconque visite cette ville. Elle attire l'attention particulière des constructions, leur originalité, la monumentalité de maints ensembles, les solutions compositionnelles réussies, la parfaite adaptation au terrain accidenté où elles se situent, ainsi que par tant d'autres aspects.

La monographie du chercheur Emin Riza qui vise à nous donner une présentation systématique des valeurs architectoniques de Gjirokastër, constitue une oeuvre à valeurs multiples, aidant le lecteur à mieux connaire et apprécier cette ville.

Après une brève introduction, qui donne un aperçu critique sur la bibliographie existante à propos de ce sujet soumettant les données sur lesquelles s'est basée l'étude, avec le chapitre intitulé: «La position et le développement de la ville dans le temps» (pages 8-15 de l'oeuvre), l'auteur nous introduit graduellement dans les problèmes qu'il va traiter. On y traite brièvement du terrain, du climat, du développement historique de Gjirokastër depuis ses débuts (XIIIe siècle) jusqu'au XIXe siècle.

Dans le second chapitre «L'urbanisme, la citadelle et les constructions sociales» (pages 14-49) en appréciant la composition de la ville comme un facteur évoluant plus lentement que l'architecture, laquelle concerne les unités particulières de construction et change plus vite, l'auteur soumet une série de constatations d'intérêt sur ses deux questions.

La principale contribution apportée par cette oeuvre est sans doute le troisième chapitre, intitulé «L'habitation de Gjirokastër, le programme, la typologie, les éléments compositionnels, architectoniques et constructifs, lequel est une présentation large et analytique (pages 50-203) d'un matériel documentaire très riche classifié de façon claire et convaincante. Le chapitre est imprégné de l'effort visant à voir les éléments constituants de cette habitation, non isolément mais dans leur action réciproque en tant que manifestations d'une réalite historique déterminée. Le passage qui parle de l'habitation en tant que reflet du mode de vie, présente beaucoup d'intérêt.

Il découvre avec perspicacité ce qui il y a de particulier dans l'habitation de Gjirokastër différemment aux habitation d'autres villes, rattache ces différences tout d'abord à de facteurs de classe et spécifiques de cette ville, et ensuite à des facteurs de terrain, de climat etc.

Dans ce passage l'auteur parle des relations de cette ville avec la campagne, du caractère fermé de l'économie familiale prouvé par l'aménagement dans l'habitation de pièces spéciales en vue de conserver les aliments, d'écuries pour les bêtes de somme et de multiples citernes en raison du manque sensible d'eau potable dans la ville etc.

Ensuite l'auteur nous introduit dans l'essentiel des problèmes de cette monographie: dans les parties consacrées au développement typologique et chronologique de l'habitation de Gjirokastër.

Sur la base d'une connaissance profonde et multilatérale du matériel, ou plutôt de la ville même, Emin Riza, s'appuyant sur l'élément le plus solide, la composition de l'habitation, a pu mettre en relief l'unité de base de sa composition planimétrique et volumétrique et les variantes de son développement ultérieur. Cette unité, c'est la variante verticale à un ou à deux étages avec une planimétrie de forme rectangulaire. Au rez-de-chaussée se trouve l'étable ou la citerne, le premier étage a une seule pièce habitée, laquelle, dans les formes les plus évoluées, se divise en trois unités situées l'une après l'autre. Cette variante atteint sa pleine évolution quand elle devient à deux étages, l'étage supérieur étant habité pendant l'été ou étant reservé aux amis. Une telle habitation de deux étages revêt aussi des traits défensifs. C'est la forme qui fait penser le plus à l'habitation rurale des zones de Labëri. Il est évident qu'une telle relation est d'une grande importance pour la genèse aborigène de la typologie de l'habitation urbaine de Gjirokastër.

L'auteur nous donne aussi la chronologie de la variante à un étage, en la datant du XIVe siècle en se basant sur ses analogies avec les constructions en ruine du village de Kamenice, dans l'Albanie du Sud. Quant à la sous-variante à deux étages il pense qu'elle à dû être créée au moins dès le début du XVIIIe siècle.

DO NOT COPY

Ensuite l'auteur analyse la variante la plus répandue, celle de l'habitation à une aile. Il y distingue trois sous-variantes dans la formulation desquelles on sent clairement l'influence du terrain accidenté.

Avec la variante à deux ailes, l'habitation de Gjirokastër atteint ses formes les plus avancées avec une vue extérieure monumentale, surtout à la partie centrale de la façade principale. Même dans ce groupe l'auteur distingue trois sous-variantes en donnant les principales caractéristiques qui les distinguent les uns des autres.

E. Riza établit des comparaisons d'intérêt avec les habitations d'autres centres urbains du pays en soulignant à cette occasion que toutefois «l'habitation de Gjirokastër se distingue par une typologie déterminée propre». Ainsi ses trois variantes sont unies par une seule conception, parce que, remarque l'auteur, elles sont composées d'une unité planimétrique constante qui est présente dans les trois variantes. La fonction particulière de chaque étage est aussi un autre facteur stable. L'auteur constate que pendant la deuxième moitié du XIX siècle, l'habitation de Gjirokastër enregistre quelques chengements, qui visent à souligner son caractère urbain, mais toutefois, on voit clairement qu'elle a déjà accompli son cycle de développement.

Après avoir analysé les trois principales variantes de l'habitation de Gjirokastër, l'auteur passe à l'examen de ses volumes constituants. Cet examen présente un intérêt particulier pour les ethnographes étant donné qu'il parle beaucoup du mode de vie.

L'examen des éléments architectoniques et constructifs, il le commence par la description des murs, des arcs et des voûtes des toits et des avant-toits, des planchers et.c. Une telle analyse est faite plus bas à propos des portes, des fenêtres et des placards, et l'auteur n'oublie pas de parler aussi d'une série d'autres éléments constructifs et architectoniques. Bref, presque rien n'a échappé à l'attention de l'auteur.

Dans le quatrième chapitre, L'habitation de Gjirokastër, ses caractéristiques et sa place *(pages 205-230) l'auteur reprend d'un regard général les résultats de l'analyse minutieuse soumises au troisième chapitre, en mettant en évidence ses caractéristiques, les plus fondamentales pendant la période de ses résultats les plus cristalisés (années 1800-1830).*

Quelques-uns de ses travaux de valeurs, E. Riza, les a dédiés aux problèmes importants qui se rattachent à la classification des habitations urbaines albanaises pendant le XVIIIe et le XIXe siècle ce qui lui a facilité sans doute la tâche constituant à déterminer la place qu'occuppe l'habitation de Gjirokastër dans l'architecture de l'habitation albanaise.

Dans la dernière partie du quatrième chapitre, en parlant de la genèse de l'habitation de Gjirokastër, l'auteur rejète les idées de Hahn et de Suffly qui cherchent ses racines dans les tours médiévales de Europe Occidentale, et souligne les relations évidentes entre les plus simples variantes avec l'habitation rurale des zones de collines et de montagnes environantes. Mais cette affirmation, à juste titre n'empêche point l'auteur de mettre en évidence les ressemblances qu'il a constatées entre ces habitations et celles de certaines zones du Sud des Balkans, bien qu'il soit de l'avis que dans ce sens, il reste encore beaucoup de travail à faire.

Le chapitre consacré à la protection et à la restauration de la ville-musée de Gjirokastër témoigne, on ne peut mieux, des grands soins du Parti du Travail d'Albanie et du pouvoir populaire pour la conservation de l'héritage culturel. D'autre part, l'auteur nous dit que dans ce domaine s'effectue un travail sérieux appuyé sur des critères scientifiques et que le travail de restauration est considéré comme un travail de grande responsabilité qui doit être devancé par l'étude attentive du monument qui va être restauré.

L'auteur conclut la monographie par les caractéristiques fondamentales d'une série d'habitation (50 environ) qui sont mises en protection dans cette ville.

L'oeuvre intitulée: La ville-musée de Gjirokastër témoigne de la profonde préparation idéologique et professionnelle de l'auteur. Il n'a jamais considéré les phénomènes de la construction détachés du contexte économique et social de la ville mais comme une réalité de laquelle il a pu tirer des jugements valables sur la société urbaine du XIX siècle l'échelle de son émancipation, le niveau des exigences de la vie etc.

Toute la monographie que nous sommes en train d'analyser témoigne que l'auteur connaît très bien le matériel dont il écrit, il manoeuvre librement avec lui et ainsi en examinant les parties particulières ou les éléments constituants, il ne perd pas de vue le tout, les analyses minutieuses sont suivies des passages de synthèse.

Emin Riza écrit cette monographie après la publication d'une série d'articles d'étude dans notre presse scientifique, non seulement sur Gjirokastër mais aussi sur des questions générales de l'architecture de nos villes. Ces études en général sont bien accueillie et appréciées par la critique scientifique aussi bien à l'intérieur du pays qu'à l'étranger, de même l'album illustré sur la ville musée de Gjirokastër qui dans un certain sens peut être considéré comme une partie constituante de la monographie en question. Toutes ces publications prouvent que nous avons à faire à un auteur sérieux et un chercheur passionné de l'héritage culturel du peuple albanais. Avec son oeuvre «La ville-musée de Gjirokastër» il apporte une précieuse contribution dans les études de l'habitation albanaise.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

JETA SHKENCORE

1. SESIONI I IV SHKENCOR I INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

Më 22 Dhjetor 1980, Instituti i Monumenteve të Kulturës, mbajti Sesionin e IV Shkencor. Ky sesion u zhvillua në kuadrin e 15 vjetorit të krijimit të këtij institucioni të rëndësishëm për gjurmimin, studimin dhe restaurimin e vlerave arkitektoniko-artistike të krijuara nga populli ynë gjatë shekujve.

Tematika e Sesionit të IV, përfshinte mbarë fushat e veprimtarisë kërkimore-restauruese të Institutit, për periudhën që prej Sesionit të III, të vitit 1975. Në sesion krahas referatit «Puna kërkimore-restauruese të ngrihet në nivelin e kërkesave të kohës» mbajtur nga drejtori i Institutit, Sotir Kosta pati 28 kumtesa, prej të cilave 7 të përgatitura nga bashkëpunëtorët e jashtëm.

Referati, trajton problemet e përgjithshme të punës gjurmuese dhe studimore restauruese, duke u ndalur në përforcimin e mëtejshëm të fizionomisë së Institutit, i cili gjatë periudhës pesëvjeçare 1975-1980, ka shënuar rritje të rëndësishme cilësore dhe sasiore në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij. Referati përshkohet nga fryma e vendimeve të Pleniumit të 8-të të K.Q. të PPSH, i cili hapi horizonte të reja në thellimin e punës studimore.

Referati nxjerr në pah arritjet e Institutit në mbarë fushat e veprimtarisë së tij. Një rëndësi e veçantë i kushtohet në të arritjeve në punën për gjurmimin e monumenteve të rinj. Në të vihet në dukje se një sukses i rëndësishëm i Institutit është përfundimi i gjurmimit dhe vënies në mbrojtje të ndërtimeve fshatare, duke plotësuar këtu një detyrë sa të vështirë aq edhe të rëndësishme.

Puna studimore restauruese gjithashtu ka arritur gjatë këtyre viteve një zgjerim dhe thellim të madh në mbarë gjinitë e ndryshme të monumenteve që prej atyre antike dhe deri në monumentet që lidhen me ngjarje të Luftës Nacionalçlirimtare.

Instituti gjatë këtij pesëvjeçari ka zhvilluar një veprimtari të gjerë botuese. Në radhë të parë duhet shënuar botimi i maketit të «Historisë së arkitekturës shqiptare (prej fillimeve deri në vitin 1921)» e cila përbën një kontribut me vlerë të madhe për studimin e trashëgimisë sonë arkitektonike. Botimi «Monumentet», i kthyer në vitin 1980 në revistë, ka vazhduar daljen e tij të rregullt në dy numëra në vit, duke rritur përherë e më tepër nivelin. Botimet shkencore-popullore, albumi «Gjirokastra qytet-muze» dhe «Kruja dhe monumentet e saj» janë një kontribut i mirë për popullarizimin e monumenteve. Dhënia në shtyp e dy monografive «Qyteti-muze i Gjirokastrës» dhe «5000 vjet fortifikime në Shqipëri», çelin serinë e monografive duke shënuar një rritje të gamës së botimeve.

Së fundi në referat theksohet, se detyrat e së ardhmes janë të mëdha, por me udhëheqjen e vazhdueshme të Partisë, dhe me përvojën e fituar këto detyra janë plotësisht të realizueshme.

Shpresa Prifti – Zona-muze e qytetit të Shkodrës dhe restaurimi i saj. Në këtë kumtesë parashtrohen që pari kriteret e ndjekura për vënien në mbrojtje të një zone me vlera urbanistiko-arkitektonike, të cilat çuan në shpalljen zonë-muze të rrugëve «Enver Hoxha» dhe «Branko Kadia», ndërsa zonë e mbrojtur një pjesë e rrugës «Luigj Gurakuqi». Tërësia e këtyre rrugëve, në lidhje me njera tjetrën, jep një kuadër të mirë të

karakterit urbanistiko-arkitektonik të Shkodrës që prej fundit të shekullit XVIII deri rreth fillimit të shekullit XX. Në këtë ansambël të vënë në mbrojtje, një vend me rëndësi zenë dyqanet në katin përdhe të ndërtimeve në të dy rrugët e zonës-muze. Autorja, në fund të kumtesës ndalet mbi problemet e restaurimit të ansamblit të rrugës «Enver Hoxha», punimet në të cilën tashmë kanë filluar.

Gj. Karaiskaj — Një paraqitje e ndërtimeve ushtarake të Ali Pashë Tepelenës në Shqipëri dhe disa tipare arkitektonike të tyre.

Fillimisht autori trajton shkaqet politike të lindjes së fortifikimeve të Ali Pashës dhe pozitën e tyre përkatëse. Në të shqyrtohen Kështjella e Mahallasë (rrethi i Sarandës), dy kështjellat në kanalin e Vivarit (Butrint), ajo e Libohovës, e Shën Triadhës (rrethi i Gjirokastrës), e Porto Palermos, e Tepelenës dhe e Gjirokastrës. Përveç datimit, arkitekturës dhe teknikës së kështjellave të veçanta, autori grupon dhe shqyrton karakteristikat e përbashkëta të këtyre fortifikimeve duke i kushtuar vëmendje pajisjes me artileri. Në këtë drejtim ai i sheh ato të ndërtuara në përputhje me arritjet e kohës, por dhe me veçoritë që i dallonin nga fortifikimet e tjera bashkëkohëse, veçanërisht lidhur me shfrytëzimin e mbrojtjes natyrale.

Lazër Papajani — Punimet e restaurimit në qytetin antik në Klos dhe Hekal.

Në kumtesë trajtohen së pari punimet e restaurimit që janë ndërmarrë në një trakt të murit rrethues në qytetin e Klosit. Mbasi jepen rezultatet dhe metodika e ndjekur, përcaktohet dhe arkitektura e hyrjeve, kryesorja e tipit tangencial. Mbylljen e saj autori e daton gjatë fillimit të pushtimit romak dhe e sheh atë të lidhur me një dobësim të qytetit. Në të kundërt në Bylis autori sheh një jetë intensive deri nga fundi i antikitetit. Në këtë qytet u kryen punime resaturimi në «Portën për Klos»: Së pari pastrimi e më tej anastilosa. Kjo gjë dha mundësi për një përfytyrim më të mirë të pamjes së dikurtë. Pjesët e harkut dhe vrimat e trarëve tregojnë se ajo ka qënë kullë-hyrje.

Valter Shtylla — Në gjurmët e rrugës së vjetër Durrës-Fushë e Tiranë-Dibër.

Në këtë kumtesë u trajtua rruga që kalonte nga Durësi nëpërmjet fushës së Tiranës-Brrarit-Shupalit-Qafë Murrizës-Gurit të Bardhë-Grykës së Bulqizës dhe dilte në Dibër të Madhe. Duke u mbështetur në praninë e disa pikave të hershme si kalaja e Xibrit, ajo e Tujanit dhe toponimeve si mansio, etj. autori i sheh fillimet e kësaj rruge që në antikitet. Po kështu duke shfrytëzuar burimet historike dhe të dhënat gojore ai rreh të japë funksionimin e saj në mesjetë. Më tej jepen gjurmët materiale të kësaj rruge sipas itinerarit duke j'ua nënshtruar shqyrtimit arkitekturor. Në këto gjurmë hyjnë një sërë urash të gurta me hark si ura e Brrarit në të cilën shihen dy faza, të shekullit XVI-XVII dhe fundit të shekullit XVIII fillimit të shekullit XIX, ura e Vashës mbi lumin Mat, e fundit të shekullit XVIII fillimit të shekullit XIX si dhe urat e Hoxhës, Skurës dhe e Kulmares në Gurë të Bardhë, të shekullit XVIII. Krahas urave autori shqyrton edhe disa kalldrëme të ruajtuar si ai te ura e Vashës dhe në Qafë Murrizë, ky i fundit i shekujve XII-XIV.

Ilia Papanikolla — Masat e marra nga mjeshtërit popullorë kundër lagështisë që mund të depërtojë në ndërtesë (Gjirokastër).

Mbi bazën e një vrojtimi të kujdesshëm, në këtë kumtesë janë paraqitur zgjidhjet e ndryshme, të cilat kanë bërë që të mënjanohet depërtimi i lagështisë në banesat e Gjirokastrës. Së pari trajtohen problemet e mbulimit të çatisë, formave të strehëve, etj. Interes i është kushtuar oxhakëve, të cilët në pjesën mbi kulm trajtohen në formë deflektori. Ndërtimi i muraturës me llaç vetëm në dy faqet, duke mbetur pjesa qendrore e thatë, shpjegohet me synimin për të penguar depërtimin kapilar. Kujdes i kushtohet dhe largimit të ujërave sipërfaqsorë nga ana e prapme e ndërtesës. Autori ndalet në mënyrën e hidroizolimit të sterave si dhe probleme të tjera të kësaj natyre, të cilat hedhin dritë mbi njohuritë e gjera teknike të mjeshtërave të talentuar popullorë.

Frederik Stamati — Përdorimi i rrezeve X në ndihmë të restaurimit dhe studimeve arkeologjike.

Në këtë kumtesë autori trajton problemin e mënyrës së përcaktimit të mbetjes së bërthamave të padukshme nën shtresën e ndryshkut, e domosdoshme kjo në zbatimin e metodës së reduktimit elektrolitik. Autori ndalet edhe mbi mënyrën e nxjerrjes së motiveve krejtësisht të padukshme nga objektet arkeologjike, gjithashtu duke përdorur rrezet X.

Stilian Adhami — Monumentet historike, restaurimi dhe përdorimi i tyre. Autori ndalet në karakterin dhe vlerën e këtyre monumenteve, duke dhënë edhe rrugën për vënien në mbrojtje të tyre. Më pas, autori ndalet në kriteret për restaurimin e tyre, të cilat për vetë natyrën e këtyre monumenteve paraqesin disa veçanti. Së fundi trajtohet problemi i rëndësishëm i përdorimit të tyre në jetën e sotme.

Leonard Suli — Banesa e vjetër fshatare e zonës së Vurgut dhe

BOOK COPY

problemet kryesore për restaurimin e tyre.

Në këtë kumtesë, mbi bazën e materialeve të mbledhura gjatë ekspeditave gjurmuese dhe dokumentuese në këtë zonë, jepet një panoramë e përgjithshme e tipologjisë së banesës së kësaj zone, pa lënë mënjanë karakterin e vendbanimeve. Objekt trajtimi janë dhe tiparet në planin konstruktiv të ndërtimeve, si dhe parashtrimi i nevojave dhe llojit të ndërhyrjes restauruese në këta monumente. Në planin tipologjik, autori dallon tre variante të banesës së bujkut çifçi. Më pas autori paraqet karakteristikat e banesës përdhese, asaj me gjysmë kat dhe banesës me kat.

Fatbardha Shkupi — Zbukurimorja e ndërtimtarisë në qytetin e Elbasanit.

Autorja trajton përmbledhurazi rezultatet e para të një pune të gjerë gjurmuese lidhur me zbukurimoren në qytetin e Elbasanit, si në banesat ashtu dhe në ndërtimet e kultit. Ajo ndalet në paraqitjen e tiparave kryesore të brendive në banesat e shekullit XVIII-XIX, duke prekur elementet e ndryshëm arkitektonikë si tavane, musandra, tymtarë, rafte muresh, dyer, dritare, etj. Një kontribut me rëndësi jepet në këtë kumtesë me identifikimin e disa prej mjeshtërve më të shquar popullorë, vepra e të cilëve është ndjekur me kujdes në këtë qytet, duke u përcaktuar njëkohësisht si përsa i përket repertorit ashtu edhe vlerave të saj.

Vili Kamsi — Një kishë e stilit romanik-gotik në Shqipërinë e Veriut, Kisha e Shirgjit.

Autori pasi ve në dukje rolin ekonomik të Shirgjit si skelë e doganë, kalon në shqyrtimin e mbishkrimeve ndërtimore të kishës duke mbajtur qendrim ndaj leximeve të derisotme. Në kumtesë jepet gjendja e sotme e kishës, shkaqet e kohët e rrënimit dhe shqyrtimi arkitektonik i saj, duke hequr paralele me qendrat e tjera si në Shqipëri ashtu dhe jashtë. Autori ve në dukje se në të dy anët e Adriatikut nuk pati një zhvillim të thjeshtë të arkitekturës gotike, por një shartim të sajin me romanikun. Autori i mëshon faktit se rindërtimi i kishës në vitin 1318, pas ndërtimit të parë të vitit 1290, i takon ndërtuesit shkodran Pjetër Dohne, dhe ve në dukje dhe se kishat e Shirgjit, Shkodrës, Shtojit, etj. paraprinë të quajturën «shkollë të Rashës».

Genc Samimi — Klasifikimi i banesave beratase, varianti i katërt i banesës me çardak dhe konceptet konstruktive të ndërtimit të kollonadës së çardakut dhe strehëve.

Në këtë kumtesë në radhë të parë trajtohet problemi i klasifikimit tipologjik të banesës beratase e cila grupohet në tre tipe: banesa me çardak, banesa me gjysmëkat perpendikulare, banesa të adaptuara ose të rikonstruktuara mbi banesa të vjetra dhe banesa të ngritura në truall të ri. Autori paraqet krahas tre varianteve të njohur të banesës me çardak edhe një të katërt, të cilën e emërton me çardak të lirë. Së fundi ai ndalet mbi dy koncepte të ndryshëm konstruktivë në trajtimin arkitektoniko-konstruktiv të kollonadës së ballit të çardakut, me pajanta dhe me strehë dyfishe, prej të cilëve sheh si më të vjetër konceptin e parë.

Faruk Zarshati — Disa tipare të banesës qytetare tiranase në fillim të shekullit XX.

Autori trajton një problem pak të rrahur deri më sot, atë të tipareve të banesës qytetare tiranase në fillim të shekullit XX, tipare këto që nga ana kompozicionale, gjatë kësaj kohe, kanë një shtrirje të gjerë në mbarë qytetet tanë. Së pari ai ndalet në shkaqet e përhapjes së shpejtë të kësaj banese në qytetin e Tiranës, lidhur kryesisht me caktimin e kësaj qendre kryeqytet. Më tej kumtuesi ndalet mbi variantet e ndryshme të kësaj banese, përdhese dhe me kat, si në planin e kompozimit ashtu edhe në atë të trajtimit arkitektonik. Një kujdes i veçantë i është kushtuar trajtimit e përpunimit arkitektonik të pamjeve kryesore me teknikën e suvasë. Autori ndalet edhe në problemin e teknikës së ndërtimit.

Mark Tirtja — Mbi origjinën e disa motiveve në gurgdhendje në shtëpitë fshatare shqiptare.

Objekt i kësaj kumtese janë motivet e ndryshme simbolike në pjesë të ndryshme të banesave popullore fshatare. Autori i ndan këto motive në dy grupe: me origjinë të lashtë e burim vendas dhe me origjinë të huaj. Krahas tyre ka edhe motive të shartuara. Autori më pas ndalet në paraqitjen e disa motiveve me origjinë të lashtë si: gjarpëri e dora. Krahas tyre jepen motive më të reja si takëmet e kafesë, armët, shqiponja me dy krerë, etj. Autori ndalet si në domethënien e këtyre motiveve, ashtu edhe në mënyrën e realizimit dhe pjesën e banesës ku vendosej. Përfundimisht vihet në dukje uniteti i motiveve të vjetra dhe spikatja në mënyrë të veçantë e temave me origjinë të lashtë vendase.

Avenir Sadikaj — Restaurimi i kishës së Shën Todrit — Berat.

Në këtë kumtesë trajtohen punimet e restaurimit të kryera në këtë monument, i cili ruan afreska të shekullit XVI, punuar nga Onufri. Autori ndalet mbi fazat e ndryshme që ka kaluar monumenti si në arkitekturë ashtu edhe në pikturë. Më pas autori ndalet hollësisht jo vetëm mbi kriteret udhë-

DOKTORI

DO NOT COPY

heqëse të ndërhyrjeve restauruese, por edhe mbi teknikën, mënyrën dhe shkallën e ndërhyrjes. Përfundimisht autori vëren se pas pushtimit turk në Berat, jeta qytetare rifilloi rrugën e vet, por ndërtesat e kultit tashti ngriheshin më modeste. Berati bëhet një qendër e rëndësishme e pikturës ku piktorët vazhdojnë një traditë të konsoliduar gjatë shekujsh. Onufri e çoi më tej këtë traditë duke ndikuar me talentin e tij te një varg krijuesish të njohur dhe anonimë. Në Shën Todër gjenden afresket më të hershme të Onufrit, të cilat afrohen me pikturën e ikonave.

Latif Lazimi — Një vështrim urbanistiko-arkitektonik i lagjeve brenda kalasë.

Lagjet brenda mureve rrethuese të disa kalave të vendit tonë, si ajo e kalasë së Bregdetit, Krujës dhe Elbasanit përbëjnë objektin e kësaj kumtese. Autori ndalet në karakterizimin e përgjithshëm urbanistik të këtyre ansambleve të cilët janë ndikuar dukshëm nga muret rrethuese dhe hyrjet e këtyre ndërtimeve mbrojtëse. Më pas kalohet në karakterizimin e lagjes Kala, në Berat, e cila shquan jo vetëm për zgjidhjen urbanistike, por edhe për larminë e madhe të gjinive të ndryshme arkitektonike që ruan. Lagja e banuar brenda mureve rrethues të Kalasë së Krujës bëhet gjithashtu objekt studimi. Së fundi kumtuesi ndalet në karakterizimin e lagjes së banuar brenda mureve rrethuese të Kalasë së Elbasanit, e cila paraqet karakteristika të veçanta jo vetëm sepse shtrihet në truall të rrafshtë por edhe sepse forma e kalasë është e ndryshme nga ato të Beratit dhe Krujës.

A, Baçe—G. Pani — Theatri i Butrintit, arkitektura dhe punimet restauruese.

Në kumtesë trajtohet arkitektura e theatrit të Butrintit, vendi që ai zinte në urbanistikën e qytetit dhe fazat e ndërtimit. Në kumtesë shqyrtohen pjesët përbërëse të teatrit, shkallarja, orkestra, skena dhe ndërtimet mbi shkallare. Në të vihet në dukje veçantia e shkallares së fazës së parë e cila i brendashkruhet një konturi të jashtëm me mure mbajtës, dukuri kjo e veçantë pa ndonjë shembëlltyrë për shekullin e III-II p.e.r. Duke u bazuar në shqyrtimin tipologjik të skenës dhe në ruajtjen e mirë të shkallares autorët synojnë në një rikonstruksion ideal të teatrit. Krahas kësaj jepet gjendja e ruajtjes dhe restaurimit që janë kryer e do të kryhen në të.

Pirro Thomo — Vlerat urbanistiko-arkitektonike të qytetit të Korçës dhe zonifikimi i tij.

Autori i kumtesës ndalet mbi vlerat e kësaj qendre të rëndësishme për trashëgiminë urbanistiko-arkitektonike. Ai dallon dy faza të rëndësishme, në të parën përfshihet Korça e lidhur me mënyrën feudale të prodhimit, që karakterizohet nga urbanistika spontane. Faza e dytë lidhet me forcimin e shtresave zejtaro-tregtare që kushtet e lindjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste. Në planin urbanistik, lagjet e reja të Korçës shquajnë për një koncept të përparuar urbanistik për kohën. Gjithashtu edhe banesa e kësaj periudhe shquan për tipare të theksuara qytetare. Së fundi autori argumenton zgjerimin e zonës së mbrojtur, duke përfshirë në të një pjesë të mirë të lagjes qendrore të qytetit.

Hasan Nallbani — Disa ikona të panjohura të David Selenicasit dhe pasuesve të tij.

Në këtë kumtesë autori paraqet disa ikona të panjohura të cilat mbi bazën e analizës stilistike, i identifikon si vepra të piktorit tonë të njohur David Selenicasit dhe të pasuesve të tij. Kumtuesi ndalet mirë mbi secilën prej këtyre ikonave duke dhënë në mënyrë të hollësishme gjendjen dhe teknikën e tyre dhe duke i bërë interpretimin artistik që shërben dhe si bazë e identifikimit të tyre, identifikim ky me rëndësi pasi na njeh me një aspekt pak të njohur të veprës së njerit prej piktorëve më të shquar mesjetarë shqiptarë.

Fatmir Thaçi—Eduard Sopi — Të dhëna të reja të përftuara gjatë restaurimit të pikturës së xhamisë së Beqarëve në Berat.

Objektin e kumtesës e përbëjnë të dhënat e përftuara gjatë restaurimit të këtij monumenti. Së pari autorët mbi bazën e disa gjurmëve të dala në dritë gjatë restaurimit hedhin mendimin se kjo xhami duhet të jetë ndërtuar në shekullin e XVIII ndërsa data e saj që mbart viti 1827, i përket rikonstruksionit të saj dhe ndërtimit me këtë rast të hajatit nga Sulejman Pasha, i biri i Ibrahim Pashë Vlorës. Pas punimeve restauruese në afreskun e këtij monumenti, përfshirë konsolidimin, mbushjen e boshllëqeve dhe pastrimin e pikturës, autorët vunë re se pikturimi i jashtëm, nuk është i së njëjtës dorë me atë të brendshme dhe hedhin mendimin se jashtë ka punuar mjeshtëri ndërsa brenda nxënësit e tij. Së fundi në kumtesë bëhet një shqyrtim i pikturës, me vlera artistike.

Fatos Tartari — Arkitektura e një godine banimi të shekullit III-II p.e.r.

Në këtë kumtesë trajtohet arkitektura e një banese me oborr peristil të zbuluar në rrafshin e sipërm të kodrës me kuotë 59 m, në parkun e sotëm «Rinia». Sipas autorit banesa përfshihet brenda mureve rrethues të kohës së vonë antike, zhvillohet rreth një oborri të brendshëm të shtruar me mozaik dhe të qarkuar prej kolonash të stilit jonik. Banesa ka që-

POVO-COPY

në ndërtuar me tulla dhe e suvatuar në brendi. Autori duke u mbështetur në gjetjet, qeramikën dhe monedhat, e daton këtë banesë në shekullin e III-II p.e.s. Pozita, trajtimi arkitektonik, sasia e madhe e amforave të gjetura tregojnë se ajo i përkiste një familje të pasur. Nga shekulli i V p.e.s. banesa u përdor si varrezë, rol që e luajti dhe në mesjetë.

Emin Riza — Banesa fshatare dhe ajo qytetare në raportet ndërmjet tyre.

Në këtë kumtesë trajtohen dy çështje, së pari mbi kriteret për përcaktimin e termit banesë fshatare e banesë qytetare, dhe së dyti mbi raportet ndërmjet tyre. Lidhur me çështjen e parë si kriter themelor vendoset ai i natyrës së ekonomisë bazë që ushtronte familja, pra i njëjti kriter që dallon qendrat qytetare nga ato fshatare. Më tej autori ndalet mbi raportet e këtyre dy kategorive duke vërejtur se ato për arsye ekonomiko-shoqërore, paraqesin ndërlidhje të pabarabarta, jo vetëm për nga krahu i huazimeve apo ndikimeve, por edhe nga dendësia e tyre, duke përbërë bashkësi dinamike marëdhëniesh. Gjithashtu këto bashkëmarëdhënie nuk janë të njëjta në mbarë tipologjinë e banesës shqiptare, duke qënë të lidhura me shkallët e ndryshme të zhvillimit ekonomik të qyteteve tona, dukuri e kuptueshme në kushtet e ekonomisë së coptuar feudale.

Aleksandër Meksi — Arkitektura paleokristiane në Shqipëri.

Në këtë kumtesë jepet një panoramë e arkitekturës paleokristiane në Shqipëri në shekujt IV-VI. Vendin kryesor në këto ndërtime e zenë bazilikat e llojeve të ndryshme. Një grup të vogël por të rëndësishëm përbëjnë edhe kishat me planimetri qendrore, por nuk janë të pakta edhe kishat njënefshe. Autori pas analizës arkitektonike-artistike të këtyre veprave përfundon se këto ndërtime, krahas atyre të tjerave bashkëkohëse, dëshmojnë për zhvillimin e pandërprerë të traditës së mëparshme, e favorizuar kjo nga zhvillimi i mirë ekonomik i trevave të Ilirisë dhe Epirit, duke përbërë atë bazë ndërtimesh që i shërbyen si modele për periudhën pasardhëse.

Koço Zheku — Banesa fshatare me një kthinë banimi në Shqipëri.

Në këtë kumtesë autori synon të japë një paraqitje të banesës fshatare me një kthinë, mbi bazën e një materiali të gjerë të botuar deri më sot, duke i parë ato si pikënisje për mbarë tipologjinë e banesës fshatare shqiptare. Më tej autori analizon shembujt më përfaqësues përdhes dhe me një kat të kësaj banese fshatare në mbarë vendin duke filluar prej atyre me karakter sezonal. Banesën njëkthinëshe me kat, autori e ndan në tre grupe: banesën e hapur me hajat e çardak, banesën me shkallë të jashtme dhe banesën e mbyllur. Pas një paraqitjeje të një materiali të gjerë dokumentar, autori i kësaj kumtese arrin në përfundimin se banesat me një ambient banimi, përdhese apo me një kat kanë karakteristika të përbashkëta në mbarë vendin.

Robert Ballauri — Të dhëna për studimin e një kompleksi të banuar në zonën muze të Korçës.

Autori i kësaj kumtese ka si objekt shqyrtimin e një kompleksi të banuar që përbëhet nga dy ndërtime, njeri i vitit 1841, ndërsa tjetri i ndërtuar rreth viteve 1870. Autori analizon banesën e parë, e cila është një banesë tipike korçare, një zhvillim i mëtejshëm i banesës dykatëshe të emëruar e mbyllur. Ai thekson se elemente të arkitekturës së banesës së Voskopojës dhe Beratit janë prurë edhe në Korçë. Më tej autori shpjegon zhvillimin e erkerit në pjesën qendrore të banesës korçare. Ndërtimi i dytë trekatësh cilësohet nga autori si kullë. Së fundi në kumtesë trajtohen problemet e restaurimit të këtij kompleksi dhe ato të kthimit të tij në muze etnografik e folklorik.

Sotir Kosta — Vështrim mbi strukturën e mozaikëve tanë.

Në këtë kumtesë mbasi jepet një vlerësim i përgjithshëm i vlerave dhe shumëllojshmërisë së mozaikëve tanë, kalohet në konceptin ndërtimor të tyre. Autori vëren se në mozaikët tanë vërehen tre shtresa: tabani, i cili shpesh gjendet mbi një truall të niveluar mirë me kalldrëm të niveluar me llaç gëlqereje, i cili luan rolin e drenazhit, bërthama, me llaç gëlqereje, e copa tulle e gurësh dhe së fundi shtresa e mozaikëve vendosur mbi shtresë gëlqereje të staxhionuar. Autori pastaj ndalet mbi llojet e gurëve për formimin e mozaikëve për të cilët bën edhe një klasifikim. Mbi bazën e vrojtimeve nga përvoja e derisotme shpjegohen shkaqet e lidhjes së mirë ose jo të gurëve si dhe shkaqe të tjera që bien shkatërrimin e mozaikëve.

Apollon Baçe — Vështrim mbi urbanistikën e qytetit ilir.

Në kumtesë trajtohen problemet e lindjes dhe tipareve urbanistike të qytetit ilir. Autori e sheh lindjen e qytetit ilir në shekullin VI-V p.e.r. Më tej ai rreh të japë përkufizimin e qytetit të kësaj kohe si dhe faktorët e nevojshëm për lindjen e qytetit duke theksuar faktorin mbrojtës.

Në drejtim të trajtimit planimetrik të rrjetit rrugor në kumtesë veçohen tipi radiocentrik, ortogonal dhe trekëndësh duke sjellë shembujt përkatës për secilin tip. Më tej trajtohen tipi dhe zhvillimi

nga një qendër e përbashkët në qendra me funksione të veçanta. Urbanistika e periudhës së pushtimit romak shihet si vazhdim i urbanistikës së përparëshme duke sjellë ndryshime vetëm në trajtimin e siluetit. Në kumtesë trajtohen problemet lidhur me ndërhyrjet restauruese, veçanërisht në monumentet rrënojë.

Gjergj Frashëri – Fshati historik i Odriçanit.

Në kumtesë vihet në dukje se në Odriçan, pas punimeve të Kongresit të Përmetit si dhe së dyti pas operacionit armik të Qershorit, në shtator të vitit 1944 u vendosën Komiteti Qendror i P.K.SH., kryesia e K.A.N.Ç.-it dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me shokun Enver Hoxha në krye. Krahas këtyre vlerave historike, Odriçani, paraqet interesedhe në fushën e arkitekturës popullore. Punimet e restaurimit të filluar në këtë fshat, të cilat do të vazhdojnë më tej, do ta kthejnë këtë qendër në një monument me vlerë për edukimin patriotik e revolucionar të masave.

2. MAKETI «HISTORIA E ARKITEKTURËS SHQIPTARE (deri në vitin 1912)»

Në përgjigje të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, kolektivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës hartoi maketin e «Historisë së arkitekturës shqiptare (deri në vitin 1912)». Kapitujt dhe nënkapitujt e veçantë të maketit, përveç diskutimit nga grupi i autorëve, iu nënshtruan një diskutimi të gjerë në Institutin e Monumenteve të Kulturës, ku u ftuan arkitektë, pedagogë të katedrës së arkitekturës pranë Universitetit të Tiranës, arkeologë, etj. të cilët ndihmuan me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Në nëntor të vitit 1980 maketi doli nga shtypi.

Botimi i hartuar prej një kolektivi prej pesë autorësh: A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, ka 655 faqe të formatit 70 x 100/8, me 398 tabela me ilustrime. Aparati ilustrativ përmban 1026 skica, planimetri, prerje, pamje, vizatime aksonometrike e perspektive, rilevime topografike, etj. si dhe 787 fotografi.

Materiali pararendet nga një hyrje në të cilën parashtrohen vlerat dhe rëndësia e trashëgimisë arkitektonike të popullit tonë si dhe kushtet historike në të cilat lindi dhe u zhvillua kjo arkitekturë. Trashëgimia arkitekturore në këtë kapitull shihet si një nga shfaqjet më konkrete të nivelit të zhvilimit



ekonomik dhe shoqëror të epokave dhe fazave të ndryshme të ecurisë së etnosit tonë, e cila përmban vlerën e padyshimtë të dokumentit historik në shkallën më të lartë të vërtetësisë së tij.

Në hyrje trajtohet dhe gjendja e studimeve për trashëgiminë arkitekturore të vendit tonë duke theksuar hopin cilësor që pësuan ato në vitet e Çlirimit qoftë në gjerësi, qoftë në thellësi. Botimet e shumta në revistat shkencore «Monumentet», «Etnografia shqiptare», «Iliria», e «Studime historike» kanë prekur të gjitha gjinitë dhe periudhat e ndërtimeve, duke mundësuar kështu paraqitjen të rësore dhe sintezën e historisë së arkitekturës shqiptare.

Botimi është i pajisur me bibliografinë e punimeve shkencore në të cilën përfshihen artikuj dhe punime që trajtojnë historinë e arkitekturës shqiptare, në masën dërmuese të pas çlirimit. Përveç saj në të jepet dhe një fjalor shkurtër terminologjik me shpjegimin e emërtimeve më të përdorura, si ndërkombëtare ashtu dhe lokale. Maketi i historisë së arkitekturës ndahet në pesë kapituj të veçantë. Kapitulli i parë trajton ndërtimet prehistorike, fortifikimet banesat dhe tumat, fushë kjo e paprekur nga studimet e paraçlirimit. Në të shqyrtohet arkitektura e këtyre ndërtimeve, bashkësim arkitektonik në trevat e banuara nga ilirët si dhe tiparet dalluese.

Arkitektura e shekujve V-II p.e.s. që përkon me zhvillimin e qyteti dhe shtetit ilir shqyrtohet në kapitullin e II. Në të trajtohen fortifikimet, urbanistika dhe banesat ndërtimet shoqërore (teatro, tempuj, shetitore, stadiume, ndërtime sepulkrale), dhe ndërtimet inxhinierike (urat, veprat hidrike, kanalizimet). Arkitektura e këtyre ndërtimeve që shquhen për nivelin e lartë arkitektonik shihet s pasojë e zhvillimit të brendshëm

DO NOT COPY

ekonomiko-shoqëror, si vepër e vetë mjeshtrave vendas. Në këtë drejtim duke e pranuar fenomenin e huazimit nga thesari i arkitekturës së përparuar bashkëkohëse mesdhetare, vihen në dukje dhe specifikat e tiparet e saj dalluese si në trajtimin planimetrik e hapësinor, ashtu dhe në detajet e veçanta arkitektonike.

Kapitulli i III, trajton arkitekturën në shekujt e I p.e.s. – VI e.s., periudhë gjatë së cilës Iliria u ndodh nën pushtimin romak dhe më tej bizantin. Në këtë kapitull shqyrtohet arkitektura e fortifikimeve, urbanistika, banesat, tempujt, teatrot dhe amfiteatrot, banjat publike, rrugët dhe urat, ujësjellësit dhe ndërtimet e kultit kristian. Ndërtimet e mësipërme që shquhen për nivelin e lartë teknik, shihen si vazhdime të traditave ndërtimore të periudhës së mëparëshme.

Kapitulli i IV, ka për objekt ndërtimet gjatë shekujve VII-XV, mesjetës së hershme dhe të mesme që pasqyrojnë kushtet e reja ekonomiko-shoqërore, vendosjen e marrëdhënieve feudale dhe krijimin e kombësisë shqiptare. Në të trajtohen fortifikimet dhe ndërtimet e kultit kristian, arkitektura e të cilëve shihet në një hap me ndërtimet e tjera bashkëkohëse, madje në disa raste me krijime të pavarura specifike. Në të trajtohet, për aq sa na lejojnë gjurmët, dhe urbanistika e banesa e bashkëkohëse.

Në kapitullin e fundit, të pestin, trajtohet arkitektura nga shekulli i XV deri në vitin 1912, që përkon me mesjetën e vonë dhe lindjen e marrëdhënieve kapitaliste. Ky kapitull ndahet në dy nënpjesë. Në të parën shqyrtohet arkitektura e ndërtimeve të kultit, kristian dhe mysliman, të para në një vazhdimësi formash e teknikash nga periudha e mëparëshme, banjat, kullat e sahateve, dhe urat, si ndërtime të lidhura me ecurinë ekonomiko-shoqërore si dhe fortifikimet. Një trajtim i gjerë i bëhet në këtë kapitull ndërtimeve të lidhura me pashallëqet e mëdhenj shqiptare.

Nënpjesa e dytë trajton banesën qytetare dhe fshatare të këtyre shekujve. Këto banesa pasi i nënshtrohen shqyrtimit tipologjik klasifikohen në tipe dhe variante duke ndjekur zhvillimin e tyre të brendshëm në pasqyrim të kushteve ekonomiko-shoqërore. Banesa fshatare trajtohet sipas njësish të mëdha me tipare të përbashkëta tipologjike.

Maketi do t'i nënshtrohet një diskutimi të gjerë ku do të marrin pjesë arkitektë, urbanistë, inxhinierë ndërtimi, historianë, arkeologë, punonjës të ndryshëm të kulturës, studentë etj. Ky diskutim do të ndihmojë për të shmangur të metat dhe për të ngritur më lart nivelin shkencor.

«Historia e arkitekturës shqiptare» që do të hartohet mbi bazën e maketit, pas diskutimeve, do t'u shërbejë masave të gjera të interesuara për trashëgiminë kulturore të popullit tonë, projektuesve për vënien e arkitekturës socialiste gjithmonë e më tepër në tabanin kombëtar. Njëkohësisht ajo do të shërbejë si tekst mësimor për studentët e degës së arkitekturës në Universitetin e Tiranës.

Maketi dhe hartimi përfundimtar i «Historisë së arkitekturës shqiptare» ndihmojnë që të dalë më në pah vitaliteti dhe aftësia krijuese e popullit tonë. «i cili ka krijuar vepra të mrekullueshme duke dhënë kontributin e tij dhe në thesarin e kulturës botërore».

3. MBROJTJE DISERTACIONESH TË SHKALLËS SË I-rë TË KUALIFIKIMIT

Më datë 25.XII.1980 në një nga sallat e Universitetit të Tiranës, Këshilli Shkencor i fakultetit të Inxhinierisë mori në shqyrtim tre disertacione të përgatitura nga punonjës të Institutit të Monumenteve të Kulturës, në kërkim të gradës shkencore «Kandidat i shkencave». Në mbrojtjen e tyre merrnin pjesë prof. A. Buda, Kryetar i Akademisë së Shkencave të R.P.S.SH, prof. B. Daja, Zv. rektor i Universitetit të Tiranës për anën shkencore, Dr. F. Shehu, dekan i fakultetit të Inxhinierisë, Drejtori i I.S.P. Nr. 1, arkitekt, S. Moska, punonjës të fakultetit të Inxhinierisë, Institutit të Monumenteve të Kulturës, I.S.P. Nr. 1, inxhinierë, arkitektë, studentë të degës së arkitekturës dhe historisë.

Të tre disertacionet trajtonin probleme të historisë së arkitekturës së vendit tonë dhe restaurimit të tyre. Disertacioni i parë i përgatitur nga E. Riza, me udhëheqës bashkëpunëtorin e vjetër shkencor arkitektin G. Strazimiri dhe oponentë doc. K. Mihon dhe P. Thomon me temë «Qyteti-muze i Gjirokastrës», ka për objekt karakterin, tipologjinë dhe evolucionin e vlerave arkitektonike të qytetit-muze të Gjirokastrës, si dhe kriteret dhe punën restauruese që kryhet në këtë qendër të rëndësishme të kulturës shqiptare.

Së pari disertacioni shtjellon probemin e lindjes dhe zhvillimit të qytetit të Gjirokastrës, i cili ka pasur si zanafillë Kalanë. Aty rreth gjysmës së parë të shekullit XIV fillon procesi i lindjes së qytetit të hapur, i cili veçanërisht gjatë shekullit XVI, rritet me shpejtësi. Në

POOR COPY

shekujt e mëvonshëm ky proces është në ngritje të vazhdueshme. Rreth fillimit të shekullit XVII, pazari zhvendoset në zonën ku ngrihet sot e kësaj dite, duke u rindërtuar thuajse tërësisht gjatë fundit të shekullit të kaluar. Pushtimi i qytetit nga Ali Pashë Tepelena, lidhet me punimet e rëndësishme të rindërtimit të kalasë, si dhe ndërtimin e ujësjellësit të kalasë dhe mjaft banesave me vlerë në qytet.

Ndërtimet shoqërore e të kultit janë përgjithësisht të pakta në Gjirokastër, ku banesa me karakterin e fortë monumental i jep tonin mbarë qytetit.

Disertacioni trajton gjerë banesën gjirokastrite, si, një tip i veçantë në kuadrin e banesës shqiptare. Studimi tipologjik i saj, ze një vend me rëndësi. Në kuadrin e tipologjisë së kësaj banese dallohen tre variante: varianti perpendikular, varianti me një krah dhe varianti me dy krahë. Brenda tyre ndeshet një larmi e madhe nënvariantesh, pa përjashtuar kompozimet që duhen mbajtur si zgjidhje të veçanta. Morfologjia e banesës gjirokastrite tregon qartë për lidhjen e padyshimtë gjenetike ndërmjet varianteve të saj. Të gjitha këto forma të ndryshme i bashkon një koncept i vetëm. Kjo vazhdimësi dhe larmi formash janë të dhëna me rëndësi për të treguar se këtu kemi një ecuri të ndryshme të kësaj kategorie arkitektonike, e cila duke u kushtëzuar në radhë të parë nga kushtet ekonomiko-shoqërore, shfaqet që prej formave të thjeshta deri në ato më të zhvilluarat.

Teknika e ndërtimit dhe trajtimi i zhvillimit në kohë i elementeve të ndryshëm arkitektonikë ze një vend të mirë në disertacion. Më pas shtjellohet natyra ekonomike e kësaj qendre dhe karakteri disi i veçantë i saj, i cili qendron në bazën e karakterit të banesës. Karakteristikat e këtij tipi, si në planin kompozicional, ashtu edhe në plane të tjera paraprijnë, trajtimin e vendit të banesës gjirokastrite në kuadrin e banesës shqiptare.

Gjeneza e banesës gjirokastrite shihet në lidhje të ngushtë me banesën malore shqiptare me gjysmëkat, e cila gjeti kushte të përshtatshme për një zhvillim relativisht të shpejtë në Gjirokastër. Kjo shihet qartë në planin kompozicional, ndërsa në atë të trajtimit të brendësisë, banesa gjirokastrite jeton në një kontekst më të gjerë.

Trajtimi i problemeve të restaurimit të qytetit-muze dhe veçanërisht i banesës, së bashku me përshkrimin analitik të shembujve më përfaqësues të banesës gjirokastrite, mbyll disertacionin.

Disertacioni i dytë «Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Shën Kollit në Mesopotam të Sarandës» i përgatitur nga Aleksandër Meksi, me openentë bashkëpunëtorin e vjetër shkencor G. Strazimirin dhe P. Thomon, ka për temë një ndër monumentet më të rëndësishëm të arkitekturës sonë mesjetare që studiohet si në aspektin arkitekturral ashtu edhe në atë të restaurimit.

Në pjesën e parë trajtohet më vehte arkitektura bizantine gjatë shekujve XI-XIV në Shqipëri, pa njohjen e së cilës është vështirë të përcaktohet vendi i monumentit objekt i disertacionit, si në tërësinë e arkitekturës mesjetare shqiptare, ashtu dhe në atë të arkitekturës bizantine bashkëkohëse në tërësi. Nëpërmjet shtjellimit të monumenteve të paraqitura në rend kronologjik sipas një klasifikimi tipologjik (kisha njënefshe dhe kisha në formë kryqi me kupolë) shqyrtohet kjo pasuri me vlerë arkitektonike të madhe dhe nëpërmjet analizës së tërësisë arrihet në nxjerrjen në pah të karakteristikave të përgjithshme të saj dhe në përcaktimin e lidhjeve me arkitekturën e vendeve fqinjë, nda të cilës monumentet tona zenë një vend më vehte dhe nuk mbeten prapa në pikëpamje të nivelit.

Pjesën më të madhe të studimit e ze shqyrtimi i kishës së Mesopotamit. Ai fillon me paraqitjen e metodës, të rrugës së përshkruar dhe të studimeve të deritanishme. Paraqitja e arkitekturës së monumentit bëhet fillimisht në gjendjen që ofron studimi i drejtpërdrejtë i tij dhe vijon me sondazhet dhe gërmimet që u deshën për të përcaktuar fytyrën fillestare të monumentit dhe transformimet që ka pësuar ai në vitet 1793 dhe 1845. Si rezultat i një kërkimi të tillë të imët dhe në thellësi u arrit në përfundimin që kemi të bëjmë me një monument unikal, që për përmasat e tij jo të zakonshme, flet për nivelin si të ndërtuesve ashtu edhe të porositësve dhe që forma e tij e poshtme është një cungim i formës fillestare.

Kisha e manastirit të Mesopotamit me planin e saj me dy absida shqyrtohet në disertacion dhe në aspektin tipologjik për të shpjeguar shkaqet që prunë në një zgjidhje të veçantë. Krahasimi i teknikës së ndërtimit, i formave arkitekturale, i dyshemesë me tre «lule zambaku» shtyjnë në datimin e kishës si të shekullit të XIII dhe më ngushtë në kohën e sundimit në këto anë të Anzhuinëve. Me këtë mund të shpjegohet qënia e dy absidave, shenjë e funksionimit të kishës për dy kultet (ortodoks dhe katolik). Ky studim bëhet në lidhje me monumentet e Shqipërisë dhe ato të Epirit për të gjykuar për zgjidhjen e problemeve të shtruara.

Në disertacion trajtohet dhe zbukurimorja e kishës. Relievet në muret e jashtëm, mozaikët në dysheme, kapitelet që, të ndërtuar njëherësh me kishën, flasin për kërkesat e larta që ju patën vënë ndërtuesve dhe për nivelin e tyre. Analiza arkitekturale gjithashtu

FOTOCOPY

shërben për këtë. Evidentimi i hapësirës së brendshme karakteristike për arkitekturën bizantine dhe trajtimi i anës së jashtme me dekor keramoplastik ndihmon në zbërthimin e gjithanshëm të monumentit dhe në vendosjen në kohë të tij.

Pjesën e fundit e përbën studimi për restaurimin e monumentit. Ai paraprihet nga analiza strukturale, e nevojshme për të kuptuar shkaqet e dëmtimeve të pësuara në kohë që të mund të merren masa për zëvendësimin e përforcimeve që i janë bërë monumentit pa marrë në konsiderim vlerat e tij. Me idenë restauruese të paraqitur, pjesët e humbura të monumentit, ambienti i altarit me dy absida, portikët, quhen të humbur për gjithnjë, dhe rindërtimi i tyre do të përbënte falsifikim të monumentit. Ndërhyrjet e parapara synojnë t'i kthejnë monumentit hapësirën e brendshme të dikurshme, duke mënjanuar përforcimet e rënda të viteve 1793 e 1845 dhe duke hapur dyert e dritaret e dikurshme. Gërmimi i portikut ka ndihmuar për një vlerësim të monumentit në kuadrin e një ideje të tillë restauruese që ka për qëllim nxjerrjen në pah të vlerave shkencore e artistike të monumentit dhe transmetimin e tij brezave të ardhshëm.

Disertacioni i A. Baçes, me oponentë dcc. K. Miho dhe V. Bushati, me temë «Historia e arkitekturës ilire» trajton trashëgiminë tonë arkitektonike të shekujve V p.e.r. – VI e.s.

Në pjesën e hyrjes trajtohet vlera dhe rëndësia e kësaj trashëgimie si një nga shfaqjet më konkrete të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Ilirisë. Në të jepet dhe gjendja e studimeve të kësaj trashëgimie që hapin cilësor e pësoi në vitet e pushtetit popullor.

Në kapitullin e parë trajtohet arkitektura gjatë shekujve V-II p.e.s. që përkon me periudhën e lindjes dhe fuqizimit të shtetit skllavopronar ilir. Në të vihet në dukje se duke e pranuar fenomenin e huazimit dhe përvetësimit të arkitekturës së përparuar bashkëkohëse, faktori kryesor që e çoi përpara arkitekturën ilire, ishte faktori i brendshëm që krijoi bazën e duhur ekonomike dhe shpirtërore. Në këtë kapitull shqyrtohet arkitektura e fortifikimeve, të para në lidhje të ngushtë me fortifikimet pararendëse, të periudhës paraqytetare. Teknika e ndërtimit në të shihet e ndarë në tre grupe kryesore (me gurë të thyer, blloqe të latuar në vend, dhe blloqe të parapërgatitur). Kalimi ndërmjet këtyre grupeve shihet evolutiv e jo i prerë, që tregon se faktori i brendshëm i pasqyruar në zhvillimin teknik, ishte faktori kryesor në këtë proces.

Ndërtimet shoqërore të kësaj kohe, tempujt, shetitoret, teatrot, ndërtimet sepulkrale shihen si dëshmi të zhvillimit kultural të Ilirisë. Në shqyrtimin e tyre ndalohet në mënyrë të veçantë në elementet e veçantë specifikë të kësaj arkitekture, si në trajtimin planimetrik e volumor ashtu dhe në elementet e ndryshëm arkitektonikë. Përveç tyre në këtë kapitull trajtohen dhe banesat e ndërtimet inxhinierike.

Në kapitullin e dytë trajtohet arkitektura gjatë shekujve I p.e.s. – VI e.s. që përkon me kohën e pushtimit romak dhe bizantin të hershëm të Ilirisë. Në këtë kapitull influenca romake në arkitekturë shihet e kufizuar për shkak të nivelit të lartë që pati arritur arkitektura e periudhës pararendëse dhe ndjekjen nga Roma të linjave të arkitekturës helenistike, mesdhetare. Por në ndryshim prej kësaj, arritjet teknike janë të një niveli më të lartë në sajë të materialeve të rinj ndërtimorë.

Disertacionet u vlerësuan nga oponentët dhe diskutantët të cilët krahas anëve pozitive vunë në dukje disa të meta që vlejnë për përpunimin e mëtejshëm. Këshilli Shkencor i Fakultetit të Inxhinierisë i aprovoi njëzëri të tre disertacionet.

BOTIMI

DO NOT COPY

IVe SESSION SCIENTIFIQUE DE L'INSTITUT DES MONUMENTS DE CULTURE

Le 22 Décembre 1980, l'Institut des Monuments de Culture a tenu son IVe Session Scientifique. Cette session a eu lieu dans le cadre du 15e anniversaire de la création de cette institution importante, pour la recherche, l'étude et la restauration des valeurs architectonique créées par notre peuple au cours des siècles.

La thématique de la IVe Session contenait tous les domaines de l'activité de recherche et de restauration de l'Institut, pour la période à partir de la IIIe Session de l'année 1975. A part le rapport «Que le travail de recherche et des restaurations s'élève au niveau des exigences du temps.» tenu par le directeur de l'institut, Sotir Kosta, au cours de la session, on a aussi entendu 28 études, dont 7 préparées par des collaborateurs externes.

Le rapport traite des problèmes généraux du travail de recherche, d'étude et de restauration, en mettant l'accent sur le renforcement ultérieur de la physionomie de l'Institut, qui au cours de la période longue de cinq années (1975-1980), a enregistré des hausses qualitatives et quantitatives d'importance dans tous les domaines de son activité. Le rapport est imprégné de l'esprit des décisions du 8e Plénum du C.C. du P.T.A., qui a ouvert des horizons nouveaux dans l'approfondissement du travail d'étude.

Le rapport met en évidence les succès de l'Institut dans tous les domaines de son activité. Une grande importance y est consacrée au travail de recherche des monuments nouveaux. Il s'y met en relief que l'achèvement de la découverte et la mise sous protection des constructions paysannes en remplissant une tâche aussi difficile qu'importante, constitue un succès d'envergure.

Le travail d'étude et de restauration a aussi enregistré un élargissement et un grand approfondissement dans les différents genres de monuments, partant de ceux antiques jusqu'aux monuments relatifs aux événements de la Lutte de libération nationale.

Au cours de ce quinquennal, l'Institut a déployée une vaste activité de publications. Il faut tout d'abord mentionner la publication de la maquette de l'Histoire de l'Architecture Albanaise (de ses débuts jusqu'en 1921), qui constitue une contribution de grande valeur dans l'étude de notre héritage architectonique. La publication des «Monuments», transformée en revue en 1980, a paru régulièrement en deux numéros par an, en élevant toujours plus son niveau. Les publications scientifiques populaires, les albums «Gjirokastër, ville-musée» et «Kruje et ses monuments» constituent une bonne contribution dans la popularisation des monuments. La remise à la presse des deux monographies «La Ville-musée de Gjirokastër» et «5.000 ans de fortifications en Albanie», ouvrent la série de monographies, en marquant une augmentation de la gamme de publication.

